

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I FILOLOGJISË

MA ADELAJDA BAFTIU

KORPUSI I FOLUR I SHQIPES NË KOSOVË

PUNIM I DOKTORATËS

Prishtinë, 2023

UNIVERSITY OF PRISHTINA “HASAN PRISHTINA”
FACULTY OF PHILOLOGY

MA ADELAJDA BAFTIU

ALBANIAN SPOKEN CORPUS IN KOSOVO

DOCTORAL THESIS

Prishtina, 2023

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

MA ADELAJDA BAFTIU

KORPUSI I FOLUR I SHQIPES NË KOSOVË

PUNIM I DOKTORATËS

Mentorët:

Prof.dr.Bardh Rugova

Prof.dr. Arsim Ejupi

Prishtinë, 2023

FALËNDERIME

Së pari, falënderoj mentorin tim, prof.dr. Bardh Rugovën, për orientimin drejt kësaj teme shumëdimensionale. Udhëzimet, kritikrat dhe mbështetja e tij më kanë ndihmuar gjatë gjithë kohës së hulumtimit dhe shkrimit të këtij punimi.

Përveç mentorit, falënderoj edhe bashkëmentorin, prof.dr. Arsim Ejupin, për sugjerimet dhe për literaturën nga fusha e gjeografisë.

Falënderoj gjithashtu bashkëshortin dhe familjen time për mbështetjen e vazhdueshme në studimet e doktoratës. Pa mbështetjen e tyre nuk do të ishte e mundur të kryhej ky studim.

Falënderoj, po ashtu, edhe studentët e kolegët e Fakultetit të Filologjisë për ndihmën e ofruar gjatë mbledhjes së intervistave.

REZYME

Punimi i doktoratës “Korpusi i folur i shqipes në Kosovë” përbëhet nga gjashtë kapituj. Në Hyrje trajtohen objekti i studimit, metoda e studimit, hipoteza, rëndësia dhe detyrat e studimit. Objekt i këtij studimi është krijimi i një aparature shkencore për përpilimin e korpusit të folur në Kosovë. Ky studim i përket fushës së gjuhësisë së korpusit dhe është nisur duke u mbështetur në hipotezën se korpusi i mbledhur në këtë punim do të jetë përfaqësues i shqipes së folur në Kosovë dhe do të përfaqësojë varietetet rajonale dhe shoqërore të shqipes së folur në Kosovë. Këtë hipotezë jemi përpjekur ta vërtetojmë përmes metodës statistikore dhe përmes qasjeve kryesore që përdoren për krijimin e korpusit. Dy qasjet kryesore që përdoren në gjuhësinë e korpusit janë qasja e bazuar në korpus (*The corpus based approach*) dhe qasja e drejtuar nga korpusi (*The corpus driven approach*). Në këtë studim do të përdoret qasja e bazuar në korpus, sepse shembujt që dalin nga korpusi synohen të jenë p

ërgjithësues për shqipen e folur në Kosovë. Qëllimi i këtij studimi është mbledhja dhe përpilimi i korpusit të folur. Në hulumtim përfshihen të gjitha regjionet e Kosovës. Numri i intervistave në secilin qytet është vendosur duke u bazuar në numrin e banorëve të asaj komune dhe në numrin e fshatrave, p.sh. nëse Prishtina i ka 208.230 banorë dhe 42 fshatra, në këtë komunë janë mbledhur afërsisht 200 intervista, 1 intervistë në 1000 banorë, pra në secilin fshat së paku nga 2-3 intervista. Ky korpus synon t’i përmbajë 500.000 fjalë, pra 2.000 incizime/mostra, secila mostër përafërsisht të ketë 250 fjalë. Kohëzgjatja mesatare e incizimeve është 6 minuta.

Mbledhja e intervistave ka filluar në vitin 2019 dhe ka përfunduar në vitin 2021. Shumica e incizimeve janë kryer përmes intervistave joformale, me pyetje të përgatitura në varietetin e shqipes së folur në Kosovë, me qëllim që edhe folësit të përgjigjen në të njëjtin varietet. Mjedisi apo vendi ku janë kryer pjesa më e madhe e intervistave ka qenë nëpër shtëpi, shkolla, universitete, dyqane, sheshe, kafene, zyra etj. Pas intervistës, është plotësuar anketa nga subjektet me këto të dhëna: vendlindja, vendbanimi, mosha, gjinia, profesioni, shkollimi, gjuha amtare dhe gjuhët e huaja. Subjektet u përkasin profesioneve të ndryshme: mësues, tregtarë, ekonomistë, profesorë, kuzhinierë, inxhinierë, artistë, infermierë, sociologë, përkthyes, policë, etj. Te grupmosha e vjetër ka raste edhe pa shkollim fare, ndërsa te grupmosha e mesme dhe e re dalin tri nivelet e shkollimit:

i ulët, i mesëm dhe i lartë. Pëveç këtyre që u përmendën, subjektet janë marrë në mënyrë të barabartë nga gjinia femërore e mashkullore dhe janë afërsisht të moshës 18-90 vjeç.

Shumica e subjekteve si gjuhë amtare e kanë gjuhën shqipe, por flasin edhe gjuhë të huaja, si: anglishten, gjermanishten, frëngjishten, turqishten, spanjishten dhe serbishten. Secila anketë pastaj është ruajtur edhe në format elektronik me të njëjtin emërtim si incizimi, p.sh. *Prishtinë, 1, Prishtinë, 2* etj.

Në kapitullin e parë flitet për gjuhësinë e korpusit. Analiza e të dhënave gjuhësore mbështetur në koleksione tekstesh të folura ose të shkruara që ruhen në format elektronik njihet si gjuhësi korpusi. Disa autorë gjuhësinë e korpusit e konsiderojnë si disiplinë më vete, ndërse disa të tjerë thjesht si metodologji. Sipas McEnery dhe Wilson (1996), gjuhësia e korpusit nuk është fushë e gjuhësisë e krahasueshme me sintaksën, semantikën, sociolinguistikën, sepse këto disiplina koncentrohen në përshkrimin e disa aspekteve të përdorimit të gjuhës, ndërsa gjuhësia e korpusit është më shumë metodologji. Të njëjtin mendim ndan edhe Kennedy (1998), megjithëse thekson se gjuhësia e korpusit shkon përtej përdorimit të saj si burim provash në përshkrimin gjuhësor. Në anën tjetër, Leech (1992) e definon si një qasje të re kërkimore e filozofike ndaj temës. Gjuhësinë e korpusit si disiplinë e shohin autorë si Tognini-Bonelli (2001), ajo thekson se gjuhësia e korpusit shkon përtej rolit të pastër metodologjik. Edhe McEnery dhe Hardie (2012) në studime të mëvonshme thonë se gjuhësia e korpusit e ka potencialin për ta riorientuar tërë qasjen tonë për studimin e gjuhës dhe mund të rafinojë e të ripërcaktojë një varg teorish të gjuhës, pra është një fushë heterogjene. Baker (2010: 1) po ashtu thekson rëndësinë që ka pasur gjuhësia e korpusit në njëzet vitet e fundit si një qasje për studimin e gjuhës dhe pranimin si një mënyrë e rëndësishme dhe e dobishme e kërkimit gjuhësor. Pra, mund të pranohet se gjuhësia e korpusit shkon përtej rolit të saj si metodologji.

Kapitulli i parë ndahet në pesë nënkapituj: korpusi, historiku i gjuhësisë së korpusit, historiku i gjuhësisë së korpusit në gjuhën shqipe, llojet e korpusit dhe gjuhësia e korpusit dhe sociolinguistika. Në nënkapitullin e parë është trajtuar çfarë tipa tekstesh përbëjnë një korpus dhe cilat janë kriteret që një tekst të quhet korpus. Në nënkapitullin e dytë është trajtuar historiku i gjuhësisë së korpusit në përgjithësi. Korpusi i Brownit është korpusi i parë kompjuterik i përpiluar për qëllime gjuhësore nga Nelson Francis dhe Henry Kučera (1964). Në nënkapitullin e tretë është trajtuar historiku i gjuhësisë së korpusit në gjuhën shqipe. Në Kosovë, pas vitit 2000, jepen vërejtjet e para për nevojën e krijimit të një korpusi në gjuhën shqipe. Nënkapitulli i katërt përmbledh llojet

e korpusit: korpusi gjeneral, korpusi krahasues, korpusi i specializuar, korpusi historik, korpusi për qëllime të veçanta, korpusi shumëgjuhësor, korpusi i folur, korpusi i analizuar gramatikiht, korpusi multimedial, korpusi ueb dhe korpusi *lingua franca*. Në nënkapitullin e pestë trajtohet lidhja në mes të gjuhësisë së korpusit dhe sociolinguistikës.

Në kapitullin e dytë është folur për krijimin e korpusit. Për krijimin e korpusit është shumë e rëndësishme që pyetja kërkimore të jetë e qartë. Varësisht prej pyetjes kërkimore, përcaktohet edhe madhësia e korpusit, dizajni i korpusit dhe mbledhja e teksteve. Në këtë kapitull është folur edhe për mjetet për shënimin dhe transkriptimin e korpusit.

Në kapitullin e tretë është folur për varietetet e gjuhës shqipe. Ismajli (2019) thekson se historikiht brenda shqipes janë zhvilluar dy ndarje të mëdha dialektore: gegnishtja në veri dhe toskërishtja në jug të lumit Shkumbin. Toskërishtja flitet në jug nga Struga deri tek Adriatiku në nivel të Shkumbinit, duke e përfshirë edhe shqipen e folur në Greqi dhe në Itali, ndërsa gegnishtja flitet në veri, duke përfshirë edhe arbneshët e Zarës. Kjo ndarje vazhdon tutje në: gegnishten jugore, gegnishten qendrore, gegnishten veriperëndimore/verilindore, ndërsa në jug toskërishten veriore, labërishten dhe çamërishten dhe arvanitishten e arbërishten e Italisë. Ismajli (2019) më tutje vëren se izoglosat që shërbejnë për ndarje të këtilla nuk i përkasin të njëjtës periudhë historike. Ndarja e dialekteve dytësore vijon në: arvanitika, arbërishte dhe në arbnishte (Ismajli 2019: 347-348). Në këtë kapitull janë përmbledhur edhe veçori gjuhësore të të folmeve të ndryshme të Kosovës, si nga: e folmja e Deçanit, e folmja e Rugovës, e folmja e Hasit, e folmja e Karadakut, e folmja e Shalës së Bajgorës, e folmja e Gjakovës, e folmja e Kaçanikut, e folmja e Istogut, e folmja e Opojës, e folmja e Rahovecit etj. Në pjesën e fundit të këtij kapitulli është diskutuar edhe për pozitën dhe statusin e shqipes në vendet shqipfolëse dhe për kontaktet e shqipes.

Në kapitullin e katërt është përshkruar dizajni i korpusit të folur në Kosovë. Ky kapitull ndahet në gjashtë nënkapituj: dizajni i korpusit të folur nëpër komnat e Kosovës (vendlindja dhe vendbanimi), mosha e të anketuarve, gjinia e të anketuarve, shkollimi i të anketuarve, profesionet e të anketuarve dhe gjuhët e dyta që fliten në Kosovë. Në gjithë Kosovën janë realizuar 1800 intervista. Numri i ndryshëm i intervistave nëpër komuna del për shkak të madhësisë së ndryshme demografike, por edhe numrit të ndryshëm të vendbanimeve në kuadër të komunave. Në Komunën e Deçanit janë realizuar 114 intervista, në Komunën e Gjakovës 113, në Komunën e Glllogocit 18, në Komunën e Gjilanit 121, në Komunën e Dragashit 17, në Komunën e Istogut 25, në Komunën

e Kaçanikut 47, në Komunën e Klinës 10, në Komunën e Fushë Kosovës 20, në Komunën e Kamenicës 2, në Komunën e Mitrovicës 163, në Komunën e Lipjanit 114, në Komunën e Novobërdës 2, në Komunën e Obiliqit 20, në Komunën e Rahovecit 125, në Komunën e Pejës 131, në Komunën e Podujevës 133, në Komunën e Prishtinës 117, në Komunën e Prizrenit 35, në Komunën e Skënderajt 22, në Komunën e Shtimes 93, në Komunën e Shtërpçës 21, në Komunën e Suharekës 29, në Komunën e Ferizajt 117, në Komunën e Vitisë 8, në Komunën e Vushtrrisë 28, në Komunën e Malishevës 113, në Komunën e Junikut 7, në Komunën e Hanit të Elezit 24 dhe në Komunën e Graçanicës 11 intervista. Përveç vendlindjes, vendbanimit, shkollimit, profesionit, gjuhës amtare dhe gjuhës së dytë, të anketuarit të dhënat demografike kanë plotësuar edhe gjininë dhe moshën e tyre. Nga 1800 të anketuar, 787 subjekte i përkasin grupmoshës së re (18-39 vjeç), 442 grupmoshës së mesme (40-59 vjeç), 434 grupmoshës së vjetër (60-79 vjeç) dhe 137 subjekte nuk e kanë deklaruar moshën e tyre. Nga 1800 të anketuar, 844 subjekte janë të gjinisë femërore dhe 956 subjekte të gjinisë mashkullore. Shkollimi është ndarë në shkollimin e ulët, të mesëm dhe të lartë. Nga 1800 të anketuar, të pashkolluar janë 19 subjekte, 265 të anketuar e kanë shkollimin e ulët, 505 të anketuar e kanë shkollimin e mesëm, 626 subjekte e kanë shkollimin e lartë dhe 132 nuk e kanë deklaruar shkollimin e tyre. Nga 1800 të anketuar, 213 të anketuar janë të papunë, 232 janë studentë, 166 janë nxënës, 113 janë të pensionuar, 135 nuk e kanë deklaruar profesionin e tyre dhe 941 të anketuar kanë profesione, si: mësimdhënës, ekonomistë, juristë, inxhinierë, tregtarë, bujq, psikologë, punëtorë krahu etj. Gjuhët e dyta që fliten nëpër komunat e Kosovës janë: anglishtja, gjermanishtja, serbishtja, kroatishtja, sllovenishtja, rusishtja, boshnjakishtja, maqedonishtja, polonishtja, bullgarishtja, turqishtja, frëngjishtja, arabishtja, spanjishtja, italishtja, suedishtja, latinishtja, holandishtja, norvegjishtja, rumunishtja, hungarishtja, gjuha rome dhe greqishtja.

Në kapitullin e pestë jepen përfundimet nga rezultatet e hulumtimit.

Fjalët kyçe: Gjuhësi korpusi, korpus i folur, varietete të shqipes, komuna të Kosovës, sociolinguistikë

SUMMARY

The doctoral thesis "Albanian spoken corpus in Kosovo" consists of six chapters. The Introduction deals with the object of the study, the method of the study, the hypothesis, the importance and the tasks of the study. The object of this study is the compilation of the spoken corpus in Kosovo. This study belongs to the field of corpus linguistics and it started based on the hypothesis that the corpus collected in this paper will be representative of the spoken Albanian in Kosovo and will represent the regional varieties of spoken Albanian in Kosovo. We have tried to prove this hypothesis through the statistical method and through the main approaches used to create the corpus. The two main approaches used in corpus linguistics are *The corpus-based approach* and *The corpus-driven approach*. In this study, the corpus-based approach will be used, because the examples that emerge are intended to be general for spoken Albanian in Kosovo. The purpose of this study is to collect and compile the spoken corpus. All regions of Kosovo are included in the research. The number of interviews in each city is decided based on the number of inhabitants of that municipality and the number of villages, e.g. Prishtina has 208,230 inhabitants and 42 villages, in this municipality it was necessary to collect approximately 200 interviews, 1 interview per 1000 inhabitants, so in each village at least 2-3 interviews. This corpus aims to contain 500,000 words, ie 2,000 recordings / samples, each sample approximately 250 words, with a duration of 6 minutes.

The collection of interviewees started in 2019 and ended in 2021. Most of the recordings were made through informal interviews, with questions prepared in the variety of spoken Albanian in Kosovo, in order for the speakers to answer in the same way. The environment or place where most of the interviews were conducted was in homes, schools, universities, shops, squares, cafes, offices, cars, etc. After the interview, the survey was completed by the subjects with the following data: place of birth, place of residence, age, gender, profession, education, mother tongue and foreign languages. Subjects belong to different professions: teachers, students, pupils, businessmen, economists, professors, cooks, engineers, artists, nurses, sociologists, translators, police officers, etc. In the old age group there are cases without education at all, while in the middle and young age group there are three levels of education: low, middle and high. In addition to those mentioned, the subjects were taken equally by females and males and are approximately aged 18-90 years. Most of the subjects have Albanian as their mother tongue, but they also speak English,

German, French, Turkish, Spanish and Serbian. Each survey was saved in electronic format with the same name as the recording, e.g. *Prishtina, 1, Prishtina, 2* etc.

The first chapter talks about corpus linguistics. The analysis of linguistic data based on collections of spoken or written texts that are stored in electronic format is known as corpus linguistics. Some authors consider corpus linguistics as a separate discipline, while others simply as a methodology. According to McEnery and Wilson (1996), corpus linguistics is not a field of linguistics comparable to syntax, semantics, sociolinguistics, because these disciplines concentrate on describing some aspects of language use, while corpus linguistics is more of a methodology. Kennedy (1998) shares the same opinion, although he emphasizes that corpus linguistics goes beyond its use as a source of evidence in linguistic description. While Leech (1992) defines it as a new research and philosophical approach to the subject. Authors such as Tognini-Bonelli (2001) see corpus linguistics as a discipline, she emphasizes that corpus linguistics goes beyond a pure methodological role. Even McEnery and Hardie (2012) in later studies say that corpus linguistics has the potential to reorient our entire approach to the study of language and can refine and redefine a range of theories of language, so it is a heterogeneous field. Baker (2010: 1) also emphasizes the importance that corpus linguistics has had in the last twenty years as an approach to the study of language and its acceptance as an important and useful way of linguistic research. So it can be acknowledged that corpus linguistics goes beyond its role as a methodology.

The first chapter is divided into five subchapters: the corpus, the history of corpus linguistics, the history of corpus linguistics in the Albanian language, types of corpus and corpus linguistics and sociolinguistics. In the first sub-chapter, what types of texts make up a corpus and what are the criteria for a text to be called a corpus are discussed. In the second sub-chapter, the history of corpus linguistics in general is discussed. Brown's corpus is the first computerized corpus compiled for linguistic purposes by Nelson Francis and Henry Kučera (1964). In the third sub-chapter, the history of corpus linguistics in the Albanian language is discussed. In Kosovo, after the year 2000, the first remarks were made about the need to create a corpus in the Albanian language. Subchapter fourth summarizes the types of corpus: general corpus, comparative corpus, specialized corpus, historical corpus, special purpose corpus, multilingual corpus, spoken corpus, grammatically analyzed corpus, multimedia corpus, web corpus and lingua franca corpus. The fifth subchapter deals with the connection between corpus linguistics and sociolinguistics.

The second chapter talks about the creation of the corpus. For the creation of the corpus it is very important that the research question is clear. Depending on the research question, the size of the corpus, the design of the corpus and the collection of texts are also determined. This chapter also talks about the tools for annotating and transcribing the corpus.

The third chapter talks about the varieties of the Albanian language. Ismajli (2019) points out that historically two major dialectal divisions have developed within Albanian:Gheg in the north and Tosk in the south of the Shkumbin River. Tosk is spoken in the south from Struga to the Adriatic at the level of Shkumbin, including the Albanian spoken in Greece and Italy, while Gheg is spoken in the north, including the Albanians of Zara. This division continues further into: southern Gheg, central Gheg, northwest/northeast Gheg, while in the south the northern Tosk, the lab variety and the *çamë* variety and the Arvanitika and Arberishte of Italy. Ismajli (2019) further notes that the isoglosses that serve for such divisions do not belong to the same historical period. The secondary dialects are divided into: Arvanitika, Arberishte and Arbënishte (Ismajli 2019: 347-348). In this chapter, the linguistic features of the various dialects of Kosovo are summarized, such as from: the variety of Deçani, the variety of Rugova, the variety of Has, the variety of Karadak, the variety of Shala e Bajgora, the variety of Gjakova, the variety of Kaçanik, the variety of Istog, the variety of Opoja, the variety of Rahovec, etc. The last part of this chapter also discusses the position and status of Albanian in Albanian-speaking countries and the contacts of Albanian.

In the fourth chapter, the design of the corpus spoken in Kosovo is described. 1800 interviews were conducted throughout Kosovo. In the fourth chapter is the design of the corpus spoken in Kosovo. This chapter is divided into six sub-chapters: the design of the corpus spoken in the municipalities of Kosovo, the age of the respondents, the gender of the respondents, the education of the respondents, the profession of the respondents and the second languages spoken in Kosovo. The different number of interviews in the municipalities is due to the different demographic size, but also the different number of settlements within the municipalities. In the municipality of Deçan, 114 interviewees were conducted, in the municipality of Gjakova 113, in the municipality of Gllugoci 18, in the municipality of Gjilan 121, in the municipality of Gragashi 17, in the municipality of Istog 25, in the municipality of Kaçanik 47, in the municipality of Klina 10, in the municipality of Fushë Kosova 20, in the municipality of Kamenica 2, in the municipality of Mitrovica 163, in the municipality of Lipjan 114, in the municipality of Novobërda 2, in the municipality of Obiliq 20, in the municipality of Rahovec 125, in the municipality of Peja 131, in

the municipality of Podujeva 133, in the municipality of Pristina 117, in the municipality of Prizren 35, in the municipality of Skenderaj 22, in the municipality of Shtime 93, in the municipality of Shtërpce 21, in the municipality of Suhareka 29, in the municipality of Ferizaj 117, in the municipality of Vitia 8, in the municipality of Vushtrri 28, in the municipality of Malisheva 113, in the municipality of Junik 7, in the municipality of Han i Elez 24 and in the municipality of Graçanica 11 interviews. In addition to the place of birth, place of residence, education, profession, mother tongue and second language, the respondents in the demographic data have also filled in their gender and age. Out of 1800 respondents, 787 subjects belong to the young age group (18-39 years), 442 to the middle age group (40-59 years), 434 to the old age group (60-79 years) and 137 subjects did not declare their age. Out of 1800 respondents, 844 subjects are female and 956 subjects are male. Education is divided into primary, secondary and tertiary education. Of the 1800 respondents, 19 subjects are uneducated, 265 respondents have low education, 505 respondents have secondary education, 626 subjects have high education and 132 have not declared their education. Out of 1800 respondents, 213 respondents are unemployed, 232 are students, 166 are students, 113 are retired, 135 have not declared their profession and 941 respondents have professions such as: teachers, economists, lawyers, engineers, merchants, farmers, psychologists, manual workers, etc. The second languages spoken in the municipalities of Kosovo are: English, German, Serbian, Croatian, Slovenian, Russian, Bosnian, Macedonian, Polish, Bulgarian, Turkish, French, Arabic, Spanish, Italian, Swedish, Latin, Dutch, Norwegian, Romanian, Hungarian, Romani and Greek.

In the fifth chapter, the conclusions from the research results are given.

Key words: Corpus linguistics, spoken corpus, varieties of Albanian, municipalities of Kosovo, sociolinguistics

PËRMBAJTJA

0. HYRJE.....	19
0.1. Objekti i studimit	21
0.2. Rëndësia e studimit.....	22
0.3. Qëllimi dhe detyrat e studimit.....	23
0.4. Metoda e studimit	24
1. GJUHËSIA E KORPUSIT.....	26
1.1. Korpusi	29
1.2. Historiku i gjuhësisë së korpusit	31
1.3. Historiku i gjuhësisë së korpusit në gjuhën shqipe.....	35
1.4. Llojet e korpusit	37
1.5. Korpusi gjeneral.....	38
1.6. Korpusi krahasues.....	39
1.7. Korpusi i specializuar	40
1.8. Korpusi historik.....	42
1.9. Korpusi për qëllime të veçanta.....	43
1.10. Korpusi shumëgjuhësor	45
1.11. Korpusi i folur	46
1.12. Korpusi i analizuar gramatikisht.....	47
1.13. Korpuset multimediale	48
1.14. Uebi si korpus.....	48
1.15. Korpusi <i>Lingua franca</i>	48
1.16. Gjuhësia e korpusit dhe sociolinguistika	49

2. KRIJIMI I KORPUSIT.....	54
2.1. Përfaqësimi dhe madhësia e korpusit	55
2.2. Dizajni i korpusit.....	58
2.3. Mbledhja e teksteve	61
2.4. Shënimi i korpusit	63
2.5. Mjetet për shënimin dhe transkriptimin e korpusit.....	66
3. VARIETETET E GJUHËS SHQIPE	75
3.1. E folmja e Deçanit	80
3.2. E folmja e Rugovës.....	83
3.3. E folmja e Hasit.....	89
3.4. E folmja e Karadakut.....	92
3.5. E folmja e Shalës së Bajgorës	97
3.6. E folmja e Gjakovës	103
3.7. E folmja e Kaçanikut	Error! Bookmark not defined.
3.8. E folmja e Istogut.....	107
3.9. E folmja e Opojës.....	108
3.10. E folmja e Rahovecit	108
4. POZITA DHE STATUSI I SHQIPES NË VENDET SHQIPFOLËSE	109
5. DIZAJNI I KORPUSIT TË FOLUR NË KOSOVË.....	115
5.1.1. Korpusi i folur në Komunën e Deçanit	118
5.1.2. Korpusi i folur në Komunën e Gjakovës	119
5.1.3. Korpusi i folur në Komunën e Drenasit.....	121
5.1.4. Korpusi i folur në Komunën e Dragashit.....	123
5.1.5. Korpusi i folur në Komunën e Istogut	124
5.1.6. Korpusi i folur në Komunën e Mitrovicës.....	126

5.1.7. Korpusi i folur në Komunën e Pejës	127
5.1.8. Korpusi i folur në Komunën e Prishtinës	130
5.1.9. Korpusi i folur në Komunën e Prizrenit.....	132
5.1.10. Korpusi i folur në Komunën e Gjilanit	134
5.1.11. Korpusi i folur në Komunën e Fushë Kosovës	136
5.1.12. Korpusi i folur në Komunën e Kamenicës	137
5.1.13. Korpusi i folur në Komunën e Novobërdës.....	139
5.1.14. Korpusi i folur në Komunën e Obiliqit	140
5.1.15. Korpusi i folur në Komunën e Skënderajt	141
5.1.16. Korpusi i folur në Komunën e Shtërpçës.....	142
5.1.17. Korpusi i folur në Komunën e Suharekës.....	143
5.1.18. Korpusi i folur në Komunën e Vitisë	145
5.1.19. Korpusi i folur në Komunën e Vushtrrisë	146
5.1.20. Korpusi i folur në Komunën e Hanit të Elezit	148
5.1.21. Korpusi i folur në Komunën e Graçanicës	149
5.1.22. Korpusi i folur në Komunën e Junikut.....	150
5.1. 23. Korpusi i folur në Komunën e Lipjanit.....	150
5.1.24. Korpusi i folur në Komunën e Shtimes.....	152
5.1.25. Korpusi i folur në Komunën e Ferizajt	154
5.1.26. Korpusi i folur në Komunën e Kaçanikut.....	155
5.1.27. Korpusi i folur në Komunën e Malishevës.....	157
5.1.28. Korpusi i folur në Komunën e Podujevës.....	158
5.1.29. Korpusi i folur në Komunën e Rahovecit.....	161
5.2. Moshë e të anketuarve	162
5.3. Gjinia e të anketuarve.....	164

5.4. Shkollimi i të anketuarve	166
5.5. Profesionet e të anketuarve	167
5.6. Gjuhët e dyta që fliten në Kosovë.....	188
5.6.1. Gjuha angleze si gjuhë e dytë	190
5.6.2. Gjuha serbe si gjuhë e dytë	192
5.6.3. Gjuha gjermane si gjuhë e dytë	193
5.6.4. Gjuha turke si gjuhë e dytë.....	194
5.6.5. Gjuha frënge si gjuhë e dytë	195
5.6.6. Gjuha boshnjake si gjuhë e dytë.....	196
5.6.7. Gjuha maqedone si gjuhë e dytë.....	197
5.6.8. Gjuha spanjolle si gjuhë e dytë.....	198
6. PËRFUNDIME	202
BIBLIOGRAFIA.....	206
TREGUESI I EMRAVE	210

SHKURTESA

ACE- Korpusi i anglishtes australiane (*Australian Corpus of English*)

AHI – Korpusi i ndërmjetëm i trashëgimisë amerikane (*American Heritage Intermediate Corpus*)

AICo – Korpusi i shqipes - i folur dhe i shkruar (*Albanian [text and speech] Corpus*)

ARCHER - Korpusi përfaqësues i regjistrave historikë anglezë (*A Representative Corpus of Historical English Registers*)

BASE- Anglishtja britanike akademike e folur (*The British Academic Spoken English*)

BNC - Korpusi nacional britanik (*British National Corpus*)

CANCODE - Korpusi i diskursit i Kembrixhit dhe i Notinghamit në anglisht (*The Cambridge and Nottingham Corpus of Discourse in English*)

CCL- Gjuhësia kompjuterike e korpusit (*Computational corpus linguistics*)

CHYLDES - Gjuha e fëmijëve e sistemit të shkëmbimit të të dhënave (*The Child Language of Data Exchange System*)

COHA- Korpusi i anglishtes amerikane historike (*Corpus of Historical American English*)

DCPSE – Korpusi diakronik i anglishtes amerikane të folur (*Diachronic Corpus of Spoken English*)

ECI/MCI- Iniciativa Europiane e Korpusit për Korpusin Multilingual (*European Corpus Initiative Multilingual Corpus*)

ELFA- Anglishtja si *lingua franca* në mjedisin akademik (*English as Lingua Franca in Academic Settings*)

ELISA – Korpusi i intervistave i gjuhës angleze si aplikim i gjuhës së dytë (*English Language Interview Corpus as Second-Language Application*)

ELS – Korpusi për studime leksikore (*English Lexical Studies*)

ICE- Korpusi internacional i anglishtes (*International English Corpus*)

ICLE- Korpusi ndërkombëtar i nxënësve të anglishtes (*International Corpus of Learner's English*)

LDOCE - Fjalori Longman i anglishtes bashkëkohore (*Longman Dictionary of Contemporary English*)

LINDSEI - Baza e të dhënave ndërkombëtare e Louvainit e gjuhës angleze të folur (*Louvain International Database of Spoken English Interlanguage*)

LLC – Korpusi London Lund (*London Lund Corpus*)

LOB – Korpusi Lancaster-Oslo/Bergen (*Lancaster-Oslo/Bergen Corpus*)

MICASE- Korpusi miçigan i anglishtes akademike të folur (*Michigan Corpus of Academic Spoken English*)

OEC- Korpusi i anglishtes së Oksfordit (*Oxford English Corpus*)

OED – Fjalori anglez i Oksfordit (*Oxford English Dictionary*)

POW - Politekniku i korpusit të Wellsit (*The Polytechnic of Wales Corpus*)

RAT - Korpusi i të lexuarit të tekstit akademik (*Reading Academic Text corpus*)

SBCSAE- Korpusi Santa Barbara i anglishtes amerikane të folur (*Santa Barbara Corpus of Spoken American English*)

SCoRe – Korpusi i Singaporit i studimit në arsim (*Singapore Corpus of Research in Education*)

SCOTS - Korpusi skocez i teksteve dhe i gjuhës së folur (*Scottish Corpus of Texts and Speech*)

SEU – Hulumtimi i përdorimit të anglishtes (*Survey of English Usage*)

SPACE – Korpusi i anglishtes akademike të specializuar dhe popullore (*Chemnitz Corpus of Specialized and Popular Academic English*)

VOICE – Viena- Korpusi internacional anglez i Oksfordit (*Viena –Oxford International Corpus of English*)

0. HYRJE

Kosova ndodhet në Evropën Juglindore, përkatësisht në Gadishullin Ballkanik. Në veri e lindje kufizohet me Serbinë, në juglindje me Maqedoninë e Veriut, në jugperëndim me Shqipërinë dhe në perëndim me Malin e Zi. Popullsia që jeton në Kosovë është me shumicë shqiptare, por jetojnë edhe bashkësi etnike të tjera. Sipas të dhënave të Entit Statistikor të Kosovës, 2009, popullsia e Kosovës përbëhet kryesisht nga bashkësia etnike shqiptare, që formon 88-92 për qind të banorëve; shqiptarët përbëjnë 88% të popullsisë, serbët janë bashkësia e dytë me 5.3%, të përcjellë nga turqit, boshnjakët, romët, ashkalinjtë, egjiptasit dhe goranët. Ka një sipërfaqe prej 10.880 km² dhe popullsi prej 1.9 milionë banorësh. Kosova i ka 38 komuna me 1.469 vendbanime.

Gjuhë zyrtare në Kosovë janë shqipja dhe serbishtja. Pas luftës së viteve 1998-99 dhe çlirimit të Kosovës, si gjuhë me status zyrtar kanë funksionuar anglishtja, shqipja dhe serbishtja. Kushtetuta e Republikës së Kosovës u garanton shqipes dhe serbishtes statusin e gjuhës zyrtare, ndërsa statusin e gjuhës së minoriteteve gjuhës boshnjake, turke dhe rome. Në Maqedoni gjuha shqipe e ka statusin e gjuhës zyrtare në bashkësitë ku folësit e shqipes përbëjnë 20% të popullatës, në Malin e Zi dhe në Luginën e Preshevës shqipja e ka statusin e gjuhës minoritare, në Italinë e Jugut statusin e gjuhës së grupit etnik sipas Kartës Europiane të Gjuhëve Minoritare, në Greqi dhe në Turqi statusin e gjuhës pa status, njëjtë si në pjesët e tjera të diasporës (Ismajli 2019: 323). Në tërësi, popullata shqiptare e sotme në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni dhe në Mal të Zi, sipas prejardhjes fetare, ndahet në: 80% myslimanë, 12% ortodoksë dhe 8 % katolikë. Përpjesëtimi fetar i shqiptarëve në Kosovë është në përgjithësi 95 % shqiptarë myslimanë dhe 5% shqiptarë katolikë (Malcolm 2011: 49).

Shqipja sot flitet në Kosovë, në Shqipëri, në Maqedoni, në Mal të Zi, në Luginë të Preshevës, në Greqi, në Itali, në Zvicër, në Austri, në Gjermani, në Skandinavi, në Amerikë, në Turqi, etj. Ajo përbën një degë më vete në rrethin e gjuhëve indoeuropiane. Tekstet e para të shkruara në gjuhën shqipe i përkasin shek. XV. Zhvillimet brenda shqipes janë bërë historikisht ndërmjet dy dialekteve kryesore: gegnishtes në veri dhe toskërishtes në jug të lumit Shkumbin. Këto dialekte ndahen tutje në veri *gegnishtja jugore*, *gegnishtja qendore*, *gegnishtja veriperëndimore/verilindore*; në jug –*toskërishtja veriore*, *labërishtja* dhe *çamërishtja* dhe më tej *arvanishtja* dhe *arbërishtja* (Ismajli 2019: 346-348). Gjuha letrare e njësuar e shqipes është

mbështetur në variantin e toskërishtes me disa elemente nga gegnishtja në Kongresin e Drejtshkrimit, në vitin 1972.

Vendet ku flitet toskërishtja janë: në Greqi, të folmet lokale të Çamërisë deri te Preveza dhe në Maqedoni në anën e Prespës deri te Manastiri; ndërsa gegnishtja flitet në Kosovë, Mal të Zi, në anën e Ulqinit, Krajës, Vranjës, Tuzit, Malësisë së Podgoricës, Plavës, në Preshevë, në Bujanoc, në Medvegjë dhe në Maqedoni, në anët e Strugës, Ohrit, Dibrës, Kërçovës, Prilepit, Tetovës, Gostivarit, Shkupit, Kumanovës (Gjinari 2003: 151, Beci, cit. sipas Ismajli 2019: 351). Sa u përket migrimëve të shek. XV-XVI (arbneshët e Italisë dhe të Greqisë) dhe të shek. XVIII (arbneshët e Zarës), vetëm e folmja e Zarës ka dalë nga dialekti verior (Kraja), kurse dy të parat i përkasin të folmes së toskërishtes.

Dallimet ndërmjet dy dialekteve kryesore të shqipes prekin sistemin fonetik, gramatikor dhe fushën e leksikut. Ismajli (2019: 349-350) jep të përmbledhura dallimet më të rëndësishme strukturore midis dialekteve të shqipes: gegnishtja ka zanore funksionalisht të gjata dhe të shkurtra: *plāk-plāk*, toskërishtja nuk e bën dallimin ndërmjet zanoreve të gjata dhe të shkurtra; gegnishtja ka zanore hundore: *ã, û*, toskërishtja nuk ka; zanores hundore të gegnishtes *ã* i përgjigjet në toskërishte zanorja *ë*; gegnishtja ka togun *ua/u*, toskërishtja *ua*; gegnishtja ka *ī*, toskërishtja *ye, ie*; gegnishtja ka grupin nistor *vo-*, toskërishtja *va-*; gegnishtja ka ndërzanoren *-n-*, toskërishtja e bën *-r-*; gegnishtja e ka paskajoren, *me punue*, toskërishtja përdor lidhoren në vend të paskajores; gegnishtja e ka të ardhmen e domosdosë *kam me punue*, toskërishtja *do të punoj*; grupet *mb, nd, ng* në gegnishte shpesh realizohen si *m, n, ŋ*, ndërsa në toskërishte shpesh ruhen grupet e tilla, në gegnishte *nj* fundore apo në mes të fjalës kalon në *j*, kurse në toskërishte *nj* shpesh ruhet; në gegnishte ruhen bashkëtingëlloret fundore të zëshme, ndërsa në toskërishte shurdhohen; vendi i theksit në huazimet turke në gegnishte përshtatet sipas modelit të shqipes, ndërsa në toskërishte ruhet vendi i theksit; huazimet moderne në gegnishte nuk e ruajnë theksin original, ndërsa në toskërishte e ruajnë atë.

Për shkak se shqipja është e shpërndarë në disa shtete të ndryshme, herë si gjuhë e parë, herë si gjuhë e dytë, edhe ndikimet gjuhësore vijnë nga gjuhë të ndryshme. P.sh. në Shqipëri folësit kanë kontakte më të shpeshta me italishten e greqishten, në Mal të Zi shqipfolësit janë në kontakt me malazesishten, folësit e Luginës së Preshevës dhe një pjesë e Kosovës me serbishten; shqipfolësit e Maqedonisë me maqedonishten, ndërkohë që në Shqipëri mungojnë kontaktet me

këto gjuhë; pastaj janë kontaktet me turqishten, me gjermanishten te disa breza në Kosovë, në Maqedoni, në Preshevë, në Mal të Zi, të cilat po ashtu mungojnë në Shqipëri. Në Kosovë ka përhapje të anglishtes e gjermanishtes, ndërsa në Shqipëri të italishtes (Ismajli 2019: 41).

0.1.Objekti i studimit

Ky studim i përket fushës së gjuhësisë së korpusit. Gjuhësia e korpusit merret me analizën e të dhënave gjuhësore mbështetur në koleksione tekstesh të folura ose të shkruara që ruhen në format elektronik. Në këtë fushë të gjuhësisë, të dhënat kuantitative përdoren për ta bërë përshkrimin gjuhësor. Objekt i këtij studimi është krijimi i një aparature shkencore për përpilimin e korpusit të folur në Kosovë. Korpusi përbën një koleksion tekstesh, megjithëse çfarëdo teksti nuk përbën korpus. Tekstet në korpus duhet të jenë të strukturuar dhe të jenë përfaqësuese të gjuhës apo të ndonjë varieteti të gjuhës, varësisht prej qëllimit që është hartuar. Edhe përbërja e korpuseve nuk del e njëjlojshme, duke filluar prej atyre që pretendojnë të përfaqësojnë një gjuhë apo varietet të tërë, deri te korpuset që mund të përbëhen madje edhe nga veprat e një autori të vetëm. Korpuset mund të përmbajnë tekste të tëra ose koleksione të teksteve të tëra, koleksion citimesh, fjalor elektronik, madje edhe nga një arkivë e teksteve të pastrukturuar (Kennedy 1998: 3), nga artikujt e gazetës të shkruara në ndonjë vit të caktuar (Baker 2010: 7), etj. Për më tepër, korpuset e tilla, si rasti me artikujt e gazetave, e kanë potencialin që të jenë tërësisht reprezentative, sepse mund të gjendet çdo artikull i gazetës nga një periudhë kohore dhe të përfshihet në korpus, kështu e gjithë popullata gjendet në këtë korpus. Bazuar në qëllimin për të cilin përpilohen dhe çfarë përfaqësojnë, korpuset janë disa llojesh: *korpusi gjeneral, korpusi i specializuar, korpusi sinkronik, korpusi diakronik, korpusi monitor, korpusi shumëgjuhësor, korpusi i folur, korpusi për krahasim*, etj.

Studimet në fushën e gjuhësisë së korpusit në gjuhën shqipe kanë nisur vonë, në krahasim me gjuhët me të cilat shqipja është në kontakt. Pas vitit 2000 jepen vërejtjet e para për nevojën e krijimit të një korpusi në gjuhën shqipe. Korpusi sigurisht është mbledhur për nevoja të veçanta të studiusve të ndryshëm, por jo si një korpus gjithëpërfshirës që do të mund ta shfrytëzonin të gjithë ata që merren më gjuhësi apo me ndonjë fushë tjetër. Edhe përpilimi i këtij korpusi nuk e ka këtë synim, që të jetë përfaqësues i gjithë shqipes, por vetëm i shqipes së folur në Kosovë.

0.2.Rëndësia e studimit

Ndërmarrjet për përpilimin e korpusit të folur, në krahasim me korpusin e shkruar, në përgjithësi në çdo gjuhë kanë tendecë të jenë më të pakta në numër. Kjo ndodh për shkak se te korpusi i folur mund të shfaqen vështirësi, si grumbullimi i regjistrimeve, çështjet etike, anonimiteti, ndërlikimet gjatë transkriptimit, të cilat mungojnë në korpusin e shkruar.

Në gjuhën shqipe pas vitit 2000 jepen vërejtjet e para për nevojën e krijimit të një korpusi në gjuhën shqipe. Deri në këtë periudhë ekzistonte vetëm një vepër e Kadaresë, romani *Koncert në fund të dimrit*, botuar në ECI/MCI (*European Corpus Initiative Multilingual Corpus I*) në vitin 1994, që mund të përdorej si një korpus i veçantë në gjuhën shqipe (Kabashi 2009: 98). Korpusi i parë me një milion fjalë në gjuhën shqipe është korpusi i përpiluar nga N.Caka dhe A. Caka në vitin 2006. Është përpiluar sipas metodologjisë së korpusit të Brownit të vitit 1964. Nga fundi i vitit 2011 filloi krijimi i Korpusit Nacional të Shqipes nga specialistët e Shën Peterburgut dhe të Moskës. Në Seminarin XXXVI Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare Kabashi (2017) paraqet korpusin AICo (Albanian [text and speech] Corpus) me njëqind milionë fjalë. Ky korpus ka filluar të përpilohet në vitin 1997 dhe vazhdon ende të përpunohet.

Pra, me qenë se deri në këtë periudhë shqipja nuk e ka një korpus publik gjithëpërfshirës në asnjërin vend ku flitet shqipja, përpilimi i korpusit të folur në Kosovë është një hap shumë i rëndësishëm. Korpusi mund të përdoret për qëllime të ndryshme. Mund të analizohet dhe të krahasohet me korpuse të tjera ose pjesë të korpuseve, për ta studiuar variacionin gjuhësor. Më e rëndësishmja, mund të studiohet distribucioni për të treguar se sa shpesh shfaqet një tipar fonologjik, leksikor, gramatikor, diskursiv apo pragmatik, gjithashtu ku shfaqen ato (Kennedy 1998:4).

Studimi është mbështetur në hipotezën se korpusi i mbledhur në këtë punim do të jetë përfaqësues i shqipes së folur në Kosovë dhe do të përfaqësojë varietetet rajonale dhe shoqërore të shqipes së folur në Kosovë. Këtë hipotezë jemi përpjekur ta vërtetojmë përmes metodës statistikore dhe përmes qasjeve kryesore që përdoren për krijimin e korpusit.

Ky korpus mund të jetë i dobishëm për shumë fusha të gjuhësisë, por më së shumti do të përfitonte sociolinguistika, sepse përmban informacione për subjektet, të cilat do të ishin të

dobishme për sociolinguistikën. Baker (2010: 8-9) thekson se gjuhësia e korpusit dhe sociolinguistika ndajnë një numër fundamental të parimeve të analizës gjuhësore: të dyja qasjet përfshijnë mbledhjen dhe analizën e të dhënave gjuhësore që shfaqen natyrshëm, të dyja theksojnë përdorimin e gjuhës ose kontekstin shoqëror; të dyja përdorin metodologji kuantitative, në mënyrë që të kryhen krahasimet e popullatave të ndryshme, të cilat mund të lehtësohen me teste statistikore; të dyja qasjet shpesh përdorin teknikën e mostrave, të dyja shqyrtojnë variacionin dhe ndryshimin, të dyja konsiderojnë një gamë të gjerë të karakteristikave gjuhësore (fonetikë, morfologji, leksik, gramatikë, diskurs dhe pragmatikë) dhe të dyja tentojnë të provojnë shpjegimin, kur është i mundshëm, për gjetjet që prodhon hulumtimi i tyre.

0.3.Qëllimi dhe detyrat e studimit

Duke u mbështetur në objektin e studimit, ky punim ka disa synime dhe detyra për t'i realizuar. Ky studim nënkupton grumbullimin e intervistave, që do të shërbenin si material për krijimin e korpusit të folur në Kosovë. Për këtë qëllim, është e nevojshme të merren intervista në secilin rajon të Kosovës, së paku nga 1-2 intervista në secilin fshat të secilës komunë të Kosovës.

Si detyrë tjetër e këtij studimi është edhe ndjekja e shtresëzimit social të korpusit gjuhësor. Pra, meqë të dhënat për vendlindjen dhe vendbanimin, nuk janë të mjaftueshme, janë marrë edhe të dhëna të tjera, si: gjinia, shkollimi, profesioni, gjuha amtare, njohja e gjuhëve të huaja etj.

Detyra e radhës, është transkriptimi i intervistave me programin *Partitur Editor*. Sistemi i transkriptimit përmban dy lloje transkriptimesh, duke filluar nga paraqitja themelore ortografike deri në transkriptime shumë të hollësishme, që përfshijnë informacione prozodike.

Së fundi, duke u bazuar në transkriptimet, nxirret numri i përgjithshëm i fjalëve dhe bëhet anotimi gramatikor për secilën fjalë që del në korpus.

0.4. Metoda e studimit

Dy qasjet kryesore që përdoren në gjuhësinë e korpusit janë qasja e bazuar në korpus dhe qasja e drejtuar nga korpusi. Tognini-Bonelli (2001: 65- 84) e bën këtë ndarje dhe thekson se korpusi mund të përdoret në disa mënyra që ta vërtetojë, ta ilustrojë apo ta ndërtojë një teori të gjuhës. Qasja e bazuar në korpus (*The corpus based approach*) i referohet metodologjisë që përfiton nga korpusi, kryesisht për t'i shpjeguar, për t'i testuar apo për t'i ilustruar teoritë dhe përshkrimet, që janë formuluar, përpara se të bëheshin të qasshëm korpuset e mëdha për studimin e gjuhës. Ndërsa, qasja e drejtuar nga korpusi (*The corpus driven approach*) e përdor korpusin për ta mbështetur argumentin gjuhësor ose për ta vërtetuar një qëndrim teorik. Kjo qasje e vazhdon analizën në një mënyrë më induktive, vetë korpusi është e dhënë dhe model, në të shënohen si mënyrë e të shprehurit rregullsitë dhe përjashtimet në gjuhë.

Në këtë studim do të përdoret qasja e bazuar në korpus, sepse shembujt që dalin nga korpusi synohen të jenë përfaqësues të shqipes së folur në Kosovë. Qëllimi i këtij studimi është mbledhja dhe përpilimi i korpusit të folur në Kosovë.

Fillimisht, përpara mbledhjes së intervistave, është kërkuar leja e subjekteve që të marrin pjesë në hulumtim dhe leja për publikimin e incizimeve të tyre, duke ua shpjeguar se do të integrohen në korpusin e folur të shqipes në Kosovë. Meqenëse korpusi synon të jetë përfaqësues i gjuhës së folur në Kosovë, në hulumtim do të përfshihen të gjitha regjionet e Kosovës. Komunitat të cilat janë përfshirë në hulumtim janë: Peja, Deçani, Gjakova, Gjiçani, Ferizaj, Mitrovica, Istogu, Kaçaniku, Lipjani, Obiliqi, Rahoveci, Podujeva, Shtimja, Shtërpca, Malisheva, Hani i Elezit, Graçanica, Prizreni, Prishtina, Drenasi, Dragashi, Fushë Kosova, Kamenica, Klina, Skënderaj, Suhareka, Vitia, Vushtrria, Juniku. Ndërsa komunitat që nuk janë përfshirë në hulumtim janë ato me shumicë nga bashkësi të tjera etnike, si: Mitrovica Veriore, Leposaviqi, Zubin Potoku, Ranillugu, Klokoti, Parteshi dhe Mamusha.

Ky korpus synon të ketë 500.000 fjalë, 2.000 incizime/mostra, secila mostër përafërsisht të ketë 250 fjalë. Kohëzgjatja mesatare e incizimeve është 6 minuta.

Numri i intervistave në secilin qytet është vendosur duke u bazuar në numrin e banorëve të asaj komune dhe në numrin e fshatrave, p.sh.: nëse Prishtina i ka 208.230 banorë dhe 42 fshatra,

në këtë komunë është dashur të mblidhen afërsisht 200 intervista, 1 intervistë në 1000 banorë, pra në secilin fshat së paku nga 2-3 intervista. Ndërsa te komunat me shumicë serbe nuk është marrë parasysh numri i përgjithshëm i banorëve, por janë marrë intervista vetëm në ato fshatra të banuara me shqiptarë, p.sh.: në Komunën e Graçanicës, nga dy fshatra të banuara me shqiptarë, janë marrë nga 5-6 intervista në secilin fshat.

Mbledhja e intervistave ka filluar në vitin 2019 dhe ka përfunduar në vitin 2021. Grumbullimi i tyre është bërë në periudha të ndryshme. Në fazën e parë, nëntor-dhjetor 2019, janë grumbulluar 161 intervista. Në fazën e dytë, janar-korrik 2020, janë grumbulluar 400 intervista dhe në fazën e tretë, korrik-dhjetor 2020, janë mbledhur 1239 intervista.

Korpusi përban vetëm tekste të folura joformale nga komentime për ngjarje të ndryshme, biseda brenda familjes, bisedë ndërmjet folësve që e njohin njëri-tjetrin dhe ndërmjet atyre që nuk e njohin fare njëri-tjetrin, biseda telefonike. Shumica e incizimeve janë kryer përmes intervistave joformale, me pyetje të përgatitura në varietetin e shqipes së folur në Kosovë, me qëllim që edhe folësit të përgjigjen në të njëjtin varietet. Në shumicën e incizimeve subjektet kanë rrëfyer ngjarje të rëndësishme të jetës së tyre, kanë treguar si e kalojnë një ditë të zakonshme pune dhe kanë folur për profesionet e tyre.

Mjedisi apo vendi ku janë kryer pjesa më e madhe e intervistave ka qenë nëpër shtëpi, shkolla, universitete, dyqane, sheshe, kafene, zyra, makina etj. Zakonisht, gjatë intervistave ka pasur edhe pjesëmarrës të tjerë, përveç atij që është intervistuar, qoftë familjar apo ndonjë person i panjohur. Mjetet që janë përdorur për incizimin e intervistave janë: diktafoni, telefoni *Samsung* dhe *Iphone*.

Pas intervistës, është plotësuar anketa nga subjektet me këto të dhëna: vendlindja, vendbanimi, mosha, gjinia, profesioni, shkollimi, gjuha amtare dhe gjuhët e huaja. Subjektet u përkasin profesioneve të ndryshme: mësues, tregtarë, ekonomistë, profesorë, kuzhinierë, inxhinierë, artistë, infermierë, sociologë, përkthyes, policë, juristë, futbollistë, taksistë, arkitektë, dizajnerë, rrobaqepës, psikologë, redaktorë, gjuhëtarë, historianë, gjeografë, kimistë, etj. Te grupmosha e vjetër ka raste edhe pa shkollim fare, ndërsa te grupmosha e mesme dhe e re dalin tri nivelet e shkollimit: i ulët, i mesëm dhe i lartë. Pëveç këtyre që u përmendën, subjektet janë marrë në mënyrë të barabartë nga gjinia femërore e mashkullore dhe janë afërsisht të moshës 18-90

vjeç. Shumica e subjekteve si gjuhë amtare e kanë gjuhën shqipe, por flasin edhe gjuhë të huaja, si: anglishten, gjermanishten, frëngjishten, turqishten, spanjishten, serbishten, etj.

Secila anketë pastaj është ruajtur edhe në format elektronik në *Word* me të njëjtin emërtim si incizimi, p.sh.: *Prishtinë, 1, Prishtinë, 2* etj.

I njëjti emërtim është vendosur edhe te transkriptimet. Transkriptimi i regjistrimeve është bërë me programin *Partitur Editor*. Sistemi i transkriptimit përmban dy lloje transkriptimesh, duke filluar nga paraqitja themelore ortografike deri në transkriptime shumë të hollësishme, që përfshijnë informacione prozodike. Disa prej rregullave të transkriptimit që janë përdorur janë: njësia segmentare përfundon me pauzë; parafrjalët, pjesëzat dhe rënia e tingullit janë shënuar me hapësirë; është dhënë shenja e pikësimit varësisht prej llojit të fjalisë: deklarative (.), pyetëse (?), thirrmore (!); fjali/fjalë të papërfunduara (...); përmirësim i fjalës (/); pauzë e shkurtër (·), pauzë deri në gjysmën e dytë të sekondës (··), pauzë rreth një sekondë (···), pauzë më shumë se një sekondë ((3s)); është shkruar “inc” te shprehjet e pakuptueshme, në qoftë se nuk është kuptuar asgjë dhe është shkruar supozimi nëse nuk ka qenë e sigurt se çfarë po dëgjohet (); komentet dhe veprimet joverbale (()). Deri në këtë fazë janë transkriptuar afro 200 incizime.

1. GJUHËSIA E KORPUSIT

Analiza e të dhënave gjuhësore mbështetur në koleksione tekstesh të folura ose të shkruara që ruhen në format elektronik ka çuar në zhvillimin e një studimi të ri, që njihet si gjuhësi korpusi. Pra, në këtë fushë të dhënat kuantitative përdoren për ta bërë përshkrimin gjuhësor.

Disa autorë gjuhësinë e korpusit e konsiderojnë si disiplinë më vete, ndërsa disa të tjerë thjesht si metodologji. Gjuhësia e korpusit (McEnery dhe Wilson 1996: 1) është studim i gjuhës bazuar në shembujt e përdorimit “realë” të saj. Sipas McEnery dhe Wilson, gjuhësia e korpusit nuk është fushë e gjuhësisë e krahasueshme me sintaksën, semantikën, sociolinguistikën, sepse këto disiplina koncentrohen në përshkrimin e disa aspekteve të përdorimit të gjuhës. Ndërsa, gjuhësia e korpusit është më shumë metodologji sesa një aspekt i gjuhës që kërkon shpjegim apo përshkrim.

Të njëjtin mendim ndan edhe Kennedy (1998: 7-11) kur thotë se gjuhësia e korpusit bazohet në grupe tekstesh si burim studimi dhe si burim të dhënash për përshkrimin dhe argumentimin gjuhësor. Ai shton se do të ishte keqkuptim të sugjerojmë se gjuhësia e korpusit është teori e gjuhës e njëjtë me teoritë e tjera, siç është gramatika transformativë, ose që është degë e re e ndarë e gjuhësisë. Megjithatë, thekson se gjuhësia e korpusit shkon përtej përdorimit të tij si burim provash në përshkrimin gjuhësor. Analizat në gjuhësinë e korpusit mund të kontribuojnë në fjalorë, lista fjalësh, gramatika përshkruese, studime krahasuese sinkronike dhe diakronike të varieteteve të folurit, në stilistikë, në pedagogji etj. Është e lehtë të studiohet distribucioni i fonemave, i fjalëve, pikësimi, morfemat, fjalët, kolokimet, shembujt e një klase fjalësh të caktuar, modele sintaksore ose struktura diskursi.

Në anën tjetër, Leech (1992: 106-107) gjuhësinë kompjuterike të korpusit (CCL) e definon jo vetëm një metodologji të re për studimin e gjuhës, por një qasje të re kërkimore e filozofike ndaj temës. Për Leech (ibid.) teknologjia merr një rol të rëndësishëm dhe e sheh si një mjet thelbësor për njohuri të reja dhe mënyra të reja të menduarit për gjuhën. Karakteristikat e gjuhësisë kompjuterike të korpusit në krahasim me fushat e tjera të gjuhësisë, sipas Leech, janë:

1. Fokusimi në performancën gjuhësore më shumë se në kompetencën gjuhësore;
2. Fokusimi në përshkrimin gjuhësor më shumë se në universalet gjuhësore;
3. Fokusimi në modelin kuantitativ dhe kualitativ;
4. Fokusimi në këndvështrimin empirik më shumë se në atë racionalist.

Autorë si Tognini-Bonelli (2001:1) gjuhësinë e korpusit e njohin si disiplinë, ajo thekson se gjuhësia e korpusit shkon përtej rolit të pastër metodologjik: *“Gjuhësia e korpusit është një ndërmarrje e re kërkimi dhe një qasje e re filozofike e kërkimit gjuhësor”*. Për ta argumentuar këtë, Tognini-Bonelli (2001: 47-49) dallon tri faza të korpusit kompjuterik në veprat gjuhësore. Në fazën e parë korpusi është parë si mjet që procesonte në kohë reale sasi të informacionit që vështirë se do të mund të paramendohej vite më parë. Sipas saj, ky është kontributi më impresionant i korpusit në hulumtimin gjuhësor. Në fazën e dytë, jo vetëm që është siguruar sasi e bollshme e të dhënave të reja, por natyra e tij ndikoi në sistemin metodologjik të kërkimit, duke e përshpejtuar, duke e sistemuar dhe duke bërë të aplikueshme në kohë reale gjithnjë e më shumë sasi të të dhënave. Në fazën e tretë, ajo që kishte filluar si përmirësim metodologjik rezultoi të ishte një

revolucion teorik dhe kualitativ, sepse ka ofruar njohuri mbi gjuhën që kanë lëkundur teori themelore të vendosura mirë në këtë fushë. Pra, sipas Tognini-Bonelli (2001), gjuhësia e korpusit është më shumë sesa një “bazë metodologjike” për hulumtim dhe është disiplinë më vete që kërkon domenin e saj.

Në një punim të mëvonshëm McEnery dhe Hardie (2012: 1) thonë se gjuhësia e korpusit merret me disa grupe tekstesh të lexueshme nga makineritë, të cilat vlerësohen si bazë e përshtatshme për të studiuar një grup specifik pyetjesh kërkimore. Për ta gjuhësia e korpusit ka potencialin për ta riorientuar tërë qasjen tonë për studimin e gjuhës dhe mund të rafinojë e të ripërcaktojë një varg teorish të gjuhës, pra është një fushë heterogjene.

Edhe Baker (2010: 1) thekson rëndësinë që ka pasur gjuhësia e korpusit në njëzet vitet e fundit si një qasje për studimin e gjuhës dhe pranimin si një mënyrë e rëndësishme dhe e dobishme e kërkimit gjuhësor. Ai (2010: 10-11) jep disa mite në lidhje me korpusin:

- 1. Gjuhësia e korpusit është veç një qasje kuantitative, e dobishme vetëm për identifikimin e modeleve të përgjithshme, por jo për analiza të thella kualitative.*
- 2. Gjuhëtarët e korpusit nuk i pranojnë llojet e tjera të informacionit, pra, sipas tyre, mund të merret shumë edhe nga një korpus.*
- 3. Përdoruesit nuk merren vetë me tekstet e korpusit.*
- 4. Gjuhësia e korpusit është një qasje puro naive, përdoruesit në të vërtetë nuk dinë çfarë të kërkojnë, e as nuk fillojnë me një teori.*
- 5. Kërkohet shumë pak kontribut njerëzor në gjuhësinë e korpusit.*
- 6. Kompjuteri mund të numërojë ose të identifikojë çdo gjë.*

Baker (2010: 10) për mitin e parë dhe të dytë thekson se janë gjysmë të vërtetë, sepse kërkimet e bazuara në korpus përdorin edhe teknikën kuantitative, edhe atë kualitative. Programet e korpusit mund t’i paraqesin të dhënat e konkordancës në mënyra të ndryshme, por nuk mund t’i interpretojnë ato, është gjithmonë detyra e studiuesit t’i interpretojë të dhënat. Pra, nuk duhet të konsiderohet gjuhësia e korpusit si lloji i vetëm i analizës që vlen të bëhet; përkundrazi, është një nga shumë dhe shpesh mund të përdoret në bashkëpunim me të tjerat. Ndërsa, sa i përket asaj se përdoruesit nuk merren vetë me tekstet e korpusit, shtohet se ata mund të njihen më ngushtë me

korpusin, qoftë duke e ndërtuar vetë atë, apo duke vazhduar takime të ngushta me pjesë të ndryshme të saj nëpërmjet analizave të konkordancës.

Sa i përket qasjes naive në korpus, Baker shton se derisa ne të gjithë jemi përdorues të gjuhës, kushdo që bën hulumtim gjuhësor ka gjasa të jetë tashmë i vetëdijshëm për teoritë gjuhësore ose kategoritë dhe i qaset korpusit me pyetje ose hipoteza specifike të testueshme. Ai shton se nuk mund të kërkojmë nga kompjuteri për ndonjë veçori gjuhësore dhe të marrim përgjigje të menjëhershme. Siç do të shihet vendimmarrja njerëzore është e përfshirë në pothuajse çdo fazë të hulumtimit të korpusit. Po ashtu, nuk është e vërtetë që kompjuteri mund të numërojë çdo gjë, disa modele janë shumë komplekse ose bazohen në rregulla të cilat nuk mund të kodohen lehtë si një algoritëm kërkimi. Për shembull, askush nuk ka gjetur një mënyrë për t'i thënë një kompjuteri t'i identifikojë saktë të gjitha metaforat në një korpus me 100 për qind efikasitet (Baker 2010: 11).

Duke e parë ndikimin që ka pasur gjuhësia e korpusit në përshkrimin gjuhësor, mund të pranohet se shkon përtej rolit të saj si metodologji.

1.1.Korpusi

Autorë të ndryshëm japin definicione të ndryshme për korpusin, si: *Korpusi është trupi i teksteve të shkruara dhe i transkriptimeve të të folurit që mund të shërbejë si bazë për analizë dhe përshkrim gjuhësor* (Kennedy1998); *Korpusi është “trupi” i gjuhës, ose më specifikisht, koleksion shumë i gjerë i gjuhës që shfaqet natyrshëm dhe ruhet në formë kompjuterike* (Baker 2010); *Korpusi është koleksion i teksteve të gjuhës që shfaqen natyrshëm, të zgjedhura për ta karakterizuar një gjendje ose varietet të gjuhës* (Sinclair 1991); *Korpusi mund të definohet si koleksion tekstesh që supozohet të jetë përfaqësues i një gjuhe të dhënë dhe që mund të përdoret për analiza gjuhësore* (Tognini- Bonelli 2001).

Duke u bazuar në këto definicioneve për korpusin, shihet që korpusi përbën një koleksion tekstesh. Megjithëse çfarëdo teksti nuk përbën korpus. Tekstet në korpus duhet të jenë të strukturuar dhe të jenë përfaqësuese të gjuhës apo të ndonjë varieteti të gjuhës, varësisht prej qëllimit që është hartuar, po ashtu duhet të ruhen në format elektronik. Sipas Kennedy (1998:3) kjo nuk është domosdoshmërisht kështu, sepse jo të gjitha korpuset që mund të përdoren për

hulumtim gjuhësor janë hartuar fillimisht për këtë qëllim dhe historikisht dihet që korpuset nuk janë ruajtur në formë elektronike.

Baker (2010: 6) thekson se arsyeja pse korpusi shpeshherë është i gjerë, është sepse supozohet të shërbejë si model përfaqësues i një varieteti të veçantë gjuhësor dhe këto sasi të mëdha të të dhënave na lejojnë të nxjerrim frekuencat dhe modelet gjuhësore, duke na treguar diçka për normën gjuhësore. Korpusi duhet të hartohet në mënyrë të kujdesshme, p.sh.: nëse duam të mbledhim çdo fjalë të korpusit të folur që është shqiptuar në një gjuhë të caktuar, kjo do të përfshinte balancimin e koleksionit, në mënyrë që të përmbajë modele të barabarta të të folurit të transkriptuar nga një popullatë e gjerë dhe duhet të merren parasysh shumë ndryshore, duke përfshirë moshën, gjininë, profesionin, regjionin gjeografik, nivelin e edukimit dhe gjuhën amtare të secilit folës. Gjithashtu, duhet të sigurohemi se është përfshirë sasi e njëjtë e të folurit nga secili kontribues, kështu që asnjë folës nuk kontribuon më shumë, duke e shtrembëruar balancën e korpusit. Për më tepër, mund të përfshijmë të folurit e mbedhur nga një gamë e gjerë e konteksteve: biseda private në shtëpi, biseda në radio ose në television, biseda në zyrë, në klasë, në dyqane, në operacione të mjekëve, në takime të qeverisë etj.

Tognini-Bonelli (2001: 2-3) thekson se këto tekste që përdoren si përfaqësime të gjuhës mund të përdoren për analiza gjuhësore. Zakonisht supozohet që gjuha e ruajtur në korpus të jetë spontane (e natyrshme), që mbledhet sipas kriterëve të përcaktuara të dizajnit, me një qëllim specifik dhe pretendon të përfaqësojë një pjesë të madhe të gjuhës, të selektuar sipas tipologjisë specifike. Sipas saj, qëllimi i korpusit mund të shihet si analizë dhe përshkrim i përdorimit të gjuhës, i realizuar në tekste.

Edhe përbërja e korpuseve nuk del e njëjlojshme, duke filluar prej atyre që pretendojnë të përfaqësojnë një gjuhë apo varietet të tërë deri te korpuset që mund të përbëhen madje edhe nga veprat e një autori të vetëm. Korpuset mund të përmbajnë tekste të tëra ose koleksione të teksteve të tëra, nga një koleksion citimesh, nga një fjalor elektronik, madje edhe nga një arkivë e teksteve të pastruara (Kennedy 1998: 3), nga artikujt e gazetës të shkruara në ndonjë vit të caktuar (Baker 2010: 7) etj. Për më tepër, korpuset e tilla, si rasti me artikujt e gazetave, e kanë potencialin që të jenë tërësisht reprezentative, sepse mund të gjendet çdo artikull i gazetës nga një periudhë e

caktuar kohore dhe të përfshihet në korpus, kështu e gjithë popullata ndodhet në këtë korpus (Baker 2010: 7).

Reppen (2010: 31) vëren se korpusi mund të shërbejë si mjet i dobishëm për të zbuluar shumë aspekte të përdorimit të gjuhës, që përndryshe nuk do të vëreheshin. Kështu që korpusi është esencial kur eksplorojmë çështje ose pyetje lidhur me përdorimin e gjuhës. Korpusi duhet të jetë përfaqësues i gjuhës që vëzhgohet.

Korpusi (ose koleksionet e mëdha të teksteve të kompjuterizuara, zakonisht të mbledhura kujdesshëm, në mënyrë që të jetë përfaqësuese të një varieteti të veçantë gjuhësor) ishte përdorur fillimisht si ndihmesë për leksikografinë dhe pedagogjinë, por kohët e fundit ka një gamë më të gjerë përdorimi (Baker 2010: 1).

Termi korpus është përdorur zakonisht i lidhur me studimin e gjuhës për veten, ndërsa më vonë është kufizuar për të shfaqur gjuhën e zakonshme të përditshme të njerëzve të zakonshëm që merren me punën e tyre të përditshme. Ky korpus supozohet që të jetë një depo e të dhënave të gjuhës apo të varietetit në gjendjen e tyre natyrale. Modelet e përsëritura të dukurive në korpus do të sigurojnë të dhëna që janë të pavarura nga idiolekti i një informatori të caktuar. Nëse vëzhgohen disa njerëz që nuk kanë lidhje me njëri-tjetrin, duke krujiar modele me ngjashmëri të madhe me njëri-tjetrin, këto modele ka mundësi të jenë modele të gjuhës, mjedisi i ndarë i krijimit të kuptimit në komunitetin folës (Tognini-Bonelli 2010: 22).

1.2.Historiku i gjuhësisë së korpusit

Gjuhësia e korpusit (Kennedy 1998: 1-2) nuk është një qëllim më vete, por është më shumë një burim të dhënash për përmirësimin e përshkrimit të strukturës dhe të përdorimit të gjuhëve, po ashtu edhe për qëllime të tjera, përfshirë përpunimin e të dhënave gjuhësore nga kompjuteri dhe të kuptuarit se si e mësojmë dhe si ua mësojmë të tjerëve gjuhën. Por, sipas Kennedy, pjesë e gjuhësisë së korpusit nuk është çdo përdorim i kompjuterëve me grupe tekstesh, sepse gjuhësia e korpusit nuk ka filluar me zbulimin e tyre, ata vetëm ia kanë dhënë një shtysë duke e lehtësuar punën. Pra, nuk është e rëndësishme aftësia e manipulimit me programe të ndryshme në kompjuter, por aftësia e gjuhëtarit që të krijojë pyetje, të cilat lidhen me probleme reale në studimet teorike e përshkruese.

Kjo metodë e analizës bazuar në kërkimin e detajuar të fjalëve dhe të frazave në kontekste të ndryshme me sasi të mëdha tekstesh ka filluar në shekullin XIII, kur studiuesit biblikë në mënyrë manuale kanë hartuar fjalët e biblës rresht për rresht. Vitet 1195 – 1231 lidhen me konkordancën e parë anonime të biblës, e njohur si *Concordantiae Morales* (McCarthy dhe Anne O’Keeffe 2010:3).

Pra, përpara korpusit elektronik, kishte një traditë të konsiderueshme të analizave gjuhësore të bazuara në korpus. Këto analiza janë bërë në pesë fusha të dijes: në studimet biblike dhe letrare, në leksikografi, në studimet dialektore, në studimet e edukimit gjuhësor dhe në studimet gramatikore (Kennedy 1998: 13-17). Në studimet biblike, nga shekulli XVIII janë bërë lista dhe konkordanca të fjalëve. Alexander Cruden në vitin 1776 publikoi konkordanca të fjalëve dhe disa funksione të tyre, së bashku me kolokime të caktuara.

Kennedy (1998: 14) thekson se studimet në leksikografi shkojnë edhe më herët, nga fillimi i shekullit XVII. Samuel Johnson regjistroi një korpus të gjerë të fjalive për t’i ilustruar kuptimet dhe përdorimet e fjalëve të anglishtes. Ai mbledhi 150,000 citime ilustrative me rreth 40,000 hyrje në fjalorin e tij të gjuhës angleze (*Dictionary of the English Language*). Edhe Fjalori Anglez i Oksfordit (OED - Oxford English Dictionary) ishte po ashtu i bazuar në korpus. Ky fjalor ishte botuar për herë të parë në vitin 1884, pas 71 vitesh, përpiluesit e këtij fjalori (James Murray, Henry Bradley etj) të gjithë kishin vdekur para se të përfundohej puna me 50 milionë fjalë. Ky korpus i gjerë (OED) për hulumtim leksikografik është një nga veprat më të rëndësishme në dijen gjuhësore në gjuhën angleze dhe në çdo gjuhë tjetër. Paralelisht me punën e këtij korpusi, nga fundi i shek. XIX një korpus tjetër i citimeve ishte duke u mbledhur nga Noah Webster (*An American Dictionary of the English language*), që u publikua në vitin 1828.

Në shek. XIX u përpiluan korpuse të llojeve të ndryshme të variacionit gjuhësor në dialektet regjionale. Dy rezultatet kryesore të studimeve të bazuara në korpus të variacionit leksikor në dialektet e Anglisë ishin: *The English Dialect Dictionary* (Wright 1898, 1905) dhe *Existing Phonology of English Dialects* (Ellis, 1889).

Shumica e hulumtimeve bazuar në korpus në gjysmën e parë të shek. XX kishin qëllim pedagogjik. Thorndike (1921, te Kennedy 1998: 16) përpiloi një korpus me 4.5 milionë fjalë nga burime të ndryshme për ta bërë listën e frekuencës së fjalëve, që fillimisht ishte menduar të çojë

në materiale më të mira kurrikulare për mësimin e shkrim - leximit të anglishtes në Shtetet e Bashkuara.

Korpusi më i hershëm paraelektronik, i mbledhur veçanërisht për përshkrim gramatikor ishte korpusi SEU (*Survey of English Usage*) (Quirk, 1968). Kur Radolph Quirk themeloi sondazhin më 1959, qëllimi ishte të mbledheshin 200 mostra, secila me nga 5.000 fjalë, përfaqësues i anglishtes britanike të folur dhe të shkruar, për të formuar një korpus me një milion fjalë, që do të mund të përdorej si bazë për përshkrimin e gramatikës dhe për përdorimin e anglishtes nga folës anglezë britanikë (Kennedy 1998: 17; Teubert 2004: 107).

Ndërsa në vitin 1961 filloi planifikimi i korpusit elektronik për hulumtime gjuhësore. Korpusi i Brownit është korpusi i parë kompjuterik i përpiluar për qëllime gjuhësore nga Nelson Francis dhe Henry Kučera (1964). Struktura e këtij korpusi përbëhet nga 2, 000 mostra/shembuj, secila me nga 2,000 fjalë nga anglishtja e shkruar. Mostrat e korpusit të Brownit janë marrë nga 15 kategori të tekstit, nga proza informative dhe fiktive, duke përfshirë vargun dhe dramën . Ky korpus kishte për qëllim të shërbente si standard i krahasimeve për “studime dhe analiza të anglishtes së sotme” (Kennedy 1998: 23-26, Teubert 2004: 108, Baker 2010: 12, Tognini-Bonelli 2001: 52).

Sipas Tognini-Bonelli (2010: 16), korpusi i parë elektronik i gjuhës së folur u mbledh në Universitetin e Edinburgut në vitet 1963-55 me iniciativën e John Sinclair. Pra, korpusi i shkruar dhe i folur i fillimit të viteve 1960 ishin të përgatitur në të njëjtën periudhë (nga Francis dhe Kučera nga njëra anë për gjuhën e shkruar dhe nga Sinclair nga ana tjetër për gjuhën e folur), por studiuesit nuk ishin fillimisht të vetëdijshëm për punën e njëri-tjetrit.

Ndërmjet viteve 1970-1978 ishte përpiluar korpusi i anglishtes britanike të shkruar në Universitetin e Lankasterit dhe në atë të Oslos, i njohur si korpusi LOB (*Lancaster-Oslo/Bergen*), që ishte menduar të bëhej homologu i anglishtes britanike i korpusit Brown. Përbërjen e kishte të njëjtë me korpusin e Brownit. Edhe tri korpuse të tjera janë modeluar sipas strukturës dhe madhësisë së korpusit Brown për varietetet e anglishtes indiane, australiane dhe të Zelandës së Re (*The Kolhapur Corpus of Indian English, The Wellington Corpus of Written New Zealand, Australian Corpus of English (ACE)/ Macquaire Corpus of Written Australian English*), viti 1986

është marrë për bazë për selektimin e mostrave të materialit të publikuar (Kennedy 1998: 29, Teubert 2004: 108).

Në vitin 1975 Jan Svartnik e bëri të qasshëm në formë elektronike pjesën e folur nga korpusi SEU. Tekstet origjinale (87 tekste) të të folurit të transkriptuar, me 435,000 fjalë ishin plotësuar me 13 tekste të tjera, për ta prodhuar korpusin përfundimtar LLC (*London Lund Corpus*). Ky korpus kishte gjysmë milion fjalë dhe përbën korpusin më të madh dhe më të përdorur të anglishtes së folur deri në gjysmën e viteteve 1990 (Kennedy 1998: 32). Nga shumë autorë kjo periudhë konsiderohet si gjenerata e parë e korpunit me një milion fjalë (Kennedy 1998:23-29, Tognini-Bonelli 2001: 52, Baker 2010:12).

Gjenerata e dytë e korpunit u përket viteve 1990 dhe Korpusi Nacional Britanik (*British National Corpus*) është shembulli prototip me 100 milionë fjalë. Në këtë grup futet edhe (*Brigham Young University Corpus of American English*) me më shumë se 360 milionë fjalë dhe (*Bank of English*) me 450 milionë fjalë në vitin 2005 (Baker 2010: 13). Ndërmjet viteve 1991-1995 korpusi BNC padyshim ishte projekti më ambicioz i korpunit deri në këtë kohë. Projekti u krijua që të prodhojë një korpus prej 100 milionë fjalësh të anglishtes britanike të folur dhe të shkruar. Ishte dizajnuar që të ishte përfaqësues i anglishtes britanike si e tërë, e jo i një zhanri, fushe apo regjistri të caktuar. Nga 4124 tekste, 90% ishin tekste të shkruara dhe 10% tekste të folura. Detajet që janë përfshirë në pjesën e korpunit të folur për situatën dhe bashkëbiseduesit janë: mjedisi, aktiviteti në kohën kur po regjistroheshin, lokacioni, ora, data, audienca, shkalla e spontanitetit, tema, gjinia e subjekteve, mosha, raca, profesioni, edukimi, grupi social, raportet ndërmjet bashkëbiseduesve, dialekti etj. Gjithë teksti është transkriptuar në mënyrë ortografike me puzat, hezitimet, fillime të gabuara, elementet mbisegmentore, përsëritje dhe disa veçori paralinguistike, si bërtima dhe pëshpërima. BNC-ja përmban mostra tekstesh që përgjithësisht nuk janë më të mëdha se 40,000 fjalë (Kennedy 1998: 50-52).

Korpusi Internacional i Anglishtes (ICE) është projekti i korpunit më ambicioz botëror për studime krahasuese. Ky projekt ka 20 nënkorpuse paralele, secili me nga 1 milion fjalë të anglishtes së përdorur nga subjekte mbi moshën 18 vjeç, që kanë një edukim formal përmes mediumit të anglishtes, së paku në përfundimin e shkollës së mesme në vendet, si: UK, SHBA, Kanada, Australi dhe Zelandë të Re, ku anglishtja është gjuha e parë ose gjuha dominuese, po

ashtu edhe në shtetet, si: India, Nigeria, Singapori apo regjionet, si Karaibet, ku anglishtja mund të jetë gjuhë zyrtare plotësuese ose gjuhë e dytë e një pjese domethënëse të popullatës. Tekstet e folura dhe të shkruara janë zgjedhur nga periudha 1990-1993 (Kennedy 1998:54).

Gjenerata e tretë përfshin Korpusin Internacional të Kembrijit (*Cambridge International Corpus*) me një miliard fjalë në vitin 2007 dhe Korpusin e Anglishtes së Oksfordit (*Oxford English Corpus*) me dy miliardë fjalë kur është matur në pranverë të vitit 2006 (Baker 2010: 13). Këtu futet edhe korpusi ELS (*English Lexical Studies*), që filloi në Edinburg në vitin 1963 dhe u kompletua në Birmingham. Studiuesi kryesor i këtij projekti ishte John Sinclair, i cili e përdori për herë të parë korpusin për hulumtime leksikore (Teubert 2004: 109).

1.3.Historiku i gjuhësisë së korpusit në gjuhën shqipe

Studimet në fushën e gjuhësisë së korpusit në gjuhën shqipe kanë nisur vonë, në krahasim me gjuhët me të cilat shqipja është në kontakt. Pas vitit 2000 jepen vërejtjet e para për nevojën e krijimit të një korpusi në gjuhën shqipe. Korpusi sigurisht është mbledhur për nevoja të veçanta të studiussve të ndryshëm, por jo si një korpus gjithëpërfshirës që do të mund ta shfrytëzonin të gjithë ata që merren me gjuhësi apo me ndonjë fushë tjetër.

Kabashi (2009: 98) vë në dukje se deri në këtë periudhë ekzistonte vetëm një vepër e Kadaresë, romani *Koncert në fund të dimrit*, botuar në ECI/MCI (*European Corpus Initiative Multilingual Corpus I*) në vitin 1994, që mund të përdorej si një korpus i veçantë në gjuhën shqipe.

Kabashi (2009, 2012) shtron kërkesën për krijimin e një korpusi gjithëpërfshirës të shqipes, pasi shqipja nuk e kishte një të tillë. Një vit më herët, Kabashi (2011: 377) thekson se monitorimi i gjuhës përmes të dhënave të korpusit është i domosdoshëm për zhvillimin e gjuhës dhe përmirësimin e standardit.

Korpusi i parë me një milion fjalë në gjuhën shqipe është korpusi i përpiluar nga N.Caka dhe A. Caka në vitin 2006. Është përpiluar sipas metodologjisë së korpusit të Brownit të vitit 1964. Tekstet që përfshihen në këtë korpus janë të botuara në periudhën 1976-2006, përmban 500 mostra me nga 2.000 fjalë, gjithsej 1.000.000 fjalë. Në këto mostra përfshihen pesë zhanre kryesore: prozë letrare 35%, prozë informative 15%, tekstet që janë përdorur si zëvendësim i gjuhës së folur, si dramat, pjesët teatrale dhe regjistrimet (dialogu, monologu, transkriptimet e seancave

parlamentare) 15%, proza shkencore - edukative 25 %, gjuha zyrtare nga administrata 10% (N. Caka dhe A.Caka 2012: 648).

Në këtë korpus janë skanuar 180 tekste në formatin jpg. Për dallim nga korpusi i Brownit që përfshin tekste të botuara brenda një viti, “Korpusi Caka” përfshin tekste të botuara në një periudhë prej 40-50 vjetësh. Korpusi është pjesërisht i etiketuar, është bërë lematizimi i tërë korpusit dhe përcaktimi i kategorisë gramatikore të 10 000 fjalëve të para (N. Caka dhe A.Caka 2012: 653).

Nga fundi i vitit 2011 filloi krijimi i Korpusit Nacional të Shqipes nga specialistët e Shën Peterburgut dhe Moskës. Specialistët nga Moska janë marrë me zgjidhjen e problemeve teknike dhe gjuhësore të korpusit, kurse shkencëtarët nga Shën Peterburgu, në krye me Aleksandër Rusakovin, janë marrë me grumbullimin dhe përgatitjen e teksteve, anotimin, krijimin e fjalorit gramatikor dhe probleme të tjera teorike. Për grumbullimin e teksteve janë ndihmuar nga kolegët dhe shtëpitë botuese nga Kosova e Shqipëria. Në nëntorin e vitit 2012 është vendosur versioni online i korpusit të shqipes me 750 mijë fjalë dhe vazhdon të përditësohet, nga të dhënat e vitit 2013 del se përmban 16.8 milionë fjalë teksti. Ky korpus synon të jetë një korpus referencë ose i balancuar, sepse në përbërjen e tij ka tekste të zhanreve të ndryshme dhe të madhësive të ndryshme. Ky korpus është korpus dinamik ose i hapur, i cili ndryshon kohë pas kohe, por duke ruajtur strukturën e tij. Struktura dhe përmbajtja e këtij korpusi, sipas të dhënave të vitit 2013, është: romanet 7.15%, tregime të shkurtra 3.01%, drama 0.1%, vepra fetare 6.43 %, ese 1.08% vepra shkencore 6.66%, gjuhë zyrtare 1.96% dhe shtypi 73.61%. Siç shihet, shumica e teksteve në këtë korpus janë marrë nga fusha e gazetarisë. Tekstet e këtij korpusi janë të anotuara me anë të anotimit të karakterit gjuhësor dhe jogjuhësor. Anotimi metatekstual përfshin: emrin dhe mbiemrin e autorit, titullin e librit, tipin e tekstit, zhanrin, vitin e krijimit të tekstit, për tekstet publicistike përmendet titulli i botimit periodik, data dhe numri i botimit. Ndërsa te anotimi gjuhësor ose leksiko - morfologjik, p.sh. për fjalëformën *djalin*, jepen këto informacione: lema, veçoritë gramatikore të fjalës (pjesa e ligjëratës, gjinia), veçoritë gramatikore të fjalëformës së dhënë (rasa e emrit) dhe përkthimi (Morozova dhe Rusakov 2013: 86-94).

Në Seminarin XXXVI Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare Kabashi (2017) paraqet korpusin AICo (Albanian [text and speech] Corpus) me njëqind milionë

fjalë. Ky korpus ka filluar të përpilohet në vitin 1997 dhe vazhdon ende të përpunohet. Tekstet e përzgjedhura në këtë korpus u përkasin fushave të ndryshme, si: ekonomi, mjekësi, politikë, tema shoqërore, art e kulturë. Numri i teksteve në këtë korpus është 48.181, ndërsa numri i fjalëve 100.120.118, përafërsisht një tekst ka 2.078 fjalë. Pjesa e gjuhës së folur në këtë korpus përbëhet vetëm nga 21 tekste të shkurtra të përfituara nga gjuha e folur. Ky korpus, për dallim prej korpuseve paraprahe, është i anotuar në aspektin morfo - sintaksor (Kabashi 2017: 148).

1.4.Llojet e korpusit

Kur krijohen korpuset, zakonisht e kanë një qëllim të përcaktuar, që të përfaqësojnë një gjuhë të tërë, një varietet të gjuhës, gjuhën e një autori të vetëm apo edhe gjuhën e ndonjë gazete gjatë një periudhe të caktuar.

Sipas Kennedy (1998: 3), disa korpuse janë dizajnuar për qëllime deskriptive gjenerale, në mënyrë që t'u përgjigjen pyetjeve nga nivele të ndryshme gjuhësore: prozodia, leksiku, gramatika, diskursi ose pragmatika, ndërsa korpuse të tjera janë dizajnuar për qëllime më të specializuara duke zbuluar se cilat fjalë ose kuptime fjalësh duhet të përfshihen në fjalorin e nxënësit, në ekonomi; çfarë dallimesh ka ndërmjet përdorimit të gjuhës në kontekste të ndryshme gjeografike, sociale, historike ose kontekste që lidhen me punën.

Ai tutje bën dallimin ndërmjet korpusit dhe arkivës së tekstit ose bazës së të dhënave të tekstit. Derisa korpusi i dizajnuar për analiza gjuhësore zakonisht është përpilim sistematik, i planifikuar, i strukturuar i tekstit, një arkivë është një depo teksti, shpeshherë e gjerë dhe e mbledhur në mënyrë oportuniste dhe të pastrukturuar. Të dhënat që nuk përbëhen nga mostrat, por që përbëjnë një popullsi të tërë të dhënash, mund të përbëhen nga një libër i vetëm apo nga një numër i punimeve. Këto korpuse mund të jenë puna e një autori të vetëm apo e shumë autorëve, apo gjithë numrat e një gazete të caktuar, në një vit të caktuar. Disa projekte kanë mbledhur të gjitha tekstet e mundshme në një zhanër të caktuar apo nga një periudhë e caktuar historike.

Tognini-Bonelli (2001, cit. sipas Baker 2010:7) bën dallimin ndërmjet qasjes së bazuar në korpus dhe qasjes së drejtuar nga korpusi. Qasja e bazuar në korpus e përdor korpusin si burim të shembujve, për ta kontrolluar intuitën e studiuesve ose për të ekzaminuar frekuencën dhe/ose besueshmërinë/gjasën e gjuhës së përmbajtur brenda një grupi më të vogël të të dhënave. Qasja e

drejtuar nga korpusi vazhdon analizën në një mënyrë më induktive, vetë korpusi është e dhënë dhe model, në të shënohen si mënyrë e të shprehurit rregullsitë dhe përjashtimet në gjuhë.

Pra, korpusi, sipas Tognini-Bonelli (2001: 65- 84), mund të përdoret në disa mënyra që të vërtetojë, të ilustrojë apo ta ndërtojë një teori të gjuhës. Qasja e bazuar në korpus i referohet metodologjisë që përfiton nga korpusi kryesisht për t'i shpjeguar, për t'i testuar apo për t'i ilustruar teoritë dhe përshkrimet, që janë formuluar, përpara se të bëheshin të qasshëm korpuset e mëdha për studimin e gjuhës. Ndërsa, qasja e drejtuar nga korpusi e përdor korpusin përtej selektimit të shembujve, për ta mbështetur argumentin gjuhësor ose për të vërtetuar një qëndrim teorik.

Bazuar në qëllimin për të cilin përpilohen dhe çfarë përfaqësojnë, korpuset janë disa llojesh: *korpusi gjeneral, korpusi i specializuar, korpusi sinkronik, korpusi diakronik, korpusi monitor, korpusi shumëgjuhësor, korpusi i folur, korpusi për krahasim*, etj.

1.4.1. Korpusi gjeneral

Disa korpuse mbliidhen vetëm për të vënë në dispozicion tekste për hulumtime gjuhësore të paspecifikuara. Korpuset e tilla quhen *korpuse gjenerale*, që sipas Kennedy (1998: 19), përmbajnë grupe tekstesh që gjuhëtarët i analizojnë për të kërkuar përgjigje për pyetje të caktuara rreth fjalorit, gramatikës apo strukturës së diskursit të gjuhës. Korpusi gjeneral dizajnohet që të jetë i balancuar dhe përmban tekste nga zhanre e domene të ndryshme të përdorimit, duke përfshirë gjuhën e folur dhe të shkruar, gjuhën publike dhe atë private. Korpusi *gjeneral* ose *i balancuar* shpeshherë referohet edhe si korpus *themelor* (Kennedy 1998:20), që mund të përdoret si bazë për studime krahasuese, si *korpus referencial* (Baker 2010: 12), si korpus *mostër*, kur pretendon të jetë një burim i besueshëm i të gjitha veçorive të gjuhës (Tognini-Bonelli 2010: 20) dhe si korpus *standard*, kur vendos standardin për korpuset e ardhshme (Lee 2010: 109).

Korpusi gjeneral, sipas Baker (2010: 12), mund të shihet si një korpus prototip, sepse zakonisht është shumë i gjerë, përmban miliona fjalë, me tekste të mbledhura nga një gamë e gjerë burimesh, duke përfaqësuar shumë kontekste gjuhësore (të shkruar, të folur, elektronik, publik, privat etj).

Tognini- Bonelli (2010: 20) thekson se qëllimi kryesor i këtij korpusi është të prezantojë veçoritë gjuhësore të gjuhës apo të varietetit në proporcion të përafërt me gjetjet në përdorimin

gjeneral, p.sh.: *Korpusi i Brownit* është një shembull tipik i mënyrës se si është ndërtuar një korpus i tillë, sepse përmban prozën informative dhe imagjinative, pastaj ka 16 nënkategori me nga 500 mostra, secila me nga 2,000 fjalë. Por, sipas saj, në ditët e sotme korpusi referencë duhet të jetë mjaft i gjerë, madhësia tipike është 100 milionë fjalë dhe duhet të përmbajë sasi substanciale të të gjitha varieteteve të gjuhës që gjenden në shoqëri: gjuhën e folur, të shkruar, publike, private, informative, imagjinative.

Autorë si Lee (2010: 109) këtë lloj korpusi e quan korpus *standard* i gjeneratës së parë të korpuseve, sepse edhe shumë korpuse të tjera janë përpiluar sipas modelit përafërsisht të njëjtë, p.sh.: sipas mostrës së *Korpusit të Brownit* janë përpiluar edhe korpusi LOB, ACE etj. Të gjitha këto korpuse përbëhen përafërsisht prej një milion fjalësh, nga periudha kohore 1960 (Brown, LOB), 1970 (Kolhapur), 1980 (ACE, Wellington), 1990 (FROWN, FLOB). Gjenerata e dytë e korpuseve gjenerale i përket kohës së internetit dhe janë korpuse shumë të gjera, si: *Bank of English*, BNC etj, që përbëhen prej 100 milionë fjalësh.

Baker (2010: 14) vëren se korpusi referencial shpesh përdoret në lidhje me korpusin e specializuar, gjithashtu është e mundshme të krahasohen dy korpuse të specializuara, veçanërisht nëse ndajnë një apo më shumë ndryshore të përbashkëta, p.sh.: kur përmbajnë tekste nga e njëjta periudhë kohore, janë të një madhësie dhe kanë përbërje të ngjashme, duke lejuar kështu gjuhëtarët e korpusit të bëjnë krahasime. Ai argumenton se korpuset e mëdha të përsosura referenciale nuk ekzistojnë, sepse të gjitha janë të specializuara në njëfarë mënyre, p.sh. korpusi BNC është i specializuar në anglishten britanike, prodhuar në vitet 1990. Një ironi në krijimin e një korpusi referencial të gjerë, të balancuar dhe gramatikisht të anotuar është që deri në kohën kur ai bëhet gati për përdorim, ka mundësi që të “vjetrohet”, dobia e tij si një referencë bashkëkohore komprometohet, thekson Baker (2010: 15).

1.4.2. Korpusi krahasues

Dy apo më shumë korpuse mund të dizajnohen që të jenë të krahasueshëm, nëse ndërtohen me të njëjtin kriter dizajni dhe kanë madhësi të njëjtë. Në këtë grup klasifikohen: *korpusi gjeografik*, *korpusi historik*, *korpusi sipas temave* (mund të mblidhen tekste të organizuara nga tema, p.sh.: numri i raporteve të gazetave të ngjarjes së njëjtë), *korpuset kontrastive*. Korpusi i parë i dizajnuar për krahasim ishte korpusi LOB, për shkak se e kishte dizajnin e njëjtë me korpusin

Brown, por tekstet ishin zgjedhur nga anglishtja britanike, ndërsa te korpusi *Brown* nga anglishtja amerikane. Tekstet e të dy korpuseve janë të botuara në vitin 1961, *LOB*-i është kompletuar në vitin 1978. *SEU* është një projekt i grupeve të korpuseve të krahasueshme që e lehtësojnë hulumtimin për varietetin e gjuhëve, mbi një bazë globale (*ICE*). Nisur në vitin 1990, plani ishte që të eksploroheh varietetet e anglishtes në mbarë botën, duke ndërtuar korpusë të varieteteve lokale në shumë rajone dhe duke përdorur një model të bazuar në *SEU*. Çdo korpus përmban rreth një milion fjalë, me njëzet varietete nën vëzhgim. Korpuset kontrastive krijohen me një qëllim specifik të bërjes së kontrastit brenda korpusit dhe deklarohet qysh në fillim se disa nga përbërësit kryesorë të saj pritet të jenë në kontrast me njëri-tjetrin. Korpusi kontrastiv është dizajnuar që të sjellë modelimin karakteristik të varieteteve të dallueshme. Secili komponent kryesor është dizajnuar pa iu referuar komponentëve të tjerë. Një shembull i korpusit kontrastiv është dizajnuar nga *Biberi* (1999), duke krahasuar katër varietete të anglishtes moderne (*Tognini-Bonelli* 2010: 22).

Në fushën e varieteteve gjuhësore, *Tognini-Bonelli* (2001: 7-8) vëren se një moment historik është mbledhja e *Korpusit Internacional të Anglishtes (ICE)* në vitin 1990, me qëllimin primar sigurimin e materialeve për studime krahasuese të varieteteve të anglishtes në mbarë botën. Çdo korpus brenda *ICE*-së përmban material të folur dhe të shkruar sipas dizajnit të përbashkët. Korpusi *ICE* konsiderohet si korpus krahasues në terma të madhësisë, datës së teksteve, autorëve, folësve dhe kategorisë së tekstit. Secila pjesë përbërëse e korpusit mund të qëndrojë e vetme si burim i vlefshëm për hulumtim të varieteteve nacionale dhe regjionale.

1.4.3. Korpusi i specializuar

Korpuset që dizajnohen të përfaqësojnë vetëm ndonjë domen të gjuhës, por jo gjithë gjuhën quhen korpusë të specializuara. *Kennedy* (1998) vëren se këto korpusë janë dizajnuar me një projekt hulumtues të veçantë në mendje, p.sh.: korpuset e mbledhura nga publikues të shumtë komercialë si burim të dhënash të frekuencës së fjalëve dhe citimeve për përpilimin e fjalorëve modernë janë të këtij lloji. Korpuset e specializuara janë mbledhur për të studiuar edhe tema të ndryshme, si zhvillimi i gjuhës së fëmijës, por mund të jenë edhe më të specializuara dhe të përmbajnë shembuj të debateve në intervistat e radios ose udhëzimet e mësuesve në klasat e shkollës së mesme. Shumica e tipave të korpusit të specializuar përfshijnë ato që janë përpiluar

për studime variacioni regjional apo sociolinguistik. Në këtë kategori hyjnë: *korpusi dialektor, regjional, jostandard* etj (Kennedy 1998: 20).

Në njërën anë, korpusi mund të përmbajë një popullsi totale statistikore, p.sh.: një korpus i përbërë prej punës complete të Charles Dikensit apo të gjitha botimet e gazetës *New York Time* ndërmjet viteve 1940-1990, përfaqësojnë një popullsi totale teksti, thekson Kennedy (1998: 20). Pra, korpusi, sipas tij, nuk është përfaqësues i një entiteti, por është vetë entiteti, ndërsa, në anën tjetër, korpusi gjuhësor me një milion fjalë, që kërkon ta përfaqësojë një gjuhë apo një varietet gjuhësor në një vit të veçantë, duhet të mblidhet sistematikisht në mënyrë ideale nga të gjitha prodhimet e anglishtes së folur dhe të shkruar në atë vend, në të njëjtin vit, që të përfaqësojë gjuhën sa më drejt që është e mundur. Një mostër e tillë teksti e korpusit dizajnohet që të përfaqësojë mostrën e popullsisë totale të diskursit. Popullsia e tillë nuk është domosdoshmërisht “gjuha në tërësi”. Tekstet mund të mblidhen bazuar në regjione, zhanre, përdorues të grupeve (nxënësit, gazetarët apo imigrantët).

Në varësi prej varietetit ose varieteteve të marra në shqyrtim dhe pyetjeve të hulumtimit që korpusi është i dizajnuar t'i adresojë, gjithashtu mund të krijohen korpuse të specializuara, të cilat kanë kufizime të qarta sipas teksteve që mund të përfshihen brenda tyre, p. sh.: korpusi *MICASE (Michigan Corpus of Academic Spoken English)* përmban rreth 1, 840, 000 fjalë të fjalimeve bashkëkohore, me 190 regjistrime, të mbledhura brenda Universitetit të Miçiganit. Hulumtimi në këtë korpus kontekstualizohet si relevant vetëm në gjuhën akademike bashkëkohore të përdorur në Miçigan (Simpson 2000, cit. sipas Baker 2010: 14). Lee (2010: 114) shton se duke u bazuar në këtë fushë specifike të anglishtes akademike, janë përpiluar edhe disa korpuse të tjera akademike të folura, si korpusi *BASE (the British Academic Spoken English)* me 1.6 milion fjalë, ndërsa korpuset akademike të shkruara, përveç kategorive në korpusin *LOB* dhe *BNC*, janë korpusi *SPACE (Chemnitz Corpus of Specialized and Popular Academic English)*, që përmban tekste akademike të studiusve dhe korpusi *RAT (Reading Academic Text corpus)*, që përbëhet prej artikujve hulumtues dhe temave të doktoratës nga fusha e bujqësisë, nga fusha e ekonomisë ushqimore etj.

Tognini-Bonelli (2010: 22) thekson se korpusi i specializuar mblledh tekste që nuk dizajnohen të jenë reprezentative të gjithë gjuhës apo gjithë varietetit, p.sh.: nëse mblidhet puna e

Shekspirit, e Gëtes apo Prustit nuk do të janë shembuj të besueshëm të anglishtes, të gjermanishtes apo të frëngjishtes bashkëkohore, ata janë zgjedhur për shkak se kanë qenë jo të zakonshëm. Pra, sipas saj, korpusi i specializuar nuk merret me të përgjithshmet, por me të veçantat e gjuhës. Në punimin e saj të mëhershëm, *Corpus Linguistics at Work*, Tognini- Bonelli (2001: 8) thotë se korpuset e specializuara janë të ndryshme në parim nga korpuset që përmbajnë një ose varietete të tjera të gjuhës autentike të zakonshme. Korpusi i bisedave nuk është një korpus i specializuar, apo i teksteve të gazetave, apo i ndonjë gazete të veçantë. Korpuset e specializuara, sipas saj, janë ato që nuk kontribuojnë në përshkrimin e gjuhës së zakonshme, sepse përmbajnë një proporcion të lartë të veçorive jo të zakonshme apo origjina e tyre nuk është e besueshme si regjistrime të njerëzve të zakonshëm. Ajo shton se korpusi i specializuar ofron një pasqyrë më të limituar të origjinalitetit të përdorimit autentik.

Ndërmjet dy ekstremeve, të korpusit të specializuar dhe referencial, janë korpuset historike ose diakronike, që synojnë të pasqyrojnë përdorimin e gjuhës në një periudhë të caktuar kohore. Baker (2010: 14-15) argumenton se të gjitha korpuset janë historike dhe të specializuara, p.sh.: te korpusi *BNC* data më e hershme e publikimit të teksteve është viti 1960, kurse data e fundit 1993.

1.4.4. Korpusi historik

Korpuset që përfshijnë dimensionin e kohës si veçori të dizajnit janë: *korpusi sinkronik*, *korpusi monitor* dhe *korpusi diakronik*.

Korpusi sinkronik është një përpjekje për ta përfaqësuar gjuhën apo një tip teksti në një kohë të caktuar, p.sh.: korpusi i *Brownit* përmban tekste të shkruara të anglishtes amerikane të publikuara në vitin 1961. Korpusi mund të jetë koleksion statik i teksteve të zgjedhura në një mënyrë parimore, që synojnë të jenë tipike për gjithë gjuhën ose një aspekt të gjuhës në një kohë të caktuar. P.sh.: korpusi *BNC* ishte statik. Një pikëpamje alternative e korpusit është edhe korpusi dinamik ose monitor. Korpusi monitor në analogji me një fotografi që lëviz më shumë se sa një kapje e fotografisë, siguron mjetet për të monitoruar ndryshimin e modelit të përdorimit me kalimin e kohës. Korpusi monitor mund të përshkruhet edhe si mbajtja e gjendjes së gjuhës në çdo kohë. Përbërja dhe madhësia e korpusit monitor ndryshon vazhdimisht, dhe kjo e bën të papërshtatshëm për studime krahasuese, p.sh.: të frekuencës relative të njësisve në varietete të ndryshme të gjuhës (Kennedy 1998: 61).

Edhe Tognini-Bonelli (2010: 22-23) dallon korpusin monitor, i cili është hartuar në atë mënyrë që të mund të kompletohet derisa ndodh ndryshimi gjuhësor. Ky korpus u parashtrua nga Sinclair (1982) si përpjekje për ta mbajtur të përditësuar korpusin sinkronik. Në vend që të hiqej materiali që duhej të zëvendësohej me shembuj më bashkëkohorë, ishte më e përshtatshme që të mbahej ai me një etiketim kohor dhe të shtohej dimensionin diakronik në korpus. Përpjekja e parë ishte projekti *Aviator*, me dhjetë milionë fjalë të gazetës *The Times* dhe programi ishte sajuar që do t'i zbulonte risitë e ndryshme.

Korpusi diakronik përfaqëson gjuhën gjatë një periudhe kohore, p.sh.: *Korpusi i Helsinkut* përmban tekste të anglishtes gjatë periudhës së viteve 700-1700 p.k.dhe, përveç tjerash, mund të përdoret edhe për ndryshimin gjuhësor (Kennedy 1998: 22). Ky është korpusi i parë i specializuar diakronik i anglishtes, i hartuar në Universitetin e Helsinkut ndërmjet viteve 1984-1991, që përmban 400 mostra, me 1.5 milionë fjalë. Zhanret përfshijnë: letrat, predikimet, ditarët, dokumentet legale e zyrtare dhe dramën (Kennedy 1998:38). Përveç këtij korpusi, janë edhe dy korpuse të tjera kryesore diakronike: korpusi *ARCHER (A Representative Corpus of Historical English Registers)* është një korpus me shumë zhanre që mbulon periudhën 1650-1990 të anglishtes britanike e amerikane dhe korpusi *COHA (Corpus of Historical American English)*, që ka për qëllim të krijojë një korpus prej 300 milionë fjalësh të anglishtes amerikane gjatë periudhës 1800 deri në ditët e sotme (Lee 2010: 113).

Për gjuhën e folur korpusi diakronik është i kufizuar në periudhën që nga shpikja e teknikave të regjistrimit të zërit. Një ndërmarrje e përfunduar së fundmi është korpusi *DCPSE (Diachronic Corpus of English Spoken English)*, një korpus i cili paraqet dy korpuse të folura: korpusin *LLC*, i cili është elementi i folur i korpusit *SEU*, i regjistruar në vitet 1960, dhe korpusin *ICE-GB*, të regjistruar në vitet 1990 (Tognini-Bonelli 2010: 23).

1.4.5. Korpusi për qëllime të veçanta

Përveç këtyre që u përmendën deri tash, korpuset mund të përdoren edhe për qëllime më të veçanta. Për qëllime leksikografike mund të përmendet korpusi *AHI (American Heritage Intermediate Corpus)*, që është një korpus komercial dhe përmban 5, 9 milionë fjalë të teksteve bazuar në vitin 1969 të shkollave në Shtetet e Bashkuara (Kennedy 1998: 34).

Edhe fjalorët mund të përdoren si korpusë. Fjalori më i njohur elektronik, i përdorur si korpus në vitin 1980, ishte fjalori LDOCE (*Longman Dictionary of Contemporary English*), që ishte i disponueshëm për ekipet kërkimore. Ngjarja më e rëndësishme në vitet 1990 ishte publikimi i *Fjalorit Anglez të Oksfordit* në formën elektronike (edicioni i dytë). Gjithashtu, *Baza e të Dhënave Psikolinguistike e Oksfordit* që siguron të dhëna leksikore të specializuara për hulumtim gjuhësor, duke sjellë koleksion heterogjen të informacioneve me 99, 000 fjalë angleze që janë të pritshme të përdoren në hulumtime psikolinguistike (Kennedy 1998:35).

Korpuset që janë krijuar për hulumtimet e përvetësimit të gjuhës janë: *CHYLDES* (*The Child Language of Data Exchange System*), që është depo e të dhënave të ndryshme të përvetësimit të gjuhës, *POW* (*The Polytechnic of Wales Corpus*) është një korpus elektronik për hulumtimin e përvetësimit dhe të zhvillimit të strukturave sintaktiko-semantike nga fëmijët (Kennedy 1998, Lee 2010). Këto korpusë Lee (2010: 116) janë koleksione të gjuhës së folësve nativë të prodhuara nga fëmijët në faza të ndryshme të zhvillimit. Ai shton edhe korpusin *LUCY* në këtë grup, që përmban ese të shkruara në vitin 1960 nga fëmijët britanikë të moshës 9-12 vjeç.

Ndërsa korpuset e mbledhura për hulumtimin e përvetësimit të gjuhës së dytë apo të huaj janë: *ICLE* (*International Corpus of Learner's English*) për gjuhën e shkruar (Kennedy 1998: 42), i cili përmban ese argumentuese nga studentë universitarë të anglishtes nga 21 gjuhë me prejardhje të ndryshme dhe *LINDSEI* (*Louvain International Database of Spoken English Interlanguage*) për gjuhën e folur, që përmban transkriptime nga dy tipa të të folurit nga subjekte me 11 gjuhë native të ndryshme, nga intervistat informale dhe nga të folurit e nxitur prej pikturave (Lee 2010: 116).

Ky lloj korpusi përdoret për t'i identifikuar modelet karakteristike të të shkruarit të studentëve dhe është një mjet i dobishëm për mësuesit e nxënësit për t'i gjetur gabimet e bëra nga një student i angazhuar në një aktivitet specifik. Ofron mundësinë e identifikimit të tipit të tekstit dhe subjektit ku shfaqen gabimet më shpesh, duke ia mundur mësuesit të mësojë paraprakisht dhe kështu t'i parandalojë gabimet e zakonshme (Tognini-Bonelli 2001:9).

1.4.6. Korpusi shumëgjuhësor

Korpusi shumëgjuhësor konceptohet si koleksion i teksteve në dy apo më shumë gjuhë, të cilat bashkohen në mënyrë parimore, me qëllim të studimeve gjuhësore krahasuese dhe të përgatitura në formë elektronike për kërkim dhe analizë me kompjuter (Johanson 2007: 9). Që të përdoren për qëllime krahasimi, korpuset duhet të jenë paralele në disa kuptime. Johnson (2007) te korpusi paralel fut korpusin e përkthimit dhe korpusin krahasues. Definicionet e tij për këto dy korpuse janë:

Korpusi i përkthimit - përmban tekste origjinale dhe përkthimet e tyre në një apo më shumë gjuhë të tjera.

Korpusi i krahasimit - përmban tekste origjinale në dy apo më shumë gjuhë, që përputhen nga kriteri i zhanrit, i datës së publikimit, i shkallës së formalitetit etj.

Këtë ndarje e bën edhe Tognini-Bonelli (2001: 2010: 23-25), e cila thekson se korpuset *paralele* janë korpuse shumëgjuhësore, bazuar në marrëdhënien e përkthimit midis teksteve përbërëse. Për korpusin e përkthimit, ajo (2001: 6-7) thotë se janë korpuse të teksteve që qëndrojnë në raporte përkthimi me njëri-tjetrin, që do të thotë se secili tekst mund të jetë përkthim i një origjinali që mungon, apo njëri prej tyre mund të jetë origjinali dhe të tjerët përkthime. Brenda këtij korpusi dallon edhe *korpusin e përkthimit të lirë*. P.sh.: korpus paralel është korpusi që përmban novelën e George Orwell 1984 në origjinal dhe përkthimin në gjashtë gjuhë.

Një korpus tjetër paralel, sipas saj (2010: 24), është korpusi kontrastiv shumëgjuhësor që përbëhet prej dy nënkorpuseve: njëri me tekste të përkthyer dhe njëri me tekste të papërkthyer, në të njëjtën gjuhë. Niset prej asaj se tekstet e përkthyer dallojnë prej teksteve origjinale dhe do të shpjegoheshin duke iu referuar veçorive të gjuhës burimore. Ajo bën ndarjen edhe në korpusin e folësit jonativ, që përfaqëson shembuj të përdorimit të folësve që mësojnë një gjuhë të huaj dhe krahasohen me modelin normativ të korpusit, gjuha e tyre mund të eksplorohet në një mënyrë shumë më të thellë sesa që ishte në gjendje të bënte puna e mëparshme për analizën e gabimeve.

1.4.7. Korpusi i folur

Ka disa mënyra të mbledhjes së gjuhës së folur, ku përfaqësimi elektronik ndjek një mori konventash të ndryshme. Njëri grup quhet *korpusi i të folurit*, që krijohet për studime të detajuara të tingujve individualë dhe veçorive fonetike dhe nuk është e nevojshme të jenë tekste të vazhdueshme apo të mblidhen në situata të natyrshme. Shumica janë të regjistruar në laboratorë, në mënyrë që të rriten detajet në versionin e regjistruar. Korpusi i të folurit është pjesë e korpusit të specializuar që nuk e ka për qëllim të jetë përfaqësues i gjuhës së zakonshme në përdorimin e saj karakteristik si komunikim (Tognini-Bonelli 2010: 25). Përveç transkriptimeve të folura në korpuset BNC dhe ANC, ekzistojnë disa korpuse të tjera që i plotësojnë nevojat e studiuesve në mënyrë më precize. Lee (2010: 110) thekson se disa studiues e përdorin termin “korpusi i të folurit” për t’iu referuar korpusit multimedial, që ta dallojnë prej korpuseve të tjera që e kanë të qashtëm vetëm formën e transkriptimeve ose përmbajnë regjistrime të dobëta, të cilat nuk janë të përshtatshme për studime fonetike, p.sh. korpusi *BNC* nuk kualifikohet si korpusi i të folurit.

Zakonisht korpuset e mëdha referencë përmbajnë disa materiale të folura, rreth 10%, me një transkriptim të thjeshtë ortografik. Përgjatë periudhës së qasjes në korpus dhe rëndësisë që i është dhënë korpusit të shkruar, është rritur vlera e regjistrimeve të gjuhës së atypëratyshme, veçanërisht biseda që përfshijnë njerëz të cilët e njohin njëri-tjetrin. Derisa disa lloje të gjuhës së folur, si fjalimet apo ligjëratat, duken si variacione të vogla të normës së shkruar, ka një cilësi të re rreth mbledhjes së ndërveprimit informal që hapi studimet e diskursit dhe e bëri të qartë se gramatikat e pranura nuk ishin ndërtuar për të përballuar modelet kuptimore që dalin nga bisedat; ato ishin shumë të njëanshme në favorizimin e gjuhës së shkruar (Tognini- Bonelli 2010:25).

Interneti pranon çdo lloj të çdo gjuhe dhe disa nga varietetet e reja, si psh.: E-maili, chati, blogjet, janë kryesisht joformale dhe nuk i nënshtrohen asnjë konvente përdorimi. Për disa vëzhgues, ata duket se janë afër stilit të bisedës së zakonshme të folur, duke qenë një lloj bisede me shkrim dhe zhvillohet shpesh në kohë reale. Kjo ka çuar në pretendime optimiste se interneti mund të kapërcejë pikat teknike që parandalojnë studiuesit që qasen në sasi të mëdha të të folurit; megjithatë, kërkesa nuk ka qenë ende e vërtetuar, dhe të folurit mbetet mbase veprimtaria njerëzore më e ndërlikuar (Tognini-Bonelli 2010: 26).

Te ky lloj korpusi mund të përmenden korpusi SEC (53, 000 fjalë) për studime gjenerale britanike të shqiptimit, i përbërë kryesisht prej emisioneve në radio ndërmjet viteve 1984-1991, edhe pse materiali është pak i vjetër. Një korpus tjetër që përmban shënime prozodike është korpusi *LLC* (regjistrime të bëra ndërmjet viteve 1960 dhe 1970, me 500,000 fjalë, 100 tekste, 5,000 fjalë secila). Shënime të detajuara prozodike përfshijnë: theksin, tonet, pauzat dhe fenomene të tjera prozodike e paralingvistike, të cilat janë të dobishme për studiuesit e të folurit (Lee 2010: 111).

Në këtë renditje, Lee (2010: 112) rendit edhe korpusin CANCODE, i cili përmban 5 milionë fjalë nga anglishtja britanike e folur, të transkriptuara nga regjistrimet e bëra ndërmjet viteve 1995-2000 nga një varietet i gjerë situatash: biseda të zakonshme, biseda në punë, shopping, marrje e informacioneve, diskutime etj. Gjithashtu, jepen informacione për raportin ndërmjet folësve, nëse kanë marrëdhënie intime, nëse janë njohur rastësisht, janë kolegë apo nuk njihen fare. Ndërsa për anglishten amerikane është korpusi *Switchboard* me tre milionë fjalë, 240 orë të folur, që përmban biseda telefonike spontane, mesatarisht 6 minuta të gjata, të regjistruara në vitet e hershme 90' me folës nga secili dialekt i anglishtes amerikane. Për një kualitet më të mirë dhe bisedë të drejtpërdrejtë është korpusi *Santa Barbara* (SBCSAE) i anglishtes amerikane të folur (249, 000 fjalë), që përmban regjistrime të bisedave spontane të regjioneve të ndryshme të SHBA-ve dhe nga folës të të gjitha prejardhjeve etnike, gjinisë, moshës etj. Regjistrimet janë bërë nga biseda spontane, chate familjare, vizita te doktori, ligjërata, predikime etj.

1.4.8. Korpusi i analizuar gramatikisht

Këto janë korpuse që janë analizuar në nivelin gramatikor. Ky korpus lejon që të kërkohen shënime strukturore sintaksore. Këto korpuse janë më të vogla se korpuset e paanalizuara, sepse shumica prej tyre, për saktësi, kontrollohen në mënyrë manuale. Korpusi i parë i analizuar në këtë mënyrë është *The Lancaster-Leeds Treebank*, një korpus i vogël me 45, 000 fjalë që bën pjesë në korpusin LOB. Pastaj, korpusi *SUSANNE* (*Surface and Underlying Structural Analyses of Naturalistic English*, 130, 000 fjalë) i Geoff Sampsonit është korpus i bazuar në nënkorpusin e *Korpusit Brown* të anglishtes amerikane, i cili ka shënime të frazës e të klauzës dhe shënime të funksionit sipërfaqësor. Nga i njëjti autor është edhe korpusi *CHRISTINE* (80, 500 fjalë), por në këtë rast skema e shënimit i përket gjuhës së folur, si pauzat, njësitë e diskursit, korrigjimet e të

folurit. Një korpus tjetër i analizuar i anglishtes së folur dhe të shkruar është ICE-GB, komponenti britanik i korpusit *ICE*, por edhe shumë korpuse të tjera historike të varieteteve të anglishtes janë analizuar në këtë mënyrë (*The Penn –Helsinki Parsed Corpus of Middle English version 2*) (Lee 2010: 112).

1.4.9. Korpuset multimediale

Transkriptimet e teksteve mund të jenë të sinkronizuara me regjistrimin original, që ua lejon studiuesve dhe përdoruesve të korpusit të shkojnë përtej fjalës së shkruar, t'i prekin elementet vizuale të diskursit, si: përdorimin e prozodisë, gjestikulacionin, vështrimin, hapësirën etj. Një korpus i tillë është korpusi *SBCSAE* (*Santa Barbara Corpus of Spoken American English*), i cili mund të gjendet në uebsajtin *TalkBank*, ku regjistrimi lëviz bashkë me transkriptimin në mënyrë sinkronike. Korpuse të ngjashme janë edhe *SCOTS* (*Scottish Corpus of Texts and Speech*) e *ELISA* (*English Language Interview Corpus as Second-Language Application*). Ndërsa korpusi më ambicioz i këtij lloji është korpusi *SCoRe* (*Singapore Corpus of Research in Education*), që është një korpus multimedial në shumë nivele të teksteve të folura dhe të shkruara, të mbledhura nga shkollat fillore dhe të mesme në Singapor (Lee 2010: 115).

1.4.10. Uebi si korpus

Edhe pse zakonisht kërkohet që korpuset të jenë të balancuara e të selektuara me kujdes, ka autorë si Lee (2010: 116) që edhe uebin e konsiderojnë si korpus të vlefshëm. Shembuj të këtij lloji janë: *WebCorpLSE* i Universitetit të Birminghamit, që përmban tekste me rreth 70 milionë fjalë, pastaj koprusi '*ukWaC*' që përmban 2 miliardë fjalë të anglishtes britanike.

1.4.11. Korpusi *lingua franca*

Disa korpuse merren posaçërisht me takime ndërkulturore, ku anglishtja përdoret si *lingua franca* ndërmjet folësve që nuk e kanë të përbashkët gjuhën amtare apo që nuk kanë prejardhje kulturore apo nacionale të njëjtë. Në këtë lloj mund të përmenden korpuset: *VOICE* (*Viena – Oxford International Corpus of English*, 1 milion fjalë, 120 orë regjistrim) dhe *ELFA* (*English as Lingua Franca in Academic Settings*, 1 milion fjalë, 131 orë regjistrim). Korpusi *VOICE* përfshin ndërveprime të drejtpërdrejta jo të shkruara në anglishte ndërmjet folësve me gjuhë amtare të ndryshme (përfaqësuesi korean i shitjeve, duke negociuar kontratën me një klient gjerman në

Luksemburg). Ndërsa te korpusi ELFA konteksti i të folurit është më shumë akademik sesa biznesor apo i përgjithshëm (Lee 2010: 118).

1.5.Gjuhësia e korpusit dhe sociolinguistika

Fillimisht korpusi ishte përdorur për të ndihmuar leksikografinë dhe pedagogjinë, ndërsa sot ka një përdorim të madh edhe në fusha të tjera të gjuhësisë. Do të përpiqemi ta shohim lidhjen që e ka gjuhësia e korpusit me sociolinguistikën.

Baker (2010: 2) thekson se sociolinguistët shpesh interesohen për lidhjen e identitetit të një personi ose grupi social me mënyrën se si e përdor gjuhën. Sociolinguistët merren me ndryshimet dhe ngjashmëritë gjuhësore ndërmjet tipave të caktuar ose grupeve të njerëzve dhe me ndikimin e variablave gjuhësore (mosha, gjinia, klasa shoqërore, regjioni gjeografik, niveli i edukimit, në kombinim me variabla të tjera) në përdorimin e gjuhës. Disa sociolinguistë tentojnë të mbledhin të dhëna, duke kërkuar prej informatorëve të lexojnë lista fjalësh ose duke kryer intervista me ta, me shpresë që të merren më pak përdorime të vetëdijshme të gjuhës, të tjerë provojnë të marrin të dhëna në mjedise më të natyrshme, disa hulumtojnë përdorimin e gjuhës së folur në kontekste të caktuara, p.sh. bashkëveprimi doktor-pacient, biseda private ndërmjet partnerëve, fjalime politike, thirrje në radio etj, në mënyrë që të hulumtohet se si negocohen fenomenet e konfliktit dhe i bashkëveprimit dhe si është krijuar kuptimi.

Folësit e përdorin gjuhën ndryshe varësisht në një ose më shumë ndryshore sociale ose regjionale. Kjo pastaj sjell variacionin në gjuhësi. Variacioni mund të jetë sinkronik dhe diakronik. Variacioni sinkronik u referohet folësve që ekzistojnë në të njëjtën kohë, mund të mos e ndajnë identitetin e njëjtë apo të jetojnë në të njëjtin vend, u referohet ndryshimeve ndërmjet varieteteve të së njëjtës gjuhë. Ndërsa, ndryshimi diakronik i referohet variacionit që ndodh gjatë kohës, mund të hulumtohet se si ndryshon gjuha e dikujt përgjatë kohës, mund të hulumtohet variacioni diakronik në forma të ndryshme në një popullsi të caktuar apo lokacion përgjatë kohës (Baker 2010:4).

Baker (2010:4) termave variacion sinkronik dhe diakronik u referohet me *variacion* dhe *ndryshim*. Variacioni dhe ndryshimi janë të lidhur, ndryshimi paraprihet nga variacioni. Pra, në mënyrë që popullata të fillojë ta përdorë një karakteristikë të veçantë (shqiptim, fjalë, ndërtim

gramatikor), duhet fillimisht të përdoret nga dikush në atë popullatë, duke rezultuar në variacion brenda komunitetit (ibid.). Për shembull, shumë fjalë për të cilat konsiderohen të jenë raciste tani shihen gjerësisht si të papranueshme, veçanërisht në kontekstet publike (megjithëse ato akoma mund të përdoren në situata private). Sidoqoftë, Baker thekson se njerëzit nuk ndalojnë së përdoruri termat raciste brenda natës, por është një proces gradual që ndodh gjatë dekadave. Që këto ndryshime të ndodhin, ato duhet të paraprihen nga variacioni, ku një numër më i vogël njerëzish do të kishin përdorur format e varianteve në periudhat e mëparshme kohore. Sidoqoftë, derisa ndryshimi tenton të paraprihet nga variacioni në shumicën e rasteve, jo të gjitha variacionet përcillen nga ndryshimi (Baker 2010:5). Një grup folësish mund të përdorë një formë të caktuar, por nuk do të thotë që një praktikë e tillë do të rezultojë në një formë që bëhet e njohur me kalimin e kohës, duke u marrë nga grupet e tjera sociale brenda të njëjtës popullatë.

Baker (2010: 8-9) vë në pah dobite që ka metodologjia e mbështetur në korpus për sociolinguistikën:

1. Gjuhësia e korpusit dhe sociolinguistika ndajnë një numër fundamental të parimeve kur bëhet fjalë për analizën gjuhësore. Të dyja qasjet përfshijnë mbledhjen dhe analizën e të dhënave gjuhësore që shfaqen natyrshëm (në krahasim me marrjen e gjykimeve introspektive në lidhje me përdorimin e gjuhës). Të dyja theksojnë përdorimin e gjuhës ose kontekstin shoqëror.
2. Të dyja përdorin metodologji kuantitative, në mënyrë që të kryhen krahasimet e popullatave të ndryshme, të cilat mund të lehtësohen me teste statistikore.
3. Të dyja qasjet shpesh përdorin teknikën e mostrave, në mënyrë që të jenë në gjendje të nxjerrin pretendimet për një popullatë më të gjerë.
4. Të dyja shqyrtojnë variacionin dhe ndryshimin dhe të dyja konsiderojnë një gamë të gjerë të karakteristikave gjuhësore (fonetikë, morfologji, leksik, gramatikë, diskurs dhe pragmatikë).
5. Të dyja tentojnë të provojnë shpjegimin, kur është i mundshëm, për gjetjet që prodhon hulumtimi i tyre.

Në përgjithësi, variacioni demografik është përdorimi i gjuhës nga një grup identiteti, i cili shënohet duke hulumtuar prezencën (ose joprezencën) e një ndryshoreje të veçantë gjuhësore. Ndryshoret e tilla mund të jenë: prozodike, fonetike, leksikore, gramatikore, diskursive dhe pragmatike. Mund të shqyrtohet prodhimi gjuhësor i folur ose i shkruar, edhe pse shumë sociolinguistë tentojnë të fokusohen në përdorimin e gjuhës së folur. Përdoruesit e gjuhës shpeshherë ndahen në një apo më shumë kategori demografike të veçanta, bazuar në identitetin që ata mbajnë. P.sh duke e përdorur gjininë si ndryshore, mund t'i krahasojmë folësit meshkuj kundrejt folëseve femra. Shumë studime sociolinguistike përqipen të marrin parasysh ndryshore të shumëfishta, p.sh.: gjininë, moshën, klasën shoqërore, profesionin, lokacionin gjeografik, seksualitetin, etj (Baker 2010: 31).

Një qasje që është marrë nga disa variacionistë është nxjerrja e të dhënave. P.sh. Labov (1966) vizitoi tri dyqane në Manhatan (me paga të larta, të mesme dhe të ulëta) dhe ua bën punonjësve një pyetje, që ishte e dizajnuar për ta nxjerrë përgjigjen “kati i katërt (fourth floor)”. Shqiptimi i *r*-së në fjalët *fourth* dhe *floor* ishte me prestigj në anglishten amerikane (e ashtuquajtura *r*-postvokalike, shqiptimi i së cilës në anglishten britanike nuk konsiderohet me prestigj). Njujorkezët luhaten në përdorimin e kësaj veçorie, me mungesën e *r*-së, duke e mbajtur me më pak prestigj. Pasi nxori përgjigjen ‘*fourth floor*’, Labov bëri sikur nuk e kishte dëgjuar përgjigjen, në mënyrë që të mund të nxirrte më shumë theksim përsëritja e kujdesshme e përgjigjes. Ai zbuloi se njerëzit në dyqanin me çmime të larta përdorën formën me prestigj më shumë, ndërsa ata nga dyqani me çmime të ulëta e përdorën atë më pak, dhe ato nga dyqani me çmime të mesme tregoi zhvendosjen më të madhe në përdorimin e formës me prestigj kur u kërkua që të përsërisnin përgjigjen e tyre. Studimi i tij tregoi se përdorimi i kësaj forme me prestigj ndryshonte sipas nivelit të formalitetit dhe klasës shoqërore (Baker 2010: 32).

Sociolinguistë të tjerë kanë provuar të mbledhin të dhëna në një situatë më pak të kontrolluar, p.sh. një numër i studimeve që kanë provuar të analizojnë ndryshimet gjinore gjuhësore kanë raportuar gjetje, duke regjistruar një numër të vogël të folësve në mjedise, si: vendi i punës, darka, shtëpia, dhe janë hulumtuar frekuencat e fjalëve nga Zimmerman dhe West (1975),

Mulac et al. (1988). Disa studiues të tjerë kanë raportuar përshtypjet e tyre të ndryshimeve gjinore bazuar në ndërveprimet me bashkësinë e tyre ose grupmoshatarët e tyre (Lakoff 1975, cit. sipas Baker 2010:32).

Schmid (2003, cit. sipas Baker 2010: 33) kreu një analizë të dallimeve gjinore në sektorin e gjuhës së folur 10 milionë fjalësh në BNC. Ai shqyrtoi termat që reflektojnë sjelljen e bisedës, fjalë ose kategori, të cilat Lakoff (1975) i quan “fjalë të grave”: përdorimi i mbrojtjes, hezitimi, përgjigje minimale, pyetje dhe leksik nga domeni që ai priste të kishin epërsi te femrat (veshja, ngjyrat, shtëpia, ushqimi, pijet, trupi dhe shëndeti, referencat personale dhe lidhjet, deiksi kohor). Ai gjithashtu shqyrtoi termat që priste të kishin epërsi te meshkujt (betimet, fjalët që kanë të bëjnë me trafikun dhe makinat, punën, informatikën, aferat publike dhe nocione abstrakte). Në përgjithësi, duket se janë mbështetur disa nga hipotezat e dallimeve gjuhësore gjinore nga hulumtimi i tij: femrat, për shembull, priren të përdorin më shumë fjalë që lidhen me ngjyrën, shtëpinë dhe veshmbathjen, ndërsa meshkujt përdorin më shumë fjalë që kanë të bëjnë me publikun dhe koncepte abstrakte. Sidoqoftë, me disa nga kategoritë e tjera të dallimeve gjinore të pritshme, Schmid vuri re që kishte një pamje më komplekse. Kështu, gratë përdorën fjalë të caktuara betimi më shumë se meshkujt, megjithëse fjalët betuese që kanë tendencë të kenë një 'efekt të fortë' (p.sh. shih Jay 1992: 162) ishin më të shpeshta te gjuha e meshkujve. Brenda kategorisë së makinave dhe trafikimit, gratë kanë tendencë t'u referohen formave të transportit më shpesh (*autobus, tren, makinë*), por meshkujt tentojnë të përdorin aspekte më specifike të transportit. Një tjetër tip i testimit statistikor që thekson Baker (2010: 40) është analiza e ‘grupimeve’, e cila është e dobishme në termat e grupimit së bashku të tipave të ngjashëm të folësve (‘në grupime’), që ia lejon studiuesit të konstatojë ndryshoret sociale që janë më me ndikim në termat e dallimeve gjuhësore.

Schmid (2003: 217–19) thekson se dallimet gjinore që ai gjeti në BNC ka mundësi të lidhen me situata të ndryshme që burrat dhe gratë shpesh e gjejnë veten në pika të ndryshme të jetës së tyre. Pra, në kohën kur u mblodhën të dhënat e korpusit të folur (fillimi i viteve 1990), ishte më e zakonshme që mashkulli të ishte në punë me pagë dhe një grua të kujdesej për fëmijët dhe të drejtojë shtëpinë. Prandaj, dallimet gjuhësore të gjetura ka mundësi t'i pasqyrojnë këto role të ndryshme shoqërore, në vend që të reflektojnë ndonjë dallim "thelbësor". Mund të argumentohet se nëse burrat qëndrojnë në shtëpi dhe kujdesen për fëmijët, ata do të përdorin më shumë fjalë për shtëpinë, ushqimin dhe marrëdhëniet (Baker 2010: 41).

Një mënyrë tjetër e të menduarit për variacionin është fokusimi në atë se si mjedisi apo përdorimi i funksionit të gjuhës do të ketë ndikim në llojin e gjuhës që përdoret, më shumë se fokusimi në atë se si tipat e ndryshëm e ndryshëm të folësve e përdorin gjuhën në mënyrë të ndryshme. Pra, në vend se të merrim parasysh identitetin e folësve, përqendrohemi në kontekstet gjuhësore në të cilat ata e gjejnë veten. Konteksti e luan një rol të rëndësishëm në llojin e gjuhës që ne e përdorim, ka mundësi ta adaptojmë përdorimin tonë të gjuhës në këto kontekste të ndryshme, kur shkruajmë një letër akademike, kur flasim me një grup shokësh, kur provojmë të porosisim një biletë me telefon etj, pavarësisht se posedojnë ndryshore identiteti, si: gjinia, moshë, klasa shoqërore. Biber (1988, 1998) i referohet kontekstit të prodhimit gjuhësor si regjistër, por përdoren edhe termat, si: mjedis, zhanër, stil, varietet, tip teksti apo domen (Baker 2010: 44).

Korpusi mund të analizohet dhe të krahasohet me korpuse të tjera ose pjesë të korpuseve për ta studiuar variacionin. Më e rëndësishmja, mund të studiohet distribucioni për të treguar se sa shpesh shfaqet një tipar fonologjik, leksikor, gramatikor, diskursiv apo pragmatik, gjithashtu ku shfaqen ato (Kennedy 1998:4).

Reppen (2010: 31) thekson se pyetjet që variojnë nga niveli i fjalëve dhe intonacioni deri në atë se si funksionon bashkësia e tipareve gjuhësore së bashku në ligjërim, të gjitha mund të hulumtohen përmes gjuhësisë së korpusit. Pyetjet se si ndryshon përdorimi i gjuhës sipas situatës, ose me kalimin e kohës, janë gjithashtu fusha ideale për të eksploruar përmes hulumtimit të korpusit.

2. KRIJIMI I KORPUSIT

Gjuhësia e korpusit kërkon mjetet e veta për ta kryer analizën e korpusit. Prandaj, një korpus nuk është i vlefshëm, përveç nëse përdoret në lidhje me programin kompjuterik që mund të kryejë shpejt dhe me saktësi manipulime mbi përmbajtjen e tij. Disa mjete gjenden në internet, duke i lejuar përdoruesit të kërkojnë një korpus në internet, ndërsa mjetet e tjera drejtohen nga kompjuteri i vetë përdoruesit (Baker 2010:7).

Zbulimet në teknologjinë e informacionit kanë ndryshuar mënyrën e punës me korpusin. Gjuhëtarët mund t'i përdorin kompjuterët për të ruajtur sasi të mëdha tekstesh dhe të rigjejnë fjalë, fraza apo shprehje të tëra të tekstit në kontekst shpejt dhe në mënyrë shteruese në ekranet e tyre. Veç kësaj, njësitë gjuhësore mund të ruhen në mënyra të ndryshme, p.sh numërimi i njërive me të cilat ato kolokohen, sjellja e tyre tipike gramatikore. Gjuhësia e korpusit tani është e lidhur me kompjuterin në mënyrë të pandashme, që paraqet shpejtësi të jashtëzakonshme, përgjegjshmëri totale, përsëritje të saktë dhe aftësi të ruajë sasi të mëdha të të dhënave. Kompjuterët e kanë lehtësuar zhvillimin e bazës matematikore për procesin gjuhësor matematik dhe kanë sjellë në studimet gjuhësore një shkallë të lartë të saktësisë së matjes, që është e rëndësishme në të gjitha shkencat. Ata ua kanë lejuar gjuhëtarëve të punojnë me varietete të gjera tekstesh dhe kështu kërkimin e përgjithësimeve për gjuhën dhe përdorimin e gjuhës, që mund të shkojë përtej teksteve të caktuara apo intuitës së gjuhëtarëve të caktuar. Kuantifikimi i përdorimit të gjuhës së studimeve të korpusit të bazuar ka çuar në përgjithësime interesante gjuhësore dhe e ka përtërirë apo e ka forcuar lidhjen ndërmjet përshkrimit gjuhësor dhe aplikimeve të ndryshme (Kennedy 1998:5).

Në studimet e korpusit, që përfshihet edhe analiza kritike e diskursit, besohet se analiza e korpusit duhet të përdoret në lidhje me format e tjera të analizës që merr parasysh kontekstet sociale, historike, politike, si dhe teoritë ekzistuese (Baker 2010:8).

Tognini-Bonelli (2010: 15-17) thekson se nuk ishte mjedisi gjuhësor që e stimuloi zhvillimin e korpusit, por teknologjia. Ajo e jep progresin e ndërtimit të korpusit elektronik përmes tri fazave apo gjeneratave:

- a. Vitet 1960-1980; faza kur është mësuar se si krijohet korpusi prej një milion fjalësh; pa materiale të disponueshme në formë elektronike, kështu që gjithçka është dashur të shkruhet me tastierë.
- b. Vitet 1980-2000 ndahen në dy dekada:
 - 1980 - dekada e skanerit, kur me skanerët më të hershëm bëhet reale një target prej njëzet milionë fjalësh.
 - 1990 - kur teksti bëhet i disponueshëm si nënprodukt i shtypjes së kompjuterave, duke lejuar një rend tjetër të përmasave në madhësinë e synuar të korpuseve.
- c. Vitet 2000 - kur teksti që kurrë nuk kishte ekzistuar si kopje e fortë vihet në dispozicion në sasi të pakufizuar nga interneti.

Për ta krijuar një korpus, së pari duhet të hulumtojmë a ekziston një korpus paraprak që i plotëson nevojat tona dhe, nëse ekziston, duhet të shohim a përfaqësohet gjuha si duhet në atë korpus. Reppen (2010: 31) thekson se një hap esencial në ndërtimin e korpusit është kur kemi një pyetje të qartë të hulumtimit, sepse kjo do ta udhëheqë dizajnin e korpusit dhe ai duhet të jetë përfaqësues i gjuhës që vëzhgohet.

2.1.Përfaqësimi dhe madhësia e korpusit

Varësisht prej pyetjes hulumtuese dhe fushës së cilës i përket ajo, dizajnohet edhe madhësia e korpusit. Për hulumtimet që janë krijuar për t'i kapur të gjitha domethëniet e një fjale të caktuar apo të një grupi fjalësh, siç është ndërtimi i një fjalori, atëherë korpusi duhet të jetë shumë i gjerë dhjetëra ose qindra miliona fjalësh. Reppen (2010: 32) vëren se madhësia e korpusit varet nga dy faktorë: përfaqësimi (a janë mbledhur mjaftueshëm tekste që të përfaqësojë tipin e gjuhës nën vëzhgim) dhe praktikaliteti (kufizimet kohore). Në disa raste është e mundshme që të përfaqësohet e gjithë gjuha që studiohet, p.sh.: është e mundshme të mblidhet e gjithë puna e një autori të veçantë apo tekstet historike nga një periudhë e caktuar, tekstet nga një ngjarje e caktuar (p.sh.:emisionet në radio dhe në television dhe fjalimet politike). Në këto raste mund të arrihet përfaqësimi i plotë i gjuhës. Një shembull i tillë është korpusi prej 604,767 fjalësh i nëntë sezoneve të serialit të famshëm televiziv *Friends*. Sidoqoftë, në shumicën e rasteve nuk është e mundur të arrihet përfaqësimi i plotë, dhe në këto raste madhësia e korpusit përcaktohet duke kapur mjaftueshëm gjuhë për saktësi përfaqësimi.

Kennedy (1998: 21) për madhësinë e teksteve thekson se korpusi mund të përmbajë ose një popullatë totale të teksteve ose një mostër tekstesh nga një popullatë e dhënë, p.sh.: për studime stilistike apo për studime diskursi një korpus që përmban 2,000 mostra fjalësh të nxjerra nga shumë tekste mund të mos jetë në gjendje të kapë në mënyrë të besueshme karakteristikat e brendshme strukturore të teksteve të plota, ku pjesa hyrëse dhe përmyllëse mund të pritet të ketë karakteristika të tjera gjuhësore. Studimet e tilla kërkojnë përdorimin e teksteve të plota.

Sipas Leech (1991), korpusi është përfaqësues në kuptimin që gjetjet e bazuara në analizë mund të përgjithësohen në gjithë gjuhën apo në pjesë specifike të saj, p.sh.: struktura e korpusit Brown apo LOB është dizajnuar me kujdes, kështu që mund të konsiderohen se janë përfaqësues të anglishtes së shkruar britanike dhe angleze. Balanca ndërmjet teksteve të shkruara në ICE është 60%, kurse e teksteve të folura 40%, ky është një ndër korpuset me balancën në favor të teksteve të folura (Kennedy 1998: 62). Balanca në korpus nuk adresohet duke pasur sasi të barabartë të teksteve nga burime të ndryshme të folura e të shkruara, sepse askush nuk e di çfarë proporcioni fjalësh të folura e të shkruara prodhohen çdo ditë në gjuhë. Në mënyrë individuale, të folurit përbën një proporcion më të madh se sa të shkruarit që shumica prej nesh pranon ose prodhon në një ditë tipike. Balanca në korpusin e shkruar është e vështirë, Sinclair (1991) sugjeroi se për një korpus të shkruar të përgjithshëm kriteri minimal për selektimin e teksteve duhet të përfshijë ndarjen ndërmjet fikcionit dhe jofikcionit. Summers (1991) vëren se edhe një korpus i shkruar prej 30 milionë fjalësh është i vogël kur krahasohet me popullatën e teksteve të shkruara nga e cila është mbledhur. Gjithashtu, është i rëndësishëm viti apo vitet kur janë përzgjedhur tekstet (Kennedy 1998: 63).

Sa u përket kriterëve se sa mund të jetë përfaqësues një korpus regjional për qëllime krahasuese, Kennedy (1998: 64) thekson se vendbanimi i subjekteve, shtetësia apo edhe të lindurit në një vend të ri mund të krijojnë probleme për përpiluesin e korpusit. Holmes (1996) raporton se për qëllimet e projektit ICE, një folës mund të konsiderohet folës i anglishtes së Zelandës së Re, nëse ka jetuar në Zelandë të Re qysh para moshës 10 vjeçare, nuk është kthyer nga ndonjë udhëtim jashtë vendit brenda vitit të fundit ose që nuk ka kaluar më shumë se 10 vjet ose më shumë se gjysmën e jetës së vet jashtë vendit. Pra, efektet e moshës, mosha kur fillon ta mësojë gjuhën, përvoja e udhëtimeve, edukimi, profesioni, etnia, janë disa nga faktorët që duhet të konsiderohen kur selektojmë tekste të folura ose të shkruara për përfshirje në korpus (Kennedy 1998: 65).

Derisa përfaqësimi dhe balancimi lidhen me kualitetin e korpusit, madhësia e tij lidhet me kuantitetin. Kjo çështje nuk ka të bëjë me numrin e fjalëve apo me fjalët e ndryshme në korpus, por me atë se sa kategori duhet t'i përmbajë teksti, sa mostra duhet të jenë në secilën kategori dhe sa fjalë duhet të jenë në secilën mostër. Çdo korpus, sado i madh të jetë, nuk mund të jetë asnjëherë më shumë se një mostër e vogël e gjuhës së folur dhe të shkruar të prodhuar ose të pranuar nga gjithë përdoruesit e gjuhës kryesore brenda një dite të vetme (ibid.). Në korpusin LOB një milion fjalësh, rreth 100 fjalë shfaqen më shumë se 1000 herë. Një korpus i gjerë jo domosdoshmërisht e përfaqëson më mirë gjuhën apo varietetin se një korpus më i vogël. Për një studim prozodik një korpus prej 100,000 fjalësh është i mjaftueshëm sa për të bërë përgjithësime për qëllime deskriptive, për aq sa mund të jemi të sigurt se të folurit është spontan. Ndërsa një analizë e përdorimit të formave të foljes mund të bëhet me rreth gjysmë milioni fjalësh, kurse analiza sintaksore dhe analiza e frekuencës së fjalëve kërkon gjysmë milion deri në një milion fjalë. Brenda kategorisë së tekstit, sa më i madh të jetë numri i mostrave individuale, aq më e madhe është besueshmëria e analizave të ndryshoreve gjuhësore. Korpusi mund të jetë më pak ose më shumë adekuat bazuar në masën në të cilën korpusi i përshtatet qëllimit që i është vendosur. Në gjeneratën e parë të korpusit për një mostër janë përdorur 2000 fjalë. Disa prej këtyre teksteve ishin dokumente të plota, por disa ishin edhe vetëm pjesë të dokumenteve (Kennedy 1998: 68).

Sa i përket korpusit të folur në veçanti, korpusi LLC i anglishtes së folur është përdorur për analiza leksikore, gramatikore, prozodike dhe analiza diskursi, SEC (*The Lancaster/IBM Spoken English Corpus*) është dizajnuar dhe është përdorur veçanërisht për hulumtime të detajuara prozodike. Korpusi përmban rreth 52,600 fjalë të anglishtes standarde britanike të folur të të rriturve, mbledhur ndërmjet viteve 1984-1987 nga 11 kategori, duke përfshirë: emisione dhe lajme në radio, ligjërata universiteti, emisione religjioze, emisione fiktive, poezi, dialogë dhe propagandë. Një tjetër korpus i rëndësishëm në vitet 1990 është CSAE (*Corpus of Spoken American English*) i dizajnuar që të sigurojë korpusin e parë të madh të kompjuterizuar të anglishtes amerikane të folur të përdorur nga të rriturit dhe një nga korpuset e mëdha të folura të përpiluar që nga korpusi LLC i anglishtes britanike. Fillimisht synonte të kishte rreth 200,000 fjalë, por kohët e fundit përshkruhet se kishte një milion fjalë. CSAE përbëhet së paku prej 80 orësh të folur të transkriptuar të 900 folësve, duke përfshirë dialogë e monologë, biseda spontane dhe të planifikuara, të drejtpërdrejta, telefonike, diskutime, shërbime të ndryshme, shitje, biseda në

vendin e punës, takime politike dhe biznesi, këshilla, ligjërata, lutje, predikime, shfaqje, biseda në radio, komentime sporti dhe lajme (Kennedy 1998: 36-37).

Një nga korpuset më të mëdha të një varieteti të veçantë të anglishtes së folur është *Wellington Corpus of spoken New Zealand English*. Ky korpus një milion fjalësh ishte dizajnuar që të reflekojë sa më shumë që të jetë e mundur bisedat e rastësishme në kontekste informale, të mbledhura ndërmjet viteve 1988-1993. Përbërja e këtij korpusi ishte: monolog, fjalim gjysmëzyrtar dhe dialog informal. Kompletimi i korpusit me 500 mostra, secila me nga 2000 fjalë, është transkriptuar ortografikisht me veçori minimale prozodike, siç është gjatësia e pauzës (Kennedy 1998: 38).

Korpusi i teksteve të folura është shumë i vështirë për t'u ndërmarrë, duke filluar nga shumë çështje që lidhen me marrjen e mostrave, mbajtjen e regjistrave, etikën dhe anonimitetin, ndërsa ka ndërlikime në transkriptimin e tyre dhe në shënimet gramatikore, që zakonisht nuk e prekin korpusin e shkruar (Baker 2010:13). Prandaj, nuk është aspak befasuese që korpusi i folur në ekzistencë ka tendencë të jetë më i pakët në numrin e përgjithshëm dhe më i vogël se korpusi i shkruar.

Edhe pse gjuha e folur është forma më e zakonshme, shumica e studimeve bazuar në korpusin leksikor apo gramatikor të anglishtes janë bazuar në analizën e korpusit të shkruar. Është shumë më i ngadaltë dhe më i vështirë për t'u bërë një korpus i folur, për shkak të transkriptimit, përfshirjes ideale të veçorive komplekse fonetike dhe tipareve prozodike, po ashtu është më i shtrenjtë për t'u marrë përsipër (Kennedy 1998: 20).

2.2.Dizajni i korpusit

Kennedy (1998: 70) jep tri fazat kryesore që duhet të ndërmerren për përpilimin e korpusit: dizajni i korpusit, koleksioni i teksteve dhe kodimi ose shënimi i tekstit. Dizajni optimal i korpusit është shumë i varur nga qëllimi për të cilin synohet të përdoret, nëse qëllimi është të ndërmerren analiza gjuhësore dhe sociolinguistike për t'i zbuluar sistemet apo përdorimet e këtyre sistemeve, atëherë duhet të mendohet mirë tipi, përmbajtja, struktura dhe madhësia e korpusit; nëse korpusi është sinkronik, duhet të vendoset viti apo vitet kur janë prodhuar ato; nëse korpusi është diakronik, atëherë periodha që mbulohet është relevante, duhet të ketë një mbulim sistematik kronologjik të

periudhës apo pikës së fundit të periudhës për t'u siguruar që ka një datë adekuate në të cilën bazohen studimet e ndryshimit gjuhësor. Një vendim tjetër, sipas Kennedy (1998: 71), që duhet të merret për përpilimin e korpusit është edhe përmbajtja e tij, nëse gjuha duhet të jetë e folur apo e shkruar, apo të dyja dhe proporcionin që duhet ta kenë në korpus. Nëse tekstet e folura janë pjesë e korpusit, duhet pasur kujdes në zhanret që përfshihen në të. Kennedy (1998: 72) jep një tabelë me disa kategori që janë përfshirë në korpuset e mëhershme dhe që duhet të merren parasysh për përfshirje në korpusin e teksteve të folura:

- **Monolog**
- **Formal**

I shkruar që lexohet me zë të lartë;

Të folurit publik i përgatitur, por jo i shkruar;

- **Më pak formal**

Ligjërata akademike;

Komentime në ngjarje publike;

Komentime sporti;

Demonstrime;

- **Dialog**
- Dialog i drejtpërdrejtë;
- Diskutime publike (p.sh në radio);
- Transaksione biznesore ose profesionale;

Klienti dhe profesionisti;

Bashkëveprimi ndërmjet kolegëve në vendin e punës;

Shitje komerciale;

- Informal

Brenda familjes;

Ndërmjet miqve;

- Dialog telefonik

Ndërmjet bashkëbiseduesve që e njohin njëri-tjetrin;

Ndërmjet bashkëbiseduesve që nuk e njohin njëri-tjetrin;

- Ndërveprim i strukturuar

- Intervista

Formale, p.sh. programe arti;

Më pak formale, p.sh. me të mbijetuarit dhe dëshmitarët e ndonjë ngjarjeje, si aksidenti;

- Debate

- Takime komiteti

Kennedy (1998: 73-74) thekson se një korpus prej 1 milion fjalësh konsiderohet i vogël për shumë qëllime, por do të konsiderohej një ndërmarrje e madhe, nëse do të përfshinte tekste të folura. Një mostër teksti prej 2000 - 5000 fjalësh do të jetë i besueshëm për shumë studime gjuhësore, p.sh. diskursin, ku nevojiten mostra të gjata duke përfshirë kohezionin apo karakteristikat e pjesës së hyrjes, të zhvillimit dhe të përfundimit. Disa ndryshore gjuhësore shtesë që duhet të merren parasysh në përmbajtjen dhe strukturën e korpusit janë: origjina e tekstit, pjesëmarrësit, mediumi (i folur apo i shkruar), zhanri, stili, mjedisi, gjendja faktike, tema, data e publikimit, autorësia (gjinia, mosha, nacionaliteti), mosha dhe madhësia e audiencës së synuar apo rrethi i lexuesve.

Kur kryhet dizajni, përmbajtja dhe struktura e korpusit, duhet të përcaktohen edhe tekstet individuale që vendosen në kategoritë e përcaktuara më herët. Ekzistojnë tri mënyra për t'i futur tekstet në fajll kompjuterik. Njëra mënyrë është kthimi i asaj që është shkruar me dorë në formë kompjuterike, forma tjetër, nëse korpusi krijohet me qëllimin e lehtësimit të studimeve është e

mundshme që me pëlqimin e studentëve të merren esetë e shkruara në word dhe të transferohen në të dhënat e korpusit dhe mënyra e tretë është përmes skanimit (Kennedy 1998: 79).

2.3.Mbledhja e teksteve

Kur bëhet e qartë pyetja kërkimore, mund të fillojë krijimi i korpusit. Detyra e radhës është identifikimi i teksteve dhe zhvillimi i planit për mbledhjen e tekstit. Në të gjitha rastet, përpara mbledhjes së teksteve, është e rëndësishme ta kemi lejen për mbledhjen e tyre (Reppen 2010: 32). Përpara se tekstet të kopjohen në të dhënat e korpusit, përpiluesi i korpusit duhet ta kërkojë dhe ta marrë lejen e autorëve dhe të publikuesve që e kanë të drejtën e autorit, të drejtat e të cilëve duhet të njihen për privatësinë. Përpiluesit e korpusit të folur kanë vërejtur se shumë pjesëmarrës janë të gatshëm ta japin lejen që regjistrimet të bëhen në një kohë të paspecifikuar në të ardhmen për aq kohë sa ata kanë të drejtë t'i dëgjojnë të dhënat e mbledhura dhe t'i fshijnë pjesët ku e ndiejnë veten të turpëruar ose jorehat. Kur tekstet mbledhen nga domeni publik, duhet të kërkohet leja nga autoritetet përkatëse, siç është drejtori i stacionit të transmetimit apo i rrjetit televiziv dhe shpeshherë këto autoritete kërkojnë tarifa të larta edhe nëse rrjeti është publik (Kennedy 2010: 76).

Kur krijojmë korpusin, janë disa procedura që duhet të ndiqen, pavarësisht nëse korpusi përfaqëson gjuhën e folur apo gjuhën e shkruar. Reppen (2010:32-34) thekson disa çështje që lidhen me krijimin e korpusit dhe duhet të merren parasysh, si: Çfarë e përbën një tekst? Si do të emërtohen fajllat? Çfarë informacione duhet të përfshihen në secilin fajll? Si do të ruhet teksti (formati i fajllit). Po ashtu, përpara se të ruhen tekstet, duhet të vendosen konventat e emërimit të fajllave. Shumica e analizave të korpusit funksionojnë shumë mirë me formatin *plain text*.

Krijimi i teksteve të shkruara është një detyrë më e lehtë se e teksteve të folura, por të dyja kanë sfida që lidhen me to. Shpesh tekstet e shkruara janë tashmë në format elektronik dhe nëse tekstet nuk janë, ato futen në formën elektronike. Nëse tekstet përfaqësojnë gjuhën e nxënësve, shkrimin e fëmijëve, është e rëndësishme të ruhen strukturat jostandarde drejtshkrimore dhe gramatikore (Reppen 2010: 34).

Para së gjithash, korpusi i folur që nuk ekziston në formën e shkruar duhet të regjistrohet dhe të transkriptohet, në mënyrë që të analizohet duke përdorur mjetet e korpusit që janë aktualisht në dispozicion. Tekstet e folura mund të mbledhen me regjistrues digjitalë. Kualiteti i zërit, lehtësia

e ruajtjes dhe aftësia për t'i lidhur regjistrimet me transkriptimet janë shumë të rëndësishme. Kur bëhen regjistrimet, është e nevojshme të transkriptonen në format digjital. Shndërrimi i një teksti të folur në një format të shkruar është një proces i lodhshëm dhe merr shumë kohë. Varësisht prej kualitetit të regjistrimit dhe nivelit të detajeve që duhet të përfshihen (prozodia, intonacioni, pauzat) mund të marrë 10-15 orë për ta transkriptuar një orë regjistrim (Reppen 2010, Kennedy 1998).

Përpara se të kalohet te transkriptimi, duhet të merren disa vendime. Disa prej pyetjeve që mund të bëhen për transkriptimin janë: si do të transkriptonen format e reduktuara? Shpeshherë është e vështirë të dëgjohet ose të kuptohet së çfarë është thënë, për shkak të zhurmave jashtë apo kur folësi nuk është i qartë. Në këto raste transkriptuesi e bën një supozim dhe e shënon një pikëpyetje (?) pas fjalës së supozuar. Ose thjesht mund ta shkruajë *e paqartë* dhe numrin e rrokjeve pas fjalës. Të folurit e mbivendosur është një tjetër sfidë në transkriptimin e të folurit. Folësit shpeshherë flasin në të njëjtën kohë ose ia përfundojnë fjalën njëri-tjetrit. Dëgjuesit shpesh përdorin përgjigje minimale (uh, hm, mm) për të treguar se janë duke dëgjuar dhe janë të vëmendshëm ndaj asaj që po flitet. Është mirë që edhe këto forma të standardizohen, p.sh. nëse është përdorur mm, të shkruhet me tri m-ja. Të qeshurat, përsëritjet, pauzat janë gjithashtu veçori që duhet të transkriptonen në gjuhën e folur. Pauzat do të mund të ndaheshin në pauza të shkurtra (dy deri në pesë sec) dhe në pauza të gjata (më të gjata se gjashtë sec). Nëse krijojmë një korpus të transkriptuar prozodik, zakonisht bëhet në dy faza: e para bëhet transkriptimi dhe e dyta kthimi prapa dhe shënimi i veçorive prozodike (Reppen 2010: 35).

Në anën tjetër, gjuha e folur edhe pse është rreth nesh, prapëseprapë është më vështirë dhe më e shtrenjtë për t'u mbledhur se gjuha e shkruar, pikërisht për shkak të hapave shtesë që duhet të ndërmerren për ta kthyer korpusin e regjistruar në mënyrë elektronike në korpus të shkruar apo të transkriptuar. Mund të mblidhet direkt monologu apo dialogu nga pjesëmarrësit në video. Disa zhanre mund të mblidhen me leje, qoftë si emisione publike apo nga ndonjë formë e parapërgatitur për emision në radio apo television. Ndojëherë tekste të përshtatshme për korpus janë të qasshme edhe në akriyat e radios dhe të televisionit me një kualitet të lartë të regjistrimit. Përpiluesi i korpusit të folur, kur e regjistron, duhet ta konsiderojë si të rëndësishëm kualitetin e regjistrimit. Sidomos kur nga këto regjistrime do të bëhen analiza e transkriptime delikate me detaje prozodike, atëherë kualiteti i regjistrimit apo burimi është i domosdoshëm. Transkriptimi merr shumë kohë, është i

shtrenjtë dhe sjell shumë vështirësi. Derisa nuk ka një transkriptim mjaftueshëm të detajizuar, është e pamundur të ndërmerret ndonjë hulumtim i rëndësishëm. Theksi i fjalës dhe i fjalisë dhe intonacioni kanë efekt substancial në kuptim. Parakushtet për studime diskursi janë: gjatësia e pauzave, hezitimet, radhitja korrekte e të folurit të njëkohshëm, reagimet etj. Ndërsa për studime gramatikore dhe për shumë aplikime në fushën e mësimin të gjuhëve për shumë qëllime do të kërkohej transkriptim më pak i detajizuar (Reppen 2010: 81-82). Transkriptimi është një përafrim i shkruar jo i përsosur i të folurit. Niveli i detajeve të transkriptimit është i lidhur me përdorimin e tij. Pasi teksti i folur apo i shkruar të mblidhet, para pranimit të të dhënave është e rëndësishme të kontrollohet nëse teksti i zgjedhur është i përdorshëm.

Pra, pas transkriptimit dhe futjes së të dhënave është esenciale të kontrollohet teksti a ka kualitet të lartë dhe a ka gabime. Rishikimi dhe redaktimi janë të rëndësishme për të siguruar integritetin e teksteve në korpus.

2.4.Shënimi i korpusit

Shënimi i referohet shtimit të informacioneve në fajllin e korpusit. Jo të gjitha korpuset përmbajnë shënime, megjithatë shënimet mund ta lehtësojnë analizën e korpusit. Shënimi mund të ndahet në dy tipa: shënimi i dokumenteve dhe shënimi i thjeshtë. Shënimi i dokumenteve u referohet më shumë kodeve HTML që përdoren për të treguar veçori të dokumentit, siç janë: paragrafët (Kennedy 1998), fonti, fjalitë, numri i fjalive, identifikimi i folësit dhe shënimi i fundit të tekstit (Reppen 2010).

Një prej shënimeve më të zakonshme të korpusit përfshin etiketimin e secilës fjalë në korpus me kategorinë e saj gramatikore (p.sh.: emër, mbiemër, ndajfolje). Këto etiketa mund të jenë shumë të dobishme për adresimin e një numri pyetjesh dhe ndihmojnë për të zgjidhur shumë prej çështjeve që lidhen thjesht me kërkimin e një fjale të veçantë (Reppen 2010: 35, Kennedy 1998). Korpusi gjithashtu mund të analizohet për të treguar strukturën e fjalisë apo funksionin e klasëve të ndryshme të fjalëve në fjali (parsing) (Kennedy 1998: 21).

Gjatë regjistrimit dhe gjatë ruajtjes së teksteve në versionin elektronik në kompjuter është esenciale që të planifikohen sa më shumë informacione që të jetë e mundur për autorësinë dhe burimin e teksteve. Në rastin e teksteve të folura apo të shkruara është e rëndësishme të shënohet

kur dhe ku është regjistruar apo mbledhur teksti. Në rastin e teksteve të folura përpiluesi duhet të shënojë kush ishte i pranishëm, ndonjë marrëdhënie relevante ndërmjet pjesëmarrësve, temën, nëse diskursi ishte i planifikuar apo spontan dhe shkallën e formalitetit. Ndërsa në rastin e materialeve të emisioneve shpeshherë është e vështirë të gjenden informacione për pjesëmarrësit, e që është esenciale në analizat bazuar në korpus. Gjithashtu, është e dobishme të mblidhen informacione për vendin e lindjes dhe ku janë rrituar ata, ku kanë jetuar dhe sa kanë jetuar në një apo më shumë vende. Në korpusin BNC janë konsideruar këto karakteristika kontekstuale për mbledhjen e teksteve të gjuhës së folur (Kennedy 1998: 76-77):

Mjedisi (makinë, zyrë, tren);

Aktiviteti (duke shikuar TV);

Lokacioni (qyteti ose rrethi ku është bërë diskursi);

Koha;

Data;

Audienca (numri i pjesëmarrësve dhe numri i njerëzve që e kanë dëgjuar bisedën);

Spontaniteti (shkalla nga i planifikuar në jo i planifikuar);

Tema;

Gjinia;

Mosha;

Raca;

Gjuha e parë apo varieteti gjuhësor i pjesëmarrësve të tjerë;

Profesioni;

Edukimi;

Grupi social;

Marrëdhënia me personin që regjistron (familjar apo i panjohur);

Dialekti i personit që regjistron;

Këshillohet që përpiluesit e korpuseve të mbledhin më shumë tekste sesa kërkohet brenda çdo kategorie, në mënyrë që të mbushen boshllëqet nëse nuk mund të merret leja që ndonjë tekst të përfshihet në korpus (Kennedy 1998: 78).

Shumica e projekteve të krijimit të korpuseve përfshijnë një formë të skemës së anotimit në tekstet e korpusit të tyre që siguron informacion metalinguistik ose metatekstual, të dobishëm për shumë forma analizash. P.sh. tekstet shpesh janë të anotuara me informacione rreth identitetit të autorit të tyre, me ndryshore demografike, si: gjinia, mosha, vendi etj. Përveç kësaj, krijuesit e korpusit mund të dëshirojnë të kodifikojnë informacione rreth audiencës së synuar, datën e publikimit, zhanrin, regjistrin, nivelin e vështirësisë, nëse tekstet janë gjuhë e folur apo e shkruar, të ndërmjetësuar nga kompjuteri ose të shkruara që përdoren si gjuhë e folur (skenari i filmit). Përfshirja e këtij lloji të metainformacionit e bën më të lehtë që llojet e ndryshme të teksteve të krahasohen me njëra-tjetrën ose të veçohen një ose më shumë lloje. Një lloj tjetër i shënimit mund të bëhet në nivelin ortografik, ku, për shembull, nivele të ndryshme të titujve dallohen nga paragrafët ose fonti italic dallohet nga ai bold. Në mënyrë që të përfitojnë nga korpusi një gamë e gjerë e përdoruesve, ka kuptim që të ruhet në formatin më të standardizuar (zakonisht si plain text). Kjo ka avantazhin që korpuset më pas mund të importohen për përdorim me softuerë të ndryshëm të analizave, shumica e të cilëve mund ta përballojnë me lehtësi plain text.

Një nga standardet më të njohura të kodimit quhet *Text Encoding Initiative* (TEI), i cili përdor një seri udhëzimesh për kodimin e tekstit, të hartuara nga *Standard Generalised Markup Language* (SGML). TEI është fleksibil në atë që ua lejon (në të vërtetë ua kërkon) përdoruesve individualë të korpusit të shtojnë ose të përshtatin udhëzimet e tij ku është e nevojshme. Elementet SGML shfaqen brenda kllapave, p.sh. , <p> paraqet fillimin e një paragrafi të ri.

Anotimi është veçanërisht i rëndësishëm për gjuhësinë e korpusit, sepse lejon të bëhen analiza shumë më komplekse dhe më të sofistikuara (Baker 2010: 16).

Ekziston një numër skemash të njohura anotimesh, gjithashtu është e mundur që përdoruesit e korpusit të hartojnë skemën e tyre të anotimeve për qëllime specifike, që nuk nënkupton domosdoshmërisht etiketimin e çdo fjale ose fjalie në korpus. Për shembull, në ekzaminimin e *betimit* të McEnery (2006), ai sajoi një numër mënyrash të vërejtjes së fjalëve të betimit në korpusin e tij (duke lënë të gjitha fjalët e tjera të paetiketuara) (Baker 2010:18).

Skema e tij merrte parasysh funksionet e betimit, si dhe gjininë, moshën dhe klasën shoqërore të folësit dhe gjininë, numrin, animacionin dhe personin e caktuar të betimit. Skema e kategorizimit është realizuar kryesisht me dorë, bazuar në ekzaminimin e kujdesshëm të secilit rast individual të betimit në korpus. Ky lloj etiketimi selektiv ka të ngjarë të jetë me interes të veçantë për sociolinguistët, të cilët mund të jenë të interesuar në aspektet specifike të përdorimit të gjuhës dhe prandaj nuk janë tepër të shqetësuar për etiketimin e çdo fjale të vetme në një korpus (Baker 2010: 18).

2.5.Mjetet për shënimin dhe transkriptimin e korpusit

EXMARaLDA Partitur Editor është një mjet për transkriptimin dhe shënimin e regjistrimeve digjitale, që është përdorur edhe për transkriptimin regjistrimeve të korpusit të folur të shqipës në Kosovë. Me Partitur Editor mund të futen, të modifikohen dhe të lëshohen transkriptime në formatin muzikor. Shkarkimi i këtij programi është falas: <https://exmaralda.org/en/release-version/>.



EXMaRALDA përfshin:

- Transkriptime të regjistrimeve;
- Shënim fleksibil për kategori të zgjedhura në mënyrë të lirë;
- Dokumentim sistematik të një korpusi përmes të dhënave;
- Prodhim fleksibil të të dhënave të transkriptimit në paraqitje dhe formate të ndryshme (shënim, dokument);
- Pyetje të asistuar nga kompjuteri të transkriptimit, të shënimit dhe të të dhënave;
- Ndërveprues me të dhëna të bazuara në XML, që lejojnë shkëmbimin e të dhënave me mjete të tjera (Praat, ELAN, Transcriber) dhe mundësojnë një përpunim fleksibil dhe përdorim të qëndrueshëm të të dhënave.


EXMaRALDA përdoret në kontekste të ndryshme, në të cilat analizohet gjuha e folur, si:

- Analiza e diskursit;
- Studimi i nxënies së gjuhës dhe shumëgjuhësia;
- Fonetika dhe fonologjia;
- Dialektologjia dhe sociolinguistika;


EXMARaLDA u zhvillua në Qendrën Bashkëpunuese të Kërkimit "Multilingualism" në Universitetin e Hamburgut. Që nga korriku 2011, zhvillimi i këtij programi vazhdon në Qendrën e Hamburgut për Korpusin Gjuhësor, që nga nëntori 2011 në bashkëpunim me Arkivin për Gjermanishten e Folur në Institutin për Gjuhën Gjermane në Mannheim.

Si përdoret programi Partitur Editor?


Hapi i parë që duhet ndjekur për ta transkriptuar një incizim është butoni *Recordings*.



Për ta shtuar incizimin në listë, shtypet butoni *Add*. Incizimi duhet të jetë në formatin *WAV*, sepse formatet e tjera nuk pranohen.




Pasi shtohet incizimi, selektohet segmenti i caktuar. Selektimi i segmentit fillimisht bëhet në mënyrë automatike me *Add event*, por, nëse ky segment nuk përputhet me këtë ndarje në mënyrë automatike, zhvendoset me kursor derisa kufiri i ndarjes të jetë i plotë kuptimisht.



Butonat për të operuar me incizimin gjenden në mes të oshilogramit ose në mes të fjalëve/fjalive të ndara në segmente.




Për të shtuar segmente derisa të përfundohet i gjithë regjistrimi, shtypet butoni ***Append interval***.



Disa nga rregullat e transkriptimit të përdorura në këtë punim janë:


- Njësia segmentore përfundon me pauzë;
- Parafjalët, pjesëzat dhe rënia e tingullit shënohet me hapësirë;
- HIAT;
- Fjalitë;
- . declarative;
- ? pyetëse;
- ! thirrmore;
- ... fjali/fjalë të papërfunduara;
- / përmirësim i fjalës;
- · pauzë e shkurtër;
- ·· pauzë deri në gjysmën e dytë të sekondës ;
- ··· pauzë rreth një sekondë;
- ((3s)) pauzë më shumë se një sekondë;
- () shprehjet e pakuptueshme;
- sugjerim: shkruani "inc" në qoftë se nuk kuptoni asgjë, shkruani supozime nëse nuk jeni të sigurt se çfarë dëgjoni;

- (O) komentet, veprimet joverbale;




Shkronjat, të cilat mund të mos jenë të disponueshme në një tastierë normale, mund të futen duke përdorur tastierën virtuale. Nëse tastiera është e pajisur me tastet e kërkuara, nuk ka nevojë të përdoret tastiera virtuale. Nëse tastiera nuk shfaqet automatikisht në ekran, zgjedhet opsioni **View< Keyboard** për ta shfaqur atë.


Nga opsionet që shfaqen në tastierë zgjedhet *HIAT-Roman languages supplement*, sepse i përshtatet më shumë alfabetit të shqipes.




Anotimi shërben për të futur të dhëna për njësitë gjuhësore nga fusha të ndryshme të gjuhësisë.



Të dhënat për njësitë gjuhësore gjatë anotimit bëhen duke shtypur butonin **Tier** → **Add tier**.



Futja e të dhënave në Partitur Editor bëhet përmes opsionit **Speakers** → **Add attribute**.



Të dhënat që shkruhen këtu janë:

Subjekti: Prishtinë, 2

Mosha: 39

Gjinia: Femër

Shkollimi: I lartë

Profesioni: Mësuese


Vendlindja: Shtime

Vendbanimi: Prishtinë

Gjuha amtare:Gjuha shqipe

Gjuhë të tjera:Gjuha angleze

Secili fajll e ka emërtimin e njëjtë, pra incizimi, të dhënat e subjekteve dhe transkriptimet ruhen me të njëjtin emërtim. Regjistrimet ruhen në WAV, të dhënat e folësve në Word dhe transkriptimet në Partitur Editor.



3. VARIETETET E GJUHËS SHQIPE

Të gjitha emërtimet për shqiptarët dalin nga baza e vjetër *alb-*, *arb-*, që lidhen me emrin mesjetar të vendit Arbënë, kurse nga shek. XVIII shqiptarët janë quajtur me një emërtim mbi bazën *shqip - shqiptar*. Pra, në gjuhën shqipe përdoren emërtimet arbërishte e Italisë, e Greqisë, arbnishte e Zarës, por për varietetet e tjera përdoret emërtimi shqipe (Ismajli 2019: 345).

Historikisht brenda shqipes janë zhvilluar dy ndarje të mëdha dialektore: gegnishtja në veri dhe toskërishtja në jug të lumit Shkumbin. Toskërishtja flitet në jug nga Struga deri tek Adriatiku në nivel të Shkumbinit, duke e përfshirë edhe shqipen e folur në Greqi dhe në Itali, ndërsa gegnishtja flitet në veri, duke përfshirë edhe arbneshët e Zarës. Kjo ndarje vazhdon tutje në: gegnishten jugore, gegnishten qendrore, gegnishten veriperëndimore/verilindore, ndërsa në jug toskërishten veriore, labërishten dhe çamërishten dhe arvanitishten e arbërishten e Italisë. Ismajli më tutje thekson se izoglosat që shërbejnë për ndarje të këtilla nuk i përkasin të njëjtës periudhë historike. Ndarja e dialekteve dytësore vijon në: arvanitika, arbërishte dhe në arbnishte (Ismajli 2019: 347-348).

Dallimet ndërmjet dy dialekteve kryesore të shqipes prekin sistemin fonetik, gramatikor dhe fushën e leksikut. Ismajli (2019: 349-350) jep të përmbledhura dallimet më të rëndësishme strukturore midis dialekteve të shqipes:

- a. gegnishtja ka zanore funksionalisht të gjata dhe të shkurtra: *plāk-plāk*, toskërishtja nuk e bën dallimin ndërmjet zanoreve të gjata dhe të shkurtra;
- b. gegnishtja ka zanore hundore: *ã, ù*, toskërishtja nuk ka;
- c. zanores hundore të gegnishtes *ã* i përgjigjet në toskërishte zanorja *ë*;
- d. gegnishtja ka togun *ua/u*, toskërishtja *ua*;
- e. gegnishtja ka *ī*, toskërishtja *ye, ie*;
- f. gegnishtja ka grupin nistor *vo-*, toskërishtja *va-*;
- g. gegnishtja ka ndërzanoren *-n-*, toskërishtja e bën *-r-*;
- h. gegnishtja e ka paskajoren *me punue*, toskërishtja përdor lidhoren në vend të paskajores;
- i. gegnishtja e ka të ardhmen e domosdosë *kam me punue*, toskërishtja *do të punoj*;

- j. grupet *mb, nd, ng* në gegnishte shpesh realizohen si *m, n, η*, ndërsa në toskërishte shpesh ruhen grupet e tilla,
- k. në gegnishte *nj* fundore apo në mes të fjalës kalon në *j*, kurse në toskërishte *nj* shpesh ruhet;
- l. në gegnishte ruhen bashkëtingëlloret fundore të zëshme, ndërsa në toskërishte shurdhohen;
- m. vendi i theksit në huazimet turke në gegnishte përshtatet sipas modelit të shqipes, ndërsa në toskërishte ruhet vendi i theksit;
- n. huazimet moderne në gegnishte nuk e ruajnë theksin origjinal, ndërsa në toskërishte e ruajnë atë.

Desnickaja (1972: 69) klasifikimin e të folmeve geqe e ndan në grupin veriperëndimor dhe në grupin verilindor. Grupin veriperëndimor e ndan tutje në të folmen e pjesës perëndimore të Alpeve veriore të Shqipërisë dhe në pjesën verilindore të liqenit të Shkodrës; të folmen e popullsisë shqiptare të krahinës së Krajës në Malin e Zi; të folmen e pjesës qendore të Alpeve të Shqipërisë së veriut dhe të pjesës së mesme të basenit të Drinit të bashkuar; të folmet e rajoneve rreth Shkodrës dhe të folmen e qytetit të Shkodrës. Grupin verilindor e ndan në të folmet kalimtare të pjesës lindore të basenit të Drinit të bashkuar dhe të folmen e Kosovës.

Në periudhën e sundimit turk krahinat shqiptare të verilindjes kanë anuar nga qendrat ekonomike, si: Prizreni, Gjakova, Peja, Prishtina, derisa pjesa veriperëndimore ka anuar nga ndikimi ekonomik dhe politik i Shkodrës. Në Krahinën e Kosovës shqiptarët përbënin 70% të popullsisë, e cila përqendrohej në rajonet: Pejë, Gjakovë, Prizren, Prishtinë, Vushtrri, Mitrovicë, Ferizaj dhe Kaçanik. E folmja dialektore e shqiptarëve të Kosovës është nën ndikimin e fortë të trajtës geqe të gjuhës letrare. Krahina e Kosovës që në kohën romake ka qenë pikëqendrim rrugësh të rëndësishme të komunikacionit, që e ndanin siujdhesën Ballkanike. Nëpër të kalonte rruga Shkodër-Lipjan-Nish, e cila lidhte bregdetin Adriatik me krahinat e brendshme të Siujdhesës. Kjo rrugë ishte e rëndësishme edhe në kohën e mesjetës dhe në sundimin turk. Në xeheroret malore të Novobërdës dhe të Janjevës përfitimi i arit, i arxhendit dhe i plumbit përbënte një prej burimeve të lulëzimit ekonomik të Kosovës. Rëndësi të madhe ka pasur Prizreni, i cili shtrihet në pjesën jugore të Kosovës, ka qenë një prej qendrave më të rëndësishme tregtare në pjesën evropiane të Peradorisë turke. Në shek. XVI-XVII ka qenë qytet i zejtarisë dhe i tregtisë së zhvilluar. Pjesën

më të madhe të popullsisë e përbënin shqiptarët myslimanë. Numri i popullsisë arrinte në 46 mijë banorë. Në treg është dëgjuar gjuha turke, sllave, shqipe dhe vllehe. Në këtë qytet vend të posaçëm zinin prodhimet e armëve dhe e lëkurës, që shiteshin në Serbi dhe në Egjipt. Edhe në qytetin e Gjakovës dhe të Pejës u zhvilluan zejjet dhe tregtia (Desnickaja 1972: 94-110).

Në periudhën e sundimit turk, qytetet më të mëdha dhe më të rëndësishme ishin Vushtrria dhe Prishtina. Prishtina gjithnjë e ka ruajtur rëndësinë e saj si qendër zejtare dhe tregtare, sepse është shtrirë në qendër të Kosovës, në rrugën e rëndësishme tregtare Maqedoni-Bosnjë (Desnickaja 1972: 111).

Desnickaja (1972: 113-125) thekson këto dukuri, të cilat janë tipike për të folmen e Kosovës:

1. Akoma ruhet kryesisht shqiptimi i diftongjeve: *ue, ye, ie*, mirëpo me një tendencë të monoftongimit, ku në disa pjesë të territorit të Kosovës ka përfunduar tashmë dhe shqiptohen si: *u, y, i*.
2. Dukuria që lidhet me shqiptimin e përgjithshëm të artikulimit të zanoreve, të cilat dukshëm tërhiqen prapa, qëndron në të forcuarit përkatës të elementit të velarizimit gjatë shqiptimit të një vargu zanoresh. Kjo shprehet më shumë në të tërhequrit prapa të zanores *a* të gjatë, e cila përcillet me një labializim.
3. Dukuria e delabializimit *y>i* vërehet edhe në të folmen e Kosovës.
4. Dukuria e diftongimit *e >ie*, që është e kufizuar vetëm pas okluzivit të pazëshëm të qiellzës së prapme: *qe-kije, ti ke- ti kie*.
5. Ndryshimet *mb>m* dhe *nd>n*: *me mbarue- me maru, mbushi-mushi, mbrenda-mrena, vend-ven*.
6. Përzierja e shqiptimit të konsonanteve *dh* e *ll*, por shkalla e realizimit të kësaj dukurie fonetike zakonisht nuk është stabile, sepse në të njëjtin lokalitet mund të hasen trajtat me *dh* dhe me *ll*.
7. Kthimi i qiellzoreve të vjetra të mesme okluzive (*q, gj*) në afrikate (*ç, xh*).
8. Reflekset e grupeve të vjetra të shqipes *kl', gl'* në Kosovë paraqiten me okluzivet e qiellzës së prapme: *klan-kian-kan*.

9. Si inovacion në Kosovë paraqitet edhe likuidimi i opozicionit të formanteve *i/u* gjatë formimit të trajtës së shquar të emrave të gjinisë mashkullore me tipa të ndryshëm temash: *mik-i, zog-i, beg-i*.

Variantet e shqipes (Gjinari dhe Shkurtaj 2003: 151) shtrihen në Shqipëri dhe jashtë kufijve të Shqipërisë, si toskërishtja në Greqi, në krahinën e Çamërisë deri në gjirin e Prevezës, në Maqedoni në anën e Prespës deri nga Manastiri, kurse gegërishtja në Mal të Zi, në Ulqin, në Krajë, në Vranjë, në Tuz, në Malësi të Podgoricës, në Plavë, në gjithë Kosovën, në Jabllanisë, në Preshevë, në Bujanoc, në Peshter afër Novi Pazarit dhe në Maqedoni, në Strugë, në Ohër, në Dibër, në Kërçovë, në Prilep, në Tetovë, në Gostivar, në Shkup dhe në Kumanovë.

Përveç kësaj ndarjeje, Gjinari e Shkurtaj veçojnë edhe të folmet e arbëreshëve të Italisë në Italinë e Jugut dhe në Sicili, të folmet e arbëreshëve të Greqisë në rrethinat e Athinës në Peloponez, të folmen e Mandricës në Bullgari, të folmen e disa fshatrave shqiptare në Ukrainë dhe të folmen e arbëreshëve të Zarës në bregdetin e Dalmacisë. Nga këto të folme, vetëm e folmja e Zarës ka dalë nga dialekti verior, nga anët e Krajës, ndërsa të folmet e tjera janë të folme të dialektit jugor, sidomos të toskërishtes jugore. Ndërsa shpërngulje më të vona të shqiptarëve gjenden edhe në Turqi, në SHBA, në Argjentinë, në Australi etj.

Gjinari e Shkurtaj (2003: 152-159) të folmet e gjuhës shqipe i grupojnë në dy dialekte kryesore, të cilat gjeografikisht ndahen te lumi Shkumbin, në të djathtë të lumit shtrihet dialekti verior ose gegërishtja, kurse në të majtë të tij dialekti jugor ose toskërishtja. Secili dialekt ndahet në dy nëndialekte: gegërishtja veriore dhe gegërishtja jugore në dialektin gegë dhe toskërishtja veriore dhe toskërishtja jugore në dialektin toskë. Nëndialektet e gegërishtes ndahen gjeografikisht te lumi i Matit. Gegërishtja veriore shtrihet në të djathtë të Matit: në Mirditë, në Pukë, në Lumë, në Has, në Malësinë e Gjakovës, në Kosovë, në Maqedoninë Veriperëndimore, në Dukagjin, në Malësi të Madhe, në Shkodër dhe në rrethinat e saj, në krahinën e Krajës dhe të Ulqinit. Gegërishtja jugore shtrihet në të majtë të lumit Mat: në zonën e Elbasanit, të Durrësit, të Tiranës, të Krujës, të Matit, të Lurës, të Peshkopisë, të Maqedonisë Perëndimore prej Dibrës deri në Shkup e Kumanovë. Toskërishtja veriore shtrihet në rrethet e Beratit, të Fierit, të Skraparit, të Pogradecit, të Kolonjës, të Permetit, të Tepelenës dhe në Vlorë e në fshatrat veriore e verilindore të saj. Toskërishtja jugore shtrihet në Labëri, në anët e Gjirokastrës e të Delvinës dhe në Çamëri. Të folmet kalimtare gjenden

në një zonë të ndërmjetme midis dy dialekteve të shqipes, ku përfshihen: Rajca, Bërzeshta, krahina e Vërçës, e Shpatit, e Polisit, e Sulovës, e Dumresë, e Darsisë, e Peqinit, Bregdeti i Poshtëm i Kavajës dhe pjesa veriore e fushës së Lushnjës.

Nëndialektet i ndajnë edhe në grupe të të folmeve, dialekti verior ndahet në këto grupe: gegërishtja veriperëndimore, gegërishtja verilindore, gegërishtja qendrore dhe gegërishtja e Shqipërisë së Mesme. Gegërishtja veriperëndimore dhe gegërishtja verilindore i përkasin nëndialektit të gegërishtes veriore, që si kufi ndarës e kanë Thethin. Gegërishtja qendrore përfshin: të folmet e Lurës, të Lumës, të rrethit të Dibrës dhe të folmet shqipes të Maqedonisë Perëndimore, të Dibrës, Kërçovës, Tetovës, Gostivarit, Shkupit e Kumanovës. Në të folmet e Shqipërisë së Mesme përfshihen: të folmet e Tiranës, të Durrësit dhe të Elbasanit. Në dialektin e toskërishtes vetëm nëndialekti jugor ndahet më tutje në labërishte dhe në çamërishte, që ndahen gjeografikisht te lumi i Shalësit, në jug të Delvinës. Labërishtja përfshin të folmet e Labërisë e të krahinave të rrethit të Gjirokastrës, ndërsa grupi i dytë përfshin të folmet e zonës së Konispolit dhe të Çamërisë deri te gjiri i Prevezës (Gjinari, Shkurtaç 2003: 160-161).

Raka (2004: 105-106) vazhdon klasifikimin me grupet e të folmeve që e përbëjnë gegërishten verilindore. Në viset perëndimore të Maqedonisë, duke filluar me rrethinën e Shkupit, Tetovën, Gostivarin, Dibrën, Kërçovën dhe Strugën flitet gegërishtja jugore, që ndryshe njihet si gegërishte qendrore, krahas grupit të të folmeve të Shqipërisë Jugore, që e përbëjnë të folmet e Elbasanit, të Tiranës dhe të Durrësit. Ndërkaq, të folmet e rrethit të Kumanovës dhe qyteti i Kumanovës nuk përfshihen në këtë grup, por shkojnë me të folmet e gegërishtes verilindore, që janë më të afërta me të folmet e Moravës, të Preshevës dhe Bujanocit, por edhe me të folmet e Kaçanikut. Disa fshatra në rrethin e Strugës dhe e folmja e Ohrit e Prespës me rrethinë u përkasin të folmeve toske. Në Kosovë të gjitha të folmet janë geqe dhe përfshihen në gegërishten veriore. E folmja e Kosovës Veriore ndahet në dy grupe: e folmja e Mitrovicës me Shalën e Bajgorës dhe rrethinat e tjera, ku hyn edhe e folmja e Llapit me rrethinë. E folmja e Kosovës Qendrore përfshin Drenicën dhe Prishtinën. E folmja e Dukagjinit përfshin: Pejën, Gjakovën dhe Prizrenin me rrethinat e tyre. E folmja e Suharekës me rrethinë përbëjnë një nëngrup tjetër. Në të folmet e Kosovës Jugore hyjnë: e folmja e Ferizajt, e Shtimes, e Lipjanit, e folmja e Kaçanikut, përveç të folmes së Jugut të komunës së Kaçanikut, e cila mbetet si e folme kalimtare midis gegërishtes verilindore dhe gegërishtes qendrore. Grupin e të folmeve të Kosovës Lindore e përbëjnë: Vitia,

Gjilani, Kamenica, e folmja e Preshevës, e folmja e Bujanocit me të folmet e fshatrave të Karadakut.

Të folmen e Kaçanikut Raka (2004: 107-108) e klasifikon në këto grupe kryesore: e folmja e qytezës së Kaçanikut, e folmja jugore e Kaçanikut, e folmja përreth fshatrave të Kaçanikut. Kjo e fundit vazhdon të ndahet më tutje në dy grupe të mëdha: të folmet e anës së djathtë të lumit Lepenc (Ivaja, Gajra, Bobi, Kovaçeci, Biçeci, Nikaj, Vata, Dubrava, Doganaj, Elezaj, Dura, Semaja, Gabrica) dhe të folmet e Gjurgjedellit, Llanishtes, Nikocit, Kërbliqit, Runevës, Stagovës, Kaçanikut të Vjetër dhe Begracës. E folmja jugore Kaçanikut përfshin të folmen e fshatrave: Gllloboçicë, Shtrazë, Kotlinë, Gorancë, Rezhancë, Krivenik, Seçishtë, Laç dhe Pustenik në anën e djathtë të lumit Lepenc dhe në anën e majtë të tij Dimca, Paldonica dhe Dermjaku. Edhe e folmja e Hanit të Elezit përfshihet në të folmet jugore të komunës së Kaçanikut

3.1.E folmja e Deçanit

Për të folmen e Deçanit ka shkruar Mehmetaj (2006) në monografinë *E folmja e Deçanit me rrethinë-morfologjia dhe fjalëformimi*. Në këtë të folme, emrat e gjinisë mashkullore marrin mbaresën i, edhe emrat që mbarojnë me -k, -g, -h e marrin këtë mbaresë, përveç brezit të vjetër që e përdorin edhe mbaresën -u: *miku, zogu, krahu*. Disa emra, që në të folme të tjera janë të gjinisë mashkullore, përdoren si emra të gjinisë femërore, si: *pjepën-pjepna, ner-nera, uj-uj* etj. Si emra të gjinisë femërore përdoren edhe emrat që mbarojnë me zanore të theksuar: *liri, shpi, tepsi*, por edhe emrat që mbarojnë me bashkëtingëllore, si: *kokërr, motër, kumull* etj. Si emra të gjinisë asnjënjës përdoren emri *uj-t* dhe *krye-t*, ndërsa disa emra të tjerë, kur përdoren me përcaktorë, dalin si asnjënjës: *kta vjam, kta mish, çeta mill* etj. Prapashtesat që përdoren për formimin e gjinisë femërore në këtë të folme janë: *-esh, -e, -ic, -an* etj (Mehmetaj 2006: 33-40).

Për emrat mashkullorë, Mehmetaj (2006 42-50) shton se shumësin e formojnë me këto prapashtesa: *-a, -e, -j, -na, -en*. Me prapashtesën -a: *doktorr-doktorra, oficer-oficera, msus-msusa, nip-nipa, thelb-thelba, pus-pusa, plum-pluma* etj; me prapashtesën -e: *ven-vene, katun-katune, oborr-oborre, fakulltet-fakulltete/fakullteta, burg-burxhe, fis-fise, mal-maliqe, rreth-rrethije, shtrat-shtratije, pyll-pyje* etj; me prapashtesën -j: *grumull-grumuj, mashkull-mashkuj, gu-guj, huhuj, pe-pej, zog-zoj, ftu-ftoj, thua-thoj, krue-kroj* etj.; me prapashtesën -na: *asht-eshtna, mall-mallna, drith-drithna, bar-barna*; me prapashtesën -en: *vlla-vllazen, dre-dreçen*. Emrat e gjinisë

femërore, në shumicën e rasteve, e formojnë shumësin me prapashtesën –a: *dardh- dardha, than-thana, ar-ara, letër-letra, motër-motra, lakën-lakna, shpi-shpija, buri-burija, kusi-kusija, fshis-fshisa, lugin-lugina*, por e formojnë edhe me prapashtesën –na: *loj-lojna, er-erna, pelhur-pelhurna* etj. Në këtë të folme përdoren pesë rasat e shqipes, por shpeshherë del edhe rasa thirrore. Te rasa gjinore e dhanore, numri njëjës, te emrat mashkullorë, del mbaresa –i dhe –u, ndërsa te emrat e gjinisë femërore –s dhe –e: *i ni djali, i ni çike, por edhe çiks*. Rasa gjinore e dhanore e numrit shumës del me mbaresën–e dhe –ve: *mrena tri dite, shokve, grave* etj. Trajta e shquar e rasës kallëzore formohet duke ia vënë emrit mbaresën –n: *oborrin, malin, shiun, dheun, njerin, deren, lulen, shpin* etj. Rasa thirrore e ka trajtën e emërores së pashquar, të shoqëruar me pasthirrat, *o, ore, more: O Syl-o, oj Hatmon* etj. Rasa rrjedhore njëjës te emrat e gjinisë femërore del njësoj si rasa dhanore e gjinore. Trajta e pashquar e rrjedhores shumës del me dy forma, me mbaresën -ve dhe me mbaresën –sh: *pej degve, i ra terr sysh* (Mehmetaj 2006: 55-60).

Te kjo e folme hasen mbiemrat e formuar me prapashtesën –un: *i rritun, i matun, i djegun, i çelun* etj, por edhe me prapashtesën –m: *i lam, i lym, i zim, i martum* etj. Te numërori merret si shembull numërori *një*, i cili del me këto variante: *njo, ni, i dhe j*. Numërorët nuk e kanë kategorinë e gjinisë, përveç numërorëve *dy* e *tri*: *dy djem-dy çika; tri gra-tre burra*. Numërori përdoret edhe si i emëruar: *dyshti, treshi, nizetedytën* etj.

Përemrat vektorë në këtë të folme dalin:

Emërore:	une/un/u	ti	na	ju
Dhanore:	mu/mue	ty/tyje	ne	juve
Kallëzore:	mu/mue	ty/tyje	ne	juve
Rrjedhore:	teje	nesh		

Mehmetaj (2006: 73) jep paradigmen e përemrit vektor *ai*:

Emërore:	aj, tina, ti	ajo	ata	ato
Gjinore:	i ati (atina, atinaj)	i asaj (asej, asajna, asejna)	i,e atyne	i,e atyne,tyne

Dhanore:	ati, i atina	asaj, asajna	atyne, u	atyne, u
Kallëzore:	ato, e	ato, e	ata, i	ato, i
Rrjedhore:	ati, atina, atinaj	asaj, asejna, asej	atyne, tyne	atyne, tyne

Përemri vetvetor del me këto trajta: *vet, veti, vetja*. Përemrat dëftorë që përdoren në këtë të folme janë: *ky, kjo, kta, kto, ai, ajo, ata, ato*. Nga baza e këtyre dëftorëve, me parashtesën –*çe* janë formuar këta përemra: *çeky, çekjo, çeta, çeto, çaj, çajo, çata, çato*. Dëftorë të tjerë përdoren edhe: *asi (asish), çasi, çasish, ksi, ksish, aso, asoje, çeso, çesoje, çesoshe, çasoshe, kso, ksoshe, ksifar* etj. Nga përemrat pyetës përdoren: *kush, cilli, cillt, cilla, cillat, çka (ça, shka), sa, çfare* etj. Përemrat e pacaktuar që dalin në këtë të folme janë: *kush, nokush, asnjo, asnjoni, secilli, secilla, pakkush, shumkush, xhithsecilla, tjeterkush, xhithkush, kurrnjo, nonjo, xhdokush, tjetexho, kushmos* etj. Pronorët shfaqen me këto forma: *jem, jeme, yt, jote, tan, tone, juve, juv*, ndërsa vetvetorët: *i vet, i veti, e vet, e vetja* etj (Mehmetaj 2006: 73-84).

Sistemi foljor, sipas Mehmetajt (2006: 85), në këtë të folme ka ndryshime të mbaresat vetore, të përdorimi i njëjës kohë në vend të tjetrës, të kalimi i njërit zgjedhim në tjetrin dhe në kuptimet leksikore. Foljet e zgjedhimit të parë dalin me këto forma: *punoj, punon, punon, punojm, punoni, punojn*; foljet e zgjedhimit të dytë e zgjerojnë vetën e parë njëjës me mbaresën –i: *shkeli, shtypi, djegi, iki, preki*; disa folje të zgjedhimit të tretë kanë kaluar në zgjedhimin e parë ose të dytë: *flas-foli, vras-vraj, pres-prej* etj. Diateza pësore-vetvetore ka këto forma: *gzohna, gzohesh, gzohet, gzohem, gzohi, gzohen*. E pakryera e dëftores ndërtohet mbi temën e së tashmes dhe të pjesores: *delsha, delshe, delke, delshim, delshi, delshin*, por ka edhe folje të cilat dalin me dy trajta në këtë kohë, si: *vjelsha-vilsha, tjerrsha-tirsha, nxjerrsha-nxirrsha* etj. Diateza pësore-vetvetore e kësaj kohe formohet me pjesëzën u përpara: *u mërzitsha, u nxhitsu, u lajshe* etj. E kryera e thjeshtë del me këto trajta: *ftofa, ftofe, ftofi, ftofem, ftofet, ftofen*. Foljet e zgjedhimit të dytë dalin me dy trajta: *pjek-poça* të brezi i vjetër dhe *pjek- pjek* të brezi i ri. Diateza pësore-vetvetore formohet me pjesëzën u: *u nxeva, u ktheva, u pshtjella/ pshtolla* etj. Koha e kryer në këtë të folme formohet me foljen ndihmëse *kam/kom* dhe me pjesoren e foljes: *kom mjell, ke mjell, ka mjell, kemi mjell, kini mjell, kan mjell*; ndërsa format e diatezës pësore-vetvetore formohen me foljen *jam* dhe me pjesoren: *jom nal, jom zbe, jom rrit* etj. E kryera e plotë formohet nga e pakryera e foljeve *kom* e *jom* dhe pjesorja e foljes: *kish marr, kishin livru, ish nal, ish met*; ndërsa e kryera e tejshkuar me

aoristin e foljeve *kom* e *jom* dhe pjesoren e foljes: *pat liftue, pat nxerr, pat fal*. Te kjo e folme përdoren edhe kohët e përbëra të dyta, si: *i kemi pas ble, ki pa thon, jon kon met, i kan pa prish, kish pa met, ishin kon pa lodh* etj. Koha e ardhme në këtë të folme del me dy trajta: kam + paskajore dhe do + e tashme e lidhore.

Mënyra lidhore në të folmen e Deçanit përdoret më shumë te fjalitë kushtore, lidhore, kohore: *sa t jom xhall kom me ta nxi jeten*; mënyra kushtore: *pata me ardh/ po e kom shpin vetun*; mënyra habitore: *kositkna, kositke, kositka, kositkem, kositki, kositkan*; mënyra dëshirore: *lafsha, lafshe, laft, lafshim, lafshi, lafshi*; mënyra urdhërore: *puno, laj, thuj, dixh, merri, shkeli, ruju* etj. Prej formave të pashtjelluara të foljes, pjesorja del me këto trajta: *punu/punue, livru/livruë, gatu/gatue, lon, dhon, thon*; paskajorja: *me ardh, me dal, me hi, për me pshtu, për pa dek* etj dhe përcjellorja: *tu dal, tu ardh, tu punu, tu nejt* etj (Mehmetaj 2006: 85-109).

Edhe pjesët e pandryshueshme të ligjëratës nuk kanë ndonjë dallim të madh me të folmet e tjera në Kosovë, por i kanë edhe disa veçori karakteristike. Ndajfolje vendi që dalin në këtë të folme janë: *kho, kun, asajde, ksajde, lerg, teposht/pjetposht, çekho, çenej, çanej, çenenaj, çaty, çatje, çetu*; ndajfolje kohe: *tash, prom, parprom, parnat, partjetripromi, nestra, masnestri, parvjete, tonaheret, tonshi, nisesos, kadit, dogri, apet*; ndajfolje mënyre: *burrnisht, cubnisht, fytaz, kollaj, malsorçe, diçqysh, kurçysh, nryshe, mazu, dallash*; ndajfolje sasi: *çekaç, çaç, boll* etj. Ndeshen parafjalët: *tu, tuk, te, tëk, kah, në, për, nër, nëpër, mi, përmi, pej, jashta, përskej, përte* etj. Në këtë të folme përdoren këto lidhëza bashkërenditëse e nënrenditëse: *e, edhe, as, veç, po, e, prandaj, pranajshi, masi, kur, n koft ç, sepse, edhe se, edhe ç, ku, kudo ç, sado, si* etj. Pjesëzat në këtë të folme dalin: *o, more, ore, oj, mori, ori, pekej, bash, nja, pernjo, rrafsh, rrumullak, veç* etj. Disa prej pasthirmave të cilat përdoren në të folmen e Deçanit janë: *uha, çyçja, kuku, haj medet, mozomakeq, hup, hajt bre, mule, shuj more, tymermeçi* etj (Mehmetaj 2006: 109-124).

3.2.E folmja e Rugovës

E folmja e Rugovës është trajtuar nga Hajdaraj (1996) në monografinë *E folmja e Rugovës*. Në këtë studim janë paraqitur veçoritë fonetike, morfologjike dhe sintaksore të kësaj të folmeje, por edhe janë krahasuar disa tipare me të folmet e tjera të afërta me të.

Hajdaraj (1996: 22) jep disa prej veçorive fonetike kryesore në të folmen e Rugovës:

1. Hundorësia ruhet në mënyrë të plotë si në të folmet e gegërishtes veriperëndimore, si: *nâna, hûni, pêni, dryni* etj;
2. Toçu *ua* ruhet vetëm te pjesorja e foljes (*punua, shkua, xhua*) dhe te koha e tashme e foljes *dua*, toçu *ue* ruhet te disa emra (*truell, muej, duej*) ose trajtat me *uo* që i kanë ruajtur disa të folme (*truoll, muoj, duoj*);
3. Togjet konsonantike *gl, kl* i ruan të papalatalizuara: *giûni, giûha, kiê:n* etj;
4. Togjet konsonantike *mb, nd, ng, ngj*, paraqiten në variante të ndryshme (*ndalu-dalu, nduk-tuk, ndejta-tejta, ngutem-gutena, ngadalë-kadale, ngjyey-çyey, mbush-bushi, mbeta-peta, mbrapa-prapa* etj).

Në sistemin morfologjik, Hajdaraj vëren këto veçori në këtë të folme:

1. Përdorimi i infinitivit të vjetër: *me shkua, me punua, me ha:p, me fje:t* etj;
2. Përdorimi i së pakryerës së tipit: *shkojsha, pûnojsha, disha, flêjsha* etj.

Në sistemin sintaksor vërehen këto dallime:

1. Formimi i fjalive bashkërenditëse dhe nënrenditëse me trajtat e pashtjelluara të foljes: *Me pa da:sht s'ishe ar:dh! Tye a:rdh, u tesh n'Cufën!*.
2. Përdorimi i dendur i fjalive mungesore, në të cilat kryesisht mungon njëra nga gjymtyrët kryesore: *Shkove atje mozomâkeç! N'shkofsh te ata, ja ti, ja ata!*

Vendi i theksit në këtë të folme, te fjalët me origjinë turke oksitone janë bërë paraoksitone: *káfe, xháde, çábe, fájde, híle, xhéze* etj. Lëvizje e theksit vërehet edhe te shumësi i disa emrave mashkullorë: *kopsht-kopshtie, drapën-drapâj* etj.

Zanoret në këtë të folme paraqiten në tri shkallë gjatësie: të gjata, të mesme dhe të shkurtra. Në rrokje të mbyllur zanorja e theksuar në shumicën e rasteve është e shkurtër: *bàc, sjàp, dash, èlp* etj., por bëjnë përjashtim emrat që mbarojnë me *ll, r, ç*: *za:ll. Shta:r, ma :ll, cikác, cèrkác* etj. Te emrat e gjinisë femërore në trajtën e pashquar, zanorja është e gjatë në rrokje të theksuar: *ba:c, fu:sh, rru:g, dri:t, fla:k, rra:sht* etj. Zanoret e mesme përftohen nga zanoret e gjata ose të shkurtra gjatë procesit të fleksionit: *bála, lára, bishtúka, sórra* etj. Zanoret e shkurtra hasen te fjalët: *kòs, mòs, pàs, près, tràp* etj. Zanore hundore në këtë të folme janë: *â, î, ê, û dhe ý: â, já, bâj, shtâ:z, rrâ:z, tûti, brê:g, gât, rrê:, xhêj, shtêj, shtî, zâ, hú, hí, pê, ânkh, giâtërr, çîç, lâk,*

lâ:t, gû:g, dêk, rrât, fllâ:x, tât, shpêt, âtërr, sÿ:n, vêt, mêt etj. Zanoret hundore mund të jenë të gjata (*zâ:, pê:, drû:*), të mesme (*zâni, pêni, drûni*) dhe të shkurtra (*gât, pêk, vêt*) (Hajdaraj 1996: 28-33).

Hajdaraj (1996: 33) përshkruan secilën zanore që del në këtë të folme. Zanorja *a* është ruajtur në fjalët: *zjarm, lajthi, thalb*, por në disa fjalë të tjera është alternuar në *e*: *skêj, mestis, shêj* etj. Në disa fjalë të tjera, *si lavdoj, gjëmoj*, ka dhënë *i* ose ka rënë në shkallën e dytë të saj: *lavroj-lëvroj-livroj, lavdoj-livdoj, xhamoj-xhëmoj-xhimoj* etj. Zanorja *e* e patheksuar ruhet te mbaresat e kohës së tashme të vetës së parë, të dytë dhe të tretë të njëjësit: *lahena, falena, lyhena, kruhena*, por jo edhe në vetën e dytë të shumësit *bie*: *lahi, fali, lyhi, kruhi* etj. Zanorja *e* ruhet edhe në fund të ditëve të javës në trajtën e pashquar (e hane, e marte), në disa fjalë të tjera kalon në *u*: *çershishurshi*, kurse përpara tingujve *ç, xh, e*-ja e patheksuar alternohet në *i*: *shisher, tinxhere, pinxhere* etj. Zanorja *ë* ruhet tek emrat përpara bashkëtingëlloretë *r, rr, l, ll, m, n*, dhe te emrat e gjinisë femërore në rasën kallëzore: *vetër, motër, fëmën, êmën, vegël, dimën, lopën, mollën, derën, dritën, rrotën* etj. Zanorja *ë* alternohet në *i* te mbiemrat e formuar me prapashtesën-*shëm*: *i siellshim, i dishim, i kujdesshim, i rriçim, i moçim*, ndërsa te emrat e gjinisë femërore *ë*-ja *bie*: *lops, drits, rrugs* etj. Te disa fjalë *ë*-ja kalon në *i*, si: *qëndroj-çindroj, një-i, gjëmoj-xhimoj, shpërndërroshpindrroj* etj. Përpara bashkëtingëlloretë *m*, zanorja *ë* dëgjohet si *u*: *dasmë-dasum, shkelëmshkelum, merrëm-merrum*. Zanorja *i* vërehet se kalon në *y* te përemri *ai-ay* dhe te disa fjalë të tjera, si: *rrip-rryp, kripë-kryp, qilim-çylym, bilbil-bylyl* etj. Në të folmen e Rugovës, te trajta e pashquar e emrave mashkullorë, për dallim prej te folmeve të tjera të Kosovës që dalin me *i*, del pa *i*: *E bleva i ka:l; Mei gur s 'bâhet mur!* Zanorja *o* në disa fjalë të huaja ka kaluar në *u*: *çukulla:t-çokolladë, bori-buri, gomë-gumë*. Në disa fjalë të tjera në *a*: *lodroj-ladroj, katolik-katalik* etj. Te zanorja *u* vërehet kalimi në *i* te fjala *luftoj-liftoj*. Zanorja *y* ruhet te fjalët, si: *dy, ky, ty, myk, byk, dyll, xhy:s, kryçi, çyp, çymyr, shyçyr, ymër* etj (1996: 33-41).

Togu *ua* në këtë të folme dëgjohet në këto raste: te emrat me rrokje të hapur (*grua, krua, ftua, prrua* te pjesorja e foljeve (*fillua, pûnua, barua, çua*), te koha e tashme e foljeve (*dua, drua*), te ndajfolja (*drua*), te përemri vetor (*unë*) në gjinore dhe në dhanore, në rrokje të mbyllur reflektohet në *ue* (*grua- gruen*), e më shumë mblidhet në *o* (*spua- sponin, krua-kronin*). Togu *ye* po ashtu del i plotë: *kcyë, krye, thye, lye, çye, kapërcyell, dyer* etj. Diftongu *ie* gjendet te fjalët: *diell, çie, miell, fier, nier, shkie* etj. Togu *ae* në këtë të folme ka dhënë një *e* të hapur të

pahundorëzuar: *re, the, le, pe, he, kales, beles* etj. Togu *oe* është reduktuar në *e* të gjatë: *ve:, re:, ve:s* etj (Hajdaraj 1996: 41-46).

Sistemi bashkëtingëllor del me këto ndryshime: bashkëtingëllorja *h* nuk shqiptohet te fjalët: *ndihmoj-dimoj, i,e zbehtë-zbe:t, lehtësoj-letoj, i nxehtë-ze:t* etj; bashkëtingëllorja *nj* ka kaluar në *j*: *thoj, kroje, ftoje, prroje* etj; bashkëtingëlloret *q* e *gj* janë rrafshuar në *ç, xh*: *çeni, çuni, xhumi, xhaja* etj; bashkëtingëllorja *j* në disa raste kalon në *i*: *me viell, me siell, bieshk, zgiedh, fiet, hiek, viesht* etj; bashkëtingëllorja *g* në trajtën e pashquar të emrave, në pozicion fundor kthehet në *k*: *zok, brek, luk, shtok* etj; bashkëtingëllorja *f*, te grupet e fjalëve *fsh, vsh*, ka rënë tërësisht: *pashim, rasha, pa:t*, në disa raste të tjera këmbëhet me *p* dhe *th* : *rrapshoj, rrapshim, i, e rrapshuem, thmi* etj; bashkëtingëllorja *v* bie plotësisht në pozicion nistor te fjala *vdes*: *des, i dekun, e dekt* etj; bashkëtingëllorja *l* shqiptohet si *ll* te disa përemra, si: *i cilli, e cilla, t'cillit, t' cillat* etj; bashkëtingëllorja *s* ka raste kur kalon në *c*: *thinc, rrenc, faculet, egërcim, lypc, shtypc* etj; bashkëtingëllorja *dh* në fund të fjalës e humb zëshmërinë: *garth, i math, u derth* etj; bashkëtingëllorja *p* kalon në *m* te disa fjalë: *psyj, psysh, i, e psyeme* etj; bashkëtingëllorja *sh* alternohet në *ç* në këto raste: *çfaqje, çfarosi, çvillua, çlirua, çpifi, çkye, çmallena* etj; bashkëtingëllorja *zh* në pozicion nistor alternohet në *ç* ose *xh*: *çbihet, xhbordohet, xhveshet, xhgozhdohet, xhdredhet* etj (Hajdaraj 1996: 47-65).

Në fushën e morfologjisë vërehen disa veçori, të cilat nuk hasen në të folmet e tjera të Kosovës. Emrat e gjinisë maskullore, të cilët në trajtën e pashquar e kanë togun zanor *ua*, trajtën e shquar e bëjnë në këtë mënyrë: *ftua-ftoni, krua-kroni potkua-potkoni, thua-thoni* etj. Emrat që mbarojnë me *k* dhe *g*, shquhen me mbaresën *u*: *ujku, xhaku, zoku, shtoku, breku*, por emrat që mbarojnë me *h*, në trajtën e shquar dalin me *i*: *ahi, krahi, plehi* etj. Disa emra që mbarojnë me zanore të theksuar, në trajtën e shquar dalin me *u*: *kau, vllau, sheu, thiu* etj. Emrat mashkullorë të përveçëm, si: *Avdi, Kadri, Sadri, Fasli* etj, në trajtën e shquar dalin me *a*. Emrat e gjinisë asnjësore në këtë të folme kanë kaluar në gjininë mashkullorë, por disa edhe në gjininë femërore: *djathi, drithi, dhjami, tlyeni, tamli, mjalta, bryma, dylla, buka* etj. Emra të gjinisë mashkullorë janë: *çaji, djepi, pasuli, mushku, kurthi, ashti, xhisi, druni* etj, ndërsa emra të gjinisë femërore: *libra, lota, dera, maza, ytyra, lakshata, rriçna* etj.

Emrat e gjinisë mashkullore, të cilët në trajtën e pashquar mbarojnë me *g/k*, shumësin e bëjnë me *ç/xh*: *brek-brixhe, lak-laxhe, shtok-shtoxhe, prak-praç, bujk-bujç, zok-zoç, shtek-shtixhe*, etj. Disa emra të tjerë e bëjnë shumësin me zgjatjen e zanores: *fishek-fishe:k, dyshek-dyshe:k, çarap-çara:p, krah- kra:h* etj. Emrat *krua, ftua, thua, potkua*, shumësin e formojnë me *j*: *ftoj, thoj, potkoj, kroje* etj. Me *j* e formojnë shumësin edhe këta emra: *kalli-kallij, mulli-mullij, hu-huj, dre-drej*. Emrat që në trajtën e pashquar përfundojnë me *-ës, -ues*, shumësin e bëjnë me *a*: *xansa, nëpuns, psuesa, filluesa* etj, me *a* e bëjnë shumësin edhe këta emra: *grushta, pusa, molla, shega, kmisha, prifta, gishta, baba, xhysha, mixha, filxhana, çylyma, groshana* etj. Me ndërrime fonetike e bëjnë shumësin këta emra: *plak-pleç, dash-desh, lak-leç, sjap-sjep* etj. Shumësin me *-ën* dhe *-na* e formojnë këta emra: *dreç-dreçën, meleç-meleçën, bri-briena* etj. Janë edhe disa emra që përdoren vetëm në shumës ose vetëm në njëjës, si: *gërshant, danat, tierçit, pantollt, byku, tërshana, gruni* etj (Hajdaraj 1996: 92-94).

Sa u përket rasave, u është kushtuar rëndësi e veçantë kallëzores njëjës e shumës, rrjedhore njëjës dhe shumës, gjinore e dhanore. Emrat *krua, ftua, potkua, thua*, në rasën kallëzore të pashquar e ruajnë togun *ua*, ndërsa në trajtën e shquar e rrudhin togun në *o*: *kroni, ftoni* etj. Emrat e gjinisë mashkullore, të cilët në trajtën e pashquar dalin me zanore të gjatë, në trajtën e shquar marrin mbaresën *u*: *kau, vllau, trau* etj. Trajta e shquar e kallëzores formohet me mbaresën *-n*: *kroni, ftoni, shokun, krahin, plakun, synin, fyllin, dhin, tezen* etj. Në këtë të folme, trajta e rrjedhore njëjës del me *-e*: *pej bjeshke, pej rruge* etj., ndërsa rrjedhorja në shumës me mbaresat *-sh* dhe *-ve*: *tamël dhesh, fjal burrash, pej burrave, pej krave* etj. Rrjedhorja del edhe me mbaresën *-t*: *d'viçit, t'kiçit, t'puls*, ndërsa te emrat e gjinisë femërore me *-e*: *mish pule, mish delme* etj. Te brezi i vjetër janë hasur edhe trajta të rrjedhore me mbaresën *-sh*: *pej disa krojesh, pej dis lopsh, pej disa fluturash* etj (Hajdaraj 1996: 94-98).

Nyja e përparme *i*, e cila e ka një emër të gjinisë mashkullore në trajtën e shquar me *i*, nuk dëgjohet asnjëherë: *guri math, livadhi vogël, mali diegun, lisi tham* etj. Nyja *i* dhe *e* dalin te emrat e pjesëtarëve të një fisi apo banorëve të një ane: *i kelmatasi, i shkrelasi, i pejani* etj. Në togfjalëshin emër+emër dhe emër+ mbiemër, emrat e farefisnisë përdoren të panyjzuar: *biri Arifit, vjehrrri Rushs, kusherine Beçs* etj (Hajdaraj 1996: 98-100).

Përemri vetor në vetën e parë njëjës është *û* me hundorësi të theksuar, ndërsa te brezi i mesëm dhe te i riu del trajta *ûne/ ûn*. Në rasën dhanore e në kallëzore përdoret trajta *mua*. Trajtat e shkurtra të përemrit *unë* në këtë të folme janë: *em, m' dhe um*. Në rasën rrjedhore del trajta *meje*. Veta e parë shumës e përemrit vetor del *na*, në dhanore e në kallëzore del *ne* dhe rasa rrjedhore *nesh*. Veta e dytë shumës në emërore, dhanore e kallëzore del *ju*, ndërsa në rrjedhore *jush*. Përemri dëftor *ai* del me dy trajta: *ai* te brezi i mesëm dhe i riu dhe *ay* te brezi i vjetër. Në gjinore, në dhanore dhe në rrjedhore del me trajtën *ati*, ndërsa në kallëzore *atâ*. Si përemra dëftorë hasen edhe: *çeky, çekjo, çeta, çato, çaj, çajo, çata* etj. Përemrat që dalin në këtë të folme janë: *kush, i cilli, e cilla, cillt, cillat, ç', çka, sa* dhe *se*. Përemri vetvetor del me trajtat: *vetja, veti, vetvetja*. Përemrat e pacaktuar në këtë të folme janë: *kush, dikush, dicilli, diç, diçka, disa, secilli, ni, njâ, donjâ, secilli, xhithsecilli, tjetër, njâri-tjetri, shumë, pak, disa, xhith, xhithfar, sekush* etj. Përemrat pronorë dalin me trajtat: *ëm, ême, mi, mia, y:n, jo:n, ta:n, tona, yt, jote, tu, tona, juej, taj, tueja*. Numërori *një* në këtë të folme del me trajtën *i* dhe *njâ*, numërorët *dy* dhe *tre* përdoren në të dy gjinitë: *dy djel-dy: varza, tri shoqe* etj (Hajdaraj 1996: 101-120).

Foljet e zgjedhimit të parë, në vetën e parë njëjës, marrin mbaresën *j*, ndërsa në vetën e dytë dhe të tretë dalin pa mbaresë: *punoj, puno, puno*. Në numrin shumës të gjitha foljet e zgjedhimit të parë i marrin mbaresat: *-jamë, -ni, -jnë*. Foljet ndihmëse *jam* dhe *kam* në kohën e tashme në njëjës dalin pa mbaresa: *jâ, kê, jé, ké, â, ká*, ndërsa në shumës dalin: *jem, kem, îni, kîni, jâ:n, ka:n*. Foljet e zgjedhimit të dytë, në vetën e parë njëjës, marrin mbaresën *i*: *hapi, psheli, çeshi, mâti, shtypi* etj. Nuk marrin mbaresë në vetën e parë foljet: *shes, pres, marr, dal, ap, sho, she, njo, bërtas, flas, pëlsas* etj. Foljet e zgjedhimit të tretë dalin pa mbaresa: *lâ, xâ, zâ, përzâ, di, pi shtie* etj. Në të pakryerën, foljet me temë në zanore *i* marrin mbaresat *-jsha, -jshe, -jke, -jshim, -jshi dhe -jshin: flêjsha, flêjshe, flêjke, flêjshim, flêjshi, flêjshin*. E kryera e thjeshtë del me trajtat: *ra:sh, pa:sh, thash, re, pe, the (v.II), punova, bleu, prita, pata, duel, muer, hoç, poç, doç, voll, vodh* etj. Kohët e kryera të dëftores në këtë të folme dalin: e kryera, më se e kryera dhe e kryera e tejshkuar. Përveç këtyre kohëve, dalin edhe kohët e mbipërbëra: *kâ la, kê pa la, kisha la, kisha pa la, pata la, pata pa la*. Koha e ardhme del me ndërtime *kam+paskajore, do + lidhore dhe dua + paskajore: kê me a'rdh, dua mei la, do ta mbiellim* etj. Lidhorja gjendet në përbërje të së ardhmes dhe te trajtat e urdhërores: *do t'shko:jmë, do t'punoj:m, t'shkojme atje*. Urdhërorja del me trajtat: *puno, pso, kto, ço, laj, thaj, lyej, xhuj* etj, ndërsa dëshirorja: *psofsha, bafsha, disha, kiosha, ardhsha* etj. Format

e pashtjelluara të foljes në këtë të folme janë: pjesorja (*la:*, *tha:*, *pshte:l*, *za:n*), paskajorja (*me la:*, *me ble:dh*, *me za:n*), përcjellorja (*tye ble:dh*, *tye zan*) (120-147).

Disa prej ndajfoljeve që përdoren në të folmen e Rugovës janë: *kha*, *ktej*, *atej*, *breta*, *asajte*, *ksajte*, *lark*, *ksajtena*, *asajtena*, *çektu*, *çekha*, *çatej*, *çetej*, *çeksajtena*, *çasajtena*, *pasnesri*, *tepasnesri*, *tepastjetri*, *prema*, *parprama*, *teparprama*, *tovona*, *meiher*, *perisher*, *kurriher*, *xhithher*, *kaher*, *kadit*, *çekshtu* etj. Parafjalët hasen me këto trajta: *dar*, *pas*, *tu*, *der*, *ngat*, *dej*, *em/um*, *krye*, *përkrye*, *përpi*, *përder*, *përte*, *përpas*, *dërshej*, *përmaje*, *ka*, *buz*, *rret*, *kudra* etj. Lidhëzat në këtë të folme janë: *e*, *edhe*, *ja..ja*, *do...do*, *hose..hose*, *dose..dose*, *po*, *veç* etj (Hajdaraj 1996: 148-154).

3.3.E folmja e Hasit

Për të folmen e Hasit është shkruar në monografinë e Badallajt (2001) *E folmja e Hasit*. Kjo monografi përfshin fushën e fonetikës, morfologjinë, sintaksën dhe leksikun. Hulumtimi i kësaj monografie është kryer përmes vrojtimit të drejtpërdrejtë, duke zhvilluar biseda të lira me subjektet nëpër të gjitha fshatrat e Hasit.

Hasi shtrihet në jugperëndim të Kosovës dhe kufizohet me rrethin e Prizrenit, me rrethin e Gjakovës, me rrethin e Tropojës, me Lumën dhe me Zhurin. Katundet e Hasit brenda kufirit të Kosovës janë: Gorozhupi, Zymi, Karashëngjergji, Krajki, Lukinaj, Lubizhda e Hasit, Kabashi Hasit, Dedaj, Lubizhda Hasit, Romaja, Demjani, Gërçina, Godeni, Zylfaj, Rogova, Ujza, Smaçi, Kushevci, Bishtrazhini, Raça, Moglica, Firza, Lipovci, Petrushani, Brekovci, Guska, Bobaj Bokës, Deva, Vogova, Zhubi dhe Kushnini (Badallaj 2001: 23).

Në të folmen e Hasit, Badallaj (2001: 25-30) thekson se ka regjistruar 7 tinguj zanorë të mirëfilltë: *i*, *y*, *u*, *e*, *ë*, *o*, *a*, por duke u bazuar në kundërvëniet me vlerë fonologjike të shkallës së kuantitetit dhe të nazalitetit, dalin 24 fonema vokalike, pra zanoret janë të shkurtra dhe të gjata, gojore dhe hundore. Sa i përket theksit, në këtë të folme del theksi parafundor, por disa fjalë orientale dhe shumësi i disa emrave dhe mbiemrave mashkullorë e zhvendosin theksin, si: *ba:b-baba*, *penxhe:re-penxhere*, *dhã:nër-dhanu:r*, *i madh- t mdhej*. Zanoret e kësaj të folmeje dalin të gjata, të mesme dhe të shkurtra. Me zanore të gjatë dalin disa emra të gjinisë femërore, të cilët e kanë reduktuar ë-në fundore, si: *balu:sh*, *ã:n*, *bo:j*, *de:r* etj, disa emra të cilët dalin me rrokje të hapur, si: *kala:*, *bri:*, *ship:* etj, disa emra të tjerë me rrokje të mbyllur, si: *ba:l*, *ka:l*, *djã:l*, *ba:ll*,

za:ll, ba:r etj, disa emra mashkullorë dhe pjesoret e disa foljeve: *sho:k, çora:p, me ko:rr, me la:n, pi:n, rri:n, di:n* etj. Zanoret e gjata në trajtën e shquar gjithmonë dalin të mesme, si: *mā:z- maza*, të mesme bëhen edhe zanoret e shkurtra në emrat e trajtës së pashquar, kur shquhen: *asht- ashti, cub-cubi* etj. Zanoret e shkurtra kryesisht dalin në rrokje të mbyllur në fjalët njërrrokëshe: *shall, dash, lesh, klysh, rrush, prush, dem* etj, në disa folje në mënyrën urdhërore: *pi, rri, shko, kno, kthe, kce, puno, hyp* etj. Në këtë të folme dalin edhe zanoret hundore: *nā:m, hā:n, vjā:m, sā:n, njā, āsht* etj (Badallaj 2001: 37-45).

Badallaj (2001: 53-60) dalloi katër fonema të zanores *a*, dy zanore gojore /a/, /a:/ dhe dy zanore hundore /ā/, /ā:/, p.sh.: *plak-pla:k, han-hā:n, dhan-dhā:n, āsht-asht*; te zanorja *e* dalloi fonemat /e/, /e:/, /ẽ/, /ẽ/: *fishek-fishe:k, vën- vë:n*; te zanorja *i* dalloi fonemat /i/, /i:/, /ĩ/, /ĩ/: *pin-pi:n, hîn- hĩ:n, bri:-brĩ:*; te zanorja *o* dalloi dy fonema, *o-* në gojore të shkurtër dhe *o-* në gojore të gjatë: *mlo:j-mloj, llo:m-llom, gro:sh-grosh, ko:ll-koll* etj.; te zanorja *u* dalloi katër fonema /u/, /u:/, /ũ/, /ũ/: *krushk-kru:sk, hũ:, me prũ:, mũ:z* etj.; te zanorja dalloi katër fonema /y/, /y:/, /ỹ/, /ỹ/: *lyps-ly:ps, kryp-kry:p, dy-dy:, krỹ:m-krỹm* etj.

Sistemi bashkëtingëllor i së folmes së Hasit përbëhet prej 30 fonemave: /p/, /b/, /t/, /d/, /ć/, /x/, /k/, /g/, /c/, /x/, /ç/, /xh/, /m/, /n/, /nj/, /ŋ/, /f/, /v/, /th/, /dh/, /h/, /s/, /z/, /sh/, /zh/, /j/, /l/, /ll/, /r/, /rr/. Grupet konsonantike *mb, nd, ng* në këtë të folme nuk dalin asnjëherë të plota, sepse janë asimiluar në elementin e parë: *mbes-mes, këmbë-kā:m, dhemb-dhem, vend-ven, fund-fun, hunda-hūna, cung-cũŋ, nguc- ŋuc, ngadale-kadale* etj (Badallaj 2001: 68-99).

Në fushën e morfologjisë, në sistemin emëror të së folmes së Hasit, Badallaj (2001: 115) thekson disa veçori karakteristike për këtë të folme. Në këtë të folme emrat e gjinisë asnjëherë kanë kaluar në emra të gjinisë mashkullore, por disa edhe në gjininë femërore: *ballët-balli, djalët-djali, drithët-drithi, dyllët-dyly/dylla, mjaltët-mjalta/mjalti* etj. Si emra asnjëherë kanë mbetur vetëm emrat *ujët* dhe *kryet*. Në përgjithësi, emrat mashkullorë në këtë të folme dalin me bashkëtingëllore: *dash, cjan, lesh, gur, mal, zabel* etj., por edhe me zanore hundore e johundore: *mullë, dru, gũ, pru:, kru:, ftu:, patku:, vlla:* etj. Emrat e gjinisë femërore në trajtën e shquar të nominativit marrin mbaresat *a* dhe *ja*: *dora, pula, dardha, nusja, lullja* etj. Disa emra me origjinë orientale, ndryshe prej të folmeve të tjera të Kosovës, në të folmen e Hasit shkojnë me lakimin e tretë: *Fitneti-Fitnetja, Nimeti-Nimetja, Kimeti-Kimetja* etj.

Sa i përket shquarsisë së emrave, emrat e gjinisë mashkullore, të cilët në emërore të pashquar përfundojnë me *k, g, h*, kur shquhen, marrin mbaresën *-i*: *miki, uki, bregi, zogi, plehi, krahi, tehi* etj; disa emra që përfundojnë me *-i* të theksuar në trajtën e pashquar, kur shquhen, e marrin mbaresën *-a* ose *-ja*: *dahi-dahija, haxhi-haxhija*; emrat e gjinisë femërore që mbarojnë me *-ë* dhe me *-e* marrin mbaresat *a* dhe *-ja*: *dora, flutra, lulja, nusja* etj. Te sistemi rasor, rasa emërore te emrat e tipit *mulli*:, kur shquhen marrin mbaresën *-ni*; rasa gjinore në shumës del me mbaresën *-ve* dhe me njëjën përkatëse përpara: *maleve, gurve*, por ka raste kur del edhe pa *v*-në epentetike: *leshi dhene, buka robe* etj; te emrat mashkullorë njëjës del me mbaresën *-t*, kurse te disa emra të gjinisë femërore me *-es*: *mikit, djalit, e dors, e fushs, e lules* etj; në rasën dhanore emrat dalin me të njëjtat mbaresat si te rasa gjinore, vetëm se te kjo rasë mungon *nyja*; në rasën kallëzore emrat e të dy gjinive marrin mbaresën *-n*: *kronin, ftonin, mikin, zogin* etj.; rasa rrjedhore e pashquar njëjës del paralelisht me mbaresat *-ve* dhe *-sh*: *pi maleve tona, mas tri ditsh, pshtoj dursh* etj, ndërsa mbaresat e ablativit në shumës kanë një tendencë drejt zëvendësimit të mbaresës *-sh* me mbaresën *-ve*. Shumësi i emrave mashkullorë formohet me mbaresat *-a, -e, -j, -llar, -ler*: *lis-lisa, msus-msusa, mal-male, fis-fise, bir-bij, ba:b-baballarë, dervish-dervishler* etj.; Emrat e gjinisë femërore shumësin e formojnë me mbaresën *-a*: *de:g-dega, shty:-shtylla, motër-motra* dhe duke e zërthyer zanoren e theksuar të temës: *do:r-duar, de:r-dyer* etj (Badallaj 2001: 134).

Nyjat në këtë të folme në strukturën e një togfjalëshi vazhdimisht elidohen: *Bota Lugit, Kodra Lelakecit* etj. Numërori *një* del me dy variante: *ni* dhe *një*. Përemri vetor *unë* del me tri variante: *ũ, ùn* dhe *ũne* në rasën emërore, ndërsa në rasën rrjedhore del me variantet *mejet* dhe *mesh*. Përemrat dëftorë dalin me këto trajta: *ćaj, ćajo, ćeky, ćekjo, ćeta, ćeto, ćata, ćekta, ćekto* etj. Pronorët e vetës së parë njëjës kanë këto forma: *jëm, i jëmi, jëme, e jëmja, tëm, t tëmit, sëme, e sëms, jo:n, juj, ta:n, tona, jona, taj* etj. Prej përemrave të pacaktuar ndeshen: *nonjë, kurrnjë, asnjë, njëni, kurrnjëni, asnjëni, kurrnjëni, nonjëni, pakkush, pakkan, çetërkan*(Badallaj 2001: 135-169) etj.

Në sistemin foljor, (Badallaj 2001: 170-190) veta e parë njëjës e foljeve të zgjedhimit të parë del me mbaresën *-i*: *kepi, korri, lypi*, ndërsa veta e dytë del me mbaresën zero, por edhe me këto forma: *kepish, korrish, lypish* etj. Me mbaresën *-i* dalin edhe foljet apofonike: *mjeli, vjedhi, nxjerri*, ndërsa veta e dytë njëjës me mbaresën zero ose *-ish*: *mjel, vjedh, nxjerr, por edhe mjelish, nxjerrish, vjedhish*. Me të njëjtën mbaresë dalin edhe foljet që mbarojnë me bashkëtingëlloret *-k,-*

g,-h: pjeki, lagi, rrehi etj. Në kohën e pakryer të dëftores foljet marrin mbaresat: *shna, she, ke, shim, shit, shin*, të cilat u prapavihen foljeve që mbarojnë me bashkëtingëllore dhe me mbaresat: *jshna, jshe, jke, jshim, jshit, jshi*, u prapangjiten temave foljore që mbarojnë me zanore. Te koha e kryer e thjeshtë folja shoh del me format *pash* dhe *pava*. Mënyra habitore del me trajtat: *menojkna, menojke, menojka, menojkum, menojkni, menojkan*, por edhe *menojke* e *menojkmi*. Te format e pashtjelluara të foljes, pjesorja del pa mbaresë: *ha:p, sje:ll, pri:t*, por del edhe pjesorja e zgjeruar: *dhanun, sjellun, dalun, kositun, dalum, kositum, dhanum* etj. Paskajorja del me dy forma: *me dāl, me marr, me shkue, për me marr, për me shkue, për me kcye* etj. Përcjellorja ndërtohet duke ia vënë participit pjesëzën *tu* ose *tuj*: *jam tu la, po vike tuj kcye, a tuj nejt me do burra* etj.

Nga pjesët e pandryshueshme të ligjëratës, ndajfoljet dalin me këto forma: *shterueshëm, turras, dashtas, kamza, vjedhaz, sone, pasnesrit, kurrniher, çysh, pardjehit, sotmotmot, masane, sefte, çatje, çane, çanena, çekne, çekha, çeknenaj, terma, tepjet, ksajt, përkrye*; parafjalët: *nër, mi, pi, pëj, ña, përbuz, përmaje, përkrye, përbri*; lidhëzat: *kur, posa, masi, hem..hem, ja...ja, no..no, nash...nash, veç, pa*; pjesëzat: *ja, mu, le, net, bile, de* (Badallaj 2001: 196-209) etj.

3.4.E folmja e Karadakut

E folmja e Karadakut është trajtuar nga Halimi (2008) në monografinë e tij *E folmja e Karadakut*. Në këtë monografi trajtohen veçoritë e kësaj të folmeje në fushën e fonetikës dhe të morfologjisë.

Ky masiv gjeografik shtrihet ndërmjet Bujanocit, Preshevës, Kumanovës në verilindje, Gjilanit e Vitisë në veriperëndim dhe Kaçanikut e Shkupit në jugperëndim. Në këtë të folme, sipas Halimit (2008: 21), bëjnë pjesë komuna e Vitisë, komuna e Gjilanit, komuna e Bujanocit dhe komuna e Preshevës. Në Komunën e Vitisë bëjnë pjesë këto fshatra: *Debelldehu, Letnica, Vërnakolla, Vërnez, Shashari, Stublla e Epërme, Stublla e Poshtme, Godeni, Godeni i Fushës dhe Lubishta*; në Komunën e Gjilanit bën pjesë Zhegra me paralagjet: *Pidiqi, Shurdhani, Dunavi, Stançiqi, Çeliku, Burinca, Lipovica, Myçibaba, Kokajt, Sllubica, Llofca dhe Stublina*; në Komunën e Bujanocit Dobrosini dhe në Komunën e Preshevës bëjnë pjesë këto fshatra: *Ranatoci, Maxherja, Ilinca, Buhici, Caravajka, Garja, Bërçeci, Bukoci, Gosponica, Staneci dhe Seferi*.

Theksi në këtë të folme është dinamik, si në të gjitha të folmet e tjera të shqipës. Mirëpo, Halimi (2008: 72) thekson se nuk duhet përrjashtuar rastet kur kemi të bëjmë me lëvizje të theksit nga një rrokje në tjetrën brenda së njëjtës fjalë, p.sh.: te fjalët oksitone theksi është i ngulitur në rrokjen e fundit, ndërsa në të folmen e Karadakut dhe në të folmet e tjera të gegërishtes verilindore kthehen në fjalë paroksite, duke e zhvendosur theksin nga rrokja e fundit në atë të parafundit. Në këtë të folme dallohen tri gjatësi të zanoreve: zanore të gjata, të mesme dhe të shkurtra. Zanoret e shkurtra ndeshen te emrat e gjinisë mashkullore në rrokje të mbyllur në trajtën e pashquar, si: *plāk, mnāsh, māl, oxhāk, trāp, gārdh, dāsh, kunāt, kulāç, māl, mīk, mīsh, nīp, prīft, rrūsh, dūd* etj.; zanoret e mesme dalin në raste të veçanta: *mali, kali, nata, dita, vera, kavi, vllavi* etj.; zanoret e gjata në rrokje të mbyllur gjenden tek emrat e gjinisë femërore, por edhe te disa emra të gjinisë mashkullore, si: *pla:k, di:t, py:k, lo:p, co:p, sho:k, de:r, ve:sh, gu:r, fishe:k, kra:h, duva:k* etj.

Sistemin vokalik të së folmes së Karadakut, sipas Halimit (2008: 101-103), e përbëjnë shtatë zanore. Në disa fshatra të kësaj të folmeje ndeshet një *y*, e cila shqiptohet me prirje drejt *ë-së*. Ndërsa, zanorja *ë* në pozicion fundor nuk dëgjohej, e nganjëherë kthehet në *e*. Në rrokje të patheksuar *ë*-ja nuk shqiptohet fare: *ktu, shpi, kmi:sh, kshnellat, shmitri* etj. Në këtë të folme ndeshet edhe një *è* e hapur, si: *pè:m, vèni, i jèmi, i mèçum, fèmen, mrèna* etj. Halimi (2008: 106-132) jep shembuj për secilën zanore në këtë të folme. Për zanoren *a* vëren se del e gjatë, e mesme dhe e shurtër, duke dhënë shembuj për secilin rast: *kala, sefa:, dynja:, nata, ara, shtati, plāk, sabāh, krāh, hāk* etj. Edhe zanorja *e* mund të jetë e gjatë, e mesme dhe e shkurtër: *atdhe:, fe:, be:, bje:shk, petlla, vetlla, kerri, kërr, tërr, plëp, miner, hasrët, sebëp* etj. Zanorja *o* po ashtu i ka të tri gjatësitë e zanores: *ko:sh, sho:k, co:p, lo:p, lopa, gropa, copa, zög, stög, kōsh, lōt* etj. Sa i përket gjatësisë së zanores, edhe zanorja *i* del njësoj si zanoret e mëparshme: *trimni:, burrni:, vllazni:, shpi:, kalli, nipa, lisa, fise, kisha, kmisha, līs, fīs, plīs, mīk, gzīm, prīft, purrī* etj. Zanorja *u* gjithashtu mund të dalë e gjatë, e mesme dhe e shkurtër: *pu:l, pu:ll, ku:ll, buka, pusi, guri, funi, rrūsh, knūs, msūs* etj. Zanorja *y* i ka gjithashtu të tri gjatësitë e zanores: *fty:r, dyshek, myshk, krye, shyt, fyt, yll, fyll* etj.

Për togjet *ae, oe*, Halimi (2008: 136-145) thekson se ruhen dhe kanë një frekuencë të lartë përdorimi: *e pae, i thae, e lae, i dhae, voe, droe* etj. Ndërsa, diftongun *ue* e vëren se ruhet, por ndeshen edhe format e monoftonguara: *msue, pajtue, lshue, shkue* etj. Diftongu *ie* ose dëgjohej si një *j*, pra diell-djell, ose monoftongohet në *i*: *me zi:, me përzi:* etj. Edhe diftongu *ye* ruhet në këtë të folme, si: *kryet, fyell, dyer*, por hasen edhe trajtat e monoftonguara: *kthy:, ly:, thy:* etj.

Nazalizimi (Halimi 2008: 150) në këtë të folme prek zanoret: *ã, ě, ĭ, ũ, ŷ dhe ô: pëni, Ilïc, hũni, drũni, sŷni, ftõni, akshõmi* etj.

Në sistemin konsonantik Halimi (2008: 164) vëren se kjo e folme nuk është unike në tërë trevën e Karadakut, sepse disa fenomene nuk kanë shtrirje në gjithë arealin gjuhësor të kësaj të folmeje, p.sh. palatalet *q, gj* dhe *ç, xh* nuk shqiptohen gjithmonë njësoj. Edhe grupet e bashkëtingëlloreve *tj, dj*, herë ndeshen të asimiluara në *ć, x*, herë ruhen të plota. Në krahun verilindor të kësaj treve grupet *tj, dj* kryesisht asimilohen në qiellzoret *q, gj*, kurse në krahun jugperëndimor asimilohen në afrikatet *ć, x*. Më tutje, Halimi (2008: 189-194) shton se edhe togu *nt* nuk ruhet në këtë të folme: *dhët, mët, ćët* etj; togu *ng* në këtë të folme jep një tingull të ri *ŋ: hiŋllon, apan, shllu:ŋ, guŋ* etj.; të plota nuk ruhen as togjet *fsh* e *shq: shypta:r, shyp, Shypni, yshym, peshir* etj.

Në fushën e morfologjisë, Halimi (2008: 231-234) vëren disa veçori të kësaj të folmeje, sidomos në sistemin foljor. Në sistemin emëror, dalin disa emra, të cilët përdoren vetëm në trajtën e shquar, si: *kali, guri, shati, deti, bari, firi, helli, ari, kalli, njeri, veri* etj. Emrat që përfundojnë me bashkëtingëlloret *k, g, h*, në trajtën e shquar marrin mbaresën *i: miki, haki, gjaki, zogi, shtogi, krahi, plehi* etj. Disa emra të gjinisë mashkullore, të cilët në trajtën e pashquar përfundojnë me zanore të gjata, në trajtën e shquar marrin mbaresën *i* dhe tingullin *v* si antihiatizues: *kavi, shkavi, vllavi, dhevi, shivi, thivi* etj. Emrat që përfundojnë me togun *ue* e mbledhin në *o* dhe *e* marrin mbaresën *i: ftue-ftoni, krue-kroni, thue-thoni, patkue-patkoni* etj. Emrat, të cilët në trajtën e pashquar përfundojnë me *-uer, -uell, -iell*, në trajtën e shquar marrin mbaresën *i* dhe *i* monoftongojnë togjet në *u, i* dhe *y: punturi, unuri, laknuri, trulli, bulli, kaprulli, milli, fylli* etj. Emrat me origjinë orientale, kur shquhen, marrin mbaresën *a* dhe një *j* antihiatizuese: *Kadri-Kadrija, Ali- Alija, kala:-kalaja, mana:-manaja, dynja:-dynjaja* etj.

Pjesa më e madhe e emrave të gjinisë asnjësore kanë kaluar në gjininë mashkullore, p.sh.: *drithi, lëshi, mishi, uji*, por kur përdoren në trajtën e pashquar, atëherë përdoren në gjininë asnjësore: *ka drith, ka lësh, ka mish* etj. Gjinia asnjësore ruhet te emri kryet. Disa emra përdoren në të dy gjinitë, pra janë emra ambigjenë, si: *shnëti-shne:ta, neri-ne:ra, gjizi-gji:za* etj. Ndeshen edhe emra të tjerë, të cilët përdoren gjithmonë në gjininë femërore: *mja:lta, vojshti:na, ku:rtha, la:kshta* etj.

Kategoria e numrit (Halimi 2008: 237) në këtë të folme formohet në disa mënyra: me anë të mbaresave, me anë të palatalizimit, me anë të metafonisë dhe të apofonisë. Halimi (2008: 237-243) përveç këtyre formave shumësi, jep shembuj edhe me anë të kuantitetit të zanoreve, si: *fishek-fishe:k, dyshek-dyshe:k, shök-sho:k, kapak-kapa:k* etj. Disa emra të tjerë e bëjnë shumësin me anë të palatalizimit: *stög-stögj, breg-bregje, präg-pregj, konāk-konaće, marak-maraće, bināk, biněć, kuḡull-kuḡuj, fill-fije*. Një pjesë e madhe e emrave të gjinisë mashkullore shumësin e formojnë me mbaresën –a: *trŭp-trupa, krĕn-krena, cĕp-cepa, lamsh-lamsha, rryp-rrypa, bu:rr-burra, shpi:rt-*; Emra të tjerë e bëjnë shumësin me mbaresën –na: *ba:ll-ballna, deti-detna, buna:r-bunarna*. Një pjesë tjetër e emrave mashkulorë shumësin e bëjnë me mbaresat –ën, –e: *katun-katune, māl-male, māl-male, kërr-kerre, pajtim-pajtime, oborr-oborre, vllazën, mretën, drećën* etj; Me metafohi hasen raste, si: *plāk-plĕq, mzāt-mzĕt, kunāt-kunĕt, dj:l-djĕm, dāsh, dĕsh* etj. Te emrat e gjinisë femërore shumësi formohet në shumicën e rasteve me anë të mbaresës a: *pla:k-plaka, shpi-shpia, bukĕl-bukla, gogĕl-gogla, vetĕll-vetlla, krrabĕz-krrabza, shpatĕz-shpatza* etj.

Te sistemi rasor, si karakteristikë e kësaj të folmeje theksohen format e rasave gjinore-dhanore e numrit shumës me mbaresën –ve: *i, e lisave, fushave, maleve* etj, bëjnë përjashtim një numër emrash që e ruajnë mbaresën e vjetër –e: *i, e ćobane, ćene, kuale* etj.

Gjinia e mbiemrave dallohet me anë të nyjave të përparme te mbiemrat e nyjshëm, nyja *i* për gjininë mashkullore dhe nyja *e* për gjininë femërore: *i mi:r, i urt, e mi:r, e urt* etj., ndërsa te mbiemrat e panyjshëm gjinia dallohet me anë të mbaresave: *besnik-besnike, fisnik-fisnike, trim-trime, luftar-luftare* etj. Mbiemrat prejpjesorë dalin me mbaresat –un, –um, –shum: *i dekun, i maru:n, i ćun, i dekum, i maru:m, i ću:m, i njořshum, i dokshum, i knushum, i livdushum* etj. Në këtë të folme, kur ka sintagmë emërore emër në emërore të shquar + emër në gjinore apo mbiemër i nyjshëm, në këto raste nyja e përparme e gjinores apo e mbiemrit nuk shqiptohet fare: *xhali nanĕs, djali mi:r, mali madh* etj. E njëjta del edhe te emrat e gjinisë femërore, si *ara madhe*. Nyjat shqiptohen kur emri është në rasën kallëzore, si: *ditĕn e shinkollit, unazat e arit* etj., kur përdoren te emrat farefisnorë: *i biri, e bija, e ama, i shoći, e shoćja* etj. Në këtë të folme numërorët *dy* dhe *tre* kanë gjininë mashkullore dhe femërore, e cila dallohet me anë të gjatësisë së zanoreve, si: *dy burra e dy: gra, trĕ burra e tri: gra*. Numërori përdoret edhe i emëruar: *t'katrat, t'shtatat, t'katĕrdhetat* etj (Halimi 2008: 247-254).

Halimi (2008: 258-283) vëren se në të folmen e Karadakut përdoren këta përemra vetorë: *û, un, unë, una, ti, ai/aj, ajo, na, ju, ata, ato*. Ata i kanë edhe trajtat e shkurtra: *ma dha, ta dha* etj. Përemrat dëftorë që hasen në këtë të folme janë: *ky, kjo, aj, ajo, kta, kto, ata, ato, ksine, ksishne, asine, asishne, asosh, ksosh, ksoshne, çeky, çekjo, çaj, çajo, çata, çato, çatyne, çektyne* etj. Përemrat pronorë dalin me këto forma: *jem, jeme, jo:n, yt, jote, juv, juve, mi, mia, tu, tua, ta:n, tona, i jemi, e jemja, t'mit, t'mijat, i joni, e jona* etj. Kjo e folme e ka edhe përemrin vetvetor: *i vet, e vet, i veti, e vetja*. Përemrat pyetës, të cilët dalin në këtë të folme, janë: *çka, shka, sha, kush, shfar, cilli, cilla, cillt, cillat, i sati, e sata* etj. Përemrat lidhorë janë: *çi, i cilli, e cilla, t cillt, t cillat*.

Në sistemin foljor, koha e tashme e mënyrës dëftore merr mbaresën –i: *çeli, msheli, lidhi, nisi, iki, rroki, goditi, prashiti, myti* etj.; koha e pakryer del me trajtat: *flejshna, pishna, neyshna, ishna, kishna, punojshna*; koha më se e kryer del me format: *kishna la, kishna vadi:t, kishna harrue* etj. Përveç kohës më se të kryer, dalin edhe kryera e dytë: *kam pas punue*, e kryera e plotë e dytë *nuk kish pas besue*, e kryera e plotë tre: *me pas pa:s pushk, kish liftu*: dhe e kryera e tejskuar e dytë: *pata pas punue shumë*; koha e kryer e thjeshtë del kështu: *thash, dhash, thae, dhae, shava, pagova/pagujte, prejta/prejte/preva, mola/mjele/mjulëm* etj. Koha e ardhme del me foljen ndihmëse kam dhe folja përkatëse në paskajore: *kam me punue, kam me shku*, por del edhe koha e ardhme me pjesëzën do+lidhore e kohës së tashme: *Nesër do t'shkoj n'pazar*. Mënyra lidhore e foljes del me trajtat: *t'jam, t'je:sh, t'je:n, t'kom, t'ki:sh*. Habitorja në këtë të folme ka trajtat: *koka ko:n, kokan ko:n, paha ardh, konkam, konke, kokmi, kokni* etj. Mënyra dëshirore ka format: *paça, kosha, u çosha, u gzosha, u plaksha* etj. Mënyra urdhërore ndeshet me këto trajta: *kërkoe/kërkoje, punoe/punoje, msoe/msoje, kashoe/kashoje, kërkoe-kërkone* etj (Halimi 2008: 286:302).

Nga format e pashtjelluara të foljes, pjesorja del e reduktuar, pa mbaresa: *msue, lexue, shkue, punue, thye, përlye, përzie, bā, pre, le, pi, marr, ko:rr, lidh, agi:dh* etj., por hasen forma edhe me pjesore të zgjeruar: *bam, bamen, dekën*. Përcjellorja ndërtohet me pjesëzën tue/tuj/tu + pjesorja e foljes: *tu knu:, tu ladru:*; Paskajorja ndërtohet me pjesëzën me + pjesore: *me pre, me ble, me prashi:t, me kosi:t, me ko:rr, me mje:ll, me la:, me fshi:, me përzie* etj (Halimi 2008: 303-312).

Prej pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës jepen disa, të cilat janë më karakteristike për këtë të folme: ndajfolje *trimnisht, burrnisht, katunisht, sadokudo, herdokurdo* etj; parafjalë *me, pa,*

për, më, përmi, rreth, nër, pej, pi etj; lidhëza *viç, viçse, e, edhe, n'koft se, masi* etj; pjesëza *mu, bash, cok, bile, çë, nuk* etj, ; pasthirrma *valla, beli, bre, mule, hajde, urra, bezbeli* etj (2008: 321: 348).

3.5.E folmja e Shalës së Bajgorës

Mulaku (2005) e ka trajtuar të folmen e Shalës së Bajgorës në librin *E folmja e Shalës së Bajgorës*. Ky studim përfshin fushën e fonetikës, të morfologjisë, të sintaksës, një fjalor të fjalëve dialektore dhe toponiminë e Shalës.

Shala e Bajgorës shtrihet në pjesën veriore të Kosovës, në shpatet jugore të malit të Kopaonikut. Ajo shtrihet ndërmjet qytetit të Mitrovicës, Vushtrrisë, Podujevës dhe Leposaviçit.

Sistemi tingullor në të folmen e Shalës së Bajgorës në përgjithësi përkon me atë të të folmeve të tjera geqe, megjithatë vërehen dallime në mënyrën e shqiptimit të tingujve. Zanoret në këtë të folme mund të jenë të theksuara dhe të patheksuara. Zanoret e patheksuara dalin në këto raste (Mulaku 2005: 30):

- a. Nyjat e përparme *i, e, të* dhe të prapme apo mbaresat rasore *-i, -u, -a*, si: *i madh, e madhe, të mdhej, lisi, miku, lopa, dardhën, pej Gjakove, plepat, malet* etj;
- b. Mbaresat vetore: *punoni, shkojsha, lajshe, bleva, bleve, rrnofshi* etj;
- c. Disa fjalë të pandryshueshme: *te, me, ka, ner, edhe, e, se, pak, atje, u, çë, soll* etj;
- d. Trajtat e shkurtra të përemrave vetorë: *i harrova, u kallxuëm, ju tha, e thyen, na lype, merre, kallxona, foli, folu* etj;
- e. Nyja joshqese *ni* dhe përemri lidhor *çi*: *ni lop, ni dash, ai çë fle, ata çë shkuen* etj.

Mulaku (2005: 31) jep shembujt për gjatësinë e zanoreve. Zanoret e gjata ndeshen në këta shembuj: *dārdh, kā, me tā, dēr, pēl, i drējt, dōr, shpi, i shkūrt, hū, me prū* etj; fjalë me zanore të mesme hasen: *plaku, malin, plakën, thesi, e verdha, shkova, molla, miku, lisi, dritën* etj; fjalë me zanore të shkurtër ndeshen: *plak, dash, han, thes, thej, plep, lis, mik, kush, huj, myk, fyt, hyp* etj.

Sa i përket theksit, Mulaku (2005: 32) thekson se te disa emra, si: *njeri, veri, qiri, kalli* etj, në këtë të folme theksi ka lëvizur prej rrokjes së zanores së fundit në zanore të parafundit. Edhe

tek emrat me origjinë orientale theksi ka lëvizur prej rrokjes së fundit në atë të parafundit, si në shembujt: *bāb, bakllāv, kāfe, pare, āxh, āg, pāsh* etj.

Sistemi i zanoreve ruhet mirë në këtë të folme dhe përkojnë me të folmet e tjera geqe (Mulaku 2005: 29). Mulaku (2005: 34-44) jep për secilën zanore veçoritë që shfaqen në këtë të folme. Zanorja *a* në përgjithësi ruhet, por paraqiten edhe ndërrime në zanore të tjera, si kalimi i *a*-së në *e*: *zjarm-zjerm, lajthi-lejthi, skaj-skej, sajë-sej, rrah-rreh, kala-kale, bela-bele, dynja-dynje, fukara-fukare* etj. Zanorja *e* në disa forma të foljeve bie dhe nuk dëgjohet, si: *lidhna, msohna, lahna*, ndërsa shfaqet në fund të emrave të ditëve të javës: *e hane, e marte, e mërkure, e shtune* etj. Zanorja *ë* nuk shqiptohet pothuajse në asnjë nga pozicionet e saj në fjalë. Në këtë të folme *ë*-ja ruhet para bashkëtingëlloreve sonante ose lëngëzore *l, r, rr, n, m*: *motër, zemër, përket, përlej, kërset, kokërr, mjekër, gogël, dimën, i hershëm/hershum, darsëm* etj. Zanorja *ë* në këtë të folme kthehet në *i* në pozicion paratheksor në disa fjalë, si: *qëndroj-çinroj, një-ni, që-çi, qëlloj-çilloj, qëroj-çiroj, këtë-kit, gështenjë-gishtaj* etj. Në pozicion para bashkëtingëllores *m*, në vend të zanores *ë*, dëgjohet *u*-ja: *darsëm-darsum, i hershëm-i hershum, i meçëm-i mecum, i larëm-i larum* etj. Ndryshimet të cilat vërehen te zanorja *i* janë: kalimi i zanores *i* në gjysmëzanore, rënia ose zhdukja e *i*-së, përdorimi i zanores *i* në trajtën e pashquar të disa emrave mashkullorë: *ai pushoi-aj pushoj, ia theu dorën-ja thej dorën* etj. Zanorja *o* në disa fjalë të huazuara sllave dhe turke, por edhe në disa fjalë autoktone në këtë të folme kalon në zanoren *a*: *apet, aborr, apaj, akolla, kanop, zavit, kallaj, artake, kanak, dallap, sakak, nashta, ladroj, vanohet, kaçan, katalik* etj. Zanorja *u* e patheksuar, kur ndodhet pas një rrokjeje të theksuar, në trajtën e pashquar kthehet në *ë*: *kumbull-kumëll, vetull-vetëll, hekur-hekër, lepur-lepër* etj. Edhe disa fjalë të tjera e kanë pësuar këtë reduktimin e *u*-së në *ë*, si: *pluhun-pluhën, kurrkush-kërkush, gurmaz-gërmaz, ahur-ahër* etj. Zanorja *y* në përgjithësi ruhet mirë në këtë të folme, por ka edhe përjashtime kur kalon në *i*, p.sh. fjala *hyj-hi*.

E folmja e Shalës së Bajgorës ruan zanoret hundore në një masë relativisht të madhe, siç shihet nga shembujt: *zā, āsht, njāni, rrāja, dhāmi, lāma, tërshāna, i āmël, e rān, me dhān* etj. Në këtë të folme diftongjet *ue, ye* dhe *ie* shqiptohen të plota, si: *grue, prrue, knues, mue, punue, fyell, dyer, diell, ciell, përziej, miell, me zie* etj., por ka raste të rralla kur edhe monoftongohen, p.sh.: *grū, prū, thū, i hūj, me punū, me u kurthū, milli, dilli, firi* etj. Togu zanor *ae* ruhet te trajtat foljore:

ngae, hae, thae, pae, dhae, rae etj., por dëgjohej edhe shqiptimi me *e* të gjatë: *qe, the, re* etj. Togu *oe* shqiptohet në variantet *oe* dhe *o*: *voe/vo/, droe/dro* (Mulaku 2005: 44-51).

Për sistemin bashkëtingëllor të kësaj të folmeje, Mulaku (2005: 53-75) vëren se përkon me atë të gegërishtes verilindore. Në këtë të folme mungojnë palatalet *q* dhe *gj*, në vend të palataleve *i* ka afrikatat *ć* dhe *x*: *qen-ćen, gjarpën-xarpën, xhami-xami* etj. Kjo e folme ka edhe bashkëtingëlloren *η*. Grupet e bashkëtingëlloreve *kl, gl, nj, mb, nd, ng* etj., janë reduktuar në bashkëtingëllore të thjeshta: *k, g, j, m, n, η*: *hunj-huj, zonja-zoja, mbret-mret, pëllumb-pllum, hundë-hun, ngatërroj- ηatrrroj* etj. Disa prej ndërrimeve fonetike që hasen në këtë të folme janë: grupet e vjetra *kl, gl* janë velarizuar në *k* dhe *g*: *kumshti, guha; grupet mb, nd, ng* janë thjeshtuar në *m, n, η*: *mbledh-mledh, kumbull-kumëll, ndalet-nalet, fund-fun, ngusht-ηusht, peng-peη* etj.

Emri - gjinia asnjansë e emrave në këtë të folme ka kaluar në gjininë mashkullore dhe rrallë ndonjë edhe në gjininë femërore, si: *djathi, tamli, voji, gruni, mishi, drithi, mielli, brumi, kumshti, krypa, balta, mjalta* etj. Emri krye e ruan gjininë asnjansë, po ashtu edhe fjalët përcaktuese përdoren në gjininë asnjansë: *kta krye t madh, kryet tat*. Emrat e gjinisë mashkullore në trajtën e shquar marrin mbaresën -i: *ftue-ftoni, krue-kroni, thue-thoni, truëll-trolli, krah-krahi*, , por e marrin mbaresën -u emrat që përfundojnë me *k* dhe *g*: *plak-plaku, bark-barku, zog-zogu*. Disa emra të tjerë mashkullorë, të cilët mbarojnë me *i* në trajtën e pashqur, në trajtën e shquar marrin mbaresën *a*: *Ali-Alija, Kadri-Kadrija, Sadri-Sadrija* (Mulaku 2005:92-95).

Shumësi i emrave mashkullorë, të cilët mbarojnë me *k, g, ll, n*, formohet me anë të palatalizimit të bashkëtingëlloreve fundore: *mik-miç, zog-zox/zøj, huj, kroje, kuηuj, buej* etj. Me mbaresën *a* e bëjnë shumësin disa emra, të cilët në gjuhën standarde e formojnë shumësin me *ë*, si: *oficera, doktora, zeshkana, huta, msuesa, prifta, lypsa, dollapa, hajvana, komunista* etj. Me mbaresën -*ën, -nit, -it*, e formojnë shumësin këta emra: *vllazën, mretën, drećen, knojstit* etj. Një numër i kufizuar emrash e formojnë shumësin me metafoni, si: *shtrat-shtretën, kunat-kunet, dash-desh, çjap-çjep, mzat-mzet, kulać-kuleć*. Disa emra të tjerë shumësin e bëjnë me mbaresën -*e*: *male, livadhe, oborre, gabime, pushime, konaqe, shtigje, leće, brixë* etj. Ndeshen edhe disa emra, të cilët e formojnë trajtën e shumësit me anë të gjatësisë së zanores: *shok-shōk, dyshek-dyshēk, pehar-pehār, darsmor-darsmōr, fener-fenēr* etj (Mulaku 2005: 95-06).

Rasa e emrit- emri në rasën gjinore e dhanore shumë merr mbaresën –ve, por këtu bëjnë përjashtim disa emra, të cilët e marrin mbaresën –e, si: *lisave, lugve, nuseve, miçve, buejve, ftojve, dhive, kuale, çobane, dhene, mene, çene, vjete* etj. Kjo trajtë me mbaresën –e shpesh shtrihet edhe në rasën rrjedhore: *mos u largo pej dhene, ajo ecke para kuale, u tut pej çene* etj. Në rasën kallëzore njëjës, emrat mashkullorë të lakimit të parë në emëroren e shquar marrin mbaresën –i, ndërsa në kallëzoren e shquar mbaresën –in: *lisiin, kalin, nipin, patkonin, drunin, mullinin* etj. Emrat e lakimit të dytë marrin mbaresën –un: *mikun, zogun, kaun, dheun, shiun*, ndërsa emrat që përfundojnë me bashkëtingëlloren –h, marrin mbaresën –in: *krahin, plehin, ahin, tehin* etj. Emrat e gjinisë femërore në rasën rrjedhore njëjës të shquar e kanë mbaresën e njëjtë me të gjinore e të dhanore, pra mbaresën –s: *pej lops, pej kumllës, para pels, pej nuses, para msueses* etj., ndërsa rrjedhorja e pashquar e emrave të gjinisë femërore shpesh përdoret me mbaresën –e: *mish lope, uj bjeshke, kaçik pule* etj. Në këtë të folme përdoret mjaft shpesh rasa rrjedhore shumë me mbaresën –sh me parafjalë dhe pa to: *e kapi për duersh, loj thmish, para sysh, vjeta lopsh, katër rena plepash* etj (Mulaku 2005:97-100).

Nyja e përparme zakonisht nuk shqiptohet kur emrat, të cilët marrin mbaresën *i* ose *a*, vijnë në kontakt me një emër në gjinore me njëjën *i* ose *e*, si: *Shpati Madh, puna mar, Livadhi Ukut, vorri Fazlis, Shpati Laknave* etj., ndërsa te emrat të cilët e marrin mbaresën *u*, nyja e përparme shqiptohet rregullisht: *lugu i lisit, shteku i dhenve, miku i vjetër, zogu u malit, shtogu i moçëm* etj.

Një veçori e mbiemrave të kësaj të folmeje është se te grupi i fjalëve emër i shquar + mbiemër i njëjshëm, nyja zakonisht nuk shqiptohet, si në shembujt: *djali mash, knuesi hershëm, Rashani Poshtë, Rudari Madh, Prroni That, mali rrall* etj. Disa mbiemra, përveç prapashtesës –un, dalin edhe me prapashtesën –t, si: *i lidhun, i hapun, i pjekun, i lagt, i kulluet, i trulluet, i pjekt*, etj. Te mbiemrat dalin edhe prapashtesat –m/me, –n, si: *i lam, i blem, i fshim, e fshime, e punueme, e thyeme, i lan/e lane, i blen/ e blene* etj.

Përemri vetor njëjës në emërore ka këto trajta: *u, un, unë*; në rasën dhanore kallëzore e rrjedhore ka format: *mue, mue, meje*. Veta e parë shumë në emërore ka trajtën *na*, në dhanore *neve*, në kallëzore *ne*, në rrjedhore *nesh/neve*. Veta e dytë e përemrit vetor njëjës në emërore ka trajtën *ti*, në dhanore e në kallëzore *ty*, në rrjedhore *teje*. Përemrat vetvetorë që dalin në këtë të folme janë: *vet, vehte, vehtja*. Disa prej përemrave dëftorë në këtë të folme janë: *čeky, čekjo, čekta*,

ćai, ćajo, ćata, ćato, ćiky, ćikjo, ćita, ćito, ksi, ksish, asi, asish, kso, ksosh, aso, asosh etj. Përemrat pronorë të vetës së parë dalin pa nyja, kur përdoren në bashkëvjajtje me emra: *djali jem, motra jeme, djali yn, motra jon, motrën ton* etj, ndërsa kur përdoren pa emra, përemrat marrin nyjën përpara dhe një *-j* epentetike: *i jemi, e jemja*. Në rasën gjinore, dhanore e rrjedhore përemrat e gjinisë femërore kanë këto trajta: *i motrës ton, nanës ton, pej motrës ton*. Përemri pronor i gjinisë mashkullore në vetën e dytë njëjës në rasën emërore është *yt/i*, në rasat gjinore, dhanore e rrjedhore *tanit*, në kallëzore *tanin*. Përemri i gjinisë femërore në emërore del *jote/ja*, në gjinore, dhanore e rrjedhore *tanës*, në kallëzore *tanën*. Një veçori tjetër e kësaj të folmeje është përemri pronor i vetës së dytë, si: *i juvi, e juvja*. Përemrat e vetës së tretë përdoren herë me trajtat: *i, e tij, i, e saj*, herë në trajtat: *tinaj, sajnaj, sajna* (Mulaku 2005: 105-110).

Foljet e kohës së tashme në mënyrën dëftore, ato të cilat përfundojnë me bashkëtingëlloret *-k, -g, -h*, marrin mbaresën *-i* në vetën e parë njëjës: *ćeli, prishi, lidhi, lagi*, por nuk marrin mbaresën *-i* foljet: *pjek, djeg, dal, marr, mjell, tjerr* etj. Në vetën e dytë dhe të tretë njëjës dalin pa mbaresë foljet konsonantike, si: *prish, ćel, thrret, rrsheet, shet* etj. Në vetën e parë shumës të njëjtat folje marrin mbaresën *-im*: *mshelim, shesim, korrim* etj., por dëgjoen edhe format me mbaresën *-um*: *kapum, shesum, lidhum*. Në vetën e dytë e të tretë shumës këto folje dalin me mbaresën *-ni/in*: *kapni, korri, korrin, flasin, lidhin, shesin* etj. Foljet, të cilat mbarojnë me një zanore ose me një diftong, i marrin këto mbaresë: *laj, lan, lan, lajm, lani, lajn*. Koha e pakryer e diatezës joveprore ka këto trajta: *shitsha/shitshna, shitshe, shitke, shitshim, shitshi*. Koha e kryer e thjeshtë ka trajtat: *lidha, lidhe, lidhi, lidhëm, lidht, lidhën*. Koha e kryer formohet me foljen ndihmëse kam dhe me pjesore: *kam punue, ke punue, ka punue*. Koha më se e kryer del në këtë formë: *kisha marr, kisha marr, kish marr, isha la, ish la* etj. E Kryera e tejshkuar ka këto trajta: *pata korr, pate korr, pat korr, kesh kthye, ke kthye* etj. E kryera e dytë: *kam pas lidh, ke pas lidh* etj. Më se e kryera e dytë ka këto trajta: *kisha pas harrue, isha kan habit* etj. Koha e ardhme ndërtohet në këtë formë: *kam me punue, due me punue, don me punue, do t punoj* etj. Format e lidhores së tashme në këtë të folme dalin: *t lidhi, t lidhsh, t lidh, t lidhim, t lidhni, t lidhin*; e pakryera e lidhores del me këto trajta: *t korrrsha, t korrrshe, t korrrshim/ëm*; më se e kryera e lidhores: *kisha than, t kisha than, t kish than* etj. Mënyra kushtore formohet me foljen ndihmëse kisha dhe me paskajoren e foljes kryesore, si: *kisha me fol, kisha me lidh, kisha me pas, kisha fol, kisha lidh* etj. Mënyra habitore del me këto trajta: *po gabojkam/po gabojkna, po dhaka/po jepka* etj. E kryera e mënyrës habitore formohet në këtë mënyrë: *paskam gabue, paske gabue, paska gabue*,

paskemi/paskëm gabue, paski/paskni gabue, paskan gabue etj. Trajtat e mënyrës dëshirore në kohën e tashme dalin, si: *rrnofsha, rrnof, rrnofshim, rrnofshi, rrnofshin*, ndërsa koha e kryer e dëshirores del mjaft rrallë, si në shembujt: *ja paça marr t ligat, t past ba mir, kofshin rrit me vllazën* etj. Mënyra urdhërore ka trajtat: *lidhe, merre, preje, theje, çitma, bima/bjerma, çitëm, çelu, kapnie* etj (Mulaku 2005: 111-127).

Nga format e pashtjelluara të foljes, pjesorja del më e shkurtuar, pa mbaresa: *msue, punue, lye, përzie, la, ba, ble, pi, lyp, tut, pru, marr, korr, lidh, mledh, hap, ardh, pa, pas, tjerr, mjel* etj; përcjellorja del edhe me format: *tue kullot, tue fol, tue ardh, tue marr, tue, gatue, tue lye* etj; pjesëza *tue* te përcjellorja del ede me format *tuj* dhe *tu*; pjesorja del me format: *me marr, me dhan, me lidh, me pa, me msue, me thye* etj (Mulaku 2005: 128-132).

Te pjesët e pandryshueshme të ligjërtës ka pak dallime dialektore, më shumë hasen trajta të ndryshme te ndajfoljet, te parafjalët e te lidhëzat. Parafjalët në të folmen e Shalës së Bajgorës dalin me këto trajta: *me, pa, mi, ner, për, nëpër, përmi, pej, para, mas, karshi, nat, larg, kunër/kunra, jasht, mrena, maje, akolla, sipri, dei te, dei n, përfuni, tekderi, kah, përte* etj. Ndajfoljet në këtë të folme dalin me këto trajta: *çatje, çetu/çitu, çaty, çanej, çeknej/çiknej, çekha, ksajde, ksajte, asajde, asajte, mrena, përfuni, përte, akolla, knena, anenaj, pra, nadje, nestra, nestër, tevona e tanej, hala, çetash, çitash, apet, çeshtu, çishtu, dallash, nime, ngjim, thias, taman, pulas, bythprap, zhag, mrapsht, cok, taqall, fërk, zotnishi, nam, çekaç, çikaç, çac, tepri* etj. Lidhëzat që hasen në këtë të folme janë: *jase, ja, veçsa, edhe pse, që, çu, ndash, nash, po, masi* etj. Pjesëzat të cilat ndeshen në këtë të folme janë: *ani, nasht, po de, athue, nja, kishë, çu, ha, mos, pale, hajde* etj. Pasthirrmat hasen me këto forma: *o, oj, moj, ori, bre, more, oh, ah, of, ofa, a, uh, kuku, medet, au, eu, oksh, oç, luksh, ujst, zuryk, ishsh, kiç, dio, tërr, çyb, kuc, mac-mac* etj. Prej përshtetjeve përdoren: *koft mir, mir se vjen, tumirmeçi, me t mir vofshi, puna mar, mar paç, nadja mir*; urimet: *u rritsh, rrnofshi, t lumt goja, lum bafsh, zoti t nimoft, zoti t dhasht bereçet, t rujt zoti, mos u mërzi, mërzi mos paçi, t u bafsh shnet* etj; mallkime: *t marrt egjeli, t u thaft goja, t haçert dreçi, t marroft zoti* etj (Mulaku 2005: 133-139).

Në fushën e sintaksës, Mulaku (2005: 151) vë në pah veçoritë kryesore të sintaksës në këtë të folme, siç është përdorimi i paskajores për ndërtimin e disa tipave të fjalive, si: fjalive qëllimore, kryefjalore, kundrinore, kushtore etj: *Shkuen n livadhe, me kosit barin; Me vjedh asht marre; Kisha*

me marr buk, mos me pas harrue; Pej teje lypet me fol drejt; Pa ja nis shiu, u çue ni er e madhe etj.

Në leksikon e kësaj të folmeje ka fjalë të huazuara nga serbishtja, si: *apet, pobratim, stenica, gllavina, sakica, vllaća, gosha, kočit, etj*, por edhe nga turqishtja: *allgj, arpagjik, dajm, jaci, karagj* (Mulaku 2005: 158) etj.

Për leksikon e së folmes së Vushtrrisë ka shkruar Maxhuni (2017) në librin *Mbi leksikon dhe frazeologjinë e Vushtrrisë me rrethinë*. Në këtë studim Maxhuni sjell fjalorthin me 2000 thënie, fjalë dhe shprehje leksikore të kësaj të folmeje. Për mbledhjen e këtij materiali, Maxhuni është mbështetur në udhëzuesit dhe në pyetësorët e botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe nga Instituti Albanologjik i Prishtinës. Në këtë studim përfshihen kryesisht fjalë të sferës së bujqësisë e të blegtorisë, emra kafshësh, emra të veglave të punës, të pjesëve të shtëpisë, emërtime për bimë e lule etj. Përveç kësaj monografie, është edhe studimi i Mulakut (2005) për të folmen e Vushtrrisë dhe të folmeve përreth *Hulumtime dialektologjike dhe onomastike*, në të cilin përfshihen fusha e fonetikës, e morfologjisë dhe e sintaksës.

3.6.E folmja e Gjakovës

E folmja e Gjakovës është trajtuar në librin e Berishës (2020) *E folmja e Gjakovës-Fonetika dhe Morfologjia*. Në këtë studim janë përzgjedhur karakteristikat kryesore të kësaj të folmeje në fushën e fonetikës dhe të morfologjisë, rastet kur janë të veçanta dhe kur përkojnë me të folmet e tjera të gegërishtes verilindore. Përveç punës në terren, siç thekson Berisha, për t'i trajtuar tiparet e përbashkëta gjuhësore me të folmet e tjera, e kanë ndihmuar edhe botimet për të folmet e ndryshme të Kosovës.

3.7.E folmja e Kaçanikut

Raka (2004: 50) dallon disa nëngrupe në të folmen e Kaçanikut: *të folmen e qytezës së Kaçanikut*, e cila ndryshon nga të folmet e fshatrave përreth, *të folmen jugore të Kaçanikut*, e cila është ndikuar nga të folmet e gegërishtes qendrore dhe anon më shumë nga ky grup se nga grupi i gegërishtes verilindore dhe *të folmen e fshatrave përreth Kaçanikut* ose të folmen e fshatrave të Kaçanikut që shtrihet nga Gjyrgjedelli deri në Begracë, në anën e majtë të lumit Lepenc dhe pjesa tjetër që nis me Ivajën dhe përfshin fshatrat në anën e djathtë të Lepencit.

E folmja e qytezës së Kaçanikut përbëhet nga 6 zanore të theksuara gojore të shkurtra dhe të gjata (vetëm zanorja ë del e patheksuar) dhe 5 zanore hundore të shkurtra dhe të gjata (nuk ka ë dhe o hundore). Në të folmen e qytezës së Kaçanikut dalin 23 fonema zanore, ndërsa te të folmet e fshatrave përreth, te ato që ndodhen në anën e djathtë të lumit Lepenc, mungon fonema [y] gojore e shkurtër dhe e gjatë dhe [y]-ja hundore e shkurtër dhe e gjatë. Ndërsa fonema bashkëtingëllore dalin 27, për shkak të zhdukjes së kundërvënies midis palataleve (*q, gj*) dhe afrikateve (*ç, xh*). Sa i përket theksit, te fjalët me prejardhje sllave theksi ka pësuar ndryshime në krahasim me fjalët e huazuara, te të cilat del një rrokje më përpara. Te fjalët e huazuara nga turqishtja theksi del në rrokjen e parafundit, edhe pse në gjuhën dhënëse ka pozitë fundore: *pará-pá^ore, babá, bá^o:b, pasha, pá^o:sh, tenxheré, tenxhére* etj (Raka 2004: 8-9).

Raka (2004: 9-12) vëren se zanoret në këtë të folme mund të jenë: të shkurtra, të mesme dhe të gjata. Zanoret e shkurtra dalin te fjalët njërrrokëshe ose te fjalët dyrrrokëshe në pozicionin e rrokjes së mbyllur nga një bashkëtingëllore, p.sh.: *mik, plak, mal, zog, duvak, konak, binak*. Zanoret me gjatësi të mesme dalin te fjalët: *miki, ma^oli, pla^oki, zogi, duvaki, konaki, binaki* etj. Zanoret e gjata dalin te fjalët: *me shku:, mi:ll, di:ll, thi:k, ç:i:k, sho:k, puno:jm, shko:jm, beha:r, katuna:r, shpi:, mi:* etj. Zanoret hundore dalin në fjalë që ndiqen nga një bashkëtingëllore hundore: *llã^om nã^on, lã^om, kã^om, bã^oni, hñni, sýni, drñni, gñni, ã^osht, mullĩ* etj. Zanorja [e] hundore del me dy variante, njëra hundore e zakonshme që del edhe te të folmet e tjera të gegërishtes dhe tjetra është e mbyllur që del te fjalët e tipit: *fë:mën, vë:ni, së:ni, zë:mër, më:nja, ë:mën, frë:ni, pë:ni* etj. Kjo zanore hundore e dallon të folmen e Kaçanikut prej të folmeve të tjera të Kosovës.

E folmja e Kaçanikut me rrethinë e ka sistemin e zanoreve gojore me gjatësi të ndryshme dhe sistemin e zanoreve hundore. Zanoret gojore mund të dalin të theksuara dhe të patheksuara, ndërsa zanoret hundore dalin gjithmonë të theksuara. E folmja jugore e komunës së Kaçanikut (e folmja e Bobit, e Kovaçecit, e Biçecit, e Nikajve, e Dubravës) nuk e ka fonemën y në sistemin fonematik. Ndërsa në të folmen e qytezës së Kaçanikut del rregullisht në të gjitha pozicionet. Në të folmen e Kaçanikut me rrethinë dallohen zanoret e shkurtra (*mik, plak, duvak, shoć*), të mesme (*miki, plaki, duvaki, shoći*) dhe të gjata (*msu:, pru:, ka:, ki:,sy:*). Në këtë të folme dalin zanoret hundore të shkurtra: *â, ê, î, û, ý*, dhe zanoret hundore të gjata: *â:, ê:, î:, û:, ý:*. Hundorësia në këtë të folme shkaktohet nga nazalet *m, n, nj*: *kâ:m, nâ:n, mrêna, sêni, vêni, hî:, hñni, mullî:* etj. Në të folmet e fshatrave të Kaçanikut del vetëm një lloj i ê-së, ndërsa në të folmen e qytezës së Kaçanikut

dalin dy tipa të zanores hundore, njëra më e hapur dhe tjetra më e mbyllur. P.sh.: te fjalët: *qeni, seni, veni, emni* etj., zanoret hundore kanë timbër më të theksuar të hundorësisë dhe dallohen nga të gjitha të folmet e gegërishtes verilindore (Raka 1984: 33-45).

Një ndryshim që vërehet te e folmja e Kaçanikut është zanorja *a* te folja ndhëmse *kam*, e cila shqiptohet si *u* (*kum shku, kum tha:n, kum pa:*) në qytezën e Kaçanikut dhe te disa fshatra përreth. Në disa fshatra të tjera (Doganaj, Vatë, Elezaj) shqiptohet si *a* gojore, ndërsa në të folmet jugore të Kaçanikut shqiptohet si *o* gojore. Zanorja *a* e theksuar gojore dhe hundore ruhet mirë, por ka pësuar ndonjë ndryshim te disa fjalë, si: *gjã^o:m>gjëmoj>gjimoj, lavd>lëvdøj>livdoj, nã^o:m>nëmoj-nimoj, gaz>gëzøj>gzøj* etj. Në disa raste të tjera *a*-ja ka kaluar në *e*, si: *allat-alet, kafaz-kafez, mustak-musteçe* etj. Zanorja *e* gojore, kur ndodhet në pozitë të patheksuar, mund të pësojë ndryshime të tipit: *kirec, shiker, kimi, kini, imi, ini pami (paskemi), lã^omi (lahemi)*. Në këtë të folme zanorja *ë* ruhet mirë sa herë që ndiqet nga lëngëzoret *r, rr, l, ll*, ose nazalet *m, n*: *motër, zemër, dimën, darsëm, gogël, i vogël, tamël, rrotëll, vetëll* etj. Te zanorja *o* në disa fjalë me origjinë të huaj vërehet ndërrimi në *a*: *çarap, apet, nashta, ladroj* etj. Zanorja *u* shpesh kthehet në zanoren *ë*, si në shembujt: *rrotull- rrotëll, sjetull- sjetëll, lepur- lepër, flutur- flutër, kumbull- kumëll* etj. Zanorja [i], kur ndodhet pranë një zanoreje tjetër, kalon në lëngëzoren [j]: *maj vogli, maj dhimshmi, aj* etj., në disa raste të tjera labializohet [i]>[y]: *kryp, çylym, shyp, krym* etj. Zanorja [y] në të folmen e qytezës së Kaçanikut është ruajtur mjaft mirë, në krahasim me shumicën e fshatrave të Kaçanikut që e bëjnë ndërrimin y>i: *yll, ylber, ymyt, yny:r, yrnek, dy, dyftyrrsh, ly: pshty:, shkry:, pëlqy: etj* (Raka 2004: 11-14).

Diftongu *ue* është monoftonguar dhe ka mbetur zanorja mbi të cilën dikur binte theksi, p.sh.: *Ni gru: ish tu punu: n'oborr. Mu m' dul zani për t' keq*. Grupi vokalik *ue* ruhet mirë në këtë të folme. Togu zanor *ie* është reduktuar dhe ka mbetur zanorja *i*, mbi të cilën ka rënë theksi, p.sh.: *di:ll, mi:ll, qi:ll, zi:* etj. Togu *ae* dhe *oe* ruhen mirë në këtë të folme: *lae, thae, dhae* etj., ndërsa togu *ye* është reduktuar në *y*: *msy:, fy:ll, dy:r, ly:, pshty:, pëlky:, kapërçy:* etj (Raka 2004: 15-16).

Në sistemin e bashkëtingëlloreve në të folmen e Kaçanikut vërehen disa ndryshime te disa bashkëtingëllore. Bashkëtingëllorja *h* shqiptohet mirë në fillim dhe në mes të fjalës, por në fund të fjalës nuk dëgjohet e plotë, si: *kra, saba, gjyna, sho, le* etj. Ka raste kur vërehet alternimi i fonemës *h* me fonemën *f*, si te fjalët: *ftoft, ngroft, e njofta, u shkrifsh* etj. Bashkëtingëllorja *nj* ruhet mirë në

fillim të fjalës, në fund të fjalës kalon në *j* dhe në mes të fjalës nuk ruhet, por kalon në *n*: *ftoj, thoj, guj, kroshe, mene* etj. Disa fjalë, të cilat në të folmet e tjera të gegërishtes verilindore dalin me *gj*, në këtë të folme dalin me *g*: *gimnaz, geriz, gergef, gem, i ga:t, gethmo:n, gethka* etj. Në vend të palataleve *q* e *gj* dalin bashkëtingëlloret *ć* dhe *ğ*: *ćen, ćill, ćyce, će, ćels, ćekić, Kaćanik, ġarpën, ġezve, ġygy, ġami, ġemper, ġasht, i ġa:n* etj. Fonema *j* nuk shqiptohet te folja *jap* në të gjitha kohët dhe mënyrat, te emri *ujk* dhe te disa emra me prejardhje të huaj, si: *ćef, Hysen, Isuf, Ismal* etj. Në këtë të folme ka raste kur hasen ndërrimi i bashkëtingëllores *l* me *ll*-në: *llatin, llahu:t, llokomoti:v, llokall, i cilli, e cilla, cillt, cilla* etj. Bashkëtingëllorja *s* në raste të rralla, kur bashkohet me disa bashkëtingëllore (*t,n,dh*) kthehet në *c*: *mosc, mocanik, vedhcak, rencak* etj., ndërsa bashkëtingëllorja *z* në ndonjë rast kalon në *x*, p.sh: *kallxoj, menxi, nxe* etj (Raka 2004: 16-20).

Grupi bashkëtingëllor *mb* nuk ruhet në asnjë rast, por kalon ose në bashkëtingëlloren *m*, ose në *b>p*: *mas, mre:na, tre:m, plum, shkam, shkum, përmys, pram, hup, pshte:ll, prapasht* etj. Grupi i bashkëtingëlloreve *nd* ka përfunduar në *n*, si: *katun, shpen, ven, sen, nal, nihet, nalet, nryshe* etj. Grupi *ng* është ruajtur më mirë, si: *ngat, ngatrr:e:s, i ngujum, cung, peng, plang, magër, hangër*, por ka raste edhe kur kalon në *k*: *nga>ka, kanga-kajka, ngadal:kada:l* etj. Grupi *tj* del në dy forma në të folmen e Kaçanikut, si *k* dhe si *g*: *tjetër>ketër, tjera>kera, tjetërkush>ketërkush, tjeraka>keraka, tjetërkun>ketërkun, tjetrrri>ketrrri, atje>age, i atjehit>i agehit*. Edhe grupi *dj* del në dy forma, si *dj>g-j* dhe *dj>g*: *dje-ge, djep-gep, djeg-ge:g, djalë-gja:l, djath>gja:th* (Raka 2004: 20-21).

Në sistemin gramatikor paraqiten disa veçori të kësaj të folmeje. Emrat e gjinisë asnjaneë kanë përfunduar në emra të gjinisë mashkullore, si: *giathi, uji, voji, tlyni, mishi, milli* etj., por edhe në emra të gjinisë femërore një numër më i vogël i tyre: *krypa, buka* etj. Në lakimin e parë klasifikohen emrat të cilët marrin mbaresën *-i:lisi, mali, shoqi, plaki, miki* etj; lakimi i dytë mbetet i zbrazët, sepse emrat e këtij lakimi, të cilët marrin mbaresën *u*, janë përfshirë në lakimin e parë; në lakimin e tretë janë emrat e gjinisë femërore, të cilët marrin mbaresën *a/ja*: *nã^ona, buka, lopa, lulja, delja* etj., dhe në lakimin e katër emrat e gjinisë asnjaneë. Sa i përket shumësit të emrave, prapashtesa –*a* është mjaft produktive, si: *doktora, profesora, traktora, motorra, mësusa, oficira* etj. Shumësi formohet edhe me ndryshimin kuantitativ të zanores së theksuar, si: *dyshek-dyshe:k, gevrek-gevre:k, krevet-kreve:t, dallap-dalla:p* etj. Disa emra të tjerë e formojnë shumësin me palatalizim, si: *uq, pleq, miq, zogj, stogj, pyje, troje, buj* etj. Përdoren edhe prapashtesat me origjinë

orientale, si: *baballa^o:r, pashalla^o:r, hoxhalla^o:r, begle:r, shehle:r, dervishle:r* etj. Emrat, të cilët përfundojnë me *k, g, h*, nuk marrin mbaresën *u* në asnjë rast. Emrat e tipit *dele, nuse, lule*, e ruajnë zanoren *e* vetëm në rasën emërore, ndërsa në rasat e tjera e kthejnë në *ë*, si: *i ni nusës, ni nusës, nusën, pi nusës* etj (Raka 2004: 22-25).

Përemri vetor i vetës së parë njëjës del *une*, i vetës së dytë *aj/ajo*, veta e tretë shumës *ato* përdoret për të dy gjinitë. Përemri i vetës së tretë njëjës *aj*, në rasën kallëzore del *ata^o*. Përemri vetor *ti* në rasat e zhdrejta del me trajtën *tyje/ty*. Përemri *ato* në rasën dhanore dhe në kallëzore del me trajtën *atyneve/atyne*. Përemri dëftor *ky* e ndryshon vokalin *y* në *i*: *ky-ki*, në rasën kallëzore del *ka^o/ket*. Në këtë të folme dalin edhe përemrat: *kso, aso, ksofar, asofar, asi, ksi, ksifar, çet, çeta, çeto* etj. Përemrat pronorë në këtë të folme dalin me trajtat: *jem/jeme, i jemi, e jemja, i temës, temës, temën, pi temës, i joni, ton, tont, tonve, pi tonve, i tanit, tanit, tannin, tane, juve* etj. Disa prej përemrave të pacaktuar në këtë të folme hasen: *nejkush, nejnjë^oi* etj (Raka 2004: 25-27).

Sa i përket foljes, në këtë të folme paraqiten disa ndryshime. Foljet e zgjedhimit të parë që mbarojnë me zanore, në vetën e parë shumës, dalin me këto trajta: *shkojmi, shko:jn*. Foljet e zgjedhimit të dytë dalin me mbaresën *i*: *kapi, mledhi, prashiti, prishi, ndreqi* etj. Diateza pësore del me trajtat: *ha^opna, hapësh, hapët, hapmi, hapni, hapën* etj. Në kohën e pakryer foljet marrin këto mbaresa: *jshna, jshe, jke, jshmi, jshi, jshin*. E kryera e thjeshtë del me trajtat: *lajte, lajti, lajtëm, lajtët, lajtën*. Në këtë të folme dalin edhe kohët e dyta të përbëra: *kish pas pa^o:s, ishan kan çu, pata pas shi:t*. Koha e ardhme del me dy mënyra: *kam me shku:, dët shkoj* (Raka 2004: 28-30).

3.8.E folmja e Istogut

Për të folmen e Istogut është shkruar nga Gashi në studimin *Areali gjuhësor i Istogut me rrethinë* (2018). Gashi përdor metodën e bashkëbisedimit me subjektet, metodën e pyetësorëve dhe të vrojtimit të drejtpërdrejtë, duke zhvilluar biseda private për shëndetin, gjendjen ekonomike, punën etj. Studimi përfshin fushën e fonetikës, dukuritë fonetike, morfologjinë, fjalëformimin, sintaksën, tekste dialektore dhe një fjalorth dialektologjik.

3.9.E folmja e Opojës

Me të folmen e Opojës është marrë Pajaziti (2005) në monografinë *E folmja e Opojës*. Në këtë monografi trajtohen veçoritë gjuhësore fonetike, morfologjike dhe sintaksore të kësaj të folmeje. Hulumtimi është bërë në terren përmes ekspeditave individuale dhe kolektive, por është mbështetur edhe në materialet folklorike të Institutit Albanologjik.

Sistemi vokalik i së folmes së Opojës përbëhet prej 6 zanoresh të theksuara: *a, i, u, o, y* dhe *e*. Disa prej këtyre zanoreve pësojnë ndërrime, si: labializimi i *i*-së në *y* (*krym, kryp, bylbyl*); delabializimi i *y*-së në *i* (*tim, hina*); alternimi i *a*-së në *i* (*livdoj, gïmoj*); kalimi i zanores *ë* të patheksuar në *o* (*fjalot, lotot, naton, eton, udhon*); kalimi i zanores *e* të patheksuar në *o* (*duhot, rrihot blihot*); kalimi i zanores *a* të pathkesuar në *u* te folja ndihmëse *kam-kum*; rënia e zanores *u* të patheksuar në trup të fjalës (*me pnue, me pshue, gzosh*) etj; kalimi i zanores *u* në *o*: *petoll, vetoll, mjegoll, grumoll* etj (Pajaziti 2005: 216). Në këtë të folme nuk janë ruajtur qiellzoret *q* e *gj*, por kanë kaluar në afrikate *ç* dhe *ğ*. Në fushën e morfologjisë, Pajaziti (2005: 220), po ashtu, thekson disa dukuri dialektore të kësaj të folmeje. Emrat që dalin me bashkëtingëlloret *k* dhe *g* në trajtën e pashquar, në trajtën e shquar marrin mbaresën *i*: *maraki, zoki, veki, vargi* etj. Emrat asnjans kryesisht janë integruar në gjininë mashkullore: *tlyoni, mjalti, dylli*. Karakteristikë tjetër e së folmes së Opojës janë numërorët: *nimdhijot, dymdhijot, trimdhijot*. Përemri vetor *unë* del me trajtat: *ũ, un, una, une*. Përemra pyetës e të pacaktuar që përdoren në këtë të folme janë: *kush, sili, sila, xhi, njã^oni, donjã^oni, çerot, çetra, kreta, kret, sisili, dokush, korkush, asnjã^oni*. Mënyrat dhe kohët e foljes, në përgjithësi, dalin si te të folmet e tjera të Kosovës, por ka edhe perjashtime, si folja *jam* në kohën e tashme të habitores: *kã^ongom, kã^onge, kã^onga, kã^ongmi, kã^ongit, kã^ongon*.

3.10. E folmja e Rahovecit

E folmja e Rahovecit është trajtuar nga Dulaj (2016) në librin *E folmja e Rahovecit me rrethinë - Shqyrtime dialektologjike dhe sociolinguistike*. Kjo e folme trajtohet në fusha të ndryshme: në fonetikë, në morfologji, në sintaksë, në sociolinguistikë dhe në leksikologji. Për mbledhjen e materialit i është dhënë përparësi bisedës së lirë, por është përdorur edhe një pyetësor i hartuar për këtë qëllim dhe si ndihmesë edhe pyetësi i Atlasit Dialektologjik i Gjuhës Shqipe.

4.1. POZITA DHE STATUSI I SHQIPES NË VENDET SHQIPFOLËSE

Gjuha shqipe flitet në Kosovë, në Shqipëri, në Maqedoni, në Mal të Zi, në Luginë të Preshevës, në Greqi, në Itali, në Zvicër, në Austri, në Gjermani, në Skandinavi, në Amerikë, në Turqi etj. Sa i përket statusit të shqipes nëpër vendet shqipfolëse, Ismajli (2019: 353) thekson se shqipja e ka statusin e gjuhës zyrtare në Kosovë dhe në Shqipëri, statusin zyrtar të kufizuar si gjuhë me të drejta të plota në Maqedoni, statusin e gjuhës minoritare në Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës, statusin e gjuhës së grupit etnik në Italinë e Jugut, statusin e gjuhës pa status në Greqi dhe në Turqi.

Sipas të dhënave të Entit Statistikor të Kosovës (2009), popullsia e Kosovës përbëhet kryesisht nga komuniteti etnik shqiptar, që formon 88-92 për qind të banorëve; shqiptarët përbëjnë 88% të popullsisë, serbët janë komuniteti i dytë me 5.3%, të përcjellë nga turqit, boshnjakët, romët, ashkalinjtë, egjiptasit dhe goranët. Ka një sipërfaqe prej 10.880 km² dhe popullsi prej 1.9 milionë banorësh. Për statusin e shqipes në ish-Jugosllavi kanë shkruar Ismajli (2003, 2019), Rugova (2012), Munishi (2015) etj.

Rugova (2012), kur flet për statusin e shqipes kundruall gjuhëve të tjera të Ballkanit, dallon tri faza të ndryshme shoqëro-politike, të cilat kanë pasur ndikim në zhvillimin e shqipes. Faza e parë është nga viti 1972 deri në vitet nëntëdhjetë, kur në Shqipëri dhe në ish-Jugosllavi kalohet nga shoqëria totalitare në shoqëri demokratike. Si gjuhë zyrtare në këtë fazë përdoret serbo-kroatishtja, ndërsa shqipja është gjuhë e rendit të dytë. Faza e dytë përfshin vitet nëntëdhjetë deri në përfundimin e Luftës së Kosovës. Në këtë fazë degradohet sistemi shkollor dhe mbyllet televizionet në gjuhën shqipe. Faza e tretë është ajo pas luftërave në Kosovë, në Luginë të Preshevës dhe në Maqedoni. Rugova (ibid.) thekson se në gjithë arealin e saj shqipja është në kontakt me gjuhë të tjera dhe raporti me ato gjuhë ndryshon varësisht nga vendi.

Në ish-Jugosllavi, Ismajli (2019: 431) thekson se shqipja ka qenë gjuha e dytë pas serbo-kroatishtes, për nga numri i folësve dhe kompaktësia e popullsisë. Serbo-kroatishtja ka qenë e domosdoshme në procecin e punës, në komunikim me të tjerët, meqenëse në administratë të gjitha materialet janë hartuar në serbokroatisht, shqipja ka qenë gjuha në të cilën vetëm është përkthyer.

Shqipja është përdorur në mjetet e informimit publik, në revista të ndryshme, në monografi shkencore e teknike, në tekste universitare etj. Në këtë periudhë shqipja ka pasur statusin e gjuhës zyrtare bashkë me një gjuhë tjetër, e cila përdorej në të gjitha nivelet, nga shkolla deri te organet shtetërore, por jo edhe në ushtri. Në Kosovë, pas vitit 1989, jeta publike e shoqërore në gjuhën shqipe u shua: shkollat u mbyllën, u përjashtuan nga puna arsimtarët e shkollave fillore, të mesme dhe të universitetit, u përjashtuan nga puna 100.000 njerëz, u mbyllën televizionet shqiptare, u ndaluan gazetat në gjuhën shqipe etj. Pra, gjuha shqipe në këtë periudhë ishte gjuhë me përdorim vetëm formal, në të cilën përkthehej nga serbishtja (Ismajli 2019: 451). Munishi (2015: 124) shton se gjatë periudhës kur Kosova ishte pjesë e ish-Jugosllavisë dhe nën okupimin e Serbisë, serbishtja si *lingua franca* e atëhershme kishte më shumë prestigj dhe epërsi ndaj shqipes në shumicën e funksioneve dhe të domeneve formale. Si rrjedhojë, folësit e serbishtes ishin më të privilegjuar, ndërsa sot nxënësit nuk e kanë të domosdoshme ta mësojnë serbishten, si gjuhë në shkollë e mësojnë anglishten.

Në Kosovë, pas viteve 1998-99, shqipja, anglishtja dhe serbishtja e kishin statusin e gjuhës zyrtare, ndërsa bosnishtja, turqishtja dhe romishtja e kishin statusin e gjuhës së minoriteteve, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ligji për përdorimin e gjuhëve në Kosovës, neni 1.1, thotë se gjuha shqipe dhe gjuha serbe kanë status të barabartë si gjuhë zyrtare në Kosovë sa i përket përdorimit të tyre në të gjitha institucionet e Kosovës. Sipas nenit 1.2, në nivel komunal, gjuha turke, gjuha boshnjake dhe gjuha rome do të jenë gjuhë në përdorim zyrtar. Neni 2.3, thotë se në komunat e banuara nga një bashkësi, e cila përbën së paku 5 për qind të popullsisë së përgjithshme të asaj komune, gjuha e asaj bashkësie do të ketë statusin e gjuhës zyrtare në atë komunë dhe do përdoret në mënyrë të barabartë me gjuhët zyrtare. Pra, në Komunën e Prizrenit gjuha turke do të ketë statusin e gjuhës zyrtare. Më tutje, në nenin 2.4, theksohet se në ato komuna ku jeton një bashkësi, gjuha amtare e së cilës përfaqëson më shumë se tre për qind të popullatës së përgjithshme të komunës do të ketë statusin e gjuhës në përdorim zyrtar në atë komunë dhe do të jetë në përdorim të barabartë në pajtim me dispozitat e përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji. Aktualisht në Kosovë shqipja dhe serbishtja janë gjuhë zyrtare, ndërsa gjuha turke, boshnjake e rome e kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligjin. Turqishtja në Kosovë është gjuhë zyrtare në Prizren e në Mamushë.

Me dygjuhësinë shqip-serbisht dhe me problemet e zbatimit të dygjuhësisë në Kosovë është marrë Munishi (2016). Munishi për statusin e shqipes dhe të serbishtes në Kosovë pas vitit 1974 thekson se serbishtja ishte në pozitë më të favorshme për faktin se në kontekstin e përgjithshëm të ish-Jugosllavisë, si gjuhë e shumicës, shërbente edhe si *lingua franca* e federatës së atëhershme jugosllave. Munishi (ibid.) shton se shqiptarët dhe serbët në Kosovë në atë kohë, ndonëse ishin bashkësi folëse të ndryshme, përbënin një bashkësi komunikuese, sepse kishin ndërveprim dhe ndërkomunikim të përditshëm me njëri tjetrin, me ç'rast komunikimi zhvillohej kryesisht në kodin dominant që ishte serbishtja. Pas vitit 1990, gjuha shqipe u ndalua dhe u kufizua vetëm në domenet e familjes, në rrethin shoqëror që përbëhej kryesisht prej shqiptarëve, në punët me të cilat merreshin shqiptarët nën okupimin serb e në ato pak media që kishin mbetur në gjuhën shqipe. Pas vitit 1999 kjo situatë ndryshoi, sepse shqiptarët përbërnin 90% të popullsisë së Kosovës dhe si shumicë e favorizojnë gjuhën e tyre. Tani, edhe pse brezi i vjetër dhe i mesëm në Kosovë janë bilingë, hezitojnë ta flasin serbishten në komunikim me serbët, e njëjta vlen edhe për brezin e vjetër dhe të mesëm të serbëve. Disa prej problemeve që shfaqen në zbatimin e dygjuhësisë shqip-serbisht në Kosovë, Munishi (2016 : 569) i përmbledh në disa pika: probleme të natyrës ligjore, buxhetore e teknike, aspekti demografik, nxënia e gjuhës, denduria e komunikimit, domenet e dygjuhësisë dhe qëndrimet ndaj gjuhëve.

Për gjuhët që fliten nëpër qytete të Kosovës, Ismajli (2019: 149- 154) jep këto të dhëna: në Prishtinë flitet gjuha shqipe, gjuha serbe, turke dhe rome, por edhe gjuha angleze në kontakt me të huajt, ndërsa në kontakt me prishtinas të tjerë flitet vernakulari i shqipes veriore të Kosovës, në situata të tjera në kontakt me folësit e shqipes që i kanë mbaruar studimet (mësues, gazetarë, mjekë, avokatë etj) përdoret shqipja standarde me bazë në letrarishten geqe që është përdorur para viteve '70 të shek. XX dhe në kontakt me folës të shqipes standarde mund të flasë shqipen standarde ose vernakularin e vet të zakonshëm me elemente të standardit. Në të gjitha qytetet e tjera të Kosovës flitet vernakulari me bazë në gegnishten, me ngjyrimet e theksuara të folmja lokale. Në Prizren si gjuhë zyrtare përdoren shqipja, serbishtja, bosnishtja dhe turqishtja, ndërsa në qytet dëgjohet turqishtja vendëse; në Dragash flitet shqip, por edhe serbisht/boshnjakisht/nashki (gorançe); në Mamushë flitet turqisht, ndërsa në familje edhe shqip; në Mitrovicën Jugore gjuhë zyrtare janë shqipja dhe serbishtja, flitet shqip dhe pak turqisht, në Mitrovicën Veriore flitet serbishtja, edhe pse ka folës të shqipes; në Ferizaj varieteti i shqipes është vernakulari mbi bazë lokale dialektore me përzierje nga rajoni i Anamoravës; në Gjilan flitet varieteti i shqipes mbi bazë

të të folmeve lokale; në Gjakovë flitet shqipja e qytetit dhe vernakulari mbi këtë bazë; në komunat me shumicë serbe flitet serbishtja lokale, por edhe shqipja në fshatrat e përziera; në Vushtrri në jetën e përditshme përdoret e folmja lokale, ku ndeshet edhe turqishtja dhe në ndonjë fshat edhe serbishtja; në Pejë flitet shqipja lokale, ndërsa në rrethina përdoret e folmja lokale përkatëse, ku ka shkrirje të së folmes së Rugovës me të folmet e rretheve; në Rahovec përdoret shqipja lokale në jetën e përditshme, por në disa lokalitete përdoret edhe serbishtja vendëse; në Podujevë, në Suharekë, në Deçan, në Kaçanik, në Viti, në Lipjan, në Shtimje, në Istog, në Kamenicë, në Junik, në Klinë, në jetën e përditshme mbizotërojnë varietetet lokale me bazë të qartë dialektore; në fshatrat serbe të Deçanit e të Pejës flitet serbishtja lokale me përzierje të serbishtes letrare. Në Preshevë, në jetën e përditshme flitet shqipja e vendit, shkollat janë në gjuhën shqipe, por komunikimet me nivelet më të larta të administratës bëhen në gjuhën serbe; në Bujanoc, përveç shqipes flitet edhe serbisht e romisht.

Në Shqipëri, sipas të dhënave të Institutit të Statistikave të Shqipërisë, të vitit 2022, ka 2.793.592 banorë. Pakicat etnike që jetojnë në Shqipëri janë: grekët, maqedonasit, vllahët, malazezët, romët dhe goranët. Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 14, shqipja përcaktohet e vetmja gjuhë zyrtare në Shqipëri. Munishi (2015: 112) thekson se sa u përket funksioneve dhe domeneve të përdorimit, shqipja në Shqipëri zë pothuajse të gjitha hapësirat përkatëse të përdorimit. Tutje Munishi (ibid.) shton se shqipja është gjuhë që mësohet në të gjitha nivelet e arsimit dhe njohja e saj është parakusht për punësim. Përveç gjuhës shqipe, në Shqipëri përdoren nga grupet përkatëse etnike edhe greqishtja, maqedonishtja dhe malazezishtja, të cilat përdoren kryesisht në komunikime joformale e private, si dhe gjuhët e dy pakicave gjuhësore të romëve e të arumunëve. Pakicat greke dhe maqedonase kanë shkollat e tyre në Shqipëri (Munishi 2015: 113). Në Shqipëri ka pasur më shumë interes për italishten dhe greqishten, si gjuhë të minoritetit, të cilat fliten në nivele të ndryshme nga një pjesë e popullatës që punon në këto vende dhe që i mbajnë lidhjet me familjen në Shqipëri (Ismajli 2019: 324).

Ismajli (2019: 44) për gjendjen e arbërishtes në Itali dhe në Greqi thekson se pas vitit 1999 folësit e arbërishtes kanë të drejtë ta përdorin gjuhën e tyre në shkolla dhe në administratën lokale sipas Kartës Evropiane të Gjuhëve Minoritare, të cilën Italia e ka miratuar dhe e zbaton, pra e ka statusin e gjuhës së grupit etnik, ndërsa në Greqi situata është ndryshe, sepse ajo nuk e ka

nënshkruar Kartën Evropiane të Gjuhëve Minoritare dhe nuk e njih shqipen si gjuhë minoritare, pra është pa status.

Beci (2010) vëren se në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoni shqipja standarde funksionon si një mjet komunikimi i detyrueshëm në institucionet shtetërore, në shtyp, në botime të ndryshme, në radio e në televizion dhe në tërë sistemin shkollor, ndërsa në Mal të Zi dhe në Luginën e Preshevës mësohet në shkollë dhe përdoret në veprimtaritë e tjera. Në Kosovë, sa i përket përdorimit të gjuhës standarde, Ismajli (2019: 449) vë re se shqipja e përbashkët letrare e ka prestigjin e gjuhës së kombit dhe vlerën simbolike të bashkimit kombëtar. Gegërishtja dialektore përdoret në situata joformale, lokale, suburbane dhe rurale, ndërsa gegërishtja letrare përdoret në familje dhe në jetën e përditshme, ku nuk ka nevojë për të folurit formal.

Maqedonia ka 2,133,410 banorë. Sipas censusit të vitit 2021, në Maqedoni jetojnë afër 25% shqiptarë. Përveç shqiptarëve, në Maqedoni jetojnë edhe turqit, boshnjakët, romët, serbët etj. Në Maqedoni, sipas Kushtetutës së Maqedonisë, gjuhës shqipe i përcaktohet statusi i gjuhës zyrtare, në bashkësitë ku folësit e shqipes arrijnë 20% të popullatës. Edhe pse në Maqedoni shqipja flitet mbi 25 % e popullatës së shtetit, është gjuhë zyrtare vetëm në komunat ku flitet shqipja nga mbi 20% e popullatës. Munishi (2015: 114) thekson se funksionet dhe domenet e përdorimit të plotë të saj si gjuhë zyrtare, si dhe angazhimet për nxënien e saj, mbeten ende të kufizuara.

Në Maqedoni (Ismajli 2019: 434), shqipja përdoret në shkollën fillore, në fazën e parë të shkollës së mesme, në fazën e dytë pjesërisht, në shtyp, në radio e televizion, në botime, në teatër dhe pjesërisht në disa komuna në administratë vetëm me maqedonishten. Maqedonishtja është gjuha e vetme në përdorim zyrtar në qytete, ajo identifikohet si gjuhë e punës, e ekonomisë moderne, e shtetit dhe pushtetit, ndërsa shqipja përdoret në funksionet e gjuhës së familjes dhe të fshatit, pra të gjuhës jostandarde (Ismajli 2019: 436).

Mali i Zi, sipas regjistrimit të vitit 2011, ka 625,266 banorë. Shqiptarët përbëjnë rreth 5% të numrit të popullsisë. Edhe në Kushtetutën e Malit të Zi, në nenin 9, u përcaktua që në komunat në të cilat jeton një numër substancial i bashkësive etnike, gjuha e tyre do të jetë në përdorim zyrtar. Ismajli (2019: 438) vëren që në Mal të Zi situata është më ndryshe, për shkak të dallimeve demografike dhe sociale. Shqipja përdoret në shkollë fillore, në shkollë të mesme, pak në emisione të radios dhe në gazetë, por jo edhe në televizion. Te popullata shqiptare në Mal të Zi është një

vetëdije tjetër për gjuhën amtare, kjo vërehet edhe te ndryshimi e përshtatja e mbiemrave me prapashtesën *-ić*.

Në Preshevë, në Bujanoc dhe në Medvegjë shqipja përdoret në shkollat fillore, ndërsa në dy komunat e para edhe në të mesmet, pjesërisht edhe në administratë dhe në jetën kulturore (Ismajli 2019: 439). Në Serbi, shqipja vazhdon të ketë një përdorim më të koncentruar në komunat e Preshevës, të Bujanovcit dhe të Medvegjës, kryesisht në funksione private e domene joformale. Përdorimi i saj në funksione publike e domene formale mbetet nën trysinë e serbishtes (Munishi 2015: 116).

Kontaktet e shqipes në vendet shqipfolëse të lartpërmendura janë me gjuhë të ndryshme, Ismajli (2019: 357) vë në pah ndikimin në variacion nga kontaktet midis bashkësisë gjuhësore me gjuhët e tjera: në jug me greqishten dhe me italishten, në tërë Ballkanin me turqishten, me sllavishten e jugut në veri dhe në verilindje, me gjermanishten në Kosovë, në Luginë të Preshevës dhe në Maqedoni.

Për shkak se vendet shqipfolëse kanë qendra të ndryshme tregu, si p.sh: në Kosovë, në Maqedoni, në Preshevë e në Mal të Zi teknologjia e gjerë e konsumit kishte depërtuar përmes ndërmjetësimit të qendrave, si: Beogradi, Shkupi, Podgorica, Zagrebi, Lubjana, por edhe drejtpërdrejt nga Evropa Perëndimore, nga Gjermania, kjo ka ndikuar pastaj në terminologjinë e industrisë së ndërtimit dhe të shtresës së teknikëve dhe mjeshtërve të mirëmbajtjes, por edhe përmes kontakteve të drejtpërdrejta të njerëzve që kanë punuar në botën gjermane. Në Shqipëri tregu ishte i varur nga Italia dhe Greqia, e në këtë mënyrë edhe terminologjia vinte nga italishtja (Ismajli 2019: 34).

Shqipfolësit në Shqipëri kanë kontakte me italishten, te ta italishtja shihet si gjuhë e kulturës perëndimore dhe këto kontakte mungojnë në hapësirat e tjera; përveç me italishten popullata shqipfolëse në Shqipëri ka kontakte edhe me greqishten në punë dhe në edukim, ku shqipja nuk përdoret, po ashtu këto kontakte mungojnë në hapësirat e tjera shqipfolëse; popullata shqipfolëse në Malin e Zi ka kontakte me malazezishten, folësit e shqipes në Preshevë dhe për një pjesë në Kosovë kanë kontakte me serbishten; kontaktet e folësve të shqipes në Maqedoni me maqedonishten, kurse në Shqipëri mungojnë kontaktet me këto gjuhë sllave; kontaktet me

gjermanishten në Kosovë, në Maqedoni, në Preshevë, në Mal të Zi, ndërkohë që këto kontakte mungojnë në Shqipëri; kontaktet në rritje me turqishten gjithandej (Ismajli 2019: 41).

5. DIZAJNI I KORPUSIT TË FOLUR NË KOSOVË

Kosova ndodhet në pjesën juglindore të Evropës, përkatësisht në Gadishullin Ballkanik. Në veri e lindje kufizohet me Serbinë, në juglindje me Maqedoninë e Veriut, në jugperëndim me Shqipërinë dhe në perëndim me Malin e Zi. Ajo ndahet në dy tërësi të mëdha regjionale: Regjioni Lindor apo Rrafshi i Kosovës dhe Regjioni Perëndimor apo Rrafshi i Dukagjinit (Çavolli 1997: 6). Regjioni Lindor shtrihet në anën lindore të Republikës së Kosovës. Ky regjion, i cili përfshin mbi gjysmën e territorit të Republikës së Kosovës, në veri, në verilindje dhe në lindje kufizohet me Serbinë, në jug me Maqedoninë e Veriut, në perëndim me Rrafshin e Dukagjinit. Në rrafshet lartësia mbidetare është 400-700 m, ndërsa pika më e ulët ndodhet në Vërmicë (297 m) në kufi me Shqipërinë. Dy rrafshet janë të ndara dhe të rrethuara me vargmale në lartësi prej 2.000-2.500 m, pika më e lartë është Gjeravica (2.656 m). Lartësia mesatare mbi nivelin e detit është 811 metra. Klima e Kosovës përkufizohet nga dimri i ftohtë me reshje të rënda bore, si dhe vjeshtë e verë të nxehtë e të thatë. Në vise dhe lartësi të ndryshme mbi nivelin e detit vërehen ndikime mesdhetare dhe alpine.

Kosova ka një sipërfaqe prej 10.887 km² dhe popullsi prej 1.9 milionë banorësh. Popullsia që jeton në Kosovë është me shumicë shqiptare, por jetojnë edhe baskësi të tjera. Sipas të dhënave të Entit Statistikor të Kosovës, 2011, popullsia e Kosovës përbëhet kryesisht nga bashkësia etnike shqiptare, 92% të popullsisë e përbëjnë shqiptarët, serbët janë bashkësia e dytë me 4%, të përcjellë nga turqit, boshnjakët, romët, ashkalinjtë, egjiptasit dhe goranët.

Kosova i ka 38 komuna me 1.469 vendbanime dhe është e ndarë në shtatë rajone: rajoni i Prishtinës, i Prizrenit, i Mitrovicës, i Gjakovës, i Ferizajt, i Gjilanit dhe i Pejës.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë komunat e Kosovës dhe numri i intervistave në secilën komunë:

Tabela 1. Intervistat e realizuara nëpër komunat e Kosovës

Nr.	Komuna	Numri i banorëve	Numri i intervistave
-----	--------	------------------	----------------------

1.	Deçan	40,019	114
2.	Gjakovë	94,556	113
3.	Glllogoc	58,531	18
4.	Gjilan	90,178	120
5.	Dragash	33,997	17
6.	Istog	39,289	25
7.	Kaçanik	33,409	47
8.	Klinë	38,496	10
9.	Fushë Kosovë	34,827	19
10.	Kamenicë	36,085	2
11.	Mitrovicë	84,235	163
12.	Mitrovicë e Veriut	29.460	-
13.	Leposaviq	13,773	-
14.	Lipjan	57,605	114
15.	Novobërdë	6,729	2
16.	Obiliq	21,549	20
17.	Rahovec	56,208	125
18.	Pejë	96,450	131
19.	Podujevë	88,499	133
20.	Prishtinë	198,897	122
21.	Prizren	177,781	35
22.	Skënderaj	50,858	22
23.	Shtime	27,324	93
24.	Shtërpçë	6,949	21
25.	Suharekë	59,722	28
26.	Ferizaj	108,610	117
27.	Viti	46,987	9
28.	Vushtrri	69,870	25
29.	Zubin Potok	6,616	-
30.	Zveçan	7,481	-

31.	Malishevë	54,613	113
32.	Junik	6,084	7
33.	Mamushë	5,507	-
34.	Han i Elezit	9,403	24
35.	Graçanicë	10,675	11
36.	Ranillug	3,866	-
37.	Partesh	1,787	-
38.	Klllokot	2,556	-
Gjithsej	38	1,800,726	1800

Në gjithë Kosovën janë realizuar 1800 intervista. Numri i ndryshëm i intervistave nëpër komuna është bërë për shkak të madhësisë së ndryshme demografike, por edhe numrit të ndryshëm të vendbanimeve në kuadër të komunave. Në Komunën e Deçanit janë realizuar 114 intervista, në Komunën e Gjakovës 113, në Komunën e Gllogocit 18, në Komunën e Gjilanit 120, në Komunën e Dragashit 17, në Komunën e Istogut 25, në Komunën e Kaçanikut 47, në Komunën e Klinës 10, në Komunën e Fushë Kosovës 19, në Komunën e Kamenicës 2, në Komunën e Mitrovicës 163, në Komunën e Lipjanit 114, në Komunën e Novobërdës 2, në Komunën e Obiliqit 20, në Komunën e Rahovecit 125, në Komunën e Pejës 131, në Komunën e Podujevës 133, në Komunën e Prishtinës 122, në Komunën e Prizrenit 35, në Komunën e Skënderajt 22, në Komunën e Shtimes 93, në Komunën e Shtërpçës 21, në Komunën e Suharekës 28, në Komunën e Ferizajt 117, në Komunën e Vitisë 9, në Komunën e Vushtrrisë 25, në Komunën e Malishevës 113, në Komunën e Junikut 7, në Komunën e Hanit të Elezit 24 dhe në Komunën e Graçanicës 11 intervista. Nga 38 komuna, vetëm 8 nuk janë përfshirë në hulumtim, për shkak se popullsia në këto komuna është mbi 90% e banuar nga bashkësi të tjera etnike, si p.sh. Parteshi, Ranillugu, Zubin Potoku, Zveçani, Leposaviqi, Mitrovica e Veriut dhe komuna e Mamushës, në të cilat popullsia flet një gjuhë tjetër nga gjuha shqipe dhe kjo del përtej objektivit dhe qëllimit të hulumtimit.

5.1.1. Korpusi i folur në Komunën e Deçanit

Deçani është qytezë dhe qendër komunale që ndodhet në perëndim të Kosovës, rrëzë Bjeshkëve të Nemuna. Deçani ka territor prej 294 km², me gjithsej 36 vendbanime dhe rreth 40.000 banorë. Territori i Deçanit ka qenë i banuar që nga antikiteti, këtë e dëshmojnë lokalitetet arkeologjike në Vranovc të Vogël, në Gllogjan, në Strelc të Epërm, në Baballoq dhe në Irzniq. Deçani njihej me emrin *Ulëza*, në mesjetë (1689) me emrin *Deciani* dhe në fillim të shek. XX me emrin *Deçan* (Çevani 2018: 467). Sipas regjistrimit të vitit 2011, 99,4% të popullsisë e përbënin shqiptarët, 0,2% ashkalinjtë dhe 0,1% serbët.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë vendbanimet në Komunën e Deçanit dhe numri i incizimeve në secilin vendbanim:

Tabela 2. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Deçanit

Vendbanimet në Komunën e Deçanit	VL	VB	Vendbanimet në Komunën e Deçanit	VL	VB
Baballoq			Lluka e Epërme		
Beleg	4	9	Lluka e Poshtme		
Bellea			Lumbardh	2	
Carrabreg i Epërm	1	10	Maznik		
Carrabreg i Ulët	1	2	Papiq	1	2
Dashinoc	1	1	Papraqan	3	4
Deçan	26	15	Përlep	3	5
Drenoc	3	5	Posar	2	3
Dubovik	2	6	Rastovicë		
Dubrava			Ratish i Epërm	1	1
Gllogjan	3	6	Ratish i Ulët	2	3
Gramaçel	2	2	Rrzniq		
Hulaj			Shaptej	1	1
Irzniq	1	1	Sllup		
Isniq	4	8	Strelc i Epërm	7	9
Kodralli		3	Strelc i Ulët	7	8

Lëbushë	3	1	Voksh	6	7
Lloçan	2	2	Vranoc i Vogël		
Llovcë	1		Livoç	1	
Gjithsej	114				

Në Komunën e Deçanit janë mbledhur 114 incizime, në 24 vendbanime. Vendbanimet që janë përfshirë në hulumtim janë: Belegu, Carrabregu i Epërm, Carrabregu i Ulët, Dashinoci, Drenoci, Dyboviku, Gllogjani, Gramaçeli, Irzniqi, Isniqi, Kodralia, Lëbusha, Lloçani, Papiqi, Papatqani, Përlepi, Posari, Ratishini i Epërm, Ratishini i Ulët, Shaptej, Strellci i Epërm, Strellci i Ulët dhe Vokshi. Nga 114 subjekte, 91 vendin e lindjes e kanë brenda komunës së Deçanit dhe 23 në komuna të tjera, si: në Pejë 14 të anketuar, në Gjakovë 5, në Istog 3 dhe në Gjermani 1.

5.1.2. Korpusi i folur në Komunën e Gjakovës

Gjakova është qendër urbane, komunale dhe regjionale e pjesës qendrore të Rrafshit të Dukagjinit. Ndodhet në pjesën jugperëndimore të Kosovës dhe ndërmjet dy qendrave të rëndësishme regjionale, Prizrenit dhe Pejës. Në aspektin demografik, funksional dhe gravitues është qendra e tretë më e rëndësishme në Rrafshin e Dukagjinit.

Gjurimet arkeologjike dhe rrënojat e identifikuara afër lumit Erenik dëshmojnë se jeta në Gjakovë me rrethinë daton që nga koha antike romake. Kjo dëshmohet me artefaktet e gjetura në fshatrat: Fshaj, Ujë, Rogovë, Bardhasan, Bishtazhin, Moglicë, Brekoc etj. Qyteti përmendet për herë të parë në vitin 1574 nga tregtari Jak Vula, prej nga rrjedh edhe emri i qytetit, *Jakova* (Kastrati, Bytyqi 2018: 205). Sipas Agjencionit të Statistikave të Kosovës (2011), komuna e Gjakovës ka 94,556 banorë.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë vendbanimet në Komunën e Gjakovës dhe numri i intervistave në secilin vendbanim:

Tabela 3. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Gjakovës

Vendbanimet në Komunën e Gjakovës	VL	VB	Vendbanimet në Komunën e Gjakovës	VL	VB
Babaj i Bokës	3	3	Nivokaz	3	2
Bardhasan	2	2	Nec		1
Bardhaniq	1	1	Novosellë e Epërme	1	
Batushë	1	1	Novosellë e Poshtme		
Bec	2	3	Orize	3	3
Berjah	1	1	Osek Hilë	1	
Bishtazhin	2	2	Osek Pashë	1	1
Brekoc	1	1	Palabardhë	1	1
Brovinë			Pjetershtan	2	2
Cërmjan	1	1	Planqor	1	1
Damjan	1	1	Piskotë		1
Devë	3	3	Ponoshec	3	3
Doblibarë	4	2	Qerim	1	1
Dobrixhë		2	Qerret	1	1
Dujakë	1	1	Raçë	2	2
Duzhnjë		1	Radoniq	1	
Firzë	1		Rakoc	1	1
Gërçinë	2	2	Ramoc	3	3
Gërgoc	1	1	Rracaaj	2	2
Gjakovë	17	19	Rogovë	2	1
Goden			Sheremet	1	1
Guskë	3	3	Shishman	2	2
Hereç	1	1	Skivjan	2	2
Jabllanicë			Smaçë		
Jahoc	1		Smolicë	2	1
Janosh			Stubell	1	1
Kodralli			Trakaniq	1	1
Korenicë	1	1	Ujez	3	3

Koshare	1	2	Vogovë	1	1
Kralanë	2	1	Vraniq	1	1
Kushavec	1	1	Zhabel	1	1
Lipovec	1	1	Zhdrellë	1	1
Marmullë	3	3	Zhub	1	1
Meqe	1	1	Zidi Sadik Agës	3	3
Moglica	1	1	Zylfaj	1	1
Molliq	1				
Gjithsej	113				

Në Komunën e Gjakovës janë realizuar 113 intervista, në 58 vendbanime. Vendbanimet që janë përfshirë në hulumtim janë: Babaj i Bokës, Bardhasani, Bardhaniqi, Batusha, Beci, Berjahu, Bishtazhini, Brekoci, Cërmjani, Damjani, Deva, Doblilara, Nivokazi, Novosella e Epërme, Orize, Osek Hila, Osek Pasha, Palabardha, Pjetërshani, Planqori, Piskota, Ponosheci, Qerimi, Dujaka, Firza, Gërçina, Gërgoci, Guska, Hereçi, Jahoci, Korenica, Kosharja, Kralana, Kushavec, Lipoveci, Marmulla, Meqa, Moglica, Molliqi, Qerreti, Raça, Radoniqi, Rakoci, Ramoci, Rracaj, Rogova, Sheremeti, Shishmani, Skivjani, Smolica, Stublla, Trakaniqi, Ujza, Vogova, Vraniqi, Zhabeli, Zhdrella, Zhubi, Zidi i Sadik Agës dhe Zylfaj. Pesë subjekte banojnë jashtë Kosovës, në: SHBA, në Gjermani, në Francë, në Zvicër dhe në Shqipëri. Nga 113 të intervistuar, 112 e kanë vendin e lindjes në Komunën e Gjakovës dhe një subjekt në Komunën e Prizrenit.

5.1.3. Korpusi i folur në Komunën e Drenasit

Glllogoci apo Drenasi është qytezë dhe njësi komunale në pjesën qendrore të Kosovës. Kjo qytezë ka 34 vendbanime, me 58.531 banorë. Në antikitet Glllogoci me rrethinë njëhej me emrin *Dendrom*, ndërsa si vendbanim është regjistruar në vitin 1893. Në vitin 1960 është bërë qendër komunale. Sot kjo qytezë ka 6.000 banorë. Sipas regjistrimit të vitit 2011, shqiptarët e përbënin 99,8%, 3 turq, 3 egjiptianë, 1 serb dhe 1 boshnjak.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë vendbanimet në Komunën e Drenasit dhe numri i intervistave në secilin vendbanim:

Tabela 4. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Drenasit

Vendbanimet në Komunën e Drenasit	VL	VB	Vendbanimet në Komunën e Drenasit	VL	VB
Abri e Epërme			Krajkovë		
Arllat		1	Likoshan		
Baicë			Llapushnik	1	1
Cikatova e Vjetër			Negroc		
Cikatovë e Re			Nekoc		
Dobroshec			Poklek i Vjetër		
Domanek			Poluzhë		
Fushticë e Epërme			Shtrubullova		
Fushticë e Ulët	1		Shtuticë		
Gllanasellë			Stankoc		
Glllogoc	8	12	Tërdevc		
Gllabar	1	1	Tërstenik	1	1
Godanc			Vasilevë		
Gradicë			Vërboc		
Kishnarekë			Vuçak		
Komorani		1	Zabeli i Epërm		
Koreticë e Epërme			Zabeli i Ulët	1	1
Koroticë e Poshtme					
Gjithsej	18				

Në Komunën e Drenasit janë mbledhur 18 incizime në 8 vendbanime. Vendbanimet që janë përfshirë në hulumtim janë: Arllati, Fushtica e Ulët, Drenasi, Gllabari, Komorani, Llapushniku, Tërsteniku dhe Zabeli i Ulët. Prej 18 subjekteve, 13 e kanë vendlindjen në Komunën e Drenasit, 3 e kanë vendlindjen në Skënderaj, 1 në Prishtinë dhe 1 në Prizren.

5.1.4. Korpusi i folur në Komunën e Dragashit

Dragashi është qytezë dhe seli komunale në jug të Kosovës. Dragashi ka 35 vendbanime, sipërfaqe prej 433.8 km² dhe popullsi prej 33.997 banorësh. Vendbanimet më të hershme të kësaj komunë ishin Krakoshta dhe Dragashi, të cilat me kalimin e kohës janë shkrirë në një vendbanim të vetëm, Dragashin. Në mesin e viteve të 60-ta Dragashi e fiton statusin e qendrës komunale. Në qytezë, sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011, jetojnë 51,7% goranë, 45,4% shqiptarë, 1,6% boshnjakë etj.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë vendbanimet e komunës së Dragashit dhe numri i intervistave në secilin vendbanim:

Tabela 5. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Dragashit

Vendbanimet në Komunën e Dragashit	VL	VB	Vendbanimet në Komunën e Dragashit	VL	VB
Baçkë			Kukulan		
Bellobrod			Leshtan		
Blas			Lubovishtë		
Brezne (Mështekna)		1	Mlikë		
Brod			Orqushë		
Brodosanë (Bresanë)	5	5	Plava I		
Brrut	1	1	Plava II		
Buçe			Radeshë		
Buzez			Rapqë		
Dikancë			Restelicë		
Dragash	2	2	Rrenc		
Glloboçica I			Shajn I	4	4
Glloboçica II			Shajn II		
Kapre			Vranishtë		
Kërstec			Xërxë		
Kosavë			Zaplluxhë		

Krushevc			Zgatar		
Kuklibeg	4	4	Zlipotok		
Kukovc			Zym		
Plajnik					
Gjithsej	17				

Në Komunën e Dragashit janë mbledhur 17 incizime, në 6 vendbanime. Vendbanimet që janë përfshirë në hulumtim janë: Brezna, Brodosana, Brruti, Dragashi, Shajni dhe Kuklibegu. Prej 17 subjekteve, 16 vendlindjen e kanë në Komunën e Dragashit dhe 1 në Komunën e Prizrenit.

5.1.5. Korpusi i folur në Komunën e Istogut

Istogu apo Burimi është qytezë në pjesën veriperëndimore të Kosovës, ndërsa administrativisht i takon regjionit të Pejës. Istogu ka 49 vendbanime dhe 39. 289 banorë. Deri në shek. XIV nuk janë gjetur dëshmi të shkruara për ekzistencën e këtij vendbanimi. Në vitin 1942 e fiton statusin e qendrës urbane dhe të selisë komunale. Sipas regjistrimit të popullsisë (2011), Istogu ka këtë përbërje etnike: 98,6% shqiptarë, 0,6% egjiptianë, 0,3% romë, 0,3% boshnjakë dhe 1 serb.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë vendbanimet në Komunën e Istogut dhe numri i intervistave në secilin vendbanim:

Tabela 6. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Istogut

Vendbanimet në Komunën e Istogut	VL	VB	Vendbanimet në Komunën e Istogut	VL	VB
Banjë	1		Lubozhdë		1
Banjicë			Mojstir		
Belicë			Muzhevinë		
Bellopojë			Orobërdë		1
Carallukë			Osojan		

Cërkolez	1	2	Polan		
Cerrcë			Prekallë		
Dobrushë			Prigodë		
Dragolec			Rakosh		
Drejë			Shalinovicë		
Dubovë e Vogël	1		Sinaj		
Dubravë		2	Staradran		1
Gjurakoc (Gurrakoc)		1	Studenicë		
Istog	15	12	Suhogërlle		
Kaliqan			Sushicë		2
Kashicë			Tomoc		
Kërninë			Trubuhoc		
Kosh			Tuçep		
Kovragë			Uçë		1
Llugë			Veriq		
Llukac i Thatë			Vrellë		1
Llukac i Begut		1	Zhakovë		
Lubovë			Zhaq		
Gjithsej	25				

Në Komunën e Istogut janë realizuar 25 incizime, në 13 vendbanime. Vendbanimet që janë përfshirë në hulumtim janë: Banja, Cërkolezi, Dubova e Vogël, Dubrava, Gjurakoci, Istogu, Llukaci i Begut, Lubozhda, Orobërda, Staradrani, Sushica, Uça dhe Vrella. Nga 25 subjekte, 18 vendin e lindjes e kanë në Komunën e Istogut, 4 të anketuar në Pejë, 2 të anketuar në Gjermani dhe 1 në Mitrovicë.

5.1.6. Korpusi i folur në Komunën e Mitrovicës

Mitrovica është qytet, qendër komunale dhe regjionale e Republikës së Kosovës. Mitrovica është 9,8 km², prej të cilave Mitrovica Jugore ka 7, 22 km², ndërsa Mitrovica Veriore 2, 58 km². Sipërfaqja e territorit urban të Mitrovicës është rreth 1.000 ha, ku jetojnë 60.000 banorë. Zona suburbane që përfshin territorin e komunës është 336 km², me 85.701 banorë. Zona e Mitrovicës me komunitat e tjera në kuadër të këtij regjioni (Skënderaj, Vushtrria, Zveçani, Zubin Potoku, Leposaviqi) ka 336 vendbanime dhe 235.000 banorë (Ejupi, Ramadani 2018: 171). Të dhënat arkeologjike dëshmojnë për vazhdimësinë e jetës dhe të banimit në këtë zonë prej shek. II deri në shek. IV të e.s. Qyteti është i ndarë në dy pjesë: në pjesën jugore dominojnë shqiptarët, ndërsa në pjesën veriore serbët. Sipas regjistrimeve të vitit 2011, qyteti kishte këtë përbërje kombëtare: 93,3% shqiptarë, 1,9% ashkali, 1,6% romë, 1,5% turq dhe 1, 0% boshnjakë. Komuna e Mitrovicës i ka gjithsej 47 vendbanime.

Në tabelën e mëposhtme jepen vendbanimet në Komunën e Mitrovicës dhe numri i intervistave në secilin vendbanim:

Tabela 7. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Mitrovicës

Vendbanimet në Komunën e Mitrovicës	VL	VB	Vendbanimet në Komunën e Mitrovicës	VL	VB
Bajgorë	2	6	Rrzhanë		
Bare	3	7	Selac		
Batahir			Shipol		7
Broboniq		1	Shupkoc	2	10
Dedi	1	1	Stantërg	2	2
Gushac		2	Stranë		
Kaçandoll		2	Suhadoll	1	3
Kçiqi i Madh	2	3	Svinjar (Frashër)		3
Kçiqi i Vogël		1	Tërstenë		
Koprivë			Tunel i Parë	2	1
Koshtovë	2	5	Vaganicë	1	7

Kovaqicë			Vërnice		
Kutllovc	1	1	Vidimriq		
Lisicë	2	3	Vidishiq		
Lushtë		2	Vinarc i Epërm	1	1
Magjerë			Vinarci i Ultë		
Mazhiq			Vllahi		3
Melenicë	2		Zabërgjë		
Mitrovicë	119	25	Zasellë (Kodër)		3
Ofçar			Zhabari i Epërm	1	9
Pirç		1	Zhabari i Ultë		5
Rahovë	1	4	Zhazhë		1
Rashan		3	Zijaç		
Rekë (Pronas/Lumëz)		5	Tavnik		36
Gjithsej			163		

Në Komunën e Mitrovicës janë mbledhur 163 incizime, në 31 vendbanime. Vendbanimet që janë përfshirë në hulumtim janë: Bajgora, Barje, Broboniqi, Dedia, Gushaci, Kaçandolli, Kçiqi i Madh, Kçiqi i Vogël, Koshtova, Kutlloci, Lisica, Lushta, Pirçi, Rahova, Rashani, Reka, Shipoli, Shupkovci, Stantërgu, Suhadolli, Svinjari, Tuneli i Parë, Vaganica, Vinarci i Epërm, Vllahia, Zasella, Zhabari i Epërm, Zhabari i Ulët, Zhazha dhe Tavniku. Prej 163 subjekteve, 18 e kanë vendlindjen jashtë komunës së Mitrovicës, 10 në Vushtrri, 2 në Skenderaj, 4 në Prishtinë dhe 1 në Gjermani.

5.1.7. Korpusi i folur në Komunën e Pejës

Peja është qytet, qendër komunale dhe regjionale që ndodhet në Rrafshin e Dukagjinit. Ka gjithsej 79 vendbanime të organizuara në 28 bashkësi lokale. Territori i sotëm i Pejës ishte i banuar që nga parahistoria, këtë e dëshmojnë gjurmët në shpellat, si: shpella e Radacit, e Karamakazit në Grykën e Rugovës, shpella e Sigës etj. Lokaliteti më i vjetër në Pejë konsiderohet të jetë “Kodra e Kishës” në fshatin Vranoc (Ramadani, Bytyqi 2018: 136). Sot në qytetin e Pejës vlerësohet se

jetojnë rreth 80.000 banorë. Duke u bazuar në të dhënat e regjistrimit të vitit 2011, qyteti ka këtë përbërje etnike: 93.8% shqiptarë, 2.4% boshnjakë, 2.2% egjiptianë, 0.3 % romë, 0.2 % ashkali etj. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në vitin 2011 ka vlerësuar se komuna e Pejës ka 96, 450 banorë.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë vendbanimet në Komunën e Pejës dhe numri i incidimeve në secilin vendbanim:

Tabela 8. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Pejës

Vendbanimet në Komunën e Pejës	VL	VB	Vendbanimet në Komunën e Pejës	VL	VB
Babiqi			Llozhani	1	1
Barani	3	3	Llugaxhia		
Bellopaqi			Loxha	1	1
Bellopoja			Lubeniqi	1	2
Bllagaja	1	1	Lutogllava	2	1
Boga	3	2	Malaj	2	2
Bregu i Zi			Millovanca		
Brestoviku		2	Nabërxhani	3	2
Brezhaniku			Naklla		1
Broliqi	1	1	Nepola		1
Buçani	1	1	Novosella	5	4
Çallapeku	1	1	Osoja		
Dobërdoli	1	2	Ozdrimi	1	1
Drelaj	1	1	Pavlani		
Duboçaku			Peja	49	42
Dubova	2	2	Pepiqi	1	
Dugaiva	1	1	Pishtani		
Gllaviçica		1	Poçesta	1	1
Gllogjani	1	1	Qyshku	2	2
Gorazhdeci			Radaca	1	1

Graboci	2	2	Ramuni	1	1
Haxhaj	2	1	Rashiqi	1	1
Jabllanica			Raushiqi	2	3
Jabllanica e Madhe		1	Reka e Allagës	2	1
Jabllanica e Vogël			Rosula	1	1
Kapeshnica	1	2	Ruhoti		1
Katundi i Ri	1	2	Shkreli	1	1
Kërstoci		2	Shtupeqi i Madh	2	2
Kliçina	1	1	Shtupeqi i Vogël		1
Koshutani			Siga		
Koshutani	1	1	Stankaj	1	2
Kosuriqi	1	1	Sverka	1	1
Kotradiqi		1	Treboviqi		2
Krysheci	3	3	Tresteniku	1	1
Kuçishti	2	1	Turjaka	1	1
Leshani	1		Vitomirica		1
Lëvosha			Vragoci		
Lipa	2	1	Vranoci	2	2
Llabjani	1	1	Zagërma		
Llaz - bellopaqi			Zahaqi		1
			Zllapeku	1	1
Gjithsej	131				

Në Komunën e Pejës janë realizuar 131 incizime, në 59 vendbanime. Vendbanimet që janë përfshirë në hulumtim janë: Barani, Bllagaja, Boga, Brestoviku, Broliqi, Buçani, Qallapeku, Dobërdoli, Drelaj, Dubova, Dugaiva, Llozhani, Loxha, Leshani, Lutogllaba, Lubeniqi, Malaj, Nabërxhani, Naklla, Nepola, Novosella, Ozdrimi, Peja, Pepiqi, Gllaviçica, Gllogjani, Graboci, Haxhaj, Jabllanica e Madhe, Kopeshnica, Katundi i Ri, Kërstoci, Kliçina, Koshutani, Kosuriqi, Kotradiqi, Krysheci, Kuçishti, Lipa, Llabjani, Poçesta, Qyshku, Radaca, Ramuni, Rashiqi, Raushiqi, Reka e Allagës, Rosula, Ruhoti, Shkreli, Shtupeqi i Madh, Shtupeqi i Vogël, Stankaj,

Sverka, Trebovici, Tresteniku, Turjaka, Vitimirica, Vranoci, Zahiqi dhe Zllapeku. Prej 131 subjekteve, 122 vendin e lindjes e kanë në Komunën e Pejës, ndërsa 8 subjekte në komuna të tjera, si: 3 në Deçan, 2 në Gjakovë, 2 në Malishevë, 1 në Viti dhe 1 në Malin e Zi.

5.1.8. Korpusi i folur në Komunën e Prishtinës

Prishtina është qendër urbane, komunale, regjionale dhe kryeqytet i Kosovës. Nodhet në pjesën lindore të Kosovës. Sipërfaqja e territorit urban të Prishtinës është 3.000 ha, me rreth 350.000 banorë, me zonën suburbane (Fushë Kosova, Obiliqi, Graçanica) dhe metropolitane (Podujeva, Glligoci, Lipjani) (Ramadani, Bytyqi 2018: 30).

Territori i sotëm i Prishtinës ishte i banuar në vazhdimësi që nga parahistoria. Kjo dëshmohet me gjetjet arkeologjike në disa lokalitete të Prishtinës, si: në lokalitetin e Badocit, në lokalitetin e Glladnicës, në Matičan, në Gërnice, në Barilevë, në Ulpianë, në Graçanicë etj. Një ndër artefaktet më të rëndësishme arkeologjike të Kosovës është “Hyjnesha në fron”, që u gjet në vitin 1956 në lagjen Kalabria, në rrënojat e një vendbanimi rreth 5.500 vjet të lashtë. Sot është simbol kulturor dhe historik i kryeqytetit (Ramadani, Bytyqi 2018: 30-31). Emërtimi i Prishtinës supozohet se vjen nga latinishtja “*Pristinume*” që e ka kuptimin e dikurshme, e lashtë (*ibid.*). Sipas regjistrimit të vitit 2011, në Prishtinë jetojnë: 97,4% shqiptarë, 1,4% turq, 0,4% ashkali, 0,3 % boshnjakë etj. Prishtina i ka 43 vendbanime.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten vendbanimet dhe numri i intervistave në secilin vendbanim:

Tabela 9. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Prishtinës

Vendbanimet në Komunën e Prishtinës	VL	VB	Vendbanimet në Komunën e Prishtinës	VL	VB
Ballaban			Marec		
Bardhosh			Matičan		
Barilevë	2		Mramor		
Bërnice e Epërme		1	Nishec		

Bërnice i Poshtme			Zllatar		
Besi			Orlloviq		
Busi			Prapashticë	1	
Cagllavicë			Prishtinë	62	117
Dabishec			Prugoc		
Dragoc			Radashec		
Drenoc			Rimanishtë		
Glllogovicë			Sharban		
Grashticë			Shashkoc		
Hajkobilë			Shkabaj		
Hajvali		1	Siqevë		
Keçekollë			Slivovë		
Koliq			Sinidoli		
Kolovicë			Sofali		
Kukavicë			Tenezhdoll		
Lebanë		2	Trudë		
Llukar			Vranidoll		
Makoc	2	1	Zllashi		
Gjithsej	122				

Në Komunën e Prishtinës janë mbledhur 122 intervista, në 5 vendbanime. Vendbanimet që janë përfshirë në hulumtim janë: Prishtina, Lebana, Bërnica, Hajvalia dhe Makoci. Në tabelën e mëposhtme është dhënë numri i intervistave të subjekteve që e kanë vendlindjen në komuna të tjera.

Tabela 9.1. Numri i intervistave të subjekteve që e kanë vendlindjen në komuna të tjera

Vendlindja	Numri i intervistave	Vendlindja	Numri i intervistave
Lipjan	2	Shkup	1
Ferizaj	2	Preshevë	1
Pejë	2	Podujevë	2

Klinë	1	Malishevë	1
Rahovec	1	Kamenicë	1
Mitrovicë	7	Drenas	2
Shtime	3	Skënderaj	1
Vushtrri	1	Suharekë	3
Istog	1	Gjakovë	1
Fushë Kosovë	1	Prizren	3
Gjithsej	55		

Nga intervistat e mbledhura në Komunën e Prishtinës, 67 të intervistuar e kanë të njëjtë vendlindjen dhe vendbanimin, ndërsa 55 e kanë vendlindjen në qytete të tjera, si: Lipjani, Ferizaj, Peja, Klina, Rahoveci, Mitrovica, Shtinja, Vushtrria, Istogu, Fushë Kosova, Shkupi, Presheva, Podujeva, Malisheva, Kamenica, Drenasi, Skenderaj, Suhareka, Prizreni dhe Gjakova. Kjo përbërje heterogjene e të intervistuarve sipas vendit të lindjes është rrjedhojë e imigrimit intensiv të popullsisë nga qendrat e tjera të Kosovës, por edhe prej vendbanimeve shqiptare jashtë Kosovës. Një dukuri e tillë e ka shkaktuar rritjen e shpejtë mekanike dhe zgjerimin territorial e urbanistik të qytetit, duke shkrirë në indin urban të Prishtinës edhe vendbanimet e afërta rurale ose edhe ato urbane, siç është shembulli i Fushë Kosovës.

5.1.9. Korpusi i folur në Komunën e Prizrenit

Prizreni është qendër urbane, historike, komunale e regjionale. Nodhet në skajin jugor të Rrafshit të Dukagjinit. Për shkak të pozitës skajore ndaj Kosovës, një pjesë e territorit të komunës së Prizrenit kufizohet me Shqipërinë dhe me Maqedoninë. Pas Prishtinës, Prizreni është qyteti i dytë për nga numri i popullsisë, me rreth 85.000 banorë. Është qendër regjionale e Dukagjinit Jugor me komunat përreth (Dragashi, Suhareka dhe Mamusha). Prizreni është i banuar që nga lashtësia. Këtë e dëshmojnë gjetjet arkeologjike brenda territorit të sotëm urban të Prizrenit dhe lokaliteteve përreth, si *Vrapuesja e Prizrenit* që gjendet në Muzeun e Londrës, e cila i takon shek. V e.s (Dana, Bytyqi 2018: 97). Sipas regjistrimit në vitin 2011, Prizreni ka këtë strukturë etnike: 78,7% shqiptarë, 10,4% turq, 5,8% boshnjakë, 3,1% romë, 0,9 % ashkali, 0,7% goranë. Agjencia

e Statistikave e Kosovës (ASK) në vitin 2011 ka vlerësuar se komuna e Prizrenit ka 177,781 banorë.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë vendbanimet në Komunën e Prizrenit dhe numri i intervistave në secilin vendbanim.

Tabela 10. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Prizrenit

Vendbanimet në Komunën e Prizrenit	VL	VB	Vendbanimet në Komunën e Prizrenit	VL	VP
Atmagjë			Lubizhde e Hasit II		
Billushë			Lukinaj		
Breg Drini	1	1	Lutogllavë		
Caparc	1	1	Manastiricë		
Dedaj	1		Mazrekë	1	
Dojnicë			Medvec		
Drajçiq			Milaj		
Dushanovë			Mushnikovë		
Gërinqar			Nashec		
Gjonaj	2	1	Nebregosht		
Gorjnasellë			Novak		
Gorozhup	1	1	Novosellë		
Grozhdanik			Petrovë		
Hoçë e Qytetit			Piranë		
Jabllanicë			Pllanejë	2	1
Jeshkovë			Pllanjan		
Kabash			Poslishtë		
Kabash i Hasit			Prizren	15	19
Karashëngjergj			Randobravë		
Kobajë			Reçan		
Kojushë			Romajë	1	1
Korishë	2	2	Sërbicë e Epërme		

Krajk			Sërbiçë e Poshtme		
Krushë e Vogël			Shpenadi		
Kushnin			Skorobishtë		
Kushtendil			Smaç		
Landovicë			Sredskë		
Leskovec			Struzhë		
Lez	1		Trepetincë		
Llovakicë			Tupec		
Lubinjë e Epërme			Velezhë		
Lubinjë e Poshtme			Vërbiçan		
Lubiqevë			Vërmicë		
Lubizhdë	4	4	Vlashnjë		
Lubizhdë e Hasit I			Zhivinjan		
Zojz		1	Zhur		1
Zym	3	2			
Gjithsej	35				

Në Komunën e Prizrenit janë mbledhur 35 intervista, në 12 vendbanime. Vendbanimet që janë përfshirë në hulumtim janë: Breg Drini, Caparci, Gjonaj, Prizreni, Zhuri, Zymi, Zojzi, Gorozhupi, Planeja, Romaj, Korisha dhe Lubizhda. Prej 35 intervistave, 28 subjekte vendlindjen dhe vendbanimin e kanë të njëjtë, ndërsa 5 subjekte vendlindjen e kanë të ndryshme, brenda komunës së Prizrenit, në vendbanimet: Lez, Dedaj dhe Mazrek.

5.1.10. Korpusi i folur në Komunën e Gjilanit

Gjilani është qendër urbane, komunale dhe një ndër shtatë qendrat më të mëdha regjionale të Kosovës. Shtrihet në juglindje të Kosovës. Qyteti i Gjilanit përfshin sipërfaqe prej 2.000 ha, ku jetojnë mbi 70.000 banorë, komuna e Gjilanit ka rreth 90.000 banorë, ndërsa Gjilani me komunat e tjera në kuadër të këtij regjioni (Vitia, Kamenica, Novobërda, Klllokoti, Ranillugu dhe Parteshi) kanë rreth 180.000 banorë. Gjilani, sipas të dhënave historike, bën pjesë në radhën e qyteteve të reja, në vitin 1455 është regjistruar si fshat (Ejupi, Ramadani 2018: 235). Sipas regjistrimit të vitit

2011, Gjilani e ka këtë përbërje etnike: 97,5% shqiptarë, 1,2% turq, 0,7% romë dhe boshnjakë, serbë dhe goranë 0,1%.

Tabela 11. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Gjilanit

Vendbanimet në Komunën e Gjilanit	VL	VB	Vendbanimet në Komunën e Gjilanit	VL	VB
Nasalë			Makresh	1	
Bilincë	1		Perlepticë	1	
Bresalc	10	7	Pidiq		
Bukovik - Capar		1	Pogragjë	1	2
Burincë			Ponesh	1	2
Çelik	1		Shillovë		3
Cërnice	1	3	Shurdhan		
Dobërçan	1	2	Sllakov i Epërm	1	1
Dunav			Sllakov i Ultë		
Gadish			Sllubicë	1	
Gjilan	55	78	Stançiq		
Godeni i Vogël			Stublinë	1	
Inatoc	1		Uglar	1	1
Kishnapolë			Velekincë	1	1
Kmetoc		2	Vërbicë	1	1
Kravaricë	2	2	Vërbicë e Zhegocit		
Lipovicë			Vladovë		
Livoç i Epërm	1		Vlashticë		
Livoç i Ulët	1		Vrapçiq		
Llovcë	2	1	Zabel		5
Malishevë	3	2	Zhegër		1
Muçibabë	1		Zhegoc	2	1
Gjithsej			120		

Në Komunën e Gjilanit janë realizuar 120 intervista, në 29 vendbanime. Vendbanimet që janë përfshirë në hulumtim janë: Bilinca, Bresalci, Bukoviku, Çeliku, Cërnicë, Dobërçani, Makreshi, Përlepnica, Pogradja, Poneshi, Shillova, Sllakovi i Epërm, Gjilani, Inatoci, Kmetoci, Kravarica, Livoçi i Epërm, Livoçi i Ulët, Llovca, Malisheva, Muçibaba, Sllubica, Stublina, Uglari, Velekinca, Vërbica, Zabeli, Zhegra dhe Zhegocë. Në këtë komunë tre prej subjekteve e kanë vendbanimin në Gjermani dhe një në Zvicër. Prej 120 subjekteve, 92 vendin e lindjes e kanë në Komunën e Gjilanit dhe 28 në komuna të tjera, në Kamenicë 18, në Preshevë 5, në Gjermani 1, në Viti 3 dhe në Zvicër 1.

5.1.11. Korpusi i folur në Komunën e Fushë Kosovës

Fushë Kosova është qendër urbane dhe komunale në Kosovë. Gjendet në qendër të Rrafshit të Kosovës, rreth 8 km larg Prishtinës. Ndërtimi i hekurudhës në fund të shek XIX dhe lidhja e saj me Prishtinën e kanë ndikuar zgjerimin territorial dhe urbanistik të Fushë Kosovës. Kufizohet me Prishtinën, me Obiliqin dhe me Graçanicën. Fushë Kosova është banuar që nga kohët e lashta, këtë e dëshmojnë gjetjet arkeologjike, si: Kalaja e Harilaçit (shek IV-VI), lokaliteti në Bardh të Madh, në Miradi të Poshtme, në Lismir, në Sllatinë të Vogël etj. Sipas regjistrimit të vitit 2011, në Fushë Kosovë jetojnë: 86,9% shqiptarë, 9,3% ashkali, 1,3% romë, 0,9% serbë, 0,8 egjiptianë etj.

Tabela 12. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Fushë Kosovës

Vendbanimet në Komunën e Fushë Kosovës	Vendlindja	Vendbanimi
Bardh i Madh	1	3
Bardh i Vogël		
Bresje	1	2
Dobrevë e Ulët		
Dobrevë e Epërme		
Fushë Kosovë		3
Grabovci i Poshtëm	3	2
Harilaç		
Henc	1	1

Kuzmin		
Lismir	2	1
Miradi e Epërme		1
Pomazotin	2	2
Sllatina e Madhe	1	1
Sllatina e Vogël		1
Vragoli	2	2
Gjithsej	19	

Në Komunën e Fushë Kosovës janë mbledhur 19 intervista, në 11 vendbanime. Vendbanimet që janë përfshirë në hulumtim janë: Bardhi i Madh, Bresja, Fushë Kosova, Graboci i Poshtëm, Henci, Lismiri, Pomazotini, Sllatina e Madhe, Sllatina e Vogël dhe Vrogolia. Prej 19 subjekteve, 13 vendin e lindjes e kanë në Komunën e Fushë Kosovës dhe 6 në komuna të tjera: në Podujevë 1, në Drenas 3, në Shtime 1 dhe në Gjermani 1.

5.1.12. Korpusi i folur në Komunën e Kamenicës

Kamenica është qytezë dhe qendër komunale në lindje të Kosovës. Komuna e Kamenicës ka 58 vendbanime dhe 36.085 banorë (sipas regjistrimit të vitit 2011). Materialet arkeologjike dëshmojnë se Kamenica ishte e banuar që nga parahistoria. Në verilindje të qytezës është gjetur një gur i kohës së bronzit, i shek. V-IV e.s, i cili i përket kulturës iliro-dardane (Kallaba, Ramadani 2018: 365). Sipas regjistrimit të vitit 2011, komuna e Kamenicës e ka këtë përbërje kombëtare: 94,3% shqiptarë, 4,45 serbë, 0,5% romë, 0,4% goranë, 2 turq dhe 2 boshnjakë.

Tabela 13. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Kamenicës

Vendbanimet në Komunën e Kamenicës	VL		VB	Vendbanimet në Komunën e Kamenicës	VL	VB
Berivojcë				Leshtar		
Bllatë				Lisockë		
Boscë				Maroc		
Bratilloç				Meshinë		

Busavatë				Moçar		
Çarakoc				Muçivërc		
Dajkoc				Novosellë		
Dazhnicë				Petroc		
Desivojcë				Poliçkë		
Feriqevë				Rahovicë		
Gjyrishec				Roboc		
Gmicë				Rogaçicë		
Gragjenik				Sedllar		
Grizimë				Shahiq		
Hajnovc				Shipashnica e Epërme		
Hodonoc				Shipashnica i Ultë		
Hogosht				Strelicë		
Kamenicë	1		1	Strezoc		
Karaçevë i Epërm				Svirçë		
Karaçevë i Ultë				Tërstenë		
Kolloleq				Topanicë		
Kopërnice	1		1	Tugjec		
Koretin				Vaganesh		
Kostadincë				Velegllavë e Epërme		
Kranidel				Velegllavë e Ultë		
Kremena I				Vriqec		
Kremenata II				Zajçec		
Krilevë				Zhujë		
Lajçiq						
Gjithsej	2					

Në Komunën e Kamenicës janë mbledhur 2 intervista, në dy vendbanime: në Kamenicë dhe në Kopërnice.

5.1.13. Korpusi i folur në Komunën e Novobërdës

Novobërda është vendbanim dhe qendër komunale në pjesën lindore të Kosovës. Novobërda është një prej vendbanimeve më të vjetra të Kosovës, që nga mesjeta. Emërtimet që janë gjetur për këtë vendbanim janë: *Novaberd, Novus Mons, Novamonte, Nyeuberghe (1326)* etj (Ejupi, Bytyqi 2018: 550). Për shkak të zhvillimit të xehetarisë, të zejtarisë dhe të tregtisë, qysh në mesjetë Novobërda ka qenë ndër qendrat urbane më të rëndësishme ekonomike dhe kulturore të nivelit ballkanik. Sipas regjistrimit të popullsisë (2011), në Novobërdë jetojnë: 176 shqiptarë ose 96,2%, 6 turq ose 3,3% dhe 1 boshnjak.

Tabela 14. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Novobërdës

Vendbanimet në Komunën e Novobërdës	VL	VB	Vendbanimet në Komunën Novobërdës	VL	VB
Bolec			Manishincë		
Bostan			Miganoc		
Bushincë			Mozgovë		
Carevc			Novobërdë		
Dragancë			Parallovë		
Izvor			Prekoc		
Jasenovik			Stanishor		
Kllobukar			Strazhë		
Koretishtë			Tërniqec		
Kufcë e Epërm			Tirincë		
Llabjan/Labljane		1	Vllasali	1	1
Makresh i Epërm			Zebincë		
Makresh i Ulët					
Gjithsej	2				

Në Komunën e Novobërdës janë mbledhur 2 intervista, në Llabjan dhe në Vllasali. Prej këtyre dy intervistave, një subjekt vendin e lindjes e ka në Prishtinë.

5.1.14. Korpusi i folur në Komunën e Obiliqit

Obiliqi është qytezë dhe qendër komunale në pjesën qendrore të fushëgropës së Kosovës. Komuna e Obiliqit i ka 19 vendbanime dhe 21.549 banorë (sipas regjistrimit të vitit 2011). Obiliqi është banuar që nga koha e neolitit të vjetër, lokaliteti më i vjetër i këtij territori është *Lugu i Kishës*, sot në këtë pjesë gjendet “Kosova B”¹. Përgjatë historisë Obiliqi haset me emrat *Kloboderica*, *Klobovaq*, *Globoder*, ndërsa emrin Kastriot e mori në vitin 1999 (Restelica, Ramadani 2018: 392). Strukturën nacionale të popullsisë e përbëjnë etnitete të ndryshme, si: serbë, malazezë, romë, boshnjakë etj. Sipas regjistrimit të vitit 2011, Obiliqi e ka këtë përbërje kombëtare: shqiptarë 91,1%, ashkali 5,8%, serbë 1,1%, romë dhe egjiptianë 1,2%.

Tabela 15. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Obiliqit

Vendbanimet në Komunën e Obiliqit	VL	VB	Vendbanimet në Komunën e Obiliqit		
Babimoc			Leshkoshiq	1	1
Bakshi	2	2	Llazarevë	1	1
Breznicë			Mazgit	2	2
Cërkvëna Vodice			Milloshëvë		1
Dobrosellë			Obiliq	5	8
Graboc i Epërm			Plemetin		
Hade	2	2	Raskovë	1	1
Hamidi			Shipitullë		
Krushevcë	1	1	Siboc	1	1
Gjithsej	20				

Në Komunën e Obiliqit janë mbledhur 20 incizime, në 10 vendbanime. Vendbanimet që janë përfshirë në hulumtim janë: Bakshi, Hade, Krusheci, Leshkoshiqi, Llazareva, Mazgiti, Millosheva, Obiliqi, Raskova dhe Siboci. Prej 20 subjekteve, 16 vendin e lindjes e kanë në Komunën e Obiliqit, 1 në Mitrovicë, 1 në Vushtri, 1 në Prishtinë dhe 1 në Preshevë.

¹ Është termocentral në Kosovë, i cili përbëhet nga dy njësi gjeneruese të njohura si njësia B1 dhe B2.

5.1.15. Korpusi i folur në Komunën e Skënderajt

Skënderaj është qytezë dhe qendër komunale në veriperëndim të pjesës qendrore të Kosovës. Në vitin 1940 fiton statusin e qytezës dhe bëhet seli komunale e komunës së Skënderajt dhe e rrethit të Drenicës. Skënderaj bën pjesë në vendbanimet e reja të Kosovës, i zhvilluar gjatë shek. XX, por rrethina e tij është e banuar që nga koha e neolitit. Ndër vendbanimet e lashta përmenden Runiku e Tushila. Sipas regjistrimit të vitit 2011, në Skënderaj jetojnë 9, 372 banorë, ndërsa komuna e Skënderajt ka 50, 858 banorë, me këtë përbërje etnike: 99, 66% shqiptarë, 50 serbë, 42 boshnjakë, 11 ashkali dhe 70 të tjerë.

Tabela 16. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Skënderajt

Vendbanimet në Komunën e Skënderajt	VL	VB	Vendbanimet në Komunën e Skënderajt	VL	VB
Abri e Poshtme			Lubavec		
Bajë			Makërmal		
Baks			Marinë		1
Burojë			Mikushnicë		
Çirez			Murgë		
Çitak			Novosellë		
Çubrel		1	Ovçarevë		
Dashec			Pemishtë		
Izbicë			Plluzhinë		
Klinë e Epërme			Polac i Ri		1
Klinë e Mesme			Polac i Vjeter		1
Klinë e Poshtme			Prekaz i Epërm		1
Klladërnice			Prekazi i Ulëm		1
Kopiliq i Epërm			Prelloc		1
Kopiliq i Poshtëm			Radishevë		
Kostërc			Rakinicë		
Kotorr			Rezallë		
Kozhicë			Runik		

Kralicë			Skënderaj	18	13
Krasaliq			Syriganë		
Krasmiroc			Tërnavc		
Kryshec			Ticë		
Kuçicë			Turiqec	1	
Leçinë		1	Tushilë		
Likoc			Vajnikë		
Llaushë		1	Vitak		
Gjithsej	22				

Në Komunën e Skënderajt janë grumbulluar 22 intervista, në 11 vendbanime. Vendbanimet që janë përfshirë në hulumtim janë: Qubreli, Marina, Polaci i Ri, Polaci i Vjetër, Prekazi i Epërm, Prekazi i Ulët, Prelloci, Skënderaj, Turiqeci, Leçina dhe Llausha. Prej 22 subjekteve, 19 e kanë vendlindjen në Komunën e Skënderajt dhe 3 në Drenas.

5.1.16. Korpusi i folur në Komunën e Shtërpçës

Shtërpca është vendbanim dhe njësi komunale në pjesën jugore të Kosovës. Shtërpca është selia e tretë komunale më e madhe në Kosovë për nga sipërfaqja e zonës kadastrale, pas Junikut dhe Rahovecit. Shtërpca bën pjesë në rajonin e Ferizajt dhe i ka 16 vendbanime. Është e rëndësishme për lidhjen e vendbanimeve të Rrafshit të Dukagjinit me ato të Rrafshit të Kosovës. Sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011, Shtërpca ka 6, 949 banorë me këtë strukturë etnike: 54% shqiptarë, 45% serbë.

Në tabelën e mëposhtme jepen vendbanimet e komunës së Shtërpçës dhe numri i intervistave në secilin vendbanim:

Tabela 17. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Shtërpçës

Vendbanimet në Komunën e Shtërpçës	VL	VB	Vendbanimet në Komunën e Shtërpçës	VL	VB
---	-----------	-----------	---	-----------	-----------

Beroc			Izhancë	1	
Beverc I			Jazhincë		
Biti e Epërme	1		Kashtanjevë	2	
Biti e Poshtme			Sevc		
Brod	2	15	Shtërpcë	1	
Drekoc		1	Sushicë	1	
Firajë	2	2	Vërbeshticë		
Gotovushë			Viçë	1	3
Gjithsej	21				

Në Komunën e Shtërpcës janë mbledhur 21 intervista, në 9 vendbanime. Vendbanimet që janë përfshirë në hulumtim janë: Bitia e Epërme, Brodi, Drekoci, Firaja, Izhanca, Kashtanjeva, Shtërpca, Sushica, dhe Viça. Prej 21 intervistave, 11 subjekte e kanë vendlindjen në Komunën e Shtërpcës, 7 në Ferizaj, 1 në Gjilan, 1 në Kaçanik dhe 1 në Gjermani.

5.1.17. Korpusi i folur në Komunën e Suharekës

Suhareka është qytet dhe njësi komunale në jug të Kosovës. Kufizohet me 11 zona të tjera kadastrale që janë në kuadër të komunës së Suharekës. Qyteti i Suharekës ka 10,422 banorë (2011), ndërsa në Komunën e Suharekës jetojnë rreth 60.000 banorë. Komuna përbëhet prej qytetit dhe 40 vendbanimeve të tjera. Gjurmimet arkeologjike zbulojnë se në Shirokë (shek. VIII-VII e.s) ka qenë një vendbanim ilir i kohës së bronzit, i cili ka ekzistuar deri në periudhën romake. Përbërja kombëtare e qytetit është kjo: 98,5% shqiptarë, 1,1% ashakli dhe 0,3 % të tjerë.

Në tabelën e mëposhtme jepen vendbanimet e komunës së Suharekës dhe numri i intervistave në secilin vendbanim.

Tabela 18. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Suharekës

Vendbanimet në Komunën e Suharekës	VL	VB	Vendbanimet në Komunën e Suharekës	VL	VB
Bllacë		3	Maçitevë		

Budakovë			Mohlan		
Bukosh I			Mushtishtë		
Bukosh II			Nepërbishtë		
Çadrak			Nishor	1	1
Delloc			Papaz		
Dobërodelan		1	Peqan	1	1
Dubravë			Popolan		
Duhël			Rashtan		
Dvoran			Reqan		
Gelanc	1	3	Sallagrazhde	1	1
Gjinovc	1	1	Samodrezh	1	1
Grejçec			Savrovë		
Grejçec			Semetishtë		
Grejkoc	2	3	Sllapuzhan		
Javor			Sopijë		2
Kastërc			Staravuçin		
Krushica e Ultë			Studençan		6
Krushicë e Epërme			Suharekë	15	4
Leshan			Tërnjë		1
Luzhnicë			Vërshec		
Gjithsej	28				

Në Komunën e Suharekës janë mbledhur 28 intervista, në 13 vendbanime. Vendbanimet që janë përfshirë në hulumtim janë: Bllaca, Dobërdelani, Gelanci, Gjinovci, Grejkoci, Nishori, Peqani, Sallagrazhda, Samodrezha, Sopija, Studençani, Suhareka dhe Tërnja. Nga 28 intervista, 23 subjekte vendlindjen e kanë në Komunën e Suharekës, 4 në Prizren dhe 1 në Prishtinë.

5.1.18. Korpusi i folur në Komunën e Vitisë

Vitia është qytezë dhe njësi komunale në juglindje të Kosovës. Vitia bën pjesë në rajonin e Gjilanit, ndërsa statusin e qytezës e fiton në vitin 1927. Komuna e Vitisë ka rreth 46, 987 banorë, ndërsa vetëm qyteza rreth 5.000 banorë. Vitia është një ndër vendbanimet më të vjetra të fushës së Anamoravës. Kjo dëshmohet me lokalitetet e vjetra të Kalasë së Binçës, asaj të Gërqarit, Tërpezës, artefaktet arkeologjike të gjetura në Smirë, në Gushicë, në Vërban, në Stubëll e Devajë, të cilat datojnë nga periudha ilire dhe më herët (Rexha, Ejupi 2018: 460). Sipas regjistrimit të vitit 2011, qyteza ka këtë përbërje etnike: 98,3% shqiptarë, 1,3% serbë dhe 0,1% boshnjakë, romë dhe goranë.

Në tabelën e mëposhtme jepen vendbanimet e komunës së Vitisë dhe numri i intervistave në secilin vendbanim.

Tabela 19. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Vitisë

Vendbanimet në Komunën e Vitisë	VL	VB	Vendbanimet në Komunën e Vitisë	VL	VB
Ballancë			Radivojcë		
Beguncë			Ramjani		
Binçë			Ramnishtë		
Budrikë e Epërme			Remnik		
Buzovik			Sadovinë e Çerkezëve		1
Çiflak			Sadovinë e Jerlive		
Debellde			Shashare		
Devajë			Sllatinë		
Drobesh			Smirë		1
Gërmovë			Stubëll e Epërme		
Gjylekar			Stublla e Poshtme		1
Godenci i Madh			Tërpezë		
Gushicë			Tërstenik		
Kabash			Vërboc		
Letnicë			Vërnakollë		

Lubishtë			Vërnez		
Mjak			Viti	7	2
Novosellë			Vërban	1	2
Podgorc			Zhiti		
Pozharan		1			
Gjithsej	9				

Në Komunën e Vitisë janë realizuar 9 intervista, në 6 vendbanime. Vendbanimet që janë përfshirë në hulumtim janë: Smira, Vitia, Vërban, Sllatina e Poshtme, Pozhorani dhe Sodovina. Të gjitha subjektet vendlindjen e kanë në Komunën e Vitisë.

5.1.19. Korpusi i folur në Komunën e Vushtrrisë

Vushtrria është vendbanim urban në pjesën veriore të Kosovës. Komuna e Vushtrrisë ka 67 vendbanime, me rreth 69, 870 banorë, sipas regjistrimeve të vitit 2011. Vushtrria është një prej vendbanimeve më të mëdha në pjesën veriore të Rrafshit të Kosovës dhe një nga qendrat më të vjetra të Kosovës. Për shkak të pozitës së favorshme gjeografike, është mundësuar zhvillimi i hershëm i Vushtrrisë. Gjetjet arkeologjike dëshmojnë se Vushtrria është ngritur në lokacionin e vendbanimit antik “Vicianum”. Sipas regjistrimit të vitit 2011, qyteti kishte 98,4% shqiptarë, 1,1% turq, 0,4% ashkali, 1% boshnjakë, 4 serbë, 1 rom, dhe 1 egjiptian.

Në tabelën e mëposhtme jepen vendbanimet e komunës së Vushtrrisë dhe numri i intervistave në secilin vendbanim:

Tabela 20. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Vushtrrisë

Vendbanimet në Komunën e Vushtrrisë	VL	VB	Vendbanimet në Komunën e Vushtrrisë	VL	VB
Akrashtica			Nedakoci		
Balinca			Novolani		
Banjska			Novosella		1
Beçiqi			Oshlani		

Beçuku			Pantina		
Begaj			Pasoma		
Bivolaku			Pestova		
Boshllani			Prelluzha		
Brusniku			Rezniku		
Bukoshi			Ropica		
Cecelia			Samadrexha		
Dalaku		1	Sfaraçaku i Epërm		
Dobërlluka			Sfaraçaku i Poshtëm		
Druari			Shala		
Duboci			Shlivovica		
Dumnica e Epërme		1	Shtitarica		
Dumnica e Llugave			Skoçani		
Dumnica e Poshtme	2	1	Skroma		
Galica			Sllakoci		
Gllavatini			Sllatina		
Gojbula			Smrekonica		
Graca			Stanoci i Epërm		1
Gumnishti			Stanoci i Poshtëm		1
Hercegovia			Stroci		
Karaça			Studimja e Epërme		
Kolla			Studimja e Poshtme		
Kunoviku			Taraxha		
Kurillova			Tërllobuqi		
Liqej			Vërnica		
Lumadhi		1	Vesekoci		
Mavriqi			Vilanca		
Maxhunaj			Vushtrri	22	17

Mihaliqi		1	Zagora		
Miraça			Zhilivoda		
Gjithsej	25				

Në Komunën e Vushtrrisë janë realizuar 25 incizime, në 9 vendbanime. Vendbanimet që janë përfshirë në hulumtim janë: Novosella, Dalaku, Dumnica e Epërme, Dumnica e Poshtme, Stanoci i Epërm, Stanoci i Poshtëm, Lumadhi, Vushtrria dhe Mihaliqi. Nga 25 subjekte, 24 vendlindjen e kanë në Komunën e Vushtrrisë dhe 1 në Prishtinë.

5.1.20. Korpusi i folur në Komunën e Hanit të Elezit

Hani i Elezit është qytezë dhe qendër komunale në pjesën jugore të Kosovës. Në vitin 2007 është shpallur komunë, me 10 vendbanime. Ndodhet në zonën kufitare të Kosovës me Maqedoninë e Veriut. Qyteza ka pozitë të mirë gjeografike, sepse është e vendosur në skajin jugor të Grykës së Kaçanikut, nëpër të cilën kalojnë rrugët magjistrale, të cilat e lidhin Kosovën me Maqedoninë e Veriut. Emërtimi i vendbanimit vjen nga hani (bujtina) që ka ekzistuar në këtë vend (Vlashi 2018: 501). Komuna e Hanit të Elezit ka 9, 403 banorë, e banuar në tërësi nga shqiptarët.

Në tabelën e mëposhtme jepen vendbanimet në Komunën e Hanit të Elezit dhe numri i intervistave në secilin vendbanim.

Tabela 21. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Hanit të Elezit

Vendbanimet në Komunën e Hanit të Elezit	VL	VB	Vendbanimet në Komunën e Hanit të Elezit	VL	VB
Dimcë	1		Paldenicë	1	1
Dromjak		1	Pustenik	4	2
Gorancë			Rezhancë	2	3
Han i Elezit	6	12	Seqishtë	4	3
Krivenik	2	2	Vërtollnicë		
Necavac					

Gjithsej	24
----------	----

Në Komunën e Hanit të Elezit janë grumbulluar 24 incizime, në 8 vendbanime. Vendbanimet që janë përfshirë në hulumtim janë: Dimca, Dromjaku, Hani i Elezit, Kriveniku, Paldenica, Pusteniku, Rezhanca dhe Seqishta. Nga 24 subjekte, 20 vendlindjen e kanë në Komunën e Hanit të Elezit, 1 në Shkup, 1 në Ferizaj, 1 në Kaçanik dhe 1 në Podujevë.

5.1.21. Korpusi i folur në Komunën e Graçanicës

Graçanica është qytezë dhe njësi komunale, e cila administrativisht i takon regjionit të Prishtinës. Është themeluar në gjermadhat e një vendbanimi të vjetër të kohës së neolitit. Nga monumentet më të rëndësishme kulturore e historike në Graçanicë është Manastiri i Graçanicës, i cili daton nga shek. XIII. Graçanica i ka 10,675 banorë, me këtë përbërje etnike: 77,8% serbë, 16,0% romë, 2,0% shqiptarë, 0,8% ashkali, 0,8% goranë, 0,3% boshnjakë dhe 3 egjiptianë.

Në tabelën e mëposhtme jepen vendbanimet në Komunën e Graçanicës dhe numri i intervistave në secilin vendbanim.

Tabela 22. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Graçanicës

Vendbanimet në Komunën e Graçanicës	VL	VB	Vendbanimet në Komunën e Graçanicës	VL	VB
Batoc			Livagjë		
Batushë			Llapllasellë		
Çagllavicë			Preoci		
Dobratin			Radevë		
Gushtericë e Epërme			Skullani		
Gushtericë e Poshtme			Suhadolli		
Kishnicë	1	1	Shushicë	6	8
Lepi			Uglarë		
Gjithsej	11				

Në Komunën e Graçanicës janë mbledhur 11 intervista, në 2 vendbanime: në Shushicë dhe në Kishnicë. Prej 11 subjekteve, 9 vendlindjen e kanë në Komunën e Graçanicës, 1 në Prishtinë dhe 1 në Lipjan.

5.1.22. Korpusi i folur në Komunën e Junikut

Juniku është komunë dhe qytet i vogël në Kosovën perëndimore, në regjionin e Gjakovës. Është e vendosur në perëndim të Kosovës. Sipas regjistrimit të vitit 2011, qyteti i Junikut ka 6,053 banorë, ndërsa komuna ka 6,084 banorë. Ndodhet në mes të Deçanit dhe Gjakovës përgjatë kufirit malor të Kosovës me Shqipërinë. Është i populluar me shqiptarë.

Tabela 23. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Junikut

Vendbanimet në Komunën e Junikut	VL	VB
Gjocaj		
Jasiq		1
Junik	3	6
Gjithsej	7	

Në Komunën e Junikut janë mbledhur 7 incizime, në Junik dhe në Jasiq. Prej 7 subjekteve, 3 vendlindjen e kanë në Komunën e Junikut dhe 4 në Komunën e Gjakovës.

5.1.23. Korpusi i folur në Komunën e Lipjanit

Lipjani është qytezë dhe qendër komunale në pjesën qendrore të Rrafshit të Kosovës. Komuna e Lipjanit ka 60 vendbanime, ku jetojnë 57, 605 banorë (regjistrimi i vitit 2011), ndërsa në qytezë jetojnë 6, 870 banorë. Për shkak të pozitës qendrore në Rrafshin e Kosovës, është mundësuar kalimi i linjës së komunikacionit hekurudhor Mitrovicë-Prishtinë- Ferizaj- Shkup dhe rrugës automobilistike regjionale Prishtinë-Prizren. Lipjani bën pjesë në vendbanimet më të hershme të Kosovës, që nga periudha ilire, romake etj, që dëshmohet përmes shkrimeve të shumta

që janë gjetur për ekzistimin e Ulpianës antike, e cila ndodhet 10 km larg Lipjanit (Lahi, Ramadani 2018: 381). Sipas regjistrimit të vitit 2011, Lipjani ka këtë strukturë etnike: 85,4% shqiptarë, 6,6% serbë, 6,0% ashkali, 1,6% romë, 8 boshnjakë dhe 3 serbë.

Në tabelën e mëposhtme jepen vendbanimet në Komunën e Lipjanit dhe numri i intervistave në secilin vendbanim.

Tabela 24. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Lipjanit

Vendbanimet në Komunën e Lipjanit	VL	VB	Vendbanimet në Komunën e Lipjanit	VL	VB
Akllap	1	3	Marec	1	2
Alashi i Madh			Medvec	1	2
Alashi i Vogël			Mirenë		
Androc			Muhaxherbabush		2
Baicë			Novorujicë		
Banullë	3	3	Okosnicë		
Brus			Plitkoviq		
Bujan	2	2	Poturoc	2	3
Bukovicë			Qylagë		2
Carabreg			Resinoc		1
Divlak			Ribar i Vogël		3
Dobrajë e Madhe		2	Ribari i Madh	1	2
Dobrajë e Vogël	1	3	Ruboc	1	4
Gadime e Epërme	3	2	Shalë		
Gadime e Ulët	2	3	Shisharkë		
Gllavicë	1		Blinajë	1	1
Glllogoc	3	3	Skullan		
Grackë e Vogël	1	5	Silovi	4	7
Gumnasellë		3	Smallushë	1	3
Hallaç i Madh			Hallaç i Vogël		3
Janjevë	1	4	Starograckë		
Kleçkë			Starorujicë		

Kojskë		4	Teqe	1	1
Konjuh	2	3	Topliqan	1	2
Krajshtë	1	3	Torinë		2
Krojmir	2	2	Varigoc		
Leletiq	1	2	Vogaçicë		
Lipjan	15	18	Vrellë		
Lipovicë			Vrellë (e Goleshit)		
Llugagji	3	5	Vrshec		
Llugë			Zllakuqan		
Magurë	1	3			
Gjithsej	114				

Në Komunën e Lipjanit janë grumbulluar 114 intervista, në këto vendbanime: Akllap, Banullë, Bujan, Blinajë, Dobrajë e Madhe, Dobrajë e Vogël, Gadime e Epërme, Gadime e Ulët, Babush i Muhaxherëve, Marec, Medvec, Poturec, Qylagë, Resinoc, Ribar i Vogël, Ribar i Madh, Ruboc, Gllogoc, Grackë e Vogël, Gumnasellë, Janjevë, Kojskë, Konjuh, Krajshtë, Krojmir, Leletiq, Lipjan, Llugagji, Magurë, Sllovi, Smallushë, Hallaç i Vogël, Teqe, Topliqan dhe Torinë. Një subjekt vendbanimin e ka në Gjermani. Prej 114 të intervistuarve, 57 subjekte vendlindjen e kanë në Komunën e Lipjanit, 48 në Komunën e Prishtinës, 3 në Komunën e Gjilanit, 4 në Komunën e Shtimes, 1 në Komunën e Prizrenit dhe 1 në Gjermani.

5.1.24. Korpusi i folur në Komunën e Shtimes

Shtimja është qytezë dhe qendër komunale në qendër të Kosovës. Numri i popullsisë në qytezë është 7.255 banorë, i ka 23 vendbanime, ndërsa në gjithë Komunën, sipas regjistrimit të vitit 2011, jetojnë rreth 27.000 banorë. Që nga lashtësia ka shërbyer si udhëkryq për qendrat e tjera, edhe sot nëpër Shtime kalon rruga magjistrale Prishtinë – Shtime – Prizren. Gjurmë të jetës në këtë vendbanim që nga kohët e hershme gjenden në Mollopolc, në Carralevë, në Petrovë, në Karaçicë etj. Gjatë historisë i ka pasur këto emërtime: *Stimni*, *Qtimle*, *Shtimle* etj (Agaj, Ramadani

2018: 373). Sipas regjstrimit të vitit 2011, në Shtime jetojnë: 92,9% shqiptarë, 5,7% ashkali, 0,7% serbë, 0,3 % romë dhe 0,2% boshnjakë.

Në tabelën e mëposhtme jepen vendbanimet në Komunën e Shtimes dhe numri i intervistave në secilin vendbanim.

Tabela 25. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Shtimes

Vendbanimet në Komunën e Shtimes	VL	VB	Vendbanimet në Komunën e Shtimes	VL	VB
Belincë	2	2	Muzeqinë	1	2
Carralevë	2	3	Petroviq		
Devetak			Petrovë	3	3
Davidoc	3	12	Pjetërshticë	2	2
Dugë			Raçak	3	3
Gllavicë	2	2	Rancë	2	3
Gjurkoc	3	3	Rashincë	9	10
Godanc i Epërm	3	4	Shtime	11	25
Godanc i Poshtëm	3	3	Topillë		
Karaçicë			Vojnoc	1	3
Llanishtë	1	1	Zborc	3	5
Mollopolcë	3	3			
Gjithsej	93				

Në Komunën e Shtimes janë realizuar 93 incizime, në këto vendbanime: Belincë, Carralevë, Davidoc, Gllavicë, Gjurkoc, Godanc i Epërm, Godanc i Poshtëm, Llanishtë, Mollopolcë, Muzeqinë, Petrovë, Pjetërshticë, Raçak, Rancë, Rashincë, Shtime, Vojnoc dhe Zborc. Katër subjekte nga komuna e Shtimes banojnë në Gjermani. Nga 93 incizime, 57 subjekte vendlindjen e kanë në Komunën e Shtimes, 11 në Komunën e Prishtinës, 1 në Komunën e Vitisë, 4 në Lipjan, 11 në Ferizaj, 2 në Shkup, 1 në Shtërpçë, 1 në Gjilan, 1 në Suharekë dhe 4 në Gjermani.

5.1.25. Korpusi i folur në Komunën e Ferizajt

Ferizaj është qytet, qendër komunale dhe regjionale në pjesën jugore të fushëgropës së Kosovës. Si vendbanim është themeluar në territorin e fshatrave Nikadin dhe Zaskok, themelimi i Ferizajt lidhet me ndërtimin e hekurudhës Mitrovicë – Shkup (1874). Ferizaj shërben si urë lidhëse e shumë regjioneve, pozita gjeokomunikative e Ferizajt është bërë shumë e favorshme me ndërtimin e linjës hekurudhore dhe të stacionit hekurudhor, sepse hekurudha e ka bërë qytezë dhe qendër tregtare për rrethinën. Në qytet sot jetojnë rreth 43.000 banorë. Në fillim qyteti është quajtur Ferizbej, sipas emrin të themeluesit, Feriz Shashivarit, por vendasit e kanë quajtur edhe Tasjan, që do të thotë stacion apo ndalesë (Musliu, Rexhepi 2018: 265). Qyteti i Ferizajt në lashtësi nuk ishte i banuar, por gjurmimet arkeologjike dëshmojnë se periferia ka qenë e banuar që nga shek. VI p.e.s, në Varosh dhe në Nikadin, shek. II dhe III të e.s. Në rajonin e Ferizajt bëjnë pjesë këto komuna: Kaçaniku, Shtimja, Hani i Elezit dhe Shtërpca. Sipas regjistrimit të vitit 2011, në Ferizaj jetojnë: 93,4% shqiptarë, 5,2% ashkali, 0,4% romë dhe boshnjakë, 0,1% goranë, egjiptianë dhe turq.

Në tabelën e mëposhtme jepen vendbanimet në Komunën e Ferizajt dhe numri i intervistave në secilin vendbanim.

Tabela 26. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Ferizajt

Vendbanimet në Komunën e Ferizajt	VL	VB	Vendbanimet në Komunën e Ferizajt	VL	VB
Bablak		1	Muhaxher-Talinovc	2	1
Babushë i Serbëve			Muhoc		1
Balaj	1	1	Nekodim	3	2
Bibaj	1	1	Nerodimja e Epërme	1	1
Burrnik			Nerodimja e Ulët		1
Cërnillë			Papaz	1	1
Doganaj	1	1	Pleshinë	1	1
Dramjak	2	1	Pojatë		1
Ferizaj	35	56	Prelez i Muhaxherëve	1	1
Gaçkë	1	1	Rahovicë	3	2

Gërllicë e Ulëtë			Rakaj	1	2
Greme	2	3	Sazli	1	1
Jerliprelez			Slivovë	1	1
Jerlitalinoc		1	Softaj		1
Jezerc	3	2	Sojevë	2	2
Komogllavë	1	2	Starosellë		
Koshare	3	5	Svrcina		
Kosinë	1	1	Tankosiq		1
Lloshkobare	4	4	Tërn	1	2
Manastirc	1	1	Varosh	2	1
			Vojnoc	1	
Mirash	1	2	Zaskok	3	2
Mirosalë	6	8	Zllatar		
Gjithsej	117				

Në Komunën e Ferizajt janë mbledhur 117 incizime, në këto vendbanime: Bablak, Balaj, Bibaj, Doganaj, Dramjak, Ferizaj, Gaçkë, Greme, Talinoc i Jerlive, Jezerv, Komogllavë, Koshare, Kosinë, Lloshkobare, Manastirc, Mirash, Mirosalë, Talinoc i Muhahexherëve, Muhoc, Nekodim, Nerodime e Epërme, Nerodime e Ulët, Papaz, Pleshinë, Pojatë, Prelez i Muhaxherëve, Rahovicë, Rakaj, Sazli, Slivovë, Softaj, Sojevë, Tankosiq, Tërn, Varosh, Vojnoc, Zaskok dhe një në Francë. Prej 117 subjekteve, 87 vendlindjen e kanë në Komunën e Ferizajt, 1 në Komunën e Vushtrrisë, 1 në Drenas, 1 në Deçan, 1 në Francë, 2 në Shkup, 2 në Suharekë, 7 në Kaçanik, 3 në Gjilan, 4 në Shtime, 2 në Prishtinë, 1 në Pejë, 1 në Lipjan, 2 në Viti dhe 2 në Shtërpçë.

5.1.26. Korpusi i folur në Komunën e Kaçanikut

Kaçaniku është qytet dhe qendër komunale në pjesën jugore të Kosovës. Sipas ndarjes administrative-territoriale, Kaçaniku i takon regjionit të Ferizajt, i ka rreth 10.393 banorë, 31 vendbanime, ndërsa komuna e Kaçanikut i ka rreth 33.409 banorë, sipas regjistrimit të vitit 2011.

Kaçaniku ka pozitë të mirë gjeografike, sepse e lidh Kosovën me Maqedoninë. Gjurmët arkeologjike dëshmojnë se rrethina e Kaçanikut ka qenë herët e banuar, si vendbanimi Paldenicë, ku janë gjetur dëshmi që i takojnë shek. II. Sipas regjistrimit të vitit 2011, në Kaçanik struktura etnike është kryesisht shqiptare, por ka edhe romë e boshnjakë.

Në tabelën e mëposhtme jepen vendbanimet në Komunën e Kaçanikut dhe numri i intervistave në secilin vendbanim.

Tabela 27. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Kaçanikut

Vendbanimet në Komunën e Kaçanikut	VL	VB	Vendbanimet në Komunën e Kaçanikut	VL	VB
Bajnicë			Korboliq		
Begracë	1	1	Kotlinë	2	2
Biqec	3	3	Kovaçecë		1
Bob	1	1	Mahalla e Hoxhajve		
Doganaj	2	1	Nikaj	1	1
Drenogllavë			Nikovc		
Dura - Gabricë	1	1	Rekë		
Elezaj		1	Runjevë	1	1
Gabricë e Epërme			Semajë		
Gajre	6	6	Sllatinë		
Gërlicë e Epërme			Soponicë		1
Gjurgjedell			Stagovë	1	1
Glloboçicë	7	7	Strzhë	1	3
Ivajë	4	3	Vata – Dubravë	1	1
Kaçanik	10	12	Vërtollnicë		
Kacaniku i Vjetër					
Gjithsej	47				

Në Komunën e Kaçanikut janë mbledhur 47 intervista, në këto vendbanime: Begracë, Biqec, Bob, Doganaj, Dura-Gabricë, Elezaj, Gajre, Glloboçicë, Ivajë, Kaçanik, Kotlinë, Kovaçec, Nikaj, Runjevë, Soponicë, Stagovë, Strzhë, Vata-Dubravë. Prej gjithsej 47 incizimeve, 42

subjekte vendlindjen e kanë në Komunën e Kaçanikut, 2 në Ferizaj, 1 në Prishtinë, 1 në Tetovë dhe 1 në Shtërpçë.

5.1.27. Korpusi i folur në Komunën e Malishevës

Malisheva është qytezë dhe qendër komunale në pjesën qendrore të Kosovës. Komuna e Malishevës i ka 44 vendbanime dhe rreth 55.000 banorë, ndërsa vetëm qyteza rreth 3.000 banorë. Në vitin 1960 është bërë për herë të parë qendër administrative e politike, ndërsa sipas kriterit administrativ bën pjesë në regjionin e Prizrenit. Lashtësinë e Malishevës e dëshmon prezenca e tumës ilire në qendrën e qytezës, bashkë me disa vendbanime të tjera në këtë komunë, por edhe lokaliteti Pallanka, që thuhet se ishte vendbanim i vjetër ilir (Kafexholli 2018: 487). Sipas regjistrimit të vitit 2011, në Malishevë jetojnë 99,4% shqiptarë dhe 0,2% romë.

Në tabelën e mëposhtme jepen vendbanimet e komunës së Malishevës dhe numri i intervistave në secilin vendbanim.

Tabela 28. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Deçanit

Vendbanimet në Komunën e Malishevës	VL	VB	Vendbanimet në Komunën Malishevës	VL	VB
Astrazup		2	Llashkadrenoc		
Balincë		2	Llazicë		1
Banjë		5	Lubizhdë		2
Bardh		1	Malishevë	105	11
Belanicë		2	Marali		2
Berishë		1	Maxharë	1	3
Bubavec		1	Millanoviq		
Bubël		2	Mirushë		2
Carallukë		5	Mleqan	1	2
Carravranë			Ngucat		6
Damanek		3	Novosellë		1
Dragobil		5	Pagarushë	1	5

Drenoc		7	Panorc		2
Gajrak		2	Pllaqicë		2
Golluboc		1	Qypevë		1
Guriq		1	Rud		2
Jançishtë		1	Senik	2	5
Joviq		3	Shkoza		2
Kërvasari		3	Skorashnik		3
Kijevë			Temeqin		1
Lladroc	2	5	Tërpezë		1
Lladroviq			Turjakë		3
Llapqevë	1	3	Vërmnicë		1
Gjithsej	113				

Në Komunën e Malishevës janë realizuar 113 intervista, në këto vendbanime: Astrazup, Banjë, Balincë, Bardh, Belanicë, Berishë, Bubavec, Bubël, Carallukë, Damanek, Dragobil, Drenoc, Gajrak, Golluboc, Guriq, Jançishtë, Joviq, Kërvasari, Lladroc, Llapqevë, Llazicë, Lubizhdë, Malishevë, Marali, Maxharë, Mirushë, Mleqan, Ngucat, Novosellë, Pagarushë, Panorc, Pllaqicë, Qypevë, Rud, Senik, Shkozë, Skorashnik, Temeqin, Tërpezë, Turjakë dhe Vërmnicë. Të gjitha subjektet vendlindjen e kanë në Komunën e Malishevës.

5.1.28.Korpusi i folur në Komunën e Podujevës

Podujeva apo Besiana është vendbanim urban dhe qendër komunale në pjesën verilindore të Kosovës. Komuna e Podujevës ka 77 vendbanime dhe bën pjesë në regjionin e Prishtinës. Kjo komunë ka 88, 499 banorë, ndërsa vetëm qyteti rreth 23.000 banorë. Pozita e mirë komunikative rritet edhe më shumë me ndërtimin e autostradës Durrës – Kukës – Merdar, përmes së cilës Kosova lidhet me brendinë e Gadishullit Ballkanik. Gjurmë të jetës në këtë vendbanim ekzistojnë nga neoliti deri në ditët e sotme (Bytyqi, Ejupi 2018: 301). Sipas regjistrimit të vitit 2011, në Podujevë jetojnë: 96,8% shqiptarë, 2,6% ashkali, 0,3% romë, 10 boshnjakë dhe 3 serbë.

Në tabelën e mëposhtme jepen vendbanimet e komunës së Podujevës dhe numri i intervistave në secilin vendbanim.

Tabela 29. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Podujevës

Vendbanimet në Komunën e Podujevës	VL	VB	Vendbanimet në Komunën e Podujevës	VL	VB
Bajqinë	3	3	Merdar		
Ballovc	1	1	Metergoc		
Barainë			Metohi	1	1
Batllavë	1	3	Miroc		
Bellopojë	1		Muhazob	1	
Bërvenik	1	1	Murgull	1	1
Bllatë			Obrangj	1	1
Bradash	4	4	Orllan	1	
Brainë	2	2	Pakashticë e Epërme	1	1
Brecë			Pakashticë e Poshtme	3	
Buricë	2	2	Penuh	2	2
Dobërdol	3	3	Peran	2	2
Dobratin	2	2	Përpellac	1	1
Dumnicë e Epërme	3	2	Podujevë	28	43
Dumnicë e Poshtme		1	Pollatë	1	
Dumosh	1	2	Popovë	2	1
Dvorishtë			Potok		
Dyz	3		Radujevë		
Gërdoc	2		Rakinicë	1	1
Gllamnik	5	3	Reçicë	1	1
Godishnjak	1		Rep	1	1
Halabak	1	1	Revuç	2	
Hërticë	3	3	Sallabajë	1	1
Kaçybeg	1	1	Shajkoc	1	1
Kalaticë			Shakovicë	2	

Kërpimeh	2	1	Shtedim	3	2
Kunushec	1	2	Siboc i Epërm	5	3
Kushevicë			Siboc i Poshtëm		
Letanc	3	3	Sllatinë	1	1
Livadicë			Surdull		
Lladoc	2	1	Surkish	3	3
Llapashticë e Epërme	1	1	Sveçël	1	1
Llapashticë e Poshtme		4	Sylevicë		
Llaushë	2	1	Tërnav	1	1
Llugë		1	Tërnavicë	1	
Lluzhan	3	2	Turuçicë	1	1
Lupç i Epërm	1	1	Velikarekë (Katunishtë)	2	2
Lupç i Poshtëm			Zakut	1	
Majac	1	1	Zhiti	1	1
Gjithsej	133				

Në Komunën e Podujevës janë mbledhur 133 intervista, në këto vendbanime: Bajqinë, Balloc, Batllavë, Bellopojë, Bërvenik, Bradash, Brainë, Metohi, Muhazob, Murgull, Obrançj, Orllan, Pakashticë e Epërme, Pakashticë e Poshtme, Buricë, Dobërdol, Dobratin, Dumnicë e Epërme, Dumnicë e Poshtme, Dumosh, Dyz, Gerdoc, Gllamnik, Godishnjak, Halabak, Herticë, Kaçybeg, Kërpimeh, Kunushec, Letanc, Lladoc, Llapashticë e Epërme, Llapashticë e Poshtme, Llaushë, Llugë, Lluzhan, Lupç i Epërm, Majac, Penuh, Peran, Përpellac, Podujevë, Rakinicë, Reçicë, Rep, Revuç, Sallabajë, Shajkoc, Shakovicë, Shtedim, Siboc i Epërm, Sllatinë, Surkush, Sveçël, Tërnav, Tërnavicë, Turuçicë, Katunisht, Zakut dhe Zhiti. Nga 133 intervista, 130 e kanë vendlindjen në Komunën e Podujevës dhe 3 në Komunën e Prishtinës.

5.1.29. Korpusi i folur në Komunën e Rahovecit

Rahoveci është qytet dhe qendër komunale në Rrafshin e Dukagjinit. Rahoveci administrativisht i takon regjionit të Gjakovës. Si vendbanim është banuar shumë herët, nga epoka e hershme ilire-romake. Në fshatin Reti janë gjetur pllaka mermeri nga koha romake me mbishkrim latin. Në qytetin e Rahovecit jetojnë rreth 20.000 banorë, ndërsa sipas regjistrimit të vitit 2011 në gjithë Komunën jetojnë 56. 208. Përbërja etnike e Rahovecit është: 97,3% shqiptarë, 1,2% ashkali, 0,55 serbë, 0,4% romë dhe 0,2 % egjiptianë.

Në tabelën e mëposhtme jepen vendbanimet e komunës së Rahovecit dhe numri i intervistave në secilin vendbanim.

Tabela 30. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Rahovecit

Vendbanimet në Komunën e Rahovecit	VL	VB	Vendbanimet në Komunën e Rahovecit	VL	VB
Bellacërkë	3	6	Nushpal		2
Bërnjak			Opterushë		6
Bratotinë	1	2	Pastasellë		4
Brestoc		3	Pataçan i Epërm	4	6
Celinë		2	Pataçan i Poshtëm		2
Çifllak	1	3	Petkoviq		
Dejnë	2	3	Polluzhë	1	1
Dobidol		3	Radostë	5	6
Drenoc	1	5	Rahovec	49	21
Gegjë	2	3	Ratkoc	5	7
Hoçë e Madhe			Retijë		3
Hoçë e Vogël		4	Sapniq	1	5
Kaznik			Senoc		1
Kramovik	3	3	Vrajak	3	3
Krushë e Madhe	3	4	Xërxë	3	6
Mrasor	3	3	Zatriq	1	2
Nagavc	3	4	Zoçishtë		5

Gjithsej	125
-----------------	------------

Në Komunën e Rahovecit janë realizuar 125 intervista, në këto vendbanime: Bellacërkë, Bratotinë, Brestoc, Celinë, Çifllak, Dejnë, Dobidol, Drenoc, Gegjë, Hoçë e Vogël, Kramovik, Nushpal, Optrushë, Pastasellë, Pataçan i Epërm, Pataçan i Poshtëm, Polluzhë, Radostë, Rahovec, Ratkoc, Retijë, Sapniq, Senoc, Vrajak, Krushë e Madhe, Mrasor, Nagavc, Xërxë, Zatriq dhe Zoçishtë. Nga 125 subjekte, 91 vendlindjen e kanë në Komunën e Rahovecit, 22 në Komunën e Gjakovës, 1 në Malishevë, 10 në Prizren dhe në Prishtinë 1.

5.2. Moshë e të anketuarve

Përveç vendlindjes, vendbanimit, shkollimit, profesionit, gjuhës amtare dhe gjuhës së dytë, të anketuarit të dhënat demografike kanë plotësuar edhe gjininë dhe moshën e tyre. Nga 1800 të anketuar, 787 subjekte i përkasin grupmoshës së re (18-39 vjeç), 442 grupmoshës së mesme (40-59 vjeç), 434 grupmoshës së vjetër (60-79 vjeç) dhe 137 subjekte nuk e kanë deklaruar moshën e tyre.

Tabela 1. Moshë e të anketuarve

Qytetet	Grupmosha e re (18 - 39)	Grupmosha e mesme (40 - 59)	Grupmosha e vjetër (60- 79)
Peja	19	48	63
Deçan	38	46	29
Gjakovë	22	31	80
Prizren	13	9	14
Prishtinë	63	19	15
Gjilan	79	16	26
Ferizaj	37	38	42
Mitrovicë	110	39	14
Drenas	8	4	8
Dragash	4	11	2
Istog	19	5	2

Kaçanik	18	10	8
Klinë	6	2	2
Fushë Kosovë	5	9	6
Kamenicë	1	-	1
Lipjan	85	17	12
Novobërdë	1	-	1
Obiliq	7	7	6
Podujevë	57	34	42
Skënderaj	8	8	6
Shtime	51	25	17
Shtërpcë	7	13	1
Suharekë	12	9	8
Viti	5	2	1
Vushtrri	17	11	-
Zubin Potok	-	-	-
Malishevë	82	14	17
Mamushë	-	-	-
Hani i Elezit	8	7	9
Graçanicë	4	6	1
Çagllavicë	-	-	-
Partesh	-	-	-
Leposaviq	-	-	-
Junik	1	2	1
Klllokot	-	-	-

Grupmosha e re mbizotëron në këto komuna të Kosovës: në Prishtinë, në Gjilan, në Mitrovicë, në Drenas, në Istog, në Kaçanik, në Klinë, në Kamenicë, në Lipjan, në Novobërdë, në Obiliq, në Podujevë, në Skënderaj, në Shtime, në Suharekë, në Viti, në Vushtrri dhe në Malishevë. Grupmosha e mesme del më shumë në këto komuna: në Deçan, në Dragash, në Fushë Kosovë, në Obiliq, në Skënderaj, në Shtërpcë, në Graçanicë dhe në Junik. Grupmosha e vjetër del më shumë

në Pejë, në Gjakovë, në Prizren, në Ferizaj, në Drenas, në Kamenicë, në Novobërdë dhe në Han të Elezit.

5.3. Gjinia e të anketuarve

Nga 1800 të anketuar, 844 subjekte janë të gjinisë femërore dhe 956 subjekte të gjinisë mashkullore.

Tabela 2. Gjinia e të anketuarve

Qytetet	Femërore	Mashkullore	Gjithsej
1.Peja	42	88	130
2.Deçan	58	55	113
3.Gjakova	27	106	133
4.Prizren	15	21	36
5.Prishtinë	68	29	97
6.Gjilan	69	52	121
7.Ferizaj	70	47	117
8.Mitrovicë	81	85	166
9.Drenas	6	14	20
10.Dragash	1	16	17
11.Istog	16	10	26
12.Kaçanik	7	40	47
13.Klinë	5	4	9
14.Fushë Kosovë	8	12	20
15.Kamenicë	1	1	2
16.Lipjan	56	58	114
17. Novobërdë	1	1	2
18.Obiliq	2	18	20
19.Rahovec	85	41	126
20.Podujevë	73	60	133
21.Skënderaj	4	18	22

22. Shtime	46	46	92
23. Shtërpçë	16	5	21
24. Suharekë	17	12	29
25. Viti	6	2	8
26. Vushtrri	16	13	29
27. Zubin Potok	-	-	-
28. Malishevë	42	71	113
29. Mamushë	-	-	-
30. Han i Elezit	4	20	24
31. Graçanicë	2	7	9
32. Çagllavicë	-	-	-
33. Partesh	-	-	-
35. Leposaviq	-	-	-
36. Junik	-	4	4
37. Kllokot	-	-	-

Siç vërehet nga tabela e mësipërme, janë përfshirë përafërsisht njëlloj të dy gjinitë në shumicën e komunave të Kosovës. Në Deçan 51.32% janë femra dhe 48.67% meshkuj, në Pejë 30.76% janë femra dhe 67.69% meshkuj, në Gjakovë 20.30% janë femra dhe 79.69% meshkuj, në Prizren 41.66% janë femra dhe 58.33% meshkuj, në Prishtinë 70.10% janë femra dhe 29.89% meshkuj, në Gjilan 57.02% janë femra dhe 42.97% meshkuj, në Ferizaj 59.82% janë femra dhe 40.17% meshkuj, në Mitrovicë 48.79% janë femra dhe 51.20% meshkuj, në Drenas 30% janë femra dhe 70% meshkuj, në Dragash 5.88% janë femra dhe 94.11% meshkuj, në Istog 61.53% janë femra dhe 38.46% meshkuj, në Kaçanik 14.89% janë femra dhe 85.10% meshkuj, në Klinë 55.55% janë femra dhe 44.44% meshkuj, në Fushë Kosovë 40% janë femra dhe 60% meshkuj, në Kamenicë 50% janë femra dhe 50% meshkuj, në Lipjan 49.12% janë femra dhe 50.87% meshkuj, në Novobërdë 50% janë femra dhe 50% meshkuj, në Obiliq 10% janë femra dhe 90% meshkuj, në Rahovec 67.46% janë femra dhe 32.53% meshkuj, në Podujevë 54.88% janë femra dhe 45.11% meshkuj, në Skënderaj 18.18% janë femra dhe 81.81% meshkuj, në Shtime 50% janë femra dhe 50% meshkuj, në Shtërpçë 76.19% janë femra dhe 23.80% meshkuj, në Suharekë 58.62% janë

femra dhe 41.37% meshkuj, në Viti 75% janë femra dhe 25% meshkuj, në Vushtrri 55.17% janë femra dhe 44.82% meshkuj, në Malishevë 37.16% janë femra dhe 62.83% meshkuj, në Han të Elezit 16.66% janë femra dhe 83.33% meshkuj, në Graçanicë 22.22% janë femra dhe 77.77% meshkuj dhe në Junik 14.28% janë femra dhe 85.71% meshkuj.

Siç u pa më lart, në komunat e Kosovës ka pasur edhe të anketuar, të cilët vendlindjen ose vendbanimin e kanë jashtë Kosovës. Më së shumti, 14 të anketuar, ka të anketuar që kanë lindur ose jetojnë në Gjermani, në Luginën e Preshevës, në Francë, në SHBA, në Zvicër, në Shqipëri, në Mal të Zi dhe në Maqedoni.

5.4. Shkollimi i të anketuarve

Shkollimi është ndarë në shkollimin e ulët, të mesëm dhe të lartë. Nga 1800 të anketuar, të pashkolluar janë 19 subjekte, 265 të anketuar e kanë shkollimin e ulët, 505 të anketuar e kanë shkollimin e mesëm, 626 subjekte e kanë shkollimin e lartë dhe 132 nuk e kanë deklaruar profesionin e tyre.

Tabela 3. Shkollimi i të anketuarve

Shkollimi	Të pashkolluar	I ulët	I mesëm	I lartë
Pejë	3	14	42	64
Deçan	-	30	25	53
Gjakovë	12	29	42	40
Prizren	-	5	11	9
Prishtinë	-	4	12	64
Gjilan	4	17	35	62
Ferizaj	-	34	40	29
Mitrovicë	-	20	59	83
Drenas	-	3	5	7
Dragash	-	1	13	1
Istog	-	1	3	19
Kaçanik	-	5	13	14
Klinë	-	1	2	4

Fushë Kosovë	-	7	8	4
Kamenicë	-	-	-	2
Novobërdë	-	-	2	-
Obiliq	-	1	14	4
Podujevë	-	25	44	48
Skënderaj	-	6	3	13
Shtime	-	18	28	43
Shtërpcë	-	10	8	1
Suharekë	-	6	4	11
Viti	-	2	2	4
Vushtrri	-	2	1	17
Malishevë	-	18	66	24
Han i Elezit	-	4	14	4
Graçanicë	-	2	6	1
Junik	-	-	3	1

Ka pasur të anketuar, të cilët nuk kanë pasur fare shkollim. Në këto komuna mbizotëron shkollimi i lartë i të anketuarve: Pejë, Deçan, Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Drenas, Istog, Kaçanik, Klinë, Kamenicë, Podujevë, Skënderaj, Shtime, Suharekë, Viti dhe në Vushtrri. Shkollimi i mesëm del më shumë në këto komuna: në Gjakovë, Prizren, Ferizaj, Dragash, Fushë Kosovë, Novobërdë, Obiliq, Malishevë, Han i Elezit, Graçanicë dhe Junik. Shkollimi i ulët del vetëm në Komunën e Shtërpcës më mbizotërues se shkollimi i mesëm dhe i lartë.

5.5. Profesionet e të anketuarve

Nga 1800 të anketuar, 213 të anketuar janë të papunë, 232 janë studentë, 166 janë nxënës, 113 janë të pensionuar, 135 nuk e kanë deklaruar profesionin e tyre dhe 941 të anketuar kanë profesione, si: mësimdhënës, ekonomistë, juristë, inxhinierë, tregtarë, bujq, psikologë, punëtorë krahu etj.

Nga 114 të anketuar në Komunën e Deçanit, 26 apo 22.80 % janë të papunë, 8 apo 7.01% janë studentë, 8 apo 7.01% janë të pensionuar, 6 apo 5.26% janë nxënës dhe 3 apo 2.63% nuk e kanë deklaruar profesionin.

Tabela 1. Profesionet në Komunën e Deçanit

Profesionet	Deçan
Mësimdhënës	19
Bujq	8
Drejtorë	5
Tregtarë	5
Infermiere	3
Ekonomistë	3
Punëtorë	6
Berberë	3
Zyrtarë	2
Hidraulik	1
Arkatar	1
Teknik	1
Inxhinier	1
Etnologe	1
Laburante	1
Dizajner grafik	1
Jurist	1
Poet	1

Profesionet që dalin në Komunën e Deçanit janë: mësimdhënës 16.66%, bujq 7.01%, punëtorë 5.26%, drejtorë 4.38%, tregtarë 4.38%, infermiere 2.63%, ekonomistë 2.63%, berberë 2.63%, zyrtarë 1.75%, hidraulikë 0.87%, arkatarë 0.87%, teknikë 0.87%, inxhinierë 0.87%, etnologe 0.87%, laburante 0.87%, dizajnerë grafikë 0.87%, juristë 0.87% dhe poetë 0.87%.

Në Komunën e Gjakovës, nga 113 të anketuar, 11 apo 9.73% nuk e kanë deklaruar profesionin, 15 apo 13.27% janë të pensionuar, 4 apo 3.53% janë të papunë dhe 2 apo 1.76% janë studentë.

Tabela 2. Profesionet në Komunën e Gjakovës

Profesionet	Gjakove
Elektracist	1
Bujq	27
Ekonomist	1
Fermer	1
Berber	1
Blegtor	1
Arkatar	1
Juristë	2
Kamarier	1
Mirëmbajtës	1
Muzicent	1
Mësimdhënës	10
Drejtor shkolle	1
Punëtorë	3
Bukëpjekës	1
Teknik i bujqësisë	1
Menaxher	1
Tregtarë	5
Shoferë	2
Shitës	14
Neurolog	1
Këshilluese e strehimores	1
Oficer	1
Agjente e thirrjeve	1

Neuropsikiatër	1
----------------	---

Profesionet që dalin në Komunën e Gjakovës janë: bujq 23.89%, shitës 12.38%, mësimdhënës 8.84%, tregtarë 4.42%, punëtorë 2.65%, juristë 1.76, shoferë 1.76, elektrikistë, ekonomistë, fermerë, berberë, blegtorë, arkatarë, kamarierë, mirëmbjates, muzicentë, drejtorë shkolle, bukëpjekës, teknikë të bujqësisë, menaxherë, neurologë, këshilluese të strehimores, oficerë, agjente të thirrjes, neuropsikiatër 0.88%.

Nga 18 të anketuar në Komunën e Drenasit, 1 apo 5.55% është i papunë, 1 apo 5.55% është student, 2 apo 11.11% nuk e kanë deklaruar profesionin dhe 4 apo 22.22% janë pensionerë.

Tabela 3. Profesionet në Komunën e Drenasit

Profesionet	Drenas
Ekonomistë	2
Hoxhë	1
Jurist	1
Mësimdhënës	1
Shitës	4
Futbollist	1

Profesionet që dalin në Komunën e Drenasit janë: shitës 22.22%, ekonomistë 11.11%, hoxhë 5.55%, juristë 5.55%, mësimdhënës 5.55% dhe futbollistë 5.55%.

Nga 120 të anketuar në Komunën e Gjilanit, 15 apo 12.5% janë të papunë, 23 apo 19.16% janë studentë, 8 apo 6.66% janë nxënës, 5 apo 4.16% nuk e kanë deklaruar profesionin dhe 1 apo 0.83% është pensioner.

Tabela 4. Profesionet në Komunën e Gjilanit

Profesionet	Gjilan
Rrobaqepëse	3
Shoferë	5

Tregtar	1
Kuzhinierë	2
Ekonomistë	3
Stomatologë	3
Zyrtar	1
Infermiere	2
Shitës	2
Punëtorë	5
Pediatre	1
Teknikë	4
Mësimdhënës	10
Mekanikë	2
Biokimistë	2
Inxhinier	1
IT	1
Dizajner	1
Pastrues	1
Menaxher	1
Berberë	2
Agronom	1
Zdrukthëtar	1
Juristë	2
Zjarrfikës	1
Trajner	1
Arkitektë	2
Instruktor	1
Përkthyes	1
Biologe	1
Kamarier	1
Gjuhëtare	1

Profesionet që dalin në Komunën e Gjilanit janë: mësimdhënës 8.33%, rrobaqepëse 2.5%, kuzhinierë 1.66%, ekonomistë 2.5%, stomatologe 2.5%, infermiere 1.66%, shitës 1.66%, punëtorë 4.16%, teknikë 3.33%, biokimistë 1.66%, shoferë 4.16%, juristë 1.66%, arkitektë 1.66%, tregtarë, zyrtarë, pediatër, mekanikë, inxhinierë, IT, dizajnerë, pastrues, menaxherë, agronomë, zdrukthëtarë, zjarrfikës, rojtarë, trajnerë, instruktorë, përkthyes, biologë, pensionerë, kamarierë, gjuhëtarë 0.83%.

Në Komunën e Dragashit, nga 17 të anketuar, 5 apo 29.41% nuk e kanë deklaruar profesionin dhe 2 apo 11.76% janë nxënës. Profesionet që dalin në Komunën e Dragashit janë: punëtorë krahu 52.94% dhe hoxhë 5.88%.

Nga 25 të anketuar në Komunën e Istogut, 10 apo 40% janë studentë, 3 apo 12% nuk e kanë deklaruar profesionin, 1 apo 4% është nxënës dhe 1 apo 4% është i papunë.

Tabela 5. Profesionet në Komunën e Istogut

Profesionet	Istog
Inxhinier i ndërtimtarisë	2
Gazetare	2
Menaxhere	1
Ekonomiste	1
Drejtor shkolle	1
Ndërtimtar	1
Grimere	1
Gjeolog	1

Profesionet që dalin në Komunën e Istogut janë: inxhinierë të ndërtimtarisë 8%, gazetarë 8%, menaxherë, ekonomistë, drejtorë shkolle, ndërtimtarë, grimerë, gjeologë 4%.

Nga 47 të anketuar në Komunën e Kaçanikut, 5 apo 10.63% janë të papunë, 9 apo 19.14% nuk e kanë deklaruar profesionin, 4 apo 8.51% janë nxënës dhe 1 apo 2.12% është student.

Tabela 6. Profesionet në Komunën e Kaçanikut

Profesionet	Kaçanik
Ekonomistë	2
Menaxher	1
Taksist	1
Mësimdhënës	3
Shitës	4
Kryesues i kuvendit	1
Kasap	1
Shankist	1
Berber	1
Mekanik	1
Jurist	1
Arkitekt	1
Stomatolog	1
Bujq	4
Tregtarë	2
Punëtor	1
Historian	1
Zyrtar	1

Profesionet që dalin në Komunën e Kaçanikut janë: ekonomistë 4.25%, mësimdhënës 6.38%, shitës 8.51%, bujq 8.51%, tregtarë 4.25%, menaxherë, taksistë, kryesues të kuvendit, kasapë, shankistë, Berberë, mekanikë, juristë, arkitektë, stomatologë, punëtorë, historianë dhe zyrtarë 2.12%.

Në Komunën e Klinës, nga 10 të anketuar, 2 apo 20% janë studentë dhe 5 apo 50% nuk e kanë deklaruar profesionin. Profesionet që dalin në Komunën e Klinës janë: infermierë, ekonomistë dhe punëtorë 10%.

Në Fushë Kosovë, nga 20 të intervistuar, 4 apo 20% janë të papunë dhe 1 është student.

Tabela 7. Profesionet në Komunën e Fushë Kosovës

Profesionet	Fushë Kosovë
Ekonomist	1
Mësimdhënës	3
Shitës	2
Mekanik	1
Bujq	2
Punëtorë	3
Xehetar	1
Drejtues i trenit	1

Profesionet që dalin në Fushë Kosovë janë: mësimdhënës 15%, punëtorë 15%, shitës 10%, bujq 10%, ekonomistë, mekanikë, xehetarë dhe drejtues treni 5%.

Nga dy të intervistuar në Komunën e Kamenicës, njëri është student dhe tjetri jurist.

Në Komunën e Mitrovicës, nga 163 të anketuar, 8 apo 4.90% janë të papunë, 27 apo 16.56% janë nxënës, 17 apo 10.42% janë studentë dhe 7 apo 4.29% nuk e kanë deklaruar profesionin.

Tabela 8. Profesionet në Komunën e Mitrovicës

Profesionet	Mitrovicë
Përkthyes	7
Zyrtarë	8
Ekonomistë	9
Instruktur	1
Arkitekt	1
Taksist	1
Inxhinierë	5
Veterinar	1
Hidraulik	1
IT	2

Juristë	6
Doganierë	2
Kuzhinier	1
Dizajner	1
Mjeshtër	1
Muzicent	1
Mësimdhënës	12
Polic	1
Punëtorë	3
Rrobaqepëse	3
Teknik (i dhëmbëve, i xehetarisë, i elektros)	5
Teknolog ushqimi	1
Sociolog	1
Tregtarë	13
Minator	1
Rojtar	1
Elektricit	1
Fizioterapist	1
Infermierë	5
Menaxherë	3
Futbollist	1
Mekanikë	4
Bibliotekist	1

Profesionet që dalin në Komunën e Mitrovicës janë: tregtarë 7.97%, mësimdhënës 7.36%, ekonomistë 5.52%, zyrtarë 4.90%, përkthyes 4.29%, juristë 3.68%, inxhinierë 3.06%, teknikë 3.06%, infermierë 3.06%, mekanikë 2.45%, menaxherë 1.84%, punëtorë 1.84%, rrobaqepëse 1.84%, IT 1.22%, doganierë 1.22%, minatorë, rojtarë, elektrikistë, fizioterapistë, futbollistë, bibliotekistë, instruktorë, arkitektë, taksistë, veterinarë, hidraulikë, kuzhinierë, dizajnerë, mjeshtër, muzicentë, policë, teknologë ushqimi dhe sociologë 0.61%.

Në Komunën e Lipjanit nga 114 të anketuar, 1 nuk e ka deklaruar profesionin, 43 apo 35.08% janë studentë, 7 apo 6.14% janë nxënës, 8 apo 7.01% janë pensionerë dhe 12 apo 10.52% janë të papunë.

Tabela 9. Profesionet në Komunën e Lipjanit

Profesionet	Lipjan
Programerë	2
Fotografë	2
Ekonomistë	6
Infermiere	2
Sociolog	1
Udhëheqës	1
Anëtarë të OJQ-së	4
Punëtorë	2
Berber	1
Arkatare	1
Gazetare	2
Mjeshtër	1
Shitës	1
Refer	1
Matematikan	1
Filozof	1
Sekretarë	2
Rrobaqepës	1
Montazher	1
Shankist	1
Teknik	1
Inxhinier	1
Mësimdhënës	1
Jurist	1

Depoist	1
Tregtarë	2
Terapeute	1

Profesionet në Komunën e Lipjanit janë: programerë 1.75%, fotografë 1.75%, ekonomistë 5.26%, infermiere 1.75%, anëtarë të OJQ-së 3.50%, punëtorë 1.75%, gazetarë 1.75%, sekretarë 1.75%, tregtarë 1.75%, sociologë, udhëheqës, berberë, arkatarë, mjeshtër, shitës, referë, matematikanë, filozofë, udhëheqës, montazherë, shankistë, teknikë, inxhinierë, mësimdhënës, juristë, depoistë dhe terapeute 0.87%.

Në Novobërdë, nga dy të anketuar, njëri subjekt është nxënës, kurse tjetri roje.

Në Komunën e Obiliqit, nga 20 të anketuar, 1 është nxënës, 2 janë studentë dhe 1 nuk e ka deklaruar profesionin.

Tabela 10. Profesionet në Komunën e Obiliqit

Profesionet	Obiliq
Ekonomistë	2
Drejtor	1
Shitës	2
Jurist	1
Tregtar	1
Punëtor	1
Xehetarë	2
Agjent	1
Polic	1
Inxhinier	1
Teknikë	3

Profesionet që dalin në Komunën e Obiliqit janë: ekonomistë 10%, shitës 10%, xehetarë 10%, teknikë 15%, drejtorë, juristë, tregtarë, punëtorë, agjentë, policë dhe inxhinierë 5%.

Nga 125 të anketuar në Komunën e Rahovecit, 35 apo 28% janë të papunë, 10 apo 8% janë studentë, 32 apo 25.6% janë nxënës, 8 apo 6.4% janë të pensionuar dhe 3 apo 2.4% nuk e kanë deklaruar profesionin e tyre.

Tabela 11. Profesionet në Komunën e Rahovecit

Profesionet	Rahovec
Bujq	6
Mjeshtër	2
Infermiere	6
Ekonomistë	6
Shofer	1
Zyrtar	1
Rojtar	1
Punëtorë	3
Profesorë	3
Shitës	3
Berber	1
Mësues	1
Tregtar	1
Pastrues	1
Arkitekt	1

Në Komunën e Rahovecit dalin këto profesione: infermiere 4.8%, ekonomistë 4.8%, bujq 4.8%, punëtorë 2.4%, profesorë 2.4%, shitës 2.4%, mjeshtër 1.6%, shoferë, zyrtarë, rojtarë, berberë, mësues, tregtarë, pastrues dhe arkitektë 0.8%.

Në Komunën e Pejës, nga 131 të anketuar, 14 apo 10.68% janë të papunë, 14 apo 10.68% janë të pensionuar, 5 apo 3.18% nuk e kanë deklaruar profesionin e tyre, 4 apo 3.05% janë studentë dhe 1 është nxënës.

Tabela 12. Profesionet në Komunën e Pejës

Profesionet	Pejë
Biolog	1
Bujq	6
Ekonomistë	7
Fermer	1
Berberë	2
Hoxhë	1
Inxhinierë (i bujqësisë, i makinerisë, i pylltarisë)	5
IT	1
Juristë	5
Kamarierë	2
Këpucarë	3
Mirëmbajtës	1
Mjeshtër	1
Muzicent	1
Mësimdhënës	14
Polic	1
Punëtorë	14
Rrobaqepëse	3
Teknik (i bujqësisë, lëkurëtari, i farmacisë i radiologjisë)	6
Trajneri i vojelbollit	1
Veterinar	1
Tregtarë	4
Shofer	1
Shitës	2
Këngëtar	1
Infermierë	3
Arxhendar	1
Agjent	1
Sportist	1

Mekanik	1
---------	---

Në Komunën e Pejës dalin këto profesione: mësimdhënës 10.68%, punëtorë 10.68%, ekonomistë 5.34%, teknikë 4.58%, bujq 4.58%, inxhinierë 3.81%, juristë 3.81%, tregtarë 3.05%, këpucarë 2.29%, rrobaqepëse 2.29%, infermierë 2.29%, berberë 1.52%, kamarierë 1.52%, shitës 1.52%, biologë, fermerë, hoxhë, IT, mirëmbajtës, mjeshtër, muzicentë, policë, trajnerë, veterinarë, shoferë, këngëtarë, arxhendarë, agjentë, sportistë dhe mekanikë 0.76%.

Në Komunën e Podujevës, nga 133 të anketuar, 9 apo 6.76% janë të papunë, 22 apo 16.54% janë të pensionuar, 14 apo 10.52% janë studentë, 15 apo 11.27% nuk e kanë deklaruar profesionin dhe 5 apo 3.75% janë nxënës.

Tabela 13. Profesionet në Komunën e Podujevës

Profesionet	Podujevë
Ekonomist	1
Bujq	2
Juristë	4
Teknikë	3
Shitës	15
Rrobaqepës	3
Mësimdhënës	11
Kamarierë	3
Punëtorë	15
Farmacist	1
Shoferë	5
Agjentë	3
Veteran	1
Kujdestare e fëmijëve	1

Në Komunën e Podujevës dalin këto profesione: shitës 11.27%, punëtorë 11.27%, mësimdhënës 8.27%, shoferë 3.75%, juristë 3.00%, teknikë 2.25%, rrobaqepës 2.25%, kamarierë

2.25%, agjentë 2.25%, bujq 1.50%, ekonomistë, farmacistë, veteranë dhe kujdestare fëmijësh 0.75%.

Në Komunën e Prishtinës, nga 122 të anketuar, 3 apo 2.45% janë të papunë, 38 apo 31.14% nuk e kanë deklaruar profesionin, 28 apo 22.95% janë studentë dhe 3 apo 2.45% janë nxënës.

Tabela 14. Profesionet në Komunën e Prishtinës

Profesionet	Prishtinë
Kimiste	1
Pedagog	1
Ekonomistë	4
Sociologe	1
Fermer	1
Inxhinier	1
Psikologe	2
Juristë	5
Doktor	1
Filozofe	1
Gjeografe	1
Mjeshtër	1
Drejtoreshë e shkollës	2
Mësimdhënës	10
Punëtor	1
IT	1
Teknik	1
Zyrtarë	2
Rrobaqepëse	1
Arkitekthe	1
Shitës	4
Redaktore	1
Infermiere	2

Piktore	1
Politologe	1
Kuzhinierë	1
Volejbollist	1
Bibliotekist	1

Profesionet që dalin në Komunën e Prishtinës janë: zyrtarë 1.63%, mësimdhënës 8.19%, shitës 3.27%, ekonomistë 8.19%, drejtorë 1.63%, juristë 4.09%, psikologë 1.63%, infermierë 1.63%, bibliotekistë, kimistë, fermerë, teknikë, kuzhinierë, redaktorë, pedagogë, inxhinierë, gjeografë, filozofë, piktorë, volejbollistë, IT, politologë, sociologë, punëtorë, arkitektë, rrobaqepës dhe doktorë 0.81%.

Nga 35 të anketuar në Komunën e Prizrenit, 3 apo 8.57% janë të papunë, 12 apo 34% janë të pensionuar, 5 apo 14.28% janë studentë, 4 apo 11.42% janë nxënës dhe 1 nuk e ka deklaruar profesionin e tij.

Tabela 15. Profesionet në Komunën e Prizrenit

Profesionet	Prizren
Infermier	1
Jurist	1
Fotograf	1
Mësimdhënës	3
Shitës	1
Murator	1
Furrtarë	2

Profesionet që dalin në Komunën e Prizrenit janë: mësimdhënës 8.57%, furrtarë 5.71%, infermierë, juristë, fotografë, shitës dhe muratorë 2,85%.

Nga 22 të anketuar në Komunën e Skënderajt, 2 apo 9.09% janë të papunë, 2 apo 9.09% janë të pensionuar, 2 apo 9.09% nuk e kanë deklaruar profesionin e tyre dhe 1 është student.

Tabela 16. Profesionet në Komunën e Skënderajt

Profesionet	Skënderaj
Tregtar	1
Mësimdhënës	3
Ekonomist	1
Teknik	1
Punëtorë	4
Pedagog	1
Sociolog	1
Juristë	2
Drejtor	1

Në Komunën e Skënderajt dalin këto profesione: punëtorë 18.18%, mësimdhënës 13.63%, juristë 9.09%, tregtarë, ekonomistë, teknikë, pedagogë, sociologë dhe drejtorë 4.54%.

Nga 93 të anketuar në Komunën e Shtimes, 16 apo 17.20% janë të papunë, 18 apo 19.35% janë studentë, 1 është i pensionuar, 2 apo 2.15% janë nxënës dhe 2 apo 2.15% nuk e kanë deklaruar profesionin.

Tabela 17. Profesionet në Komunën e Shtimes

Profesionet	Shtime
Ekonomistë	5
Bujq	2
Hoxhë	1
Teknik i radiologjisë	1
Zyrtarë e informimit	1
Shitës	9
Rrobaqepës	1
Mësimdhënës	9
Punëtorë	17

Infermiere	1
Agjent	1
Modele	1
Berber	1
Arkitekt	1
Elektracist	1

Në Komunën e Shtimes dalin këto profesione: punëtorë 18.27%, mësimdhënës 9.67%, shitës 9.67%, ekonomistë 5.37%, bujq 2.15%, hoxhë, teknikë të radiologjisë, zyrtarë, rrobaqepës, infermierë, agjentë, modele, berberë, arkitektë, elektrikistë 1.07%.

Nga 21 të anketuar në Komunën e Shtërpçës, 14 apo 66.66% janë të papunë, 2 apo 9.52% janë nxënës dhe 1 është student. Profesionet që dalin në Komunën e Shtërpçës janë: punëtorë 2 apo 9.52%, veteranë 1 apo 4.76% dhe shitës 1 apo 4.76%.

Nga 29 të anketuar në Komunën e Suharekës, 4 apo 13.79% janë të papunë, 6 apo 20.68% janë të pensionuar, 5 apo 17.24% janë studentë, 2 apo 6.89% janë nxënës dhe 3 apo 10.34% nuk e kanë deklaruar profesionin e tyre.

Tabela 18. Profesionet në Komunën e Suharekës

Profesionet	Suharekë
Ekonomistë	2
Mësimdhënës	3
Punëtor	1
Zjarrfikës	1

Profesionet që dalin në këtë komunë janë: mësimdhënës 10.34%, ekonomistë 6.89%, punëtorë dhe zjarrfikës 3.44%.

Nga 117 të anketuar në Komunën e Ferizajt, 5 apo 5.27% nuk e kanë deklaruar profesionin, 7 apo 5.98% janë të pensionuar, 29 apo 24.78% janë të papunë, 4 apo 3.41% janë nxënës dhe 11 apo 9.40% janë studentë.

Tabela 19. Profesionet në Komunën e Ferizajt

Profesionet	Ferizaj
Arxhendar	1
Biolog	1
Bujq	4
Ekonomistë	6
Berberë	2
Gazetar	1
Historianë	2
Inspektor	1
Instruktur	1
IT	1
Jurist	1
Kamarier	1
Kuzhinierë	2
Mekanik	1
Menaxherë	4
Mirëmbajtës	2
Mësimdhënës	5
Polic	1
Punëtorë	5
Rrobaqepëse	1
Shitës	7
Taksistë	2
Tregtarë	8
Zyrtar	1

Profesionet që dalin në këtë komunë janë: tregtarë 6.83%, shitës 5.98%, ekonomistë 5.12%, mësimdhënës dhe punëtorë 4.27%, menaxherë dhe bujq 3.41%, berberë, kuzhinierë,

historianë, mirëmbajtës, taksistë 1.70%, policë, biologë, kamarierë, IT, juristë, inspektorë, zyrtarë, rrobaqepës, gazetarë, instruktorë, arxhendarë dhe mekanikë 0.85%.

Nga 9 të anketuar në Komunën e Vitisë, 3 apo 33.33% janë studentë, 2 apo 22.22% janë nxënës dhe 2 apo 22.22 janë të papunë. Në këtë komunë një i anketuar është ekonomist dhe tjetri polic.

Nga 24 të anketuar në Komunën e Vushtrrisë, 2 apo 8.33% janë të papunë, 7 apo 29.16% janë studentë dhe 7 apo 29.16% nuk e kanë deklaruar profesionin e tyre.

Tabela 20. Profesionet në Komunën e Vushtrrisë

Profesionet	Vushtrri
Ekonomist	1
Mësimdhënës	2
Gazetare	1
Zyrtar ligjor	1
Gjeograf	1
Zdrukhëtar	1
Polic	1

Profesionet që dalin në këtë komunë janë: mësimdhënës 8.33%, ekonomistë, gazetarë, zyrtarë ligjorë, gjeografë, zdrukhëtarë dhe policë 4.16%.

Nga 113 të anketuar në Komunën e Malishevës, 52 apo 46.01% janë nxënës, 12 apo 10.61% janë studentë, 3 apo 2.65% janë të pensionuar dhe 1 është i papunë.

Tabela 21. Profesionet në Komunën e Malishevës

Profesionet	Malishevë
Ekonomist	1
Inxhinier	1
Mësimdhënës	10
Juristë	2

Bujq	21
Punëtorë	7

Në këtë komunë dalin këto profesione: bujq 18.58%, mësimdhënës 8.84%, juristë 1.76%, punëtorë 6.19%, ekonomistë dhe inxhinierë 0.88%.

Nga 7 të anketuar në Komunën e Junikut 1 subjekt nuk e ka deklaruar profesionin.

Tabela 22. Profesionet në Komunën e Junikut

Profesionet	Junik
Kimist	1
Teknik i dhëmbëve	1
Tregtar	1
Jurist	1
Shitës	1
Mësues	1

Në këtë komunë dalin këto profesione: kimist, teknik i dhëmbëve, tregtar, jurist, shitës dhe mësues.

Nga 24 të anketuar në Han të Elezit, 1 subjekt nuk e ka deklaruar profesionin, 1 është student, 2 apo 8.33% janë të pensionuar dhe 2 apo 8.33% janë të papunë.

Tabela 23. Profesionet në Komunën e Hanit të Elezit

Profesionet	Han i Elezit
Ekonomist	1
Mësimdhënës	1
Rrobaqepës	1
Mekanikë	2
Bujq	2
Tregtarë	3

Punëtorë	6
Gjeograf	1
Shofer	1

Në këtë komunë dalin këto profesione: punëtorë 25%, mekanikë 8.33%, bujq 8.33%, tregtarë 12.5%, ekonomistë, mësimdhënës, rrobaqepës, gjeografë dhe shoferë 4.16%.

Nga 11 të anketuar në Komunën e Graçanicës, 1 është i papunë dhe 1 është student. Profesionet që dalin në këtë komunë janë: punëtorë 45.45%, bujq 9.09% dhe juristë 9.09%.

Në të gjitha komunat e Kosovës dalin këto profesione: mësimdhënës, drejtorë/menaxherë, tregtarë, bujq, infermierë, ekonomistë, punëtorë krahu, zyrtarë administrate, hidraulikë, arkatarë, teknikë, inxhinierë, etnologë, dizajnerë, juristë, poetë, elektrikistë, fermerë, blegtorë, kamarierë, mirëmbajtës, muzikantë, shoferë, shitës, neurologë, agjentë thirrjesh, futbollistë, rrobaqepës, kuzhinierë, stomatologë, pediatër, mekanikë, IT, biokimistë, agronomë, zdrukthëtarë, zjarrfikës, trajnerë, arkitektë, instruktorë, përkthyes, gjuhëtarë, biologë, gazetarë, gjeologë, historianë, veterinarë, policë, sociologë, minatorë, fizioterapistë, programerë, bibliotekistë, fotografë, matematikanë, sportistë, filozofë, sekretarë, profesorë, këpucarë, arxhendarë, farmacistë, kimistë, psikologë, gjeografë, redaktorë, piktorë, politikanë dhe furrtarë.

5.6. Gjuhët e dyta që fliten në Kosovë

Gjuhët e dyta që fliten nëpër komunat e Kosovës janë: anglishtja, gjermanishtja, serbishtja, kroatishtja, sllovenishtja, rusishtja, boshnjakishtja, maqedonishtja, polonishtja, bullgarishtja, turqishtja, frëngjishtja, arabishtja, spanjishtja, italishtja, suedishtja, latinishtja, holandishtja, norvegjishtja, rumunishtja, hungarishtja, gjuha rome dhe greqishtja.

Tabela e mëposhtme tregon numrin e intervistave në Kosovë dhe numrin e subjekteve që i flasin gjuhët e lartpërmendura:

Tabela 1. Gjuhët e dyta në Kosovë

Numri i intervistave në Kosovë	1800
Anglishtja	506
Serbishtja	374
Gjermanishtja	197
Turqishtja	72
Frëngjishtja	38
Bosnishtja	29
Maqedonishtja	16
Spanjishtja	12
Arabishtja	7
Sllovenishtja	6
Polonishtja	4
Rusishtja	4
Norvegjishtja	4
Suedishtja	4
Holandishtja	1
Romishtja	1
Danishtja	1
Rumanishtja	1
Hungarishtja	1
Greqishtja	2
Latinishtja	1

Në Kosovë, anglishten e flasin 506 të anketuar, serbishten 374 të anketuar, gjermanishten 197, turqishten 72, frëngjishten 38, bosnishten 29, maqedonishten 16, spanjishten 12, arabishten 7, sllovenishten 6, polonishten 4, rusishten 4, norvegjishten 4, suedishten 4, holandishten 1, romishten 1, danishten 1, hungarishten 1, rumanishten 1, greqishten 2 dhe latinishten 1.

5.6.1. Gjuha angleze si gjuhë e dytë

Kosova është një nga vendet ku anglishtja ka, deri diku, një status juridik dhe administrativ, në të cilin, sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe rregulloreve të UNMIK-ut, anglishtja ka status zyrtar si shqipja dhe serbishtja (Munishi, 2006, 2010).


Munishi (2015 :47) thekson se anglishtja ka ndikuar në mënyra të ndryshme në gjuhën shqipe në Kosovë dhe ka hyrë në mënyra të ndryshme, pas vitit 1999 ajo erdhi si gjuhë e misionit, së bashku me misionet ndërkombëtare, të cilat u krijuan pas përfundimit të luftës, si dhe përmes organizatave, programeve dhe projekteve të ndryshme, të cilat synonin të ndihmonin ngritjen dhe zhvillimin e institucioneve qeveritare. Më tej, Munishi (ibid.) shton se anëtarët e këtyre misioneve kanë përdorur anglishten si gjuhë misioni, si për komunikimin brenda misioneve, ashtu edhe për komunikimin me personelin shqiptar që punonte si personel vendas në kuadër të këtyre misioneve. Pra, kontakti mes shqipes dhe anglishtes nuk ishte vetëm një ndikim kulturor, por një ndikim i drejtpërdrejtë intim, si pjesë e komunikimit të përditshëm ndërmjet anëtarëve ndërkombëtarë dhe vendas të këtyre misioneve. Shqipfolësit, të angazhuar në programe dhe projekte me aktivitete të ndryshme të institucioneve ndërkombëtare në Kosovë, janë folës të plotë dygjuhësh, veçanërisht në fushën e punës, pasi kanë kontakte të përditshme me anglishtfolësit me të cilët komunikojnë vazhdimisht. Një pjesë e konsiderueshme e anglicizmave po futen në shqip si pjesë e proceseve të globalizimit, ndërkohë që media po shërben si mekanizmi kryesor për futjen e tyre.

Disa nga fushat ku anglishtja ka depërtuar në masë të madhe janë: teknologjia e informacionit, ekonomia, financa, politika, diplomacia, legjislacioni, kultura, sporti, kuzhina, moda etj (Munishi 2015: 47-56). Si gjuhë zyrtare sot në Republikën e Kosovës janë vetëm shqipja dhe serbishtja (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2440>).

Anglishtja është gjuha e dytë që flitet më së shumti në Kosovë. Nga 1800 të anketuar, 506 flasin anglisht. Gjuha angleze flitet në këto komuna: në Prishtinë nga 118 të anketuar, 50 e flasin gjuhën angleze, në Gjilan 75 nga 120 të anketuar, në Mitrovicë 13 të anketuar nga 163, në Drenas 5 të anketuar nga 18, në Istog 17 nga 25 të anketuar, në Kaçanik 14 nga 47 të anketuar, në Klinë 3 nga 10 të anketuar, në Kamenicë 1 nga 2 të anketuar, në Novobërdë 2 nga 2 të anketuar, në Podujevë 41 nga 133 të anketuar, në Skënderaj 8 nga 22 të anketuar, në Shtime 28 nga 93, në Shtërpçë 6 nga 21 të anketuar, në Suharekë 6 nga 29 të anketuar, në Viti 5 nga 8 të anketuar, në

Malishevë 5 nga 113 të anketuar, në Pejë 21 nga 131 të anketuar, në Gjakovë 16 nga 113 të anketuar, në Prizren 6 nga 35 të anketuar, në Ferizaj 24 nga 117 të anketuar, në Fushë Kosovë 3 nga 20 të anketuar, në Vushtrri 11 nga 28 të anketuar, në Han të Elezit 6 nga 24 të anketuar, në Graçanicë 3 nga 11 të anketuar, në Junik 1 nga 7 të anketuar dhe në Deçan 48 nga 114 të anketuar.

Tabela 2. Anglishtja si gjuhë e dytë



Anglishtja si gjuhë e dytë flitet më së shumti në Mitrovicë, në Gjilan, në Prishtinë, në Podujevë, në Deçan, në Pejë, në Ferizaj dhe në Shtime. Në Gjilan anglishtja flitet nga 72 të anketuar nga grupmosha e re dhe 3 nga grupmosha e mesme. Në Mitrovicë flitet nga 87 të anketuar të grupmoshës së re dhe 23 të grupmoshës së mesme. Në Podujevë flitet nga 39 të anketuar nga grupmosha e re dhe 2 nga grupmosha e vjetër. Në Prishtinë anglishtja flitet nga 32 të anketuar të grupmoshës së re, nga 6 të grupmoshës së mesme dhe nga 3 të grupmoshës së vjetër. Pra, anglishtja flitet më së shumti nga grupmosha e re, 18-39 vjeç. Ka shumë arsye pse anglishtja flitet gjerësisht në Kosovë, veçanërisht nga grupmoshat e reja. Së pari, fëmijët në shkollën fillore dhe të mesme e kanë lëndë obligative anglishten, si dhe në universitet anglishtja është një nga provimet e obligueshme në çdo drejtim. Në Kosovë, ekzistojnë shkolla fillore dhe të mesme ku mësimi zhvillohet në gjuhën angleze. Studentët gjithashtu mund të zgjedhin ta studiojnë anglishten në Universitetin e Prishtinës dhe në Universitetin e Prizrenit. Pra, njohja e gjuhës angleze është një përparësi e madhe për punësim në Kosovë.

5.6.2. Gjuha serbe si gjuhë e dytë


Munishi ka shkruar (2016) për dygjuhësinë shqip-serbisht dhe për problemet e zbatimit të dygjuhësisë në Kosovë. Ai për statusin e shqiptarëve dhe të serbëve në Kosovë pas vitit 1974 thekson se:

